



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 225

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 30 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 818, datë 26.12.2024	Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025..... 26647
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 821, datë 26.12.2024	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe të organeve që funksionojnë pranë saj” 26714
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 26.12.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar..... 26720
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 827, datë 26.12.2024	Për miratimin e buxhetit për Agjencinë e Zhvillimit të Territorit për vitin 2025..... 26722
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 839, datë 26.12.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ruga Berat–Ballaban” 26722
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 843, datë 26.12.2024	Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare..... 26726
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 26.12.2024	Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare 26729
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 850, datë 26.12.2024	Për deklarimin “Pasuri kulturore” të zonave arkeologjike nënujore “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit, miratimin e zonifikimit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre..... 26731

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 855, datë 26.12.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar.....	26736
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 26.12.2024	Për përcaktimin e dokumentacionit për përfundimin e procesit të privatizimit, mënyrën e përlogaritjes së vlerës së pagesës së mbetur dhe afatet e pagesës së privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore.....	26750
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale kundër Korrupsionit 2024–2030, planit të veprimit 2024–2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës.....	26751
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 279, datë 30.12.2024	Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025–2027.....	26845
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 288, datë 23.12.2024	Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022.....	26847
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 298, datë 30.12.2024	Mbi lënien në fuqi të vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022 dhe nr. 72, datë 15.4.2024.....	26849
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 299, datë 30.12.2024	Mbi miratimin e listës së tarifave të ALPEX-it për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë dhe Tregut të Ditës në Avancë.....	26851

**VENDIM****Nr. 818, datë 26.12.2024**

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË
PËRGJITHSHËM ANALITIK
TË PROJEKTAKTEVE QË DO TË
PARAQITEN PËR SHQYRTIM
NË KËSHILLIN E MINISTRAVE GJATË
VITIT 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2025										
Kryeministri - Zv.Kryeministri										
Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Cështjet kryesore që parashikohen të rregullojnë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i parë	Arsyeja e propozimit të këtij Projektakti lidhet me faktin që me hyrjen në fuqi të ligjit të ri "Për Burimet Ujore", Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ka përgjegjësi të reja dhe rrjedhimisht lind nevoja për riorganizimin e saj në këtë funksion.	Projektvendimi synon të përcaktojë qartësisht detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore	jo	Integrimi Evropian, Mjedis	Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2029	po
2	Për përbërjen dhe kufijtë territorialë e hidrografikë të rajoneve të baseneve lumorë e trupave të tjerë ujorë, përbërjen e Këshillave të Baseneve lumorë dhe për elementet e informacionit për autoritetet kompetente	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i dytë	Arsyet kryesore të propozimit të projektaktit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi, dhe përcaktimin e kufijve territorialë dhe hidrografikë i në përpudhje me ligjin e ri të burimeve ujore, gjithashtu do të përcaktoje përbërjen e Këshillave të Baseneve Lumorë si një nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, si dhe elementet e nevojshëm të informacionit që do të duhet të publikohet për secilin prej autoriteve kompetente, në përputhje me legjislacionin Evropian	Projektakti parashikon përcaktimin e kufijve territorialë dhe hidrografikë i në përpudhje me ligjin e ri të burimeve ujore, gjithashtu do të përcaktoje përbërjen e Këshillave të Baseneve Lumorë si një nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, si dhe elementet e nevojshëm të informacionit që do të duhet të publikohet për secilin prej autoriteve kompetente.	po (Kapitulli 27)	Integrimi Evropian, Mjedis	SKZHI 2022-2030, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2030	jo
3	Për analizën e karakteristikave, përcaktimin e elementëve të cilësisë të trupave ujorë sipërfaqësorë, klasifikimin e tyre dhe vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i tretë	Arsyet kryesore të propozimit të projektaktit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe përcaktimin e specifikimeve teknike për kryerjen e analizës së karakteristikave të rajoneve të BL-së, vlerësimin e ndikimit të veprimtarive njerëzore në statusin e trupave ujorë sipërfaqësorë, analizën ekonomike të përdorimit të ujit, në veçanti, në përputhje me legjislacionin Evropian.	Projektakti përcakton kërkesat për kryerjen e analizës së karakteristikave dhe vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore, përcaktimin e elementëve të cilësisë dhe klasifikimin e statusit ekologjik trupave ujorë sipërfaqësorë, të cilësisë ekologjike shumë të mirë, të mirë dhe mesatare të ujërave sipërfaqësorë, kriteret e potencialit ekologjik shumë të mirë, të mirë dhe mesatar të një trupi ujor tepër të modifikuar ose artificial si dhe procedurën e përcaktimit të standardeve të cilësisë kimike	po (Kapitulli 27)	Integrimi Evropian, Mjedis	SKZHI 2022-2030, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2031	jo
4	Për miratimin e rregullores së monitorimit dhe vlerësimit të statusit të ujërave	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i tretë	Arsyet kryesore të propozimit të projektaktit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe përcaktimin e kërkesave për monitorimin e statusit ekologjik dhe kimik të ujërave sipërfaqësore, kërkesat shtesë të	Projektvendimi do të përcaktojë rregullimin e detajuar të të gjitha aspekteve që lidhen me monitorimin e statusit të ujërave sipërfaqësore dhe zonave të mbrojtura, si dhe specifikimet teknike për analizën kimike dhe monitorimin.	po (Kapitulli 27)	Integrimi Evropian, Mjedis	SKZHI 2022-2030, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2032	po



					monitorimit për zonat e mbrojtura dhe klasifikimin e paraqitjen e statusit ekologjik, në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian.					
5	Për miratimin e specifikimeve teknike për kryerjen e analizës dhe vlerësimin, monitorimin e statusit sasior dhe kimik, standardet e cilësisë si dhe procedurën për vlerësimin e statusit kimik të ujërave nëntokësorë	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i tretë	Arsyet kryesore të propozimit të projektaktit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe përcaktimin e kërkesave për mbrojtjen e ujërave nëntokësorë nga ndotja dhe përkeqësimi në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian.	Projektvendimi synon përcaktimin e specifikimeve teknike për kryerjen e analizës dhe vlerësimeve lidhur me karakteristikat e rajoneve të baseneve lumore, vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor, ndryshimeve në nivelin e trupave ujorë nëntokësorë, si dhe vlerësimin e ndikimit të ndotjes në to; përcaktimin e specifikimeve teknike për kryerjen e monitorimeve të statusit sasior dhe kimik të këtyre ujërave; përcaktimin e standardeve të cilësisë për këto ujëra si dhe procedurën për vlerësimin e statusit kimik të tyre.	po (Kapitulli 27)	Integrimi Evropian, Mjedisi	SKZHI 2022-2030, Strategia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2033	po
6	Per miratimin e listës së substancave, standardeve të cilësisë mjedisore të tyre dhe listën kombëtare të vëzhgimit	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i tretë	Arsyet kryesore të propozimit të projektaktit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe përcaktimin e standardeve të cilësisë mjedisore në fushën e politikave për burimet ujore në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian	Projektvendimi synon përcaktimin e listës së substancave prioriteteve dhe substancave të rrezikshme prioritare, përcaktimin e listës së standardeve të cilësisë mjedisore për substancat prioritare dhe substancat e rrezikshme prioritare, përcaktimin e kërkesave për zbatimin e standardeve të cilësisë mjedisore; përcaktimi i standardeve të cilësisë mjedisore për dioksinat, PTB-të dhe substancat e ngjashme me dioksinat në artikujt ushqimorë; e listës së substancave prioritare për të cilat duhet të arrihet standardi i cilësisë mjedisore, si një element i statusit të mirë kimik të ujërave sipërfaqësore; e listës së substancave prioritare që prirën të akumulohen në sediment dhe në biotë, si dhe përcaktimin e listës komëtare të vëzhgimit.	po (Kapitulli 27)	Integrimi Evropian, Mjedisi	SKZHI 2022-2030, Strategia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2034	jo
7	Për miratimin e listës së substancave ndotëse, si dhe vlerave kufi të emetimeve të ujërave të ndotura nga burimet industriale	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i dytë	Arsyet kryesore të propozimit të projektaktit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe përcaktimin e vlerave kufi të emetimeve për ujërat e ndotura nga burimet industriale, në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian.	Projektvendimi synon përcaktimin e listës së substancave ndotëse, të kushteve dhe kërkesave të veçanta për impiantet e incenerimit dhe bashkincenerimit të mbetjeve; përcaktimin e kushteve dhe kërkesave të veçanta për instalimet dhe veprimtaritë që përdorin tretës organikë, të cilat synojnë mbajtjen nën kontroll të emetimeve aksidentale,	po (Kapitulli 27)	Integrimi Evropian, Mjedisi	SKZHI 2022-2030, Strategia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2035	jo



						përcaktimi i kushteve dhe kërkesave të veçanta lidhur me instalimet që prodhojnë dioksid titani, përcaktimin e kriterëve për identifikimin e teknikave më të mira të disponueshme lidhur me burimet ujore.				
8	Për miratimin e planit të menaxhimit të riskut nga përmbytjet, për basenin lumor Ishëm	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i tretë	Arsyet kryesore të propozimit të pjojektaktit lidhen me Plotësimin, përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e burimeve ujore në përgjithësi dhe menaxhimin e riskut nga përmbytjet në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian dhe reduktimi i pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, në Basenin Lumor respektiv.	Projektvendimi është në vijim të akteve nënligjore që synojnë të plotësojnë dhe përmirësojnë kuadrin ligjor për menaxhimin e burimeve ujore në përgjithësi dhe menaxhimin e riskut nga përmbytjet në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian. Zbatimi i planit të masave dhe rekomandimeve të Planit të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet do të ndikojnë në uljen e rrezikut dhe risqeve që vijnë nga përmbytjet në territorin e basenit lumor Ishëm si dhe do të arrijnë objektivat me qëllim reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik.	po (Kapitulli 27)	Integrimi Evropian, Mjedisi	SKZHI 2022-2030, Strategia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2036	po
9	Për miratimin e planit të menaxhimit të riskut nga përmbytjet, për basenin lumor Shkumbin	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i tretë	Arsyet kryesore të propozimit të pjojektaktit lidhen me Plotësimin, përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e burimeve ujore në përgjithësi dhe menaxhimin e riskut nga përmbytjet në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian dhe reduktimi i pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, në Basenin Lumor respektiv.	Projektvendimi është në vijim të akteve nënligjore që synojnë të plotësojnë dhe përmirësojnë kuadrin ligjor për menaxhimin e burimeve ujore në përgjithësi dhe menaxhimin e riskut nga përmbytjet në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian. Zbatimi i planit të masave dhe rekomandimeve të Planit të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet do të ndikojnë në uljen e rrezikut dhe risqeve që vijnë nga përmbytjet në territorin e basenit lumor Shkumbin si dhe do të arrijnë objektivat me qëllim reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik.	po (Kapitulli 27)	Integrimi Evropian, Mjedisi	SKZHI 2022-2030, Strategia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2037	po
10	Për miratimin e planit të menaxhimit të riskut nga përmbytjet, për basenin lumor Erzen	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i tretë	Arsyet kryesore të propozimit të pjojektaktit lidhen me Plotësimin, përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e burimeve ujore në përgjithësi dhe menaxhimin e riskut nga përmbytjet në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian dhe reduktimi i pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik.	Projektvendimi është në vijim të akteve nënligjore që synojnë të plotësojnë dhe përmirësojnë kuadrin ligjor për menaxhimin e burimeve ujore në përgjithësi dhe menaxhimin e riskut nga përmbytjet në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian. Zbatimi i planit të	po (Kapitulli 27)	Integrimi Evropian, Mjedisi	SKZHI 2022-2030, Strategia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2038	po



					kulturore dhe aktivitetin ekonomik, në Basenin Lumor respektiv.	masave dhe rekomandimeve të Planit të Menaxhimit të Riskut nga Përmbajtjet do të ndikojnë në uljen e rrezikut dhe risqeve që vijnë nga përmbajtjet në territorin e basenit lumor Erzen si dhe do të arrijnë objektivat me qëllim reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbajtjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik.				
11	Për miratimin e planit të menaxhimit të riskut nga përmbajtjet, për basenin lumor Seman	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i tretë	Arsyet kryesore të propozimit të pjojektaktit lidhen me Plotësimin, përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e burimeve ujore në përgjithësi dhe menaxhimin e riskut nga përmbajtjet në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian dhe reduktimi i pasojave të mundshme negative nga përmbajtjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, në Basenin Lumor respektiv.	Projektvendimi është në vijim të akteve nënligjore që synojnë të plotësojnë dhe përmirësojnë kuadrin ligjor për menaxhimin e burimeve ujore në përgjithësi dhe menaxhimin e riskut nga përmbajtjet në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian. Zbatimi i planit të masave dhe rekomandimeve të Planit të Menaxhimit të Riskut nga Përmbajtjet do të ndikojnë në uljen e rrezikut dhe risqeve që vijnë nga përmbajtjet në territorin e basenit lumor Seman si dhe do të arrijnë objektivat me qëllim reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbajtjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik.	po (Kapitulli 27)	Integrimi Evropian, Mjedis	SKZHI 2022-2030, Strategia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2039	po
12	Per miratimin e metodologjisë për hartimin e Strategjisë së mbrojtjes së Mjedisit detar të Republikës së Shqipërisë	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AMBU)	Katër mujori i tretë	Arsyet kryesore të propozimit të projektvendimit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe në zbatim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 15/2024 "Për Strategjinë e Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë", me synim përputhjen me legjislacionin Evropian.	Projektvendimi synon miratimin e metodologjisë për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë, në të cilën do të përfshihen: a) elementet që duhet të përmbajnë dy fazat që ndiqen për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë; b) lista treguese e elementeve të ekosistemit, të presioneve antropogjene dhe të veprimtarisë njerëzore në ujërat detare; c) elementet që duhet të përmbajnë informacioni për autoritetet kompetente; d) lista treguese e karakteristikave që do të merren parasysh gjatë përcaktimit të objektivave mjedisorë për nënrajonet detare në Republikën e Shqipërisë; h) elementet që duhet të përmbajnë programet e monitorimit; e)	po (Kapitulli 27)	Integrimi Evropian, Mjedis	SKZHI 2022-2030, Strategia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2041	jo



						elementet që duhet të përmbajnë programet e masave.				
13	Për mbikëqyrjen, kryerjen e inspektimeve dhe trajnimeve, lidhur me sigurinë e informacionit të klasifikuar	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AKSIK)	Katër mujori i parë	Ligji 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar"	Projektvendimi i ka për qëllim përcaktimin e rregullave për mbikëqyrjen shtetërore, kryerjen e inspektimeve dhe trajnimeve në institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomik, në fushën e sigurisë së informacionit të klasifikuar	Jo	Jo	Jo	Jo
14	Per miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Plani të veprimit në zbatim të saj	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AKSK)	Katër mujori i parë	Akt nenligjor në zbatim të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike". Nevoja për të adresuar sfidat komplekse dhe të shpejta në fushën e sigurisë kibernetike. Krijimi i një kornize ligjore të qartë lidhur me politikën e sigurisë kibernetike, krijimin e një qasje të unifikuar dhe të qendrueshme në nivel kombëtar, përmirësimin e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjen nga kërcënimet kibernetike, forcimi i përgjegjësisë dhe transparencës, ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për reagimin ndaj incidentëve kibernetikë, ndergjegjësimi dhe edukimi etje	Strategjia do të përcaktojë politikën dhe objektivat specifike në kuadër të sigurisë kibernetike, duke përfshirë mbrojtjen e infrastrukturave të informacionit, ndergjegjësimin, bashkëpunimin midis sektorit publik dhe atij privat, krijimin e një mjedisi të sigurit online, përcatimin e aktiviteteve konkrete për secilin politik dhe institucionet perkatese etj.	Jo	Jo	Jo	Financiare sociale
15	Për miratimin e procedurave për identifikimin, klasifikimin, përshkallëzimin dhe menaxhimin e krizës kibernetike	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AKSK)	Katër mujori i parë	Akt nenligjor në zbatim të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike". Nevoja për të patur një procedurë të përcaktuar për trajtimin dhe menaxhimin e krizës kibernetike e cila do të ndihmojë për reagimin në rastet kur kemi të bëjmë me gjendjen e krizës kibernetike	Përcaktimi dhe detajimi i procedurave lidhur me identifikimin, klasifikimin,përshkallëzimin dhe menaxhimin e krizës kibernetike.	Jo	Jo	Jo	Jo
16	Për ngritjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të CERT-it	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AKSK)	Katër mujori i parë	Akt nenligjor në zbatim të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike". Nevoja për të patur një strukturë e cila do të ndihmojë për rastet e menaxhimit të krizave kibernetike.	Përcaktimi I mënyrës së organizimit dhe funksionimit të CERT-it, si një strukturë e rëndësishme,ad hoc, në rastet e menaxhimit të krizave dhe emergjencave kibernetike	Jo	Jo	Jo	Jo
17	Për përcaktimin e mënyrës së ngritjes së CSIRT-eve sektoriale	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AKSK)	Katër mujori i dytë	Akt nenligjor në zbatim të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike". Përcaktimi I qartë I strukturave përgjegjëse me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në infrastrukturën e informacionit.	Ky akt do të përcaktojë mënyrën e ngritjes së CSIRT-eve sektoriale, sesi do të bëhet përcaktimi I tyre, psh cili do të jetë CSIRT-i sektorial për bakat etje	Jo	Jo	Jo	jo
18	Per identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara	Projektligji	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AKSK)	Katër mujori i tretë	1.Nevoja për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të besuara duke bërë të mundur një qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në shërbimet e ofruara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar, me qëllim garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë në përdorimin e shërbimeve të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara nga qytetarët, bizneset dhe administrata publike, për të hyrë në shërbimet online ose për të menaxhuar transaksionet elektronike në vend. 2. Plotesimi i mangësive dhe dhenia zgjidhje e problematikave që janë vënë në pah në këtë moment gjatë zbatimit të legjislacionit ekzistues për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara. 3.	Plotëson kuadrin ligjor në përputhje me legjislacionin e BE-së duke futur elementët e rinj të cilët do të kompletojnë kornizën ligjore në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara. Identifikimin elektronik në distancë (remote) i aplikuesit për pajisjen me mjete të identifikimit elektronik duke lehtësuar procesin e identifikimit elektronik si dhe duke shkurtuar distancë. Përcaktimin i kërkesave të sigurisë (teknike dhe organizative) që duhen ndërmarrë nga ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar	Po, kapitulli 10 "Shoqëria e Informacionit dhe Media"	PO. Referencë : Fusha: Shoqëria Digjitale, Angazhimi: Njohjen e nënshkrimit dhe vullës elektronike me vendet e rajonit.	Jo	Po, ndikime financiare, sociale



					Permbshja e detyrimit ne kuader te procesit te integritimit te RSH ne BE.	për menaxhimin e rreziqeve që prekin sigurinë dhe besueshmërinë e shërbimeve që ata ofrojnë. Forcimin e bashkëpunimit midis ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar dhe institucionet shtetërore private me qëllim autentifikimin e personave fizikë apo juridikë. Përcaktime lidhur me Portofolin e Digjital të Identitetit				
19	Për miratimin e skemes kombetare te certifikimit te sigurise kibernetike	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AKSK)	Katër mujori i tretë	Akt nenligjor në zbatim të ligjit nr.25/2024 "Per sigurine kibernetike". Rritja e nivelit te sigurise kibernetike ne vend mbetet nje nga sfidat kryesore. Krijimi i një skeme kombetare te certifikimit te sigurise kibernetike do te beje te mundur certifikimin e produkteve, sherbimeve, proceseve TIK, te cilat do te rrisin nivelin e sigurise kibernetike ne infrastrukturat e informacioni.	Percaktimi I elementeve perberes te skemes se cetifikimit te sigurise kibernetike, afatet per implementimin e saj, percaktime lidhur me certifikimin e produkteve, sherbimeve, proceseve TIK, percaktimi I niveleve te sigurise se skemes se certifikimit te sigruise kibernetike	Jo	Jo	Jo	Po financiare, sociale
20	Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen së çmimeve të tokës në RSH	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (ASHK)	Katër mujori i parë	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr.111/2018 " Për Kadastrën", neni 9, pika 2, germa k.	Përcakton metodologjinë e vlerësimit të pronave të paluajtshme(tokës) në RSH, në zbatim të nenit 9/2/k të ligjit nr.111/2018 " Për Kadastrën"	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun "Siguria e pronës" (faqe 36-37)	Jo	Po, ndikim ekonomik dhe social
21	"Për disa shtesa në udhëzimin nr.1 ,datë 17.07.2024 " Për miratimin e modelit dhe përcaktimin e rregullave të mbajtjes së regjistrit të lejes së ndërtimit, si dhe të procedurave të regjistrimit të kontratës së sipërmarrjes/porosisë dhe premtim shitjes"	Projekttudhëzim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (ASHK)	Katër mujori i parë	Ne funksion të përmirësimit të ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr.111/2018 "Për Kadastrën" neni 48,49 dhe 50 i tij	Përcakton rregullat që do të ndjek ASHK në rastet e regjistrimit të karabinasë në regjistrat regjistrin e karabinasë, dhe miratimin e modelin e këtij regjistri, në vijim të regjistrimit të objektit ne regjistrin e lejes se ndertimit zbatim të nenit 48, 49 dhe 50 të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën"	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun "Siguria e pronës" (faqe 36-37)	Jo	Jo, ka karakter teknik
22	Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (ASHK)	Katër mujori i tretë	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr.111/2018 " Për Kadastrën", neni 9, pika 2, germa k.	Përcaktojë hartën e vlerës së tokës në RSH (pasurive të paluajtshme truall, tokë bujqësore, pyll, livadh, kullote), në zbatim të nenit 9/2/k të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën"	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun "Siguria e pronës" (faqe 36-37)	Jo	Po, ndikim financiar dhe social
23	Për përcaktimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve elektronike për subjektet private	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AKSHI)	Katër mujori i dytë	Neni 52, pika 4, Ligj nr. 43/2023 "Për qeverisjen elektronike" të ndryshuar	1. Për ofrimin e shërbimeve elektronike nga subjektet private, AKSHI ngre platformën elektronike dhe mundëson pagesën elektronike në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet platformës së pagesave të ngritur nga AKSHI e të pavarur nga platformat elektronike të pagesave nga institucionet financiare. 2. Ofrimi i shërbimeve elektronike në platformë ofrohet si mënyrë alternative. 3. AKSHI aplikon tarifa për subjektet që zgjedhin ofrimin e	Jo	Fusha, Shoqeria Digjitale	Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022 – 2026, miratuar me VKM Nr. 370, datë 1.6.2022,	Po



						shërbimeve elektronike publike në platformë.				
24	Për përcaktimin e Autoritetit përgjegjës për mbledhjen e tarifave (<i>open data</i>), masën e këtyre tarifave dhe mënyrën e pagesës	Projektvendim	Kryeministri/Zv.Kryeministri (AKSHI)	Katër mujori i tretë	Neni 43, pika2, Ligj nr. 43/2023 "Për qeverisjen elektronike" të ndryshuar	Me qëllim krijimin e produkteve të reja të informacionit dhe shërbimeve, të cilat kanë si bazë informacionet dhe të dhënat që gjenden në portalin opendata.gov.al, si dhe për promovimin e zhvillimit të ekonomisë së të dhënave, autoritetet publike dhe AKSHI u ofrojnë personave fizikë dhe juridikë të drejtën e ripërdorimit të informacionit që prodhohet dhe mbahet nga autoritetet publike si pjesë e të dhënave të hapura.	Jo	Fusha, Shoqëria Digjitale	Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022 – 2026, miratuar me VKM Nr. 370, datë 1.6.2022,	Po
25	Për miratimin e listës së të dhënave dhe shërbimeve të Autoritetit shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor që do të tarifohet, si dhe masën e tarifës	Projektvendim	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (ASIG)	Katër mujori i parë	Detyrim ligjor i përcaktuar në Ligjin nr. 103/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastruktursë Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".	1-Përcaktimin e listës së të dhënave dhe shërbimeve që do të ofrohen kundrejt tarifave. 2-Masa e tarifës për çdo të dhënë dhe shërbim që do të tarifohet.	Jo	Fusha, Shoqëria Digjitale	Dokumenti I politikave "Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030", miratuar me VKM Nr. 402, datë 20.05.2020.	Jo
26	Për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Shumëvjeçar "Ekonomia dhe shoqëria digjitale 2024-2027", në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA III)"	Projektligj	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katër mujori I parë	Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfituese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përthithjes së fondeve të miratuara në këtë program.	Prioritetet tematike të programit, strukturat, autoritetet, palët, mënyrat e financimit të projekteve, alokimet dhe kushtet financiare të marrëveshjes	Jo	Modernizim për zhvillim Energjia Shoqëria digjitale Integrimi Europian	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian	Po
27	Për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Shumëvjeçar "Punesimi i rinise 2024-2027", në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA III)"	Projektligj	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katër mujori I parë	Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfituese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përthithjes së fondeve të miratuara në këtë program.	Prioritetet tematike të programit, strukturat, autoritetet, palët, mënyrat e financimit të projekteve, alokimet dhe kushtet financiare të marrëveshjes	Jo	Punesimi Integrimi Europian	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian	Po
28	Për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në	Projektligj	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katër mujori I parë	Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfituese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përthithjes së fondeve të miratuara në këtë program.	Prioritetet tematike të programit, strukturat, autoritetet, palët, mënyrat e financimit të projekteve, alokimet dhe kushtet financiare të marrëveshjes	Jo	Energjia Integrimi europian	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian	Po



	lidhje me Programin Shumëvjeçar "Per Energjine 2024-2027", në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA III)"									
29	Per miratimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2024, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA III)"	Projektvendim	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katër mujori i parë	Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfutuese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përfutjes së fondeve të miratuara në këtë program.	Prioritetet tematike të programit, strukturat, autoritetet, palët, mënyrat e financimit të projekteve, alokimet dhe kushtet financiare të marrëveshjes	Jo	Punesimi Lufta kunder korrupsionit Zhvillimi i bujqësisë Infrastruktura lokale Turizmi dhe mjedisi Integrimi European	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian	Po
30	Per miratimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2025, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA III)"	Projektvendim	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katër mujori i fundit	Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfutuese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përfutjes së fondeve të miratuara në këtë program.	Prioritetet tematike të programit, strukturat, autoritetet, palët, mënyrat e financimit të projekteve, alokimet dhe kushtet financiare të marrëveshjes	Jo	Drejtesia Te drejtat e njeriut Materialet e para kritike Integrimi europian	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian	Po
31	Për miratimin e Planit të Veprimit në zbatim të Politikës së Kohëzimit 2021-2027 në Shqipëri	Projektvendim	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katër mujori i Tretë	Perafrimi me <i>acquis</i> të BE-se	Miratimi i planit të veprimit do të adresojë masat e nevojshme dhe identifikimin e përgjegjëseve institucionale për realizimin në kohë të negociatave të anëtarësimit për Kapitullin 22	PO, Kapitulli 22	Integrimi Evropian, Mireqenie per te gjithë shtresat shoqerore te vendit (wellbeing for all)	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 / Shtylla e trete / Kohëzimi Social, Strategjia Kombëtare per Mbrojtjen Sociale 2024-2030	Jo
32	Për ngritjen e Komitetit Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial Evropian	Projektvendim	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katër mujori i parë	Perafrimi me <i>acquis</i> të BE-se	Miratimi i këtij vendimi do të rrisë pjesëmarrjen e entiteve shqiptare në rrjetet URBACT dhe INTERREG EUROPE si dhe angazhimin e aktorëve shqiptarë në Strategjinë e BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian . Komiteti Kombëtar do të ketë gjithashtu një rol konsultativ në programimin e programeve INTERREG pas vitit 2027, duke siguruar kështu qeverisjen në shumë nivele.	PO, Kapitulli 22	Integrimi Evropian, Mireqenie per te gjithë shtresat shoqerore te vendit (wellbeing for all)	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 / Shtylla e trete / Kohëzimi Social, Strategjia Kombëtare per Mbrojtjen Sociale 2024-2030	Jo
33	Për miratimin e Metodologjisë për zbatimin e Parimit të Partneritetit në përputhje	Projektvendim	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katër mujori i parë	Perafrimi me <i>acquis</i> të BE-se	Miratimi i Metodologjisë për krijimin e partneritetit të politikës së kohëzimit do të mundësojë linjëzimin me dispozitat rregullatore përkatëse.	PO, Kapitulli 22	Integrimi Evropian, Mireqenie per te gjithë shtresat shoqerore te	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 / Shtylla e trete	Jo



	me Kodin Evropian të Sjeljes për Partneritetin							vendit (wellbeing for all)	/ Kohezioni Social, Strategia Kombetare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030	
34	Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2026-2028" dhe Listes Unikë të Projekteve Strategjike të rendesise Kombetare (NSPP) si pjese integrale e Dokumentit	Projektvendim	Kryeministri- Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujori i dytë	Ngritja e këtij dokumenti qendror, planifikues dhe strategjik afat-mesem në nivelin e duhur të hierarkisë ligjore për të inicuar krijën e performancës së zbatimit si edhe në funksion të paraprirjes me të mirë të drejtimit të politikës së përgjithshme ndaj funksionit të financimit në përgjithësi. NSPP është parashikuar në VKM "Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike"	Ne teresi rrit harmonizimin e perparësive dhe politikave të qeverisë me kapacitetin financiar të saj në afatin e mesëm, ose orienon racionalisht procesin e shpërndarjes së burimeve midis sektoreve. Ndihmon në përcaktimin e taveve buxhetore afat-mesme për PBA si dhe rregullon procesin e konsiderimit të projekteve të reja (politika të reja) duke siguruar vazhdimësinë e projekteve ekzistuese dhe ruajtur ekuilibrin e bilancit të shtetit. Lista Unikë e Projekteve me Rëndësi Kombëtare përmban projektet e investimeve publike që kanë rëndësi strategjike për sa i përket zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, pavarësisht nga burimi i tyre i financimit. Kjo listë shërben si instrument për mbështetjen e politikave dhe prioritetëve të Qeverisë Shqiptare, në linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHIE), si edhe strategjitë sektoriale e ndërsektoriale. Lista Unikë e Projekteve me Rëndësi Kombëtare shërben si referencë për ministrinë përgjegjëse për financat dhe njësitë e qeverisë qëndrore, në kuadër të përfshirjes së projekteve të investimeve publike në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) apo Buxhetin Vjetor.	Tematika e SKZHIE III dhe lidhjes së saj me PBA. Ky projekt akt harmonizon përkrahjet politikat dhe reformat afatmesme të qeverisë me PBA duke përfshirë projektet kombetare NSPP nga buxheti i shtetit, fondet IPA dhe financimin tjetër të huaj. DPP lidhet me të gjithë kapitujt e integritit në teresi pavarësisht se raportohet tek kap. 22, pasi përfshin reformat afatmesme dhe afatgjata të qeverisë si dhe sektoret prioritare, NSPP prek shumë sektore të zhvillimit të vendit si vertikale ashtu edhe sektore horizontale. DPP lidhet konkretisht me clusters të integritit: Themeloret, Konkureshmeria, Agjenda e gjelber dhe nderlidhjet e qëndrueshme, burimet bujqësia dhe marrëdhëniet e jashtme. Raportohet formalisht në kuadër të Kapitullit 22. Politikat Rajonale (Kohezioni) dhe Kordinimi I Instrumentave Strukturore.	Rindertimi, Zhvillimi i bujqësisë dhe i fshatit, Infrastruktura, Turizmi dhe Mjedisi, Energjia, Një strategji e re për shëndetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, Kultura, Shoqëria dixhitale, Integrimi Evropian etj	Strategjia Kombetare e Arsimit 2021-2026, Strategjia Kombetare e Shëndetësisë 2021-2030, Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelktuale 2022 - 2025 - Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027 - Agjenda Digitale e Shqipërisë 2021+ - Dokumenti i Përgjigjes Strategjike IPA III 2021-2024 – Shqipëri (2021) - Prioritetet e Programit IPA 2021 & 2022, - Prioritetet e Programit IPARD III (Instrumenti për Asistencën e Para-Anetaresimit për Zhvillimin Rural) 2021 – 2027, - Procesi i Hartimit të draftit të Strategjisë Kombetare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030	Impakton ecurinë ekzistuese dhe ndryshimin në investimet e përgjithshme kapitale (publike) afat mesme, financimin e huaj (IPA dhe financime të tjera) dhe përmirësimin e politikave mbi bazën e evidencave (fakteve) duke prezantuar vazhdimisht nevojën për buxhetim të përgjithshëm të performancës (performance based budgeting) duke kontribuar në shpërndarjen e burimeve aty ku ka me shumë nevojë dhe ku jemi me efektive dhe eficient. Impakton në konvergimin e vazhdueshëm me pragmatik të politikës qeveritare afatmesme me objektivat e integritit dhe ato të zhvillimit të qëndrueshëm.
35	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Ekonomisë Blu 2024 - 2030	Projektvendim	Kryeministri- Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujori i dytë	Arsyeja kryesore është rregullimi ligjor i sektorit të marinave dhe potenciali I identifikuar për zhvillim dhe bashkëpunim ndërkombëtar që kanë	Rregullon Zhvillimin dhe transformimin e ekonomisë detare të Shqipërisë në një kontribues kryesor të krijës së	Jo specifikisht por lidhet ngushtësisht me kapitujt 13:	Faqe 23 e Programit.. "Objektiv Strategjik I	SKZHIE 2021-2030 : Agjenda e Konektivitetit (Shtylla nr 3):	Pozitive (impakte të përgjithshme)1. Rritja e ndër-konektivitetit (nderlidhjeve) 2. Rritja ekonomike (dhe e Punësimit), 3. Rritje e Energjisë së Rinovueshme, 4.



					sektori i detarisë, turizmit blu, peshkimit, ushqimeve te detit etj.	qëndrueshme duke rikthyer traditën e lundrimit dhe mbështetur zhvillimin e turizmit detar, peshkimit, atë sportive dhe argëtuese me mekanizma dhe mjete të pajtueshme me mjedisin në të gjithë bregdetin.	Peshkimi, 14: Politikat e Transportit, 19: Politika sociale dhe Punesimi, 22: Politikat e zhvillimit Rajonal, 27: Mjedi, 20: Politikat Industriale, 8: Politika e Konkurrences etj	Qeverise Shqiptare per zhvillimin e transportit detar.. Komplementimit me zona te zhvillimit ekonomik.. Akomodimin dhe shërbimet per mjetet lundruese turistike...	Ekonomia Blu, Str per Zhv e Turizmit 2019-2023 obj 2.3, 3.1, Str Sektoriale e Transportit 2021 (1.1 Sisteme efiente portuale dhe te marinave), SDG 8, SDG 14: Ruajtja dhe perdorimi I qendrushem I oqeaneve, deteve dhe burimeve te marinave)	Zhvillim I peshkimit (eksporteve nga 130 mln USD (2021 ne 200 mln USD ne 2030, KPI SKZHIE III), sigurise ushqimore dhe akuakultures, Negative (impakte te pergjithshme) 1. Mbi-peshkimi , 2. Degradimi i Habitatit, 3. Disbalanca ne tregti (pjesa detare me pjesen tokesore te nje vendi) 4. Zhvillimi ad hoc i paplanifikuar mire midis bregdetit dhe tokes, 5. Rritja e kostove te jeteses per komunitetin qe nuk perfshihet, ose per peshkataret e vegjel artizane etj..
36	Per miratimin e Udhërrëfyesit për OZHQ 2024-2030	Projektvendim	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujori i parë	Përmbushja e detyrimeve që ka Shqipëria për angazhimin e marrë në kuadër të Agjendës së OKB-së 2030, për zhvillim të qëndrueshëm	Vendosjen e një kuadri për matjen e treguesve për zhvillim të qëndrueshëm	Po, te gjithë kapitujt e Integritimit ne teresi. Udhërrëfyesi perfshin 17 objektivat e zhvillimi te qendrushem sipas Agjendes 2030. Ai lidhet me te 5 clusters te integritimit : Themeloret, Tregu I brendshem, Kokurueshmeria dhe rritja gjithëpërfshirëse, agjenda e gjelber dhe nderlidhjet e qendrushme dhe marredheniet e jashtme	Shëndeti dhe zhvillimi i qëndrueshëm, Mirëqënie për të gjithë, Infrastruktura, Energjia, Turizmi dhe Mjedi, Arsimi etj	SKZHIE 2022-2030, reformat, politika e jashtme, sektoret prioritare te zhvillimit te vendit, bujqesia, turizmi, digitalizimi, antikorupsioni, integrimi evropian dhe energjia	Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, e miratuar nga të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në 2015, ofron një plan të përbashkët për paqen dhe prosperitetin për njerëzit dhe planetin, tani dhe në të ardhmen. Në qendër të tij janë 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), të cilat janë një thirrje urgjente për veprim nga të gjitha vendet - të zhvilluara dhe në zhvillim - në një partneritet global. Ato pranojnë se dhënia fund e varfërisë dhe privimeve të tjera duhet të shkojë krah për krah me strategjitë që përmirësojnë shëndetin dhe arsimin, zvogëlojnë pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike – të gjitha duke trajtuar ndryshimet klimatike dhe duke punuar për të ruajtur oqeanet dhe pyjet tona.



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2025										
Ministri I Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin										
Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"	Projektligji	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin	Katër mujori i parë	Rregullime për disa parashikime të ligjit, për shkak të problematikave të vëna re gjatë zbatimit të tij, të evidentuara edhe në nga raportet e progresit të BE-së, si dhe në raportin screening të BE-së	Rregullimi i parimeve, si dhe mënyrës së krijimit, organizimit, funksionimit dhe tipologjisë së institucioneve të administratës shtetërore. Gjithashtu, në këtë ligj duhet të përcaktohet mekanizimi i mbikqyrjes së performancës së institucioneve të administratës shtetërore, si dhe raportimi në Këshillin e Ministrave në lidhje me zbatimin e ligjit.	Themelorët/PAR	N/A	VKM nr. 737, datë 13.12.2023, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023-2030"	Jo
2	Për planin vjetor të pranimit në institucionet e administratës shtetërore pjesë të shërbimit civil, për vitin 2025	Projektvendim	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin	Katër mujori i parë	Miratimi i planit për plotësimin e vendeve vakante në shërbimin civil në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të fushës së veprimit të këtij legjislacioni, për vitin 2025	1. Përcaktimi i numrit të përgjithshëm të vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2025, si dhe detajimi i këtij numri sipas kategorive të shërbimit civil; 2. Përcaktimi i grupeve të administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive për të cilat planifikohen vende vakante për rekrutim për vitin 2025; 3. Përcaktimi i institucioneve të administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante për rekrutim gjatë vitit 2025.	Jo	N/A	Jo	Jo
3	Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2025	Projektvendim	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin	Katër mujori i parë	Miratimi nga Këshilli i Ministrave i mundësisë që procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilët lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira	1. Përcaktimi për secilën kategori (të ulët apo të mesme drejtuese) i numrit të pozicioneve për të cilët do të përdoret procedura sipas këtij vendimi; 2. Përcaktimi në mënyrë nominative i pozicioneve në të cilat mund konkurojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil.	Jo	N/A	jo	po
4	Për miratimin e Strategjisë Ndërkushtetare të Reformës në Administratën Publike 2024-2030	Projektvendim	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin	Katër mujori i parë	Miratimi nga Këshilli i Ministrave i objektivave dhe aktiviteteve për reformimin e administratës publike në priudhën 2024-2030	Miratimi nga Këshilli i Ministrave i objektivave dhe aktiviteteve për reformimin e administratës publike në priudhën 2024-2030	Themelorët/PAR	N/A	Jo	Jo
5	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar	Projektligji	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin	Katër mujori i tretë	Rregullimi i disa parashikimeve të ligjit, për shkak të problematikave të vëna re gjatë zbatimit të tij, si dhe shtimi i disa parashikimeve të tjera të nevojshme në të, në funksion të qartësisë së institutëve të përcaktuara në ligj.	1. Rregullime në lidhje me kriteret e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil; 2. Rregullime në lidhje me afatin e pezullimit të nëpunësve civilë që zgjidhen si anëtarë të këshillave bashkiakë; 3. Rregullime në lidhje me masën e demshpërbërimit në rastin e lirimit të nëpunësit civil për shkak të rristurimit apo mbylljes së institucionit; 4. Rregullime në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë;	Themelorët/PAR	N/A	VKM nr. 737, datë 13.12.2023, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023-2030"	Po ndikime sociale



						5. Rregullime në lidhje me procesin e vlerësimit të punës së nëpunësve civilë; 6. Rregullime në lidhje me elementët e hapave të pagës; 7. Rregullime në lidhje me organizimin dhe funksionimin e ASPA-s.				
6	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 60/2016 "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve"	Projektligji	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin	Katër mujori i tretë	Direktiva 2019/1937 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 13 tetor 2019 për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të Unionit.	Qasja sektoriale kundrejt asaj horizontale, mbrojtja e sinjalizuesve, sinjalizuesit, shkelja e ligjit të Unionit, raportimi i rasteve të mundshme të korrupsionit, kanale të brendshme të raportimit, njësi sinjalizimi.	Themelorët/ Kap. 23	Jo	VKM nr. 736, datë 13.12.2023, "Për miratimin e Udhërrefyesit për Shtetin e së Drejtës"	Po ndikime sociale



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2025										
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT										
Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për një ndryshim/shtesë në vendimin nr. 104, datë 28.02.2019 “Për përcaktimin e kritereve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë?”	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i parë	Rregullon procedurat dhe përcakton institucionin që do të pajisë me certifikatë njohje të zhvillimit të mësimit të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, mësuesit që kanë zhvilluar mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, si dhe për nxënësit që kanë ndjekur mësimin gjuhës dhe kulturës shqiptare, pajisen nga Qendra e Botimeve të Diasporës me certifikatë	1. Pajisjen nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (ASCAP) të mësuesve që japin mësim në diasporë, me certifikatë që ju njeh angazhimin si mësimdhënës; 2. Pajisjen me certifikatë nga QBD të nxënësve që ndjekin mësimin e gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë	Jo	Po.Fusha e diasporës.	Lidhet me Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026	Ka efekte financiare brenda tavaneve buxhetore. Ka efekte sociale pozitive për nxënësit/fëmijët shqiptarë në diasporë. Nuk ka efekte mjedisore
2	Për një ndryshim në vendimin nr.119, datë 01.03.2023 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit"	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i parë	Ky ndryshim propozohet në bazë të marrëveshjeve të lidhur midis MAS dhe disa institucioneve të vetqeverisjes vendore në kuadër të decentralizimit të funksioneve nga niveli qëndror në nivelin vendor me qëllim zbatimin e projektit pilot të përfshirjes së bashkisë në ushtrimin dhe forcimin e përgjegjësiave në fushën e arsimit parauniversitar që janë në territorin e saj.	Ky ndryshim propozohet në bazë të marrëveshjeve të lidhur midis MAS dhe disa institucioneve të vetqeverisjes vendore në kuadër të decentralizimit të funksioneve nga niveli qëndror në nivelin vendor me qëllim zbatimin e projektit pilot të përfshirjes së bashkisë në ushtrimin dhe forcimin e përgjegjësiave në fushën e arsimit parauniversitar që janë në territorin e saj.	Jo	Po. Fusha e arsimit	Lidhet me Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026	Ka efekte financiare brenda tavaneve buxhetore. Ka efekte sociale pozitive. Nuk ka efekte mjedisore
3	Për disa ndryshime në vendimin nr. 440, datë 19.07.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor”, i ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i parë	Ky ndryshim synon rishikimin e afateve të përcaktuara në vendimin në fuqi të Këshillit të Ministrave, me qëllim shmangien e vonesave në procedura dhe perfutimin në kohë të kreditës nga ana e studentit	Ky ndryshim synon rishikimin e afateve dhe fazave të negociimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve me bankën/at e nivelit të dytë, me qëllim shmangien e vonesave në procedura dhe perfutimin në kohë të kreditës nga ana e studentit	Jo	Po. Fusha e arsimit	Lidhet me Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026	Nuk ka efekte financiare. Ka efekte sociale pozitive. Nuk ka efekte mjedisore
4	Për miratimin e Planit të Veprimit të Arsimit Dixhital 2025-2030 duke përfshirë standardet për arrijten e kompetencës digjitale	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj një ndër objektivat kryesorë për realizim është zhvillimi i kompetencës digjitale përmes shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë. Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj. Me anë të porpozimit të projektvendimit për hartimin e planit të veprimit synohen të hartohen hapat konkretë të veprimit për zhvillimin dhe përmirësimin e Arsimit Digjital 2025-	Në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj një ndër objektivat kryesorë për realizim është zhvillimi i kompetencës digjitale përmes shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë. Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj. Me anë të porpozimit të projektvendimit për hartimin e planit të veprimit synohen të hartohen	Po Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura"	Po. Fusha e arsimit	Lidhet me strategjinë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj	Nuk ka efekte financiare. Ka efekte sociale pozitive. Nuk ka efekte mjedisore



					2030 duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale	hapat konkretë të veprimit për zhvillimin dhe përmirësimin e Arsimit Digjital 2025-2030 duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale				
5	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr.742, datë 03.12.2021 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Parauniversitar (SMIP)"	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Ky ndryshim synon mundësimin e krijimit të aksesit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) për strukturat e arsimit dhe formimit profesional, si një ndër aktorët kryesorë për menaxhimin e shkollave profesionale.	Sigurimi i të dhënave administrative është elementi bazë për qeverisjen sistemit të arsimit dhe formimit profesional dhe kryerjen e analizave që në përputhje me direktivat do të duhet të sigurojnë konkurrencën e qendrueshme dhe funksionimin e sistemit në përputhje me nevojat e tregut të punës. Gjithashtu ky akses është i rëndësishëm për kryerjen e gjurmimeve si një tjetër rekomandim i rëndësishëm.	Jo	Po. Fusha e arsimit	Lidhet me Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026	Nuk ka efekte financiare. Ka efekte sociale pozitive. Nuk ka efekte mjedisore
6	Për disa ndryshime në vendimin nr. 607, datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)"	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Projektvendimi synon riorganizimin e AKKSHI lindur nga nevoja për rritje të efikasitetit së institucionit për zbatimin e politikave të reja sektoriale, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Roli i AKKSHI si një institucion menaxhues i kërkimit shkencor duhet të fuqizohet në mënyrë që produkti shkencor t'i paraprijë politikave më të mira publike, si dhe zhvillimit ekonomik e social të vendit.	Ndryshimi i vendimit në fuqi synon të rregullojë këto çështje kryesore: 1. Forcimit të kapaciteteve për vlerësimin e performancës kërkimore të institucioneve të arsimit të lartë dhe instituteve kërkimore; 2. Ndryshimin e proceseve të brendshme, detyrave dhe përgjegjësisë, duke përfshirë sistemin e brendshëm të menaxhimit të cilësisë për të performuar më mirë si një agjenci administruuese e financuese e kërkimit shkencor	Jo	Po. Fusha e arsimit	Lidhet me Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026	Nuk ka efekte financiare. Ka efekte sociale pozitive. Nuk ka efekte mjedisore
7	Për disa ndryshime në vendimin nr. 450, datë 30.06.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së materialeve dhe pajisjeve sportive që do të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe procedurat e përjashtimit të tyre"	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Nevoja për përditësim i vendimit në fuqi të Këshillit të Ministrave për shkak të rritjes së numrit të federatave sportive shqiptare dhe të artikujve që duhet të përjashtohen nga detyrimet doganore	Nevoja për përditësim i vendimit në fuqi të Këshillit të Ministrave për shkak të rritjes së numrit të federatave sportive shqiptare dhe të artikujve që duhet të përjashtohen nga detyrimet doganore	Jo	Po. Fusha e sportit	Jo	Ka efekte financiare brenda tavaneve buxhetore. Ka efekte sociale pozitive. Nuk ka efekte mjedisore
8	Për disa ndryshime vendimin, nr. 600, datë 09.10.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë", të ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Nevoja për të shtuar shërbimin e sigurisë edhe në shkollat profesionale	Vendimi nr. 600, datë 09.10.2018 i Këshillit të Ministrave synon garantimin e sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar, si një element thelbësor i parandalimit të dukurive negative, si brenda edhe jashtë mjediseve të shkollës. Me ndryshimin e vendimit në fuqi të Këshillit të Ministrave synohet të garantohet ofrimi i shërbimit të sigurisë publike edhe në shkollat profesionale	Jo	Po. Fusha e arsimit profesional	Lidhet me Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026	Nuk ka efekte financiare, sociale dhe mjedisore
9	Rishikimi i vendimit nr. 824, datë 24.12.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Kodit të	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Zbatimi i Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane (ESG), të cilat do të rrisin sigurimin e cilësisë së arsimit, duke promovuar transparencën, llogaridhënien dhe njohjen ndërkombëtare.	Rishikimi i Kodit të Cilësisë në përputhje me standardet evropiane dhe anëtarësimi i ASCAL në ENCA (European Association for Quality Assurance in Higher Education)	Po Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura"	Po. Fusha e arsimit	Lidhet me Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026	Nuk ka efekte financiare. Ka efekte sociale pozitive. Nuk ka efekte mjedisore



	Cilësisë së arsimit të lartë"									
10	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS)	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Bazuar në Ligjin Nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore" bazat e të dhënave shtetërore krijohen me vendim të të Këshillit të Ministrave. Projektakti propozohet në kuadër të ngritjes dhe funksionimit të bazës së të dhënave shtetërore Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS)	Qëllimi i këtij projektakti është të krijojë bazën e të dhënave shtetërore Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS)	Jo	Po. Fusha e arsimit	Strategjia kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2023-2030	Ka efekte financiare brenda taveaneve buxhetore. Ka efekte sociale pozitive. Nuk ka efekte mjedisore
11	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL)	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Bazuar në Ligjin Nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore" bazat e të dhënave shtetërore krijohen me vendim të të Këshillit të Ministrave. Projektakti propozohet në kuadër të ngritjes dhe funksionimit të bazës së të dhënave shtetërore Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL)	Qëllimi i këtij projektakti është të krijojë bazën e të dhënave shtetërore në fushën e arsimit të lartë, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL)	Po Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura"	Po. Fusha e arsimit	Lidhet me Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026	Nuk ka efekte financiare. Ka efekte sociale pozitive. Nuk ka efekte mjedisore
12	Për një ndryshim në vendimin nr. 741, datë 03.12.2021 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit (SPSH)"	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Bazuar në Ligjin Nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore" Referuar ndryshimeve që ka pësuar portali "Mësues për Shqipërinë" duke kaluar administrimin nga Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) në Sistemin e Provimeve të Shtetit nën administrimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) lind nevoja e shtimit të elementëve të portalit "Mësues për Shqipërinë" në vendimin nr. 741, datë 03.12.2021 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit (SPSH)"	Qëllimi i këtij projektakti është të ndryshojë përcaktimet lidhur me bazën e të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit (SPSH)	Jo	Po. Fusha e arsimit	Lidhet me Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026	Nuk ka efekte financiare. Ka efekte sociale pozitive. Nuk ka efekte mjedisore
13	Për disa ndryshime në vendimin nr. 789, të Këshillit të Ministrave, datë 15.12.2021 "Për kriteret, mënyrën e shpërblyerit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre", i ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Përmirësim i kuadrit ligjor për shpërblyerimin e sportistëve elitare	Rishikim të masave të shperblimeve për sportistë dhe sporte të caktuara. Rishikim i përkufizimit të dopingut në garë dhe jashtë saj	Jo	Po. Fusha e sportit	Jo	Nuk ka efekte financiare. Ka efekte sociale pozitive. Nuk ka efekte mjedisore



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2025										
Ministria e Brendshme										
Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE?	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore
							Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Nëse përputhet, të jepet referencia e saktë në program	Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Per mbledhjen, përpunimin, transmetimin, ruajtjen, fshirjen, mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave të informacionit të pasagjerit në republikën e shqipërisë	Projektligji	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i parë	Ligji nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar përbën bazën ligjore të Njësisë së Informacionit të Pasagjerit (N.I.P), Sipas rekomandimeve të BE është kerkuar ndarja ne dy ligje te vecanta. Per kontrollin e kufirit Shtetror dhe API-PNR te perpuniminin e te dhenave te pasagjerit.	Përafrim me legjislacionin komunitar dhe standardet ndërkombetare në këtë fushë	PO	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Strategjia Ndërsëktoriale kundër Krimit të Organizuar 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2023-2025.	Po
2	Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të trajtimit financiar gjatë gjëndimit në punë të punonjësve të policisë së shtetit	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i parë	Projektvendimi ka për qëllim zbatimin e shkronjës "a" dhe "d", të pikës 2 dhe pikës 4, të nenit 104, të ligjit nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit"	Ky projektvendim ka për qëllim miratimin e vleravepër secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Policisë së Shtetit sipas strukturave në të cilat ushtrojnë funksionet policore, trajtimin financiar të kursantëve, studentëve, punonjësve të policisë që kryejnë shkollim/trajtim, iv. punonjësve të Policisë së Shtetit që bashkëpunojnë me institucionet arsimore të sistemit policor, si punonjës të jashtëm, shtesa për natyrë të veçantë pune dhe vlera e shpërblimit të punonjësve të policisë për rezultate të larta në kryerjen e detyrës	Jo	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Jo	Po
3	Per miratimin e numrit te pergjithshem te personelit te Policise se Shtetit, percaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë dhe kategorizimin e tyre.	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i parë	Projektvendimi ka për qëllim zbatimin e pikës 2, të nenit 66, të ligjit nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit"	Ky projektvendim ka për qëllim caktimin e gradave korresponduese çdo funksioni në organikën e Policisë së Shtetit	Jo	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Jo	Po
4	“Për Miratimin e paraqitjes, formës, dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformeve dhe shenjave të Policisë së Shtetit"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i parë	Projektvendimi ka për qëllim zbatimin e pikës 1, 2, të nenit 135, të ligjit nr.82/2024, "Për Policinë e Shtetit"	Miratimin e paraqitjes, formes dhe specifikimeve teknike të uniformeve, të stemave, shenjave dalluese të propozuara dhe simboleve të Policise së Shtetit.	Jo	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Jo	Po
5	Për përcaktimin e kohës së punës dhe pushimit,lejes pa të drejtë page, të trajtimit financiar të Punonjësit të Policisë së Shtetit kur nuk kryen pushimet, si dhe rregullat e kujdesit për punonjëset shtatëzanë në Policinë e Shtetit	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i parë	Projektvendimi ka për qëllim zbatimin e pikës 7, të nenit 100, të pikës 5, të nenit 101 dhe pikës 4, të nenit 102, të ligjit nr.82/2024, "Për Policinë e Shtetit"	Ky projektvendim ka për qëllim të rregullojë dhe standardizojë mënyrën e organizimit dhe menaxhimit të kohës së punës, pushimeve, lejeve dhe kushteve të punës për punonjësit e Policisë së Shtetit, si dhe krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të drejtë pune veçanërisht për punonjëset shtatëzanë.	Jo	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Jo	Po
6	Për përcaktimin e motivit, rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e medalieve e certifikatave dhe shpërblimit.	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i parë	Projektvendimi ka për qëllim zbatimin e pikës 6, të nenit 127, të ligjit nr.82/2024, "Për Policinë e Shtetit"	Ky projekt vendim ka për qëllim përcaktimin e motivit, rregullave, kriterëve dhe procedurave për dhënien e medaljeve e certifikatave dhe shpërblimin përkatës	Jo	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Jo	Po
7	Për kompensimin për kufizimet që i krijohen punonjësit të policisë për largësinë nga	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i parë	Projektvendimi ka për qëllim zbatimin e të pikës 2, germa "b", të nenit 104	Ky projektvendim ka për qëllim të përcaktojë kompensimin financiar në	Jo	Po, shtylla Shqipëria e	Jo	Po



	vendbanimi, pagën për papunësinë e bashkëshortit, si dhe kriteret dhe masën e përfutimit të pagesës së qirasë për strehim				dhe pikës 2, të nenit 107, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”,	lidhje me largësinë, pagesën e papunësisë së bashkëshortit/es apo pagimin e qerasë së banesës kur punonjësit e policisë për nevoja pune emërohet, transferohet në mënyrë të përkohshme apo të përhershme jashtë vendbanimit të tij.		fortë, fusha Shqipëria e Sigurt		
8	Për përcaktimin e kushteve dhe mënyrës për mbrojtjen e veçantë të punonjësit të policisë të cilit i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i parë	Projektvendimi ka për qëllim zbatimin e pikës 2, të nenit 109, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”	Ka si qëllim përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë një punonjësi i policisë për të përfutur mbrojtje të veçantë, si dhe mënyrën e realizimit të kësaj mbrojtje për punonjësin e policisë, të cilit i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës.	Jo	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Jo	Po
9	Për fondin e veçantë në Policinë e Shtetit	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i parë	Projektvendimi ka për qëllim zbatimin e pikës 2, të nenit 138, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”	Përcakton kriteret e përdorimit dhe kontrollit të fondit të veçantë	Jo	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	JO	Po
10	Per miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i parë	Ky projektvendim del në zbatim të nenit 136 ligjit nr.82/2024 "Për Policinë e Shtetit", si dhe neneve 18/4; 19/8; 22/5; 24/2; 26/5; 30/2; 32/4; 59/2; 60/5; 61/5; 62/4; 65/7; 73/8; 78/5; 82/4; 83/3; 84/5; 88/8; 89/2; 92/5; 93/2; 97/2; 100/3; 113/1 dhe 7; 114/3; 115/14; 116/8; 119/2; 120/1; 123/7 dhe 12; 126/3 dhe 6; 129/1-b; 133/3; 135/6 dhe 139/3. projekti ka për qëllim rregullimin e çështjeve të brendshme, të personelit dhe të disiplinës së organizatës së Policisë së Shtetit.	Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e marrëdhënieve brenda dhe jashtë strukturave të Policisë së Shtetit; i parimeve, standardeve dhe normave që rregullojnë sjelljen profesionale dhe etike të punonjësit të Policisë, gjatë dhe jashtë shërbimit; i ecures në karrierë dhe menaxhimit të burimeve njerëzore; i vlerësimit të performancës së strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe rregullave për disiplinën dhe procedurave që ndiqen në rastin e shkeljeve disiplinore.	Jo	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Jo	Po
11	Për ndryshimin e vendimit nr. 135, dt 6.3.2024 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave të kërkesës, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare kur republika e shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i parë	Ndryshuar ligji nr. 113/2020 "Për shtetësinë", neni 9, është hequr togfjalëshi "që ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç" në pikën 1 dhe shtuar pika 1/1 me përmbajtje si vijon: 1/1. Për shtetasin e huaj që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç, shtetësia shqiptare sipas pikës 1 të këtij neni mund të fitohet vetëm me pëlqimin e të dy prindërve ose kujdestarit ligjor, si dhe të femijës që ka moshën 14-18 vjeç.	Heqjen e kriterit në VKM "që ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç" dhe shtimin e një dokumenti që duhet të paraqitet për të vërtetuar "pëlqimin e të dy prindërve ose kujdestarit ligjor" për të miturin. Pergatitja e formatit për paraqitjen e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare për interes kombëtar.	Jo	Jo	Jo	Jo
12	Për trajtimin e familjarëve të punonjësve të Agjencisë, që humbin jetën për shkak të detyrës	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i dytë	Ligji nr. 128/2021 "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore", neni 77 pika 2	Pjesëtarët e familjes, që bashkëjetojnë me punonjësin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore që ka humbur jetën, gjatë kryerjes ose për shkak të detyrës, I paguhet ndihme e menjëhershme , fëmijëve ju paguhet burse për shkollimin në universitete shtetërore, iu sigurohet banesë kur janë pa strehim, iu sigurohet pension suplementar, Institucioni organizon dhe perballon shpenzimet mortore,	Jo	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	jo	Po
13	Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së mbrojtjes së personaliteteve apo banesës së tyre, pas përfundimit të detyrës, në rast të rrezikut për shkak të detyrës	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i dytë	Neni 13, pika 4, neni 14, pika 3, të ligjit nr. 33/2021, datë 16.03.2021 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë",	Projektvendimi, synon të përcaktojë rregullat, procedurën dhe kohëzgjatjen e mbrojtjes së personaliteteve të tjera shtetërore pas përfundimit të detyrës, në rast të rrezikut të jetës, shëndetit apo banesës, për shkak të detyrës që kanë kryer	Jo	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Jo	Po
14	Për mbrojtjen e veçantë të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i dytë	Ligji nr. 128/2021 "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore", neni 75 pika 2	Ka si qëllim përcaktimin e kushteve për të përfutur mbrojtje të veçantë, si dhe mënyrën e realizimit të kësaj mbrojtje për punonjësin e policisë, të cilit i kërcënohet	Jo	Po, shtylla Shqipëria e fortë, fusha	jo	Po



						jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës.		Shqipëria e Sigurt		
15	Projektvendim për miratimin e modelit të pasaportës biometrike	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i dytë	Përcaktim i ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", i ndryshuar", neni 13, ku parashikohet se: "Modeli i pasaportës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave."	Saktësimi i specifikimeve teknike sipas standardeve ICAO/BE	Jo	Jo	Jo	Jo
16	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", i ndryshuar"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i tretë	Ligji aktual është i miratuar në vitin 2000 dhe nuk ka pësuar ndryshime në thelb. Zhvillimet teknologjike të mëpasshme dhe legjislacioni komunitar që ka pasuar këto ndryshime nuk reflektohen në aktin aktual. Në kuadër të marrjes së vendimit për hapjen e grup kapitujve të I-rë "Thelbësorët" ku përfshihet kapitulli 24 "Drejtesia, Liria dhe Siguria" do të përafrohet me legjislacionin komunitar dhe standardet ndërkombetare në këtë fushë	Projektakti synon të rregullojë në tërësi të gjitha çështjet që lidhen me krijimin, shpërndarjen dhe administrimin e pasaportës biometrike për shtetasit shqiptar. Duhet të përcaktohen qarte objektiva dhe qëllimi i projektligjit. Dispozita mbi "perkufizimet" e domosdoshme për këtë akt të cilat lidhen edhe me zhvillimet teknologjike në këtë fushë. Duhet të përcaktohen qarte kompetencat e Këshillit të Ministrave në lidhje me aktet normative që duhet të pasojnë miratimin e ligjit, si dhe fushat e kompetencës së Ministrisë së Brendshme. Një masë e madhe rregullash në këtë fushë janë përcaktuar në aktet ligjore që kanë ratifikuar kontratën e koncesionit (ligji 9972/2008 e vijues), por që aktualisht kanë përfunduar efektet me datë 01/08/2023 me mbarimin e saj.	Jo	Kapitulli 24 "Drejtesia, Liria dhe Siguria"	Kapitulli 24 "Drejtesia, Liria dhe Siguria"	Po
17	Për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Koordinimit të Integruar të Kufirit	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i tretë	Ngritja e Qendrës Kombëtare të Koordinimit të Integruar të Kufirit është masë prioritare e planifikuar në Strategjinë Ndërsëktoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe në Planin e Veprimit 2024-2025, e konceptuar për të përmirësuar koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe institucioneve që operojnë në këtë fushë	Projektakti përcakton modalitetet e funksionimit të qendrës si strukturë kombëtare ndërinstitucionale në fushën e menaxhimit të integruar të kufirit, mënyrat e bashkëpunimit, koordinimit ndërinstitucional dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet agjencive vendase dhe atyre partnere rajonale dhe evropiane që operojnë në këtë fushë	Jo	Projektakti mbështet programin politik të qeverisë 2021-2025 për një Shqipëri më të sigurtë	Po, projektakti është i parashikuar në Strategjinë Ndërsëktoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe në Planin e Veprimit 2024-2025	Ndikimet financiare për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Koordinimit të Integruar të Kufirit janë në proces vlerësimi nga strukturat teknike
18	Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve dhe Planin e Veprimit:	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i tretë	Përfundon periudhën e shtrirjes së dokumentit strategjik dhe planit të veprimit në këtë fushë, konkretisht Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2025; Planin e Veprimit 2019-2025	Dokument strategjik përcakton vizionin e Qeverisë së Shqipërisë për kontrollin e armëve, municionit dhe eksplozivëve, qëllimet politike dhe objektivat kryesore që do të udhëheqin veprimtarinë e institucioneve dhe agjencive përgjegjëse në këtë fushë, për sa i takon aspektet e parandalimit, kontrollit, bashkëpunimit ndërkombëtar etj., duke iu përafëruar standardeve të Bashkimit Europian .	Po Kapitulli 24 "Drejtesia, Liria dhe Siguria"	Projektakti mbështet programin politik të qeverisë 2021-2025 për një Shqipëri më të sigurtë	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020 Shtylla 8.4 "Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit", Objektivi Strategjik 2 "Ulja e trafikimit të paligjshëm dhe, në veçanti, e trafikimit të genieve njerëzore	Në Planin e ri të Veprimit do të përcaktohen kostot financiare për çdo qëllim politik/objektiv/masë



									nga/përmes Shqipërisë deri në 2020"	
19	Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr.499, datë 29.08.2018 "Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori i tretë	Ne zbatim të ligjit nr. 8920, datë 11.7.2002, "Për ratifikimin e "Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj", si dhe të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore"	Rritja e strukturave shtetërore dhe jo shtetërore për të realizuar kryerjen e identifikimit të VT/VMT. Marrja e masave me qëllim adresimin e formave të reja të trafikimit. Synohet të rritet bashkëpunimi me qëllim minimizimin e këtij fenomeni. Përcaktimi i treguesve dhe hapave për identifikimin, referimin dhe asistencën e dhënë VT/VMT.	Po Kapitulli 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria"	Lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të personave.	Strategjia kundër krimit të organizuar dhe krimeve të renda 2021-2025	Jo



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2025

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Projektligji "Për nenproduktet me origjinë shtazore"	Projektligji	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katër mujori i parë	Knjimi i bazës së munguar ligjore për trajtimin e nenprodukteve me origjinë shtazore që nuk synohen të konsumohen nga njeriu. Përafrimi i Rregullores 1069/2009 "Percakton rregullat e shëndetit në lidhje me nenproduktet e kafshëve dhe produkteve derivate që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor.	Percaktimi i rregullave për mbledhjen e nenprodukteve dhe kategorizimi i tyre, caktimi i destinacionit dhe përdorimit, caktimi i autoriteteve të kontrollit, masat administrative për shkeljet.	Po, Kapitulli 12 "Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve"	Jo	Jo	Po, mjedisore
2	"Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektoreve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2025"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katër mujori i parë	Mbështetje për fermerët dhe subjektet në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural; mbështetje me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi; skema e investimeve.	Percaktimi i masave të mbështetjes kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2025, kriteret bazë, masat e financimit.	Jo	Zhvillimi i Bujqësisë dhe Fshatit; Rritja e mbështetjes në Bujqësi, Blegtori dhe Zhvillim Rural.	Strategjia Ndërsektorale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021 - 2027, miratuar me Vendimin Nr. 460, datë 29.6.2022	Po
3	"Për produktet mjekësore veterinare"	Projektligji	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katër mujori i tretë	Detyrim nga takimi Bilateral Screening Meeting për Kapitullin 28 - Mbrojtja e Konsumatorit/Shëndeti Publik, zhvilluar Më 17 shkurt 2023, në të cilin Shqipëria mori angazhim për afrimin e Rreg. (BE) 2019/6 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2018 "Për produktet mjekësore veterinare" që shfuqizon Direktivën 2001/82/EC,	Projektakti përcakton rregullat për vendosjen në treg, prodhimin, importin, eksportin, furnizimin, shpërndarjen, farmakovigjencën, kontrollin dhe përdorimin e produkteve mjekësore veterinare duke ndikuar në përmirësimin e shëndetit të kafshëve dhe njerëzve si edhe sjell. Një kuadër ligjor modern inovativ Promovimin i rritjes së disponueshmërisë së VMP-ve duke stimuluar inovacionin dhe konkurrencën Laftimi e rezistencës antimikrobike shqetësim global	Jo	Zhvillimi i Bujqësisë dhe Fshatit; Rritja e mbështetjes në Bujqësi, Blegtori dhe Zhvillim Rural.	1. Strategjia Ndërsektorale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021 - 2027, miratuar me Vendimin Nr. 460, datë 29.6.2022, në lidhje me objektivat strategjike në fushën e sigurisë ushqimore, për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve dhe shëndetin/mirëqenien e kafshëve. 2. Strategjia Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023 - 2027 miratuar me Vendimin Nr. 366, datë 16.6.2023, Politika e kësaj Strategjie miraton qasjen "Një shëndet", e cila i lejon Qeverisë të zbulojë, parandalojë dhe reagojë ndaj sëmundjeve të reja	Po



									në ndërfaqen njeri-kafshë-mjedis.	
4	“Për kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislationit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katër mujori i tretë	Ky projekt ligj do të përfshihet pjesërisht me Rregulloren (BE) 2017/625 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 15 mars 2017. Ky projekt ligj përcakton rregullat e përgjithshme dhe të veçanta, parimet dhe kërkesat që lidhen me kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare, si dhe përcakton përgjegjësitë, financimin dhe procedurat për kryerjen e kontrolleve zyrtare me qëllim garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe të mjedisit në Republikën e Shqipërisë. Hartimi i këtij projekt ligji ka për qëllim unifikim e kontrolleve zyrtare sipas legjislationit të BE-së, si dhe plotësimin e rekomandimeve të Raport-progresive.	Ky projekt ligj parashikon të përcaktojë rregullat për: a) kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare nga institucionet përgjegjëse; b) financimin e kontrolleve zyrtare; c) miratimin dhe zbatimin e kushteve që duhet të përmbushin kafshët dhe mallrat që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë nga shtete që nuk janë shtete anëtare të BE-së; d) ngritjen e një sistemi informacioni të kompjuterizuar për të menaxhuar informacionin dhe të dhënat që i përkasin kontrolleve zyrtare;	Po kapitujt 11- 12, "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural"; "Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve"	Jo	.Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2023 - 2027 miratuar me Vendimin Nr. 366, datë 16.6.2023.	Po
5	"Për Censin e Bujqësisë"	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katër mujori i tretë	Censi i Bujqësisë do të kontribuojë në sigurimin e të dhënave bazë të qëndrueshme në kohë, në përcaktimin e tipologjisë së fermës dhe madhësisë ekonomike të saj, krijimin e regjistrat statistikor të njësive ekonomike bujqësore dhe përgjithësimin e rezultateve të arritura në nivel rajonal dhe kombëtar bazuar në kriteret metodike të rekomanduara nga Eurostat. Projektligji ka si synim edhe harmonizimin me acquis të BE-së dhe zbatimin e standardeve të BE-së, duke përcaktuar terminologjinë statistikore në linjë me ato të përdorura nga Eurostat.	Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë: a) të sigurohet informacion i përgjithshëm dhe i hollësishëm për të gjitha njësitë ekonomike bujqësore, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë; b) të ofrohen të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe vënien në zbatim të politikave të përgjithshme të zhvillimit ekonomik bujqësor në Republikën e Shqipërisë; c) të krijohet regjistri statistikor i njësive ekonomike bujqësore	Po kapitulli 18 "Statistikat"	Zhvillimi i Bujqësisë dhe Fshatit; Zhvillimi i fshatit drejt turizmit rural; modernizimi për zhvillim	JO	Po, ekonomike
6	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8337, datë 30.4.1998, "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave"	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katër mujori i tretë	Detyrim nga takimi Bilateral Screening Meeting për Kapitullin 4 - levizja e lire e kapitalit, dje takimeve të nenkomitetit Ekonomi financiare, detyrim nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociativ.	Amendimi i ligjit për heqjen e kufizimit të nenit 4, të ligjit nr.8337/1998 që nuk ju njeh personave fizikë dhe juridikë të huaj të drejtën e pronësisë të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave por vetëm të drejtën e marrjes me qira për 99 vjet.	Po, kapitulli 4 "Lëvizja e lirë e kapitalit"	Jo	Jo	Po, Ekonomike



7	"Për përcaktimin e zonave të prodhimit të mushit për verë, bazuar në të dhënat e studimit, për "Zonat e kultivimit të vreshtave për verë".	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katër mujori i tretë	Detyrim pika 6, neni 10, Ligjit Nr. 86/2022; Baza për përcaktimin e varieteteve të mushit për verë, sipas karakteristikave përkatëse të zonave të Shqipërisë; rritja e prodhimit dhe cilësisë së verës dhe rritja e të ardhurave.	Përcaktimi i zonave të kultivimit të vreshtave për verë, bazuar në treguesit e tokës, klimës, etj	Jo	Zhvillimi i Bujqësisë dhe Fshatit; Zhvillimi i fshatit drejt turizmit rural; modernizimi për zhvillim	Strategjia Ndërsëktorale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021 - 2027, miratuar me Vendimin Nr. 460, datë 29.6.2022	Po
8	"Për miratimin e rregullave të hollësishme lidhur me kushtet, masat dhe kontrollin e ngarkesave të produkteve organike ose në kalim të importuara"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katër mujori i tretë	Në zbatim të pikës 4, neni 56, të ligjit 104/2024 "Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre". Boshllëk ligjor lidhur me rregullat e importit të produkteve organike.	Ky projektvendim do të përcaktojë rregullat e hollësishme për verifikimin e kushteve për importin e produkteve organike dhe në kalim, të përcaktuara në ligjin nr.104/2024 "Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre" kontrollin dhe masat e marra gjatë kontrollit të produkteve të importuara organike dhe në kalim.	Po Kapitulli 11 "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural"	Jo	Strategjia Ndërsëktorale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021 - 2027, miratuar me Vendimin Nr. 460, datë 29.6.2022.	Po
9	"Për organizimin e tregjeve të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katër mujori i tretë	Detyrim nga takimi Bilateral Screening Meeting për Kapitullin 13 - Peshkimi, në të cilin Shqipëria mori angazhim për afrimin e Rregullores (BE) Nr. 1379/2013 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 dhjetor 2013, për organizatën e përbashkët të tregjeve në produkte peshkimi dhe akuakulturë, duke ndryshuar Rregulloret e Këshillit (CE) Nr. 1184/2006 dhe (CE) Nr. 1224/2009 dhe duke anuluar Rregulloren (CE) Nr. 104/2000.	Projektvendimi përcakton rregullat për organizimin dhe rregullimin e tregjeve të produkteve të peshkimit dhe akuakultures	Po, Kapitulli 13 "Peshkimi"	Zhvillimi i Bujqësisë dhe Fshatit; Zhvillimi i fshatit drejt turizmit rural; modernizimi për zhvillim	Strategjia Ndërsëktorale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021 - 2027, miratuar me Vendimin Nr. 460, datë 29.6.2022	Po
10	"Për përcaktimin e kriterëve, procedura, mënyra e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe formati tip i kontratës"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katër mujori i tretë	Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ligjit 64/2012 "Për peshkimin", nevojitet hartimi e vendimit për përcaktimin e kriterëve, procedura, mënyra e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe formati tip i kontratës, me qëllim menaxhimin optimal të infrastrukturës së peshkimit.	Projektvendimi përcakton kriteret, procedurat, mënyren e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe formati tip i kontratës	Jo	Jo	Strategjia Ndërsëktorale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021 - 2027, miratuar me Vendimin Nr. 460, datë 29.6.2022	Po



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2025										
Ministria e Drejtësisë										
Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për miratimin, në parim, të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katër mujori i parë	Shprehje e angazhimit të Republikës së Shqipërisë për të përfshirë në rendin juridik të brendshëm këtë akt ndërkombëtar të Këshillit të Evropës, me qëllim sigurimin e respektimit të të drejtave të njeriut gjatë përdorimit të sistemeve të inteligjencës artificiale.	Projektakti synon ndërmarrjen e procedurave për përfshirjen në rendin juridik të brendshëm të Konventës.	Jo	Jo	Jo	Po, Sociale
2	Për miratimin, në parim, të ndryshimeve të Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, mbi krimin e agresionit	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katër mujori i parë	Ky projektvendim synon nisjen e procedurave për miratimin, në parim, të ndryshimeve të Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale mbi krimin e agresionit.	Objektivat kryesore lidhur me miratimin e këtyre ndryshimeve janë: 1. Përkufizimi i krimit të agresionit; 2. Mbrojtje më e mirë ndërkombëtare; 3. Mbështetje për shtetin e së drejtës; 4. Promovimi i paqes dhe stabilitetit; 5. Bashkëpunimi me Gjykatën Ndërkombëtare Penale.	Jo	Jo	Jo	Po, sociale
3	Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2025	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katër mujori i parë	Rekomandimet kanë për qëllim dhe synojnë garantimin e funksionimit efektiv të organit të prokurorisë, parandalimit dhe luftës kundër korupsionit, krimit të organizuar, dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të të drejtave të njeriut.	Përcaktimin e prioritetëve në luftën kundër korupsionit dhe krimit të organizuar, në përmbyshje të detyrimeve të brendshme ligjore, si dhe rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare. Këto rekomandime prioritare i përcillen organit të prokurorisë në ushtrim të përgjegjësisë shtetërore të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, për ndjekjen dhe realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë dhe në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrit reciprok të pushteteve	Jo	Jo	Jo	Jo
4	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katër mujori i dytë	Ky projektligj synon rregullimin e problematikave të hasura në praktikë dhe sigurimin e ofrimit të një shërbimi cilësor.	Përmes projektaktit të propozuar synohet të rregullohen çështje që lidhen me procedimin disiplinor të përmbaruesit gjyqësor privat, duke qartësuar kriteret që duhet të mbahen në konsideratë në caktimin e masave disiplinore, si dhe llojet e këtyre masave. Objektivat kryesorë që synohet të arrihen përmes kësaj nisme lidhen me qartësimin e rregullave lidhur me zëvendësimin e përmbaruesit që i është pezulluar apo hequr licenca, si dhe të	Jo	Jo	Jo	Po



						masave disiplinore dhe organeve përgjegjëse për dhënien e tyre.				
5	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i dytë	Qëllimi i projektaktit është rregullimi i disa parashikimeve ligjore të cilat kanë sjellë problematika gjatë kontrollit të veprimtarisë së noterëve nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë. Po ashtu, ndërmarrja e iniciativës ligjore është diktuar edhe nga propozime të përcjella nga ana e Dhomës Kombëtare të Noterisë, të cilat janë vlerësuar të drejta dhe që kërkojnë domosdoshmërisht ndërhyrjen në ligjin nr.110/2018.	Përmes projektaktit të propozuar synohet të rregullohen nga pikëpamja ligjore situatat problematike që kanë krijuar dispozitat në fuqi apo mungesa e rregullimeve specifike dhe në këtë mënyrë sigurohet mbarëvajtja e veprimtarisë noteriale duke garantuar një shërbim më të mirë edhe për qytetarët.	Jo	Jo	Jo	Po
6	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse".	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i dytë	Detyrimi për ndërmarrjen e nismës buron nga nevoja për plotësimin e ligjit pas vendimit nr.62/2023 të Gjykatës Kushtetuese e cila shfuqizoi kompetencën e kancelarit për të shqyrtuar kërkesat për regjistrime të tjera.	Objektivi i këtij projektligji është sigurimi i parimit të sigurisë juridike, konform arritjes së qartësisë, kuptueshmërisë dhe përcaktimit të normës juridike, shtetit të së drejtës, si dhe plotësimit të vakumit ligjor, pasi konkretisht me shfuqizimin nga Gjykata Kushtetuese, të kompetencave të kancelarit për kryerjen e regjistrimeve të tjera, mbetet e paqartë dhe e pa parashikuar nga ligji se cili është autoriteti i cili ka kompetencën për kryerjen e këtij procesi.	Jo	Jo	Jo	Po, Sociale
7	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur"	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i tretë	Përafrimi i akteve të Bashkimit Evropian në fushën e të drejtave procedurale, sikurse është parashikuar edhe në Udhërrëfyesin për shtetin e së drejtës, miratuar me VKM nr.736, datë 19.12.2023.	Projektakti synon të përafrojë aktet e BE-së lidhur me të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procesin penal, të drejtën e informimit në procesin penal, të drejtën e aksesit ndaj avokatit në procesin penal, si dhe prezumimin e pafajësisë.	Po, Të drejtat e njeriut	Po, Integritimi Evropian	Udhërrëfyesi për shtetin e së drejtës, miratuar me VKM nr.736, datë 19.12.2023.	Po, Sociale



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2025										
Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit										
10	"Për miratimin e shtesave dhe ndryshimeve në vendimet e këshillit të ministrave për të siguruar thjeshtëzimin e procedurave dhe lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike të ofruara nga sistemi ministror i Ministrisë së Mbrojtjes"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i parë	Projektvendimi "Për miratimin e shtesave dhe ndryshimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave për të siguruar thjeshtëzimin e procedurave dhe lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike të ofruara nga sistemi ministror i Ministrisë së Mbrojtjes.", është një projektvendim i hartuar në kuadër të procesit të Derregullimit të Shërbimeve të ofruara nga Ministria e Mbrojtjes. Objektivat që synohen të realizohen lidhen me ndryshimin e akteve nënligjore për të mundësuar qartësimin dhe lehtësimin e procedurave të ofrimit të shërbimeve.	Ky projekt-akt synon të ndryshojë Vendimet e Këshillit të Ministrave në kuadër të procesit të Derregullimit dhe të Rinixhinierimit të Shërbimeve. Ky projektakt përcakton ndryshime në VKM-të ekzistuese të cilat do të lehtësojnë subjektet aplikuese duke ulur barrën administrative por edhe kohën që do të duhet subjektit për të përgatitur dokumentacionin e aplikimit. Projektakti do të ndihmojë në thjeshtimin e procedurave dhe eliminimin e dokumenteve të panevojshme, duke ulur kohën dhe koston për subjektet që aplikojnë për shërbime publike. Ky projektakt parashikon një bashkëpunim ndërmjet institucioneve që lehtëson shkëmbimin e të dhënave dhe përmirëson koordinimin institucional, duke shmangur procedurat e dyfishta dhe duke ndihmuar në përshejtimin e proceseve. Aplikuesit nuk do të jenë të detyruar të përmbushin dokumentacion të përsëritur ose të ndjekin procedura komplekse; ky lehtësim rrit efektivitetin dhe ndikon pozitivisht në klimën e biznesit. Projektakti synon të krijojë rregulla më të qarta dhe konsistente për proceset administrative, duke u siguruar subjekteve që çdo vendim dhe procedurë të jetë i mbështetur në legjislacion të qartë dhe transparent.	Jo	Jo	Urdhri nr. 209, datë 07.12.2023 të Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për derregullimin e procedurave administrative në funksion të shërbimeve publike të ofruara ndaj qytetarëve dhe bizneseve"	Po
11	"Për përcaktimin e formatit të raportit, afatet dhe koha e paraqitjes së raporteve"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i parë	Projektvendimi "Për përcaktimin e formatit të raportit, afatet dhe koha e paraqitjes së raporteve" nga subjektet të cilat janë pajisur me licenca/autorizime për transferimin ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara. Ky projektvendim vjen si detyrim i pikës 2, të nenit 37 dhe pikës 2, të nenit 38, të ligjit nr.46/2018, "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikuljeve e teknologjive me përdorim të dyfishtë".	Ky projektvendim synon të rregullojë procedurën e raportimit që subjektet kanë detyrim në zbatim të pikës 2, të nenit 37 dhe pikës 2, të nenit 38, të ligjit nr. 46/2018, "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikuljeve e teknologjive me përdorim të dyfishtë".	Jo	Jo	Urdhri nr. 209, datë 07.12.2023 të Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për derregullimin e procedurave administrative në funksion të shërbimeve publike të ofruara ndaj qytetarëve dhe bizneseve"	Po
12	"Për procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënie, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin e lëndëve plasëse për përdorim civil"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i parë	Ky projektakt ka si qëllim përcaktimin e dispozitave të reja për procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënie, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.Me përcaktimin e dispozitave dhe procedurave për kushtet dhe kriteret, formatet për dhënie, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve, synohet të implementohen kërkesat e nenit 22, të ligjit 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për	Ky projektakt përmirëson procedurat e mëparshme të miratuara me vendimin nr. 469, datë 29.06.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurën për dhënie e lejes së importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil" dhe e shfuqizon atë. Operatorët ekonomikë që janë të përfshirë në import, eksport, transit dhe prodhim të lëndëve plasëse për përdorim civil, duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë projektakt për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Kjo do të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së interesave publike, si: shëndeti e siguria e personave dhe siguria publike, si dhe për të garantuar konkurrencën e ndershme. Kushtet dhe kriteret e vendosura në këtë projektakt, synojnë të rregullojnë sigurinë e objekteve të prodhimit, magazinimit dhe mjeteve të transportit, por një fokus i veçantë i jepet personelit të angazhuar për nevojat e operatorit ekonomik dhe drejtuesit teknik.Një nga	Jo	Jo	Urdhri nr. 209, datë 07.12.2023 të Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për derregullimin e procedurave administrative në funksion të shërbimeve publike të ofruara ndaj qytetarëve dhe bizneseve"	Po



					përdorim civil".Miratimi i këtyre procedurave ka si objektiv organizimin e sistemit të licencimit dhe autorizimit për operatorët ekonomikë në fushën e lëndëve plasëse, me qëllim rritjen e sigurisë publike, si dhe sigurisë së produktit.	problematikat në implementimin e akteve të mëparshme në këtë fushë ka qenë personeli i patrajnuar, si dhe personeli përgjegjës për çështjet e sigurisë. Me këtë projektakt adresohen këto problematika.				
13	"Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak "Interflex" në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut."	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i parë	Nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurave të vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar	Ky projektvendim ka për qëllim dërgimin e 8 (tetë) ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Operacionin "Interflex", që kryhet në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Projektvendimi përcakton përballimin e shpenzimeve për ushtarakët që marrin pjesë në kwtw operacion	Jo	Jo	Strategjinë Ushtarake	Po
14	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 472, datë 26.7.2023 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i dytë	Tek parashikimet e kreut 2 të VKM Nr. 472, datë 26.07.2023 mungon harmonizimi me paketën e re ligjore të industrisë ushtarake dhe konkretisht me nenin 22 të Ligjit 87/2024 "Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake" dhe konkretisht bashkëpunimi i Qendrës me subjekte të licensuara sipas Ligjit 87/2024 me objekt projekte të përbashkëta kërkimore, zhvillimin e teknologjive të reja dhe shkëmbimin e njohurive dhe ekspertizës.	Ky shtim i përgjegjësisë funksionale të Qendrës do të mundësonte harmonizimin e plotë të VKM Nr. 472/2023 me Ligjin Nr 87/2024 duke qenë në përputhje me njëra tjetrën dhe në përfshirjen e plotë të përgjegjësisë të Qendrës edhe të detyrimit ligjor që rrjedh nga Ligji 87/2024	Jo	Përputhet duke u lidhur dhe ndikuar me Kreun 3 të programit politik "Modernizimi për zhvillim", angazhimi Nr. 43 në lidhje me stimulimin e sipërmarrjeve të reja në ekonominë dixhitale edhe nëpërmjet programeve akseleruese	Jo	ndikim financiar në lidhje me parashikimin buxhetor për kryerje të aktiviteteve të kërkimit shkencor, zhvillimit teknologjik, zhvillimin e prototipeve si edhe investimin në infrastruktura testuese
15	"Procedurat për menaxhimin e sigurisë së emetimeve"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i dytë	Në zbatim të pikës 2, të nenit 46 të ligjit nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar"	E kufizuar	Po, Kapitulli 31 "Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes"	Jo	Jo	Jo
16	"Procedurat për përzgjedhjen, operimin, mirëmbajtjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e materialeve kriptografike"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i dytë	Në zbatim të pikave 4 dhe 5, të nenit 45, të ligjit nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar"	Ky projektakt përcakton procedurat e përgjithshme të mbrojtjes kriptografike të informacionit të klasifikuar. Përzgjedhjen, operimin, mirëmbajtjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e materialeve kriptografike.	Po, Kapitulli 31 "Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes"	Jo	Jo	Jo
17	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar	Projektligj	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Rishikimi në tërësi i tij duke bërë harmonizimin me ligjet e tjera të cilat kanë pësuar ndryshime.	• Prodhimin e kartës së ushtarakut aktiv dhe atij në rezervë. • Përfitimin e trajtimit financiar për vjetërsi shërbimi. • Përfitimin e trajtimit financiar në rastet e largimit nga FA-ja, sipas kriterëve ligjore. • Efektet për personelin që humbin jetën. • Tarifat për shkolim të fëmijëve të ushtarakut që ka humbur jetën. • Stërvitje, trajnime e kurse afatshkurtra. • Krijimi i infrastrukturës për strehimin e ushtarakëve	Jo	Po/ Shqipëria e Fortë, Për ruajtjen dhe kontributin në luftën kundër terrorizmit dhe sigurisë globale	Strategjia Ushtarake dhe Plani Afatgjatë i Zhvillimit 2024-2033	Po
18	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.173/2014 "Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së	Projektligj	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Ky projektligj vjen si nevojë e zgjidhjes së problematikave të reja, të patrajtuara nga ligji aktual, i cili kërkon ndërhyrje për shkak të implementimit të strukturës së re. Dinamika të reja, të cilat kanë penguar realizimin e përfortimit të disiplinës në Forcat e	Arsyet e rishikimit të këtij ligji lidhen më së shumti me rregullime teknike dhe harmonizim me teknologji me ligjet e tjera që normojnë aktivitetin e FARSH	Jo	Jo	Jo	Jo



	Shqipërisë" i ndryshuar				Armatosura, sipas ligjit nr.173/2014, adresohen nga ky projektligj që njëkohësisht shton klasifikimin e masave disiplinore kur shkelja kryhet në misionet jashtë vendit					
19	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 13.11.2019 "Për rishikimin e Planit Kombëtar të Kërkim Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Planit të Veprimit të tij"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Në zbatim të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 10435, datë 23.6.2011, "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	Ndryshimi I strukturave në FA dhe të strukturave shtetërore, bën të nevojshme rishikimin në procedura dhe kapacitete	Jo	Jo	Strategjia Ndërsëktoriale për Menaxhimin e Integruar të Kufirit	Jo
20	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.742, datë 16.10.2012"Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Në zbatim të pikës 2 të nenit 5 e të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 10 435, datë 23.6.2011 "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar	Me ndryshimet e ligjit lind nevoja dhe për organizimin dhe funksionimin e QKKSH.	Jo	Jo	Jo	Jo
21	"Mbi organizimin, përbërja dhe detyrat e Komitetit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Në zbatim të pikës 2, të nenit 4/1, të ligjit nr. 10435, datë 23.6.2011, "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar.	Komiteti Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit është komiteti AdHoc I përbërë nga MM, në bazë të dokumentit 039 të ICAO dhe aneksit 12 të ICAO.	Jo	Jo	Jo	Jo
22	"Për detyrimin e subjekteve të licencuara, për sigurimin e një rezerve të caktuar armatimesh dhe pajisjesh teknologjike, për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Në zbatim të pikës 2, të nenit 9, të ligjit 87/2024 "Për rregullimin e prodhimit, tregimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake"	Në rastin e gjendjes së luftës ose në kushtet e një rreziku të afërt dhe konkret të një agresioni ushtarak ndaj Republikës së Shqipërisë ose aleatëve të saj strategjikë, subjektet e licencuara kanë detyrimin që të sigurojnë një rezervë të caktuar armatimesh dhe pajisjesh teknologjike për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.	Jo	Jo	Strategjia e Sigurisë Kombëtare	Jo
23	"Për miratimin e listës së mallrave të përjashtuara nga taksat doganore, të cilat shërbejnë drejtpërdrejt për prodhimin e armatimit ushtarak"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Në zbatim të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 26, të ligjit 87/2024 "Për rregullimin e prodhimit, tregimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake"	Percaktimi dhe miratimi I listës së mallrave të përjashtuara, lehtësimi fiskal për industrinë e mbrojtjes, mbështetja për zhvillimin e industrisë së mbrojtjes.	Jo	Jo	Jo	Jo
24	"Për miratimin e rregullores të inspektimit dhe monitorimit të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Në zbatim të pikës 2, të nenit 31, të ligjit 87/2024 "Për rregullimin e prodhimit, tregimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake"	Ky projektakt sunon të rregullojë çështjet kryesore të procesit të inspektimit, duke përfshirë objektin, përmbajtjen, metodën, vendin dhe procedurat e inspektimit që agjencia do të ndjekë për të siguruar përpunshmërinë e subjekteve të licencuara me legjislacionin dhe rregulloret përkatëse. Do të përcaktojë standartet e inspektimit dhe kriteret e sigurisë së mjedisit si dhe aspekte të tjera të nevojshme për një proces transparent dhe efektiv duke siguruar kështu cilësinë dhe integritetin e procesit.	Jo	Jo	Jo	Jo
25	"Për përcaktimin e rasteve, kushteve dhe procedurave të marrjes së vendimit për përfshirjen e	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Në zbatim të pikës 2, të nenit 34, të ligjit 87/2024 "Për rregullimin e prodhimit, tregimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake"	Ky projektakt do të përcaktojë kriteret, kushtet dhe procedurat për përfshirjen e subjekteve në regjistrin e posaçëm të subjekteve të përjashtuara, që janë gjetur në shkelje të dispozitave referuese të këtij ligji apo që, nëpërmjet veprimtarisë së tyre të	Jo	Jo	Jo	Jo



	subjektit në regjistrin e posaçëm të subjekteve të përjashtuara"					prodhimit apo tregimit të armatimit ushtarak, kanë cenuar sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare				
26	"Për përcaktimin e kritereve për dhënie e medaljeve përkujtimore ushtarake dhe civile"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Projektvendimi i propozuar ka për qëllim përcaktimin e kritereve për dhënie e medaljeve përkujtimore ushtarake dhe civile në zbatim të pikës 5, të nenit 15, të ligjit nr. 93/2022, "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë"	Sikurse dhe ligji përcakton në nenin 15 të tij, "Medaljet përkujtimore ushtarake dhe civile", u jepen, sipas rastit, subjekteve që kanë marrë pjesë në, ngjarje të rëndësishme ushtarake dhe civile, operacione/misione ushtarake, operacione për menaxhimin e situatave të krijuara nga rastet e fatkeqësive natyrore ose emergjencave civile apo ngjarje të tjera të ngjashme me rastet e mësipërme sipas vlerësimit të autoritetit përgjegjës propozues. Medaljet përkujtimore ushtarake dhe civile krijohen me propozim të ministrit të Mbrojtjes me qëllim vlerësimin e shërbimit, punës dhe kontributit të personelit ushtarak ose civil gjatë pjesëmarrjes së tyre efektive në rastet e përcaktuara në paragrafin më sipër.	Jo	Jo	Jo	Po
27	"Për përcaktimin e kritereve për dhënie e Medaljes së Shërbimit Ushtarak"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Projektvendimi i propozuar ka për qëllim përcaktimin e kritereve për dhënie e medaljes së shërbimit ushtarak në zbatim të pikës 4, të nenit 16, të ligjit nr. 93/2022, "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë".	Kjo medalje u jepet edhe ushtarakëve të huaj për merita dhe kontribut të veçantë për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Qëllimi është njohja e kontributit dhe përkushtimit të personelit ushtarak dhe civil, që shërben në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në mbrojtje të interesave të vendit dhe kryerjes me përgjegjësi të lartë dhe përkushtim të detyrave apo në interes të FARSH	Jo	Jo	Jo	Jo
28	"Për krijimin e medaljeve, shenjave dhe distinktivëve të veçantë të nderit, kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për dhënie e tyre në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Projektvendimi i propozuar ka për qëllim krijimin e medaljeve, shenjave dhe distinktivëve të veçantë të nderit, që i jepen personelit ushtarak dhe civil që shërben në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe për ushtarakët e huaj që shquhen për merita dhe kontribute të veçanta për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë si dhe kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për dhënie e tyre në zbatim të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 93/2022, "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë".	Projektvendimi i paraqitur ka si objekt të tij krijimin e medaljeve, shenjave dhe distinktivëve të veçantë të nderit, që i jepen personelit ushtarak dhe civil që shërben në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe për ushtarakët e huaj që shquhen për merita dhe kontribute të veçanta për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë si dhe kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për dhënie e tyre. Ky vendim do të zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë territorit të saj, ku personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dërgohet me detyrë, mision, operacion ushtarak apo në ndihmë të popullsisë civile, shërbim, stërvitje të përbashkët ose mision diplomatik	Jo	Jo	Jo	Jo
29	"Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurat, afatet, strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen si pasojë e një fatkeqësie."	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Në zbatim të pikës 6, e nenit 41 të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile"	Ky projektvendim ka për qëllim përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurat, afatet, strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen si pasojë e një fatkeqësie	Jo	Jo	Jo	Po
30	"Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112."	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katër mujori i tretë	Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" në nenin 47 parashikon se numri i unifikuar i thirrjeve emergjente 112 siguron komunikim, paralajmërim të hershëm, njoftim, alarm, informim, koordinim, vendimmarrje, aktivizim dhe ndërhyrje të integruar të strukturave operacionale në përballimin e aksidenteve dhe të situatave emergjente që mund të ndodhin në të gjithë vendin.	Unifikimin e numrit 112 për çështjet e emergjencës.	Po, Kapitulli 10 "Shoqëria e informacionit dhe media"	Jo	Jo	Po



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2025										
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale										
Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikojnë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	"Për hartimin e Dokumentit Politik Kombëtar për Moshimin dhe të Planit të Veprimit për Zbatimin e tij 2025-2030"	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katër mujori i parë	Në zbatim të objektivave për politikën sociale në SKZHIE dhe programit të qeverisë.Dokumentit Politik Kombëtar për Moshimin 2025-2030 do të hartohet në përfundim të Planit paraprakis për Moshimin 2019-2024 miratuar me Vendim nr. 864, datë 24.12.2019.	Projektvendimi synon integrimin e të moshuarve në shoqëri, për një jetë më të gjatë, të shëndetshme dhe produktive dhe përditësimin e objektivave dhe masave në përputhje me ndryshimet demografike.	Jo	Programi i qeverisë 2021-2025 (Mirëqeniet për të gjithë, Familja: Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët më në nevojë)	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II - Shtylla 3: "Investimi në Kapitalin Njerëzor dhe Kohëzior Social". Dokumenti i Politikave për Moshimin	Ndikim financiar dhe social.
2	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9970, datë 24.7.2008 'Për barazinë gjinore në shoqëri'".	Projektligji	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katër mujori i dytë	Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", si pasojë e zhvillimeve ligjore dhe sociale duhet të rishikohet për të reflektuar kërkesat, nevojat dhe sfida të tjera përpara punës së institucioneve dhe dinamikat të lidhura edhe me ngjarjet e tërmetit të shtatorit 2019, pandemia Covid19, kërkesat që burojnë nga përafrimi i legjislacionit me Acquis dhe Kapitullin 19: Politikën Sociale dhe Të Punësimit dhe rekomandimet e raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare.	Ndryshimet ligjore do të adresojnë konceptet dhe përkufizimet për barazinë gjinore në shoqëri, të harmonizuara me standardet ndërkombëtare dhe Acquis të BE-së. Po ashtu, përmes ndryshimeve ligjore synohet forcimi i mekanizmave për nxitjen e zbatimit të masave për barazinë gjinore në nivel kombëtar, saktësimin e masave për çështje të aktualitetit dhe trajtimit të drejtave sociale-ekonomike, diversifikimi i pabarazive si edhe evolimi i formave të dhunës në trajta të ndryshme dhe më të sofistikuar.	Po, Kapitulli 19 "Politikën Sociale dhe të Punësimit"	Programi i qeverisë 2021-2025 (Mirëqeniet për të gjithë, Pabarazitë)	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II - Shtylla 3: "Investimi në Kapitalin Njerëzor dhe Kohëzior Social". Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026	Ndikim financiar dhe social.
3	Për një ndryshim dhe disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.237, datë 6.3.2009 "Për përcaktimin e kriterëve për hapjen dhe mbylljen e spitaleve"	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katër mujori i dytë	Për përshatjen e këtij akti nënligjor me ndryshimet ligjore të Ligjit nr. 55/2022 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" dhe me problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të këtij akti. Ligjin Nr. 123/2014, "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.	Personat juridikë, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e shërbimit spitalor jopublik, duhet të përshatet me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 55/2022, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", dhe në legjislacionin për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme të mëposhtme, si dhe kriteret e përcaktuara në shtojcat I, II e III, që i bashkëlidhen këtij vendimi.	Jo	Jo	Jo	Jo
4	"Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë"	Projektligji	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katër mujori i tretë	Reflektimin e kërkesës së Directives 2002/98/EC për autoritetin kompetent për hemovigjilencën	Menaxhimin e rrjetit të hemovigjilencës në nivel kombëtar	Po, Kapitulli 28 "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik"	Jo	Plani I veprimit 2024-2030 miratuar me Urdhërin e Ministrit Nr.77 date 13.02.2024	Jo



5	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore"	Projektligj	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katër mujori i tretë	Reflektim i kërkesave të Rregullores së parlamentit evropian dhe të keshillit 2017/745 "Për pajisjet mjekësore"	Vendosja në treg e pajisjeve mjekësore sipas standarteve dhe kërkesave të Bashkimit Europian	Po, Kapitulli 28 "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik"	Programi i qeverisë 2021-2025 Angazhimi: Investojmë në ndërtimin e një sistemi shëndetësor kombëtar të fortë, rezistent dhe gjithëpërfshirës – duke rritur investimet në infrastrukturën shëndetësore, përmirësuar kapacitetet, duke ruajtur forcën e punës në shëndetësi dhe duke promovuar kujdesin social, njëloj i rëndësishëm me atë shëndetësor. Kodi 12 Objekti: Ndërtimi i një sistemi shëndetësor kombëtar të fortë, rezistent dhe gjithëpërfshirës	VENDIM Nr. 210, datë 6.4.2022 PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË SHËNDETËSISË 2021-2030	Jo
6	Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9952/2008 "Per parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS"	Projektligj	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katër mujori i tretë	Fuqizimi i politikave parandaluese dhe kontrolluese për HIV/AIDS	Vendosjen dispozitave me të qarta lidhur me përgjegjësitë dhe rolin e institucioneve lidhur me hartimin e programeve për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS	Jo	Programi i qeverisë 2021-2025 Angazhimi: I japim përparësi parandalimit të sëmundjeve të transmetueshme dhe jo të transmetueshme. Kodi: 18 Objekti: Parandalimi i sëmundjeve të transmetueshme dhe jo të transmetueshme	Jo	Jo
7	"Për miratimin e Planit të Veprimit për Garancitë e Fëmijëve "	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katër mujori i tretë	Projektvendimi synon krijimin e Planit të Veprimit të Garancisë së Fëmijëve , sipas modelit Europian.	1. Harmonizimin me Garancinë e Fëmijëve të BE. 2. Mbështetja me shërbime gjithëpërfshirëse, sigurimi e mundësive të barabarta për fëmijët, me fokus ata nga grupe të marginalizuara, 3. Mirëqenia dhe të drejta për fëmijët	Po, Kapitulli 19 "Politikat Sociale dhe të Punësimit"	Programi i qeverisë 2021-2025 (Mirëqenia për të gjithë, Familja: Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët më në nevojë)	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030	Ndërkim financiar dhe social.



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2025
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"	Projektligji	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i parë	Rritja e shkalles se transpozimit te Direktives Kuader te Mbetjeve, qe ka pasuar ndryshime ne 2013, 2014 dhe 2018, vecanerisht amendimi i vitit 2018, duke futur konceptet e ekonomise qarkulluese dhe perditesimin e hierarkise se mbetjeve.	Projektakti do te realizoje perafrimin ne nje shkalle te avancuar te Direktives Kuader te Mbetjeve 2008/98/EC, te ndryshuar. Gjithashtu do te parashikojte per here te pare ne vend mekanizmat financiare per bashkite per financimin e menaxhimit te integruar te mbetimit dhe perfshirjen e Agjencise Kombetare te Ekonomise se Mbetjeve (AKEM) te krijuar ne Mars 2024 dhe koordinimin e monitorimin qe kjo agjenci do te realizoje me bashkite per menaxhimin e integruar te mbetjeve.	Po, Kapitulli 27 "Mjedis"	Po Menaxhim i integruar i mbetjeve në tërësinë e territorit sipas Masterplanit dhe Redukim me synim zhdukjen të ambalazhit plastik njëpërdorimësh.	Projektvendimi është në një linjë me Dokumentin e Politikave Strategjike per menaxhimin e integruar te mbetjeve	Po
2	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.710, datë 12.10.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e e veprimtarisë së operatorit turistik"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i parë	Mbingarkimi i procesit te licencimit me kriteret te panevojshme, nevoja per forcimin e mbrojtjes se konsumatorit.	Lehtesimi i procedurave/kritereve per ushtrimin e veprimtarive turistike te operatoreve turistike, mbrojtje me e mire e konsumatorit nepermjet shtimit te elementeve baze mbi te dhenat per kontraten me konsumatorin.	Jo	Jo	Strategjine Kombetare te Zhvillimit të Turizmit 2024-2030	Ndikime ekonomike - Po
3	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.709, datë 12.10.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e e veprimtarisë së Agjencisë së udhëtimit"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i parë	Mbingarkimi i procesit te licencimit me kriteret te panevojshme, nevoja per forcimin e mbrojtjes se konsumatorit.	Lehtesimi i procedurave/kritereve per ushtrimin e veprimtarive turistike te agjencive turistike, mbrojtje me e mire e konsumatorit nepermjet shtimit te elementeve baze mbi te dhenat per kontraten me konsumatorin.	Jo	Jo	Strategjine Kombetare te Zhvillimit të Turizmit 2024-2030	Ndikime ekonomike - Po
4	Për disa ndryshime në vendimin nr. 845, datë 28.10.2020 "Per miratimin e rregullave te hollesishme per zhvillimin e aktiviteteve turistike detare qe kryhen nepermjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i parë	Barriera te panevojshme ne certifikimin e operatoreve te turizmit detar.	Krijimi i një klime të favorshme biznesi për subjektet që ushtrojnë veprimtari të turizmit detar nëpërmjet heqjes së kritereve të panevojshme dhe lehtësimeve te metejshme procedurale.	Jo	Jo	Strategjine Kombetare te Zhvillimit të Turizmit 2024-2030	Ndikime ekonomike - Po



5	"Për shpalljen"Park Kombëtar", (Kategoria II) të një zone të mbrojtur	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i parë	Harmonizim i vendimeve aktuale të miratuara gjatë vitit 2022, me ndyshimet që pësoi ligjinr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" gjatë vitit 2024, në funksion të sigurimit të konformitetit dhe elementëve tekniko- formal të tyre	Qartësimi i veprimtarive të lejuara dhe të ndaluara në vendimin e shpalljes, specifikimi i formës së menaxhimit dhe adresimi I çështjeve të tjera të autorizuar nga dispozita ligjore e ligjit nr.81/2017 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar	Jo	Jo	Jo	Po
6	"Për shpalljen"Park Natyror", (Kategoria IV), të një zone të mbrojtur	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i parë	Harmonizim i vendimeve aktuale të miratuara gjatë vitit 2022, me ndyshimet që pësoi ligji nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" gjatë vitit 2024, në funksion të sigurimit të konformitetit dhe elementëve tekniko- formal të tyre	Qartësimi i veprimtarive të lejuara dhe të ndaluara në vendimin e shpalljes, specifikimi i formës së menaxhimit dhe adresimi I çështjeve të tjera të autorizuar nga dispozita ligjore e ligjit nr.81/2017 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar	Jo	Jo	Jo	Po
7	"Per krijimin, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i parë	Plotesimi i detyrimeve ligjore, pika 8, neni 17, ligji Nr. 21/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura	Krijimi i Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar, struktura dhe organika e saj	Jo	Jo	Jo	Po
8	Për disa ndryshime në vendimin nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit", i ndryshuar.	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i parë	Pershtatjen dhe harmonizimin me ndryshimet ligjore ne ligjin nr. 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar	Do te saktësoje strukturen per llogari te se ciles do te realizohet pagesa e tarifës; Mund te vlerësohet nevoja per rishikim te shumes se tarifës vjetore.	Jo	Jo	Jo	Ndikime te mundshme ekonomike-Po (Nese do te rishikohet masa e tarifës vjetore dhe ajo e tarifës se aplikimit).
9	"Për Gjuetinë"	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i dytë	përcaktimin e rregullave e të kërkesave për zhvillimin e gjuetisë së qëndrueshme, si një veprimtari tradicionale, sportive, çlodhëse dhe turistike, si edhe për të mundësuar mbrojtjen e faunës së egër dhe ruajtjen e biodiversitetit; b) ofrimin e mekanizmave për menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë, duke e vlerësuar faunën e egër si pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj; c) përcaktimin e masave për monitorimin dhe kontrollin me synim garantimin që parimet për gjuetinë të zbatohen në mënyrë rigorozë, duke ruajtur tërësinë e ekosistemit dhe baraspeshën ekologjike; ç mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik dhe ekuilibrit ekologjik të habitateve natyrore, faunës së egër dhe florës së egër) mosdëmtimin e llojeve të faunës së egër e të habitateve të tyre gjatë ushtrimit të gjuetisë; d) respektimin e së drejtës së gjuetisë dhe të të drejtave mbi gahun, mbi trofetë e produktet e gjuetisë dhe të tregtimit të tyre; dh) inkurajimin e përfshirjes së gjuetarëve në monitorimin, menaxhimin dhe kërkimin me qëllim përkujdesjen dhe ruajtjen e faunës së egër dhe të	Të përcaktojë rregulla të qarta dhe të përcaktoje institucionet qe do te menaxhojne gjuetine ne Shqiperi. Synon te perafrojte rregulloren eKëshillit (EEC) Nr. 3254/91 e datës 4 nëntor 1991 që ndalon përdorimin e kurtheve në Komunitet dhe futjen në Komunitet të lëvizshgave dhe mallrave të prodhuara të disa llojeve të kafshëve të egra me origjinë nga vendet që i kapin ato me anë të kurtheve për këmbë ose metoda e kurthit të cilat nuk plotësojnë standardet ndërkombëtare të standardeve humane të kurthit	Po, Kapitulli 27 "Mjedisit"	Jo	Jo	Po



					habitatit të vet saj; e) nxitjen e bashkëpunimit midis gjuetarëve dhe grupeve të tjerë të interesit në ruajtjen dhe menaxhimin e faunës së egër dhe të habitatit të vet saj					
10	"Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve spitalore"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i dytë	Plotesimi i detyrimeve ligjore, ne zbatim te nenit 35 "Mbetjet spitalore", të Ligjit 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".	Parashikon miremenaxhimin e mbetjeve spitalore. Kontrollin sasior, grumbullimin dhe mirëmenaxhimin e tyre nga pika krijuese deri në pikën fundore të trajtimit të tyre për mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve	Jo	Jo	Projektvendimi është në një linjë me Dokumentin e Politikave Strategjike per menaxhimin e integruar te mbetjeve	Po
11	Për përcaktimin e të dhënave parësore dhe dytësore të sistemit të të dhënave në turizëm."	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i dytë	Standardizimi i te dhenave dhe pershtatja e te dhenave me statistikat ndërkombëtare.	Nga problematikat qe kane lindur gjate hartimit te politikave te Turizmit ne vite vihet re qe kemi nje mungesë të këtyre te dhenave sidomos në nivele lokal ndaj hartimi i ketij akti do të: • Gjenerojë të dhëna kuptimplote si në nivel rajonal/bashkiak ashtu edhe në nivel kombëtar. • Sigurojë të dhëna të dobishme dhe të besueshme të turizmit për të gjithë sektorin e turizmit për planifikim, marketing, politikëbërje dhe rregullim si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. • Mundësojë përpilimin e një Kuadri Kombëtar Statistikor Plotësues të Turizmit (KSPT). • Gjenerojë 30 nga 43 indiktorët kryesorë të Sistemit Evropian të Indikatorëve të Turizmit (SEIT/ETIS).	Jo	Jo	Strategjine Kombetare te Zhvillimit të Turizmit 2024-2030	Jo
12	"Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin (rastet e lejuara), importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimi i rrugëve autopjore, përdorimi dhe standardet teknike të tyre"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i dytë	Me përfundimin e moratoriumit të pyjeve, bëhet I domosdoshëm përcatimi I rregullave dhe procedurave për shfrytëzimin e fondit pyjor	Të rregullojë procedurat e shfrytëzimit të fondit pyjor, të transportit të lëndës drusore dhe të tregëtimit të produkteve drusore.	Jo	Jo	Po lidhet me Programin Kombëtar të Pyjeve 2019-2030	Po
13	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 220, datë 11.3.2015 "Për miratimin e procedurës dhe kriterëve për pajisjen me ekoetiketë, mënyrën e përdorimit dhe vlefshmërinë e saj, dhe përbërjen e funksionimit e	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i dytë	Rritjen e nivelit te transpozimit te rregullores nr. 66/2010 te Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 nëntor 2009 për ekoetiketën.	Transpozimin e neneve te rregullores qe nuk jane transpozuar ende; Parashikimi i masave stimuluese me qellim aphikimin.	Jo	Jo	Jo	Ndikime te mundshme ekonomike, financiare -Jo. Ndikime te mundshme mjedisore- Po (promovimi i produkteve me



	komisionit për lëshimin e ekoetiketës"									ndikim më të reduktuar në mjedis)
14	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 598, datë 01.7.2015, të këshillit të ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i dytë	Reflektimin e disa ndryshimeve që vijnë si pasojë e ndryshimeve të realizuara në VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiëve e të afatëve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", i ndryshuar.	Do të përcaktoje institucionin dhe procedurat nepermjet të cilat do të njoftohet zhvilluesi i projektit të propozuar, nese nevojitet që t'i nenshtrohet procedurave të VNM në kontekst nderkufitar.	Jo	Jo	Jo	Jo
15	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 632, datë 11.06.2009 "Për miratimin e Tarifave të Perdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje dhe Kositje"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i dytë	Për të miratuar tarifën e përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje	Miratimin e Tarifave të Perdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje dhe Kositje	Jo	Jo	Jo	Po
16	"Për përcaktimin e rregullave të detajuara për organizimin dhe funksionimin e regjistrit, produktet dhe pajisjet përkatëse që regjistrohen, detyrimet e sipërmarrësve për të raportuar, si dhe niveli i aksesueshmërisë së regjistrit"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Plotesimi i detyrimeve ligjore, në zbatim të Ligjit nr. 2/2023 "për gazetën e fluoruara", Neni 16	Projektvendimi për miratimin e Regjistrit të Gazetave të Fluoruara rregullon disa çështje kryesore, përfshirë: 1. Përcaktimi i funksioneve të autoriteteve kompetente dhe funksionet e regjistrit për të mbajtur të dhënat mbi gazetën e fluoruara duke përfshirë formatin dhe afatet e raportimit. 2. Përcaktimi i detyrimeve që kanë subjektet që përdorin ose importojnë gaze të fluoruara për të siguruar përputhshmërinë me ligjin nr.2/2023 "për gazetën e fluoruara". 3. Rregullat për publikimin e informacionit të regjistruar, duke siguruar transparencë për publikun dhe për autoritetet kompetente. 4. Parashikimi i sanksioneve për mosrespektimin e rregullave dhe detyrimeve të raportimit.	Jo	Jo	Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike, Kontributi Kombëtar I Përcaktuar	Ndikimet e mundshme: Ekonomike- Po, Financiare- Po, Sociale- Jo dhe mjedisore- Jo
17	"Për disa ndryshime në vendimin nr.466 datë 03.07.2019 "Për miratimin e dokumentit strategjik dhe të planeve kombëtare për zbatimin e gazave me efekt sërre dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Plotesimi i detyrimeve ligjore, në zbatim të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit nr. 155/2020 "Për ndryshimet klimatike"	Plani i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike pritet të përmirësojë disa çështje kryesore, si: 1. Vlerësimi i ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe identifikimi i rreziqeve për komunitetet, mjedisin dhe ekonominë. 2. Planifikimi i përmirësimeve në infrastrukturën për të përballuar fenomene të tilla si përmytjet, thatësira dhe zjarret në pyje, etj.	Jo	Jo	Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike, Kontributi Kombëtar I Përcaktuar	Ndikimet e mundshme: Ekonomike- Po, Financiare- Po, Sociale- Po dhe mjedisore- Po



						3. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, përfshirë ujërat, tokat dhe biodiversitetin. 4. Adresimi i ndikimeve të ndryshmeve klimatike në shëndetin e popullsisë, përfshirë sëmundjet e lidhura me klimën. 5. Nxitjen e bashkëpunimit mes komuniteteve dhe institucioneve, si dhe edukimi i publikut për të rritur ndjeshmërinë ndaj këtyre çështjeve. 6. Identifikimi i burimeve financiare për zbatimin e masave të përshtatjes dhe sigurimin e mbështetjes për grupet më të rrezikuara. 7. Krijimi i mekanizmave për të monitoruar zbatimin dhe për të vlerësuar efektivitetin e masave të marra.				
18	"Për rishikimin e vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 581, datë 6.10.2021 "Për miratimin e dokumentit të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar"" 2025-2035"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Plotesimi i detyrimeve ligjore, ne zbatim te pikes 5, te nenit 7 te Ligjit nr. 155/2020 "per ndryshimet klimatike"	Rishikimi i dokumentit i kontributit kombëtar të përcaktuar (NDC) ka për synim përditesimin e këtij dokumenti, duke e harmonizuar me Planin Kombëtar Për energji dhe Klimën i cili rrishte aktualisht është në proces të miratimit të rishikimit, si dhe për të adresuar kërkesat e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) drejtuar paleve për të rritur ambiciet dhe angazhimin për arritjen e objektivit global për mbajtjen e temperaturave të ngrohjes globale nën 2°C. Ky projektvendim do të adresojë çështje kyçe që lidhen me emetimet e gazeve sërë, ku përcaktohen objektivat për reduktimin e tyre në sektorë të ndryshëm si energjia, transporti, mbetjet, bujqësia dhe industria. Miratimi i këtij projektvendimi ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm, duke siguruar që masat e reduktimit të shkarkimeve	Jo	Jo	Kontributi Kombëtar i Përcaktuar	Ndikimet e mundshme: Ekonomike- Po, Financiare- Po, Sociale- Po dhe mjedisore- Po



						të kontribuojnë gjithashtu në zhvillimin ekonomik dhe social. Një aspekt i rëndësishëm është financimi, që përcakton burimet dhe investimet e nevojshme për zbatimin e masave, duke ofruar gjithashtu mbështetje për vendet në zhvillim. Pjesa e përshtatjes përfshin masat për përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshmeve klimatike, me qëllim mbrojtjen e komuniteteve vulnerabël dhe burimeve natyrore. Rishikimi i dokumentit është në përputhje me afatet e përcaktuara nga Konventa, dhe sipas Ligjit Nr.155/2020.				
19	"Për disa ndryshime në vendim nr. 665, datë 21.9.2016 "Për eksportin dhe importin e Kimikateve të rrezikshme"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Plotesimi i detyrimeve ligjore, ne zbatim të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve". Ky projektvendim synon të përfshijë versionin me të fundit të Regulation (EU) No 649/2012 of the European Parliament and of the Council of 4 July 2012 concerning the export and import of hazardous chemicals	Qëllimi i këtij projektakti është përditësimi i ligjislacionit kombëtar me atë të BE-së, duke rishikuar listën e kimikateve të cilat kufizohen për t'u vendosur në treg.	Po, Kapitulli 27 "Mjedis"	Jo	Kimikatet nuk kanë një dokument strategjik	Ndikimet e mundshme: Ekonomike- Jo, Financiare- Jo, Sociale- Po dhe mjedisore- Po
20	"Për disa ndryshime në vendim nr. 594, datë 10.9.2014 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit" dhe vendim nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Plotesimi i detyrimeve ligjore të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar dhe të nenit 7, të ligjit nr. 162/2014, "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", I ndryshuar si dhe detyrimi i adresimit të rekomandimeve të lena nga KLSH	Projektakti synon të rishikoj Strategjinë dhe Planin Kombëtar të cilësisë së ajrit, si dhe do të përcaktojë objektivat për të përmirësuar më tej cilësinë e ajrit në Shqipëri për periudhën afatgjatë duke përcaktuar objektivat për reduktimin e shkarkimeve në sektorët që kontribuojnë në shkarkimet në ajër.	Jo	Jo	Strategjia Kombëtare për Cilësinë e ajrit të mjedisit	Ndikimet e mundshme: Ekonomike- Po, Financiare- Po, Sociale- Po dhe mjedisore- Po
21	"Për vendosjen e normave, standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave të mira të unifikuara në fushën e pyjeve.	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Përcaktimi i normave të punës për aktivitetet që kryhen mbi fondin pyjor si dhe përditësimi në funksion të çmimeve aktuale të tregut	Miratimi i normave dhe standardeve për shërbimin ndaj fondi pyjor kombëtar (të gjitha veprimtaritë që zhvillohen në të).	Jo	Jo	Po lidhet me Programin Kombëtar të Pyjeve 2019-2031	Po
22	"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 633, datë 15.7.2015 "Për miratimin e procedurave dhe të kërkësve për dhënie të skemave të ekomenaxhimit dhe auditimit"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Rritjen e nivelit të transpozimit të rregullores së Këshillit dhe Parlamentit Evropian nr.1221/2009, datë 25 nëntor 2009, "Mbi pjesëmarrjen vullnetare nga organizatat në një skemë ekomenaxhimi dhe auditimi të komunitetit, EMAS".	Transpozimin e neneve të rregullores që nuk janë transpozuar ende; Saktësimin e institucioneve përgjegjëse të përfshira.	Jo	Jo	Jo	Ndikime të mundshme mjedisore - Po, nepermjet përmirësimit të performancës së organizatave.
23	"Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor.	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Plotesim i detyrimeve ligjore, ne zbatim të përcaktimeve në nenin 24 të ligjit nr. 10440 date 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar.	Do të përcaktojë rregullat, procedurat dhe kriteret për kandidatet e interesuar për tu pajisur me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis.	Jo	Jo	Jo	Ndikime të mundshme ekonomike, financiare -Po (Tarifa e pagesës). Ndikime të mundshme mjedisore - Po



										(Permiresimi i raporteve mjedisore).
24	Per kriteret dhe rregullat e dhënies në përdorim të fondit pyjor kombëtar për nevojat e komuniteteve rurale	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Përcakton rregullat për përdorimin e Fondit Pyjor Kombëtar për nevojat e banorëve që banojnë në afërsi të zonave pyjore.	Të përcaktojë rregulla për përdorimin e Fondit Pyjor Kombëtar nga komunitetet në afërsi të pyjeve.	Jo	Jo	Po lidhet me Programin Kombëtar të Pyjeve 2019-2030	Po
25	"Për miratimin e masave për programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Plotesim i detyrimeve ligjore, në zbatim të nenit 14 "Rikuperimi i mbetjeve", të Ligjit 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".	Parashikohet parandalimi i krijimit të mbetjeve duke përfshirë objektivat sasiorë dhe cilësore. Programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve do të në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve si dhe me planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve.	Jo	Jo	Projektvendimi është në një linjë me Strategjinë Kombëtar për menaxhimin e mbetjeve.	Projektvendimi do të ketë ndikim ekonomik dhe mjedisor.
26	"Për miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Sigurt të Kimikateve"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Plotesimi i detyrimeve ligjore, në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve"	Miratimi i Planit Kombëtar të Kimikateve synon harmonizimin e masave që duhen ndërmarrë nga të gjithë institucionet politikberese dhe ligjzbatuese në 5 vitet e ardhshme, për të siguruar menaxhimin e sigurt të kimikateve në një qasje ndër-institucionale dhe ndërsëktoriale, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga kimikatet.	Jo	Jo	Kimikatet nuk kanë një dokument strategjik	Ndikimet e mundshme: Ekonomike- Po, Financiare- Po, Sociale- Po dhe mjedisore- Po
27	Për disa ndryshime në vendimin nr. 730, datë 20.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, aftatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori i tretë	Harmonizimi i VKM me ndryshimet ligjore të miratuara gjatë vitit 2024 lidhur me procesin e klasifikimit të strukturave akomoduese, për shkak të shtimit të strukturave akomoduese.	Reduktimi i informalitetit, rritja e standardeve në ofrimin e shërbimeve të akomodimit, mbrojtje me c mëre për konsumatorët, organizim me të mire në kuader të grumbullimit të të dhënave statistikore në turizëm.	Jo	Jo	Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit 2024-2030	Ndikim social- Po



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2025

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për disa shtesa/ndryshime në vendimin nr.450, datë 26.7.2018 "Për bashkërendimin dhe kordinimin e procesit të integritit evropian ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësjive të vetëqeverisjes vendore"	Projektvendim	Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor	Katër mujori i parë	Forcimi i strukturave bashkiake për proceset e integritit evropian; zgjerimi i kompetencave për t'u përgjigjur sfidave të procesit të negociimit; përmirësim i mekanizimit të bashkëpunimit midis tyre dhe pushtetit qendror;	Ngritje kapacitetesh për hartimin dhe menaxhimin e projekteve; Struktura të konsoliduara për pëmbushjen e detyrimeve për kapitullin 22 Zhvillimi Rajonal dhe Kohezioni	Jo	Jo	Projektakti lidhet me Strategjinë Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030	Përmirësimi i shërbimeve dhe të ardhurave për bashkitë;
2	Për krijimin dhe organizimin e Akademisë së Pushtetit Vendor	Projektvendim	Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor	Katër mujori i dytë	Krijimi i qendrës së trajnimit për pushtetin vendor në bashkëpunim me shoqatën e bashkive; Ngritje dhe forcim i kapaciteteve vendore;	Kualifikim i vazhdueshëm i burimeve njerëzore të qeverisjes vendore në fusha të ndryshme; Shtrirja e trajnimeve në të gjitha nivelet e qeverisjes vendore; Njësia trajtuese në mënyrën e organizimit dhe kryerjes së trajnimeve; Përfshirja e funksionarëve politikë në trajnime	Jo	Jo	Projektakti lidhet me Strategjinë Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030	Përmirësimi i dhënies së shërbimeve në bashki duke qenë se kapacitetet e stafëve do të forcohen;
3	Për disa shtesa/ndryshime të Ligjit nr.68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore" i ndryshuar	Projektligj	Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor	Katër mujori i tretë	Ndryshimi i formulës për transfertën e pakushtëzuar financiare si dhe kategorizimi i taksave vendore për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave për përdorimin e reklamave/tabelave	Rregullimin e skemës së financimit të bashkive; Përshtatja e parimit të ekualizimit të lidhur me numrin e popullsisë sipas Censit 2023; Stabilitet financiar për bashkitë me të ardhura të ulëta; ndryshimi i tabelës që ndan bashkitë sipas kategorisë	Jo	Jo	Projektakti lidhet me Strategjinë Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030	Rritja e të ardhurave për bashkitë që kanë performancë më të mirë; Me shumë të ardhura nga taksa e reklamës për një numër më të madh bashkish;
4	Për Ndërmarrjet Publike Vendore	Projektligj	Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor	Katër mujori i tretë	Rijetësimi i aseteve të bashkive si mjet për të krijuar të ardhura të veta për bashkitë; Ndikim në zhvillimin ekonomik vendor	Rikonceptimin e organizimit dhe funksionimit të ndërmarrjeve shtetërore vendore; Përmirësimi i mënyrës se si përdoren asetet e bashkive dhe nivelit të të ardhurave vendore;	Jo	Jo	Projektakti lidhet me Strategjinë Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030	Rritja e të ardhurave për bashkitë që kanë performancë më të mirë;



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2025
Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikojnë rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për përcaktimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Përgjithshëm	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i dytë	Neni 12 dhe 16 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Organizimi, funksionet dhe misioni i Inspektoratit të Përgjithshëm; Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit të Përgjithshëm për inspektoratet qendrore dhe ato vendore; Kriteret dhe procedura për përzgjedhjen dhe emërimin e inspektorit të Përgjithshëm dhe zëvendësit; Raportimi i veprimtarive inspektuese.	Jo	Po, Modernizim për zhvillim	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027	Po, financiare, ekonomike dhe sociale
2	Për përcaktimin e institucioneve/strukturave inspektuese që nrioganzohen sipas ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i dytë	Neni 3 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Riorganizimi i inspektorateve dhe strukturave që ushtrojnë funksione inspektuese bazuar në fushat e inspektimit, fushat e lidhura me risqet e ngjashme dhe sipas parimeve të ligjit për inspektimin.	Jo	Jo	Jo	Po, ekonomike dhe mjedisore
3	Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të denimeve administrative në procesin e inspektimeve	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i dytë	Neni 44 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Kategorizimi i denimeve administrative, duke parashikuar dënimin administrativ kryesor "paralajmërim" në inspektimin e parë të trupës inspektuese; përcaktimin e një metodologjie të unifikuar, standardizimit dhe përcaktimin e faktorëve në marrjen e dënimit administrativ; klasifikimin dhe sistematizimin e faktorëve për secilin inspektorat përmes një sistemi pikëzimi; implementimin e metodologjisë së përcaktimit të denimeve administrative në sistemin elektronik "e-Inspektimi".	Jo	Po, Modernizim për zhvillim	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027	Jo
4	Për klasifikimin e inspektorëve dhe përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen, emërimin, lirin dhe shkarkimin e kryeinspektorit dhe inspektorit të Inspektoratit të Përgjithshëm dhe inspektoratit qendror	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i dytë	Neni 20 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Klasifikimi i niveleve të inspektorëve bazuar në kompetencat, përvojën dhe fushën e tyre të veprimtari; standardizimi i kriterëve të rekrutimit dhe karrierës; përcaktimi i strukturës, përberjes dhe funksioneve të komisionit të rekrutimit dhe ecurisë në karrierë; përcaktimi i kriterëve të përzgjedhjes së kandidatëve për inspektor dhe metodologjinë që do të ndiqet për vlerësimin e kandidatëve; përcaktimi i kriterëve për ngjitjen në detyrë.	Jo	Jo	Jo	Jo
5	Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin dhe organizimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i dytë	Neni 55 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Funksionimi efektiv dhe i drejtë i komisionit të shqyrtimit të ankimit, përberja dhe përgjegjësitë e komisionit; procedura dhe afatet për shqyrtimin e ankimit; kriteret e pranueshmërisë së ankimit; transparenca dhe komunikimi i vendimeve; dokumentimi dhe arkivimi i vendimeve.	Jo	Jo	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027	Po, financiare dhe ekonomike
6	Për miratimin e Rregullores "Për funksionimin, organizimin dhe përberjen e Bordit të Inspektimeve	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i dytë	Neni 14 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Mënyra e funksionimit dhe organizimit të Bordit të Inspektimeve, përberja dhe emërimi i anëtarëve; kompetencat dhe detyrat e bordit; procedura e marrjes së vendimeve nga anëtarët e bordit; raportimi dhe dokumentimi i veprimtarive inspektuese përpara bordit.	Jo	Jo	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027	Po, financiare dhe ekonomike



7	Për mënyrën e bashkëpunimit, shkëmbimin e informacionit dhe rregullave e procedurave gjatë ushtrimit të veprimtarisë së inspektimit në fushën tatimore për verifikimin në terren	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i tretë	Neni 3 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Unifikimi dhe standardizimi i procedurave inspektuese edhe nga inspektimi në fushën tatimore nga sektori i verifikimit në terren; parimet e veprimtarisë inspektuese tatimore në terren; mënyra e bashkëpunimit; shkëmbimi i informacionit; përcaktimi i rregullave dhe procedurave për inspektimin.	Jo	Jo	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027	Jo
8	Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për administrimin e sistemit elektronik "e-Inspektimi" nga Inspektorati i Përgjithshëm, mbikëqyrjen online dhe në terren dhe raportimin	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i tretë	Neni 13 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Procedurat e mbikëqyrjes së inspektimeve në sistemin elektronik "e-Inspektimi" dhe në terren; rregullat për dokumentimin e veprimtarisë inspektuese; bashkërendimi dhe koordinimi i veprimtarive inspektuese; mbikëqyrja online dhe në terren, raportimi.	Jo	Po, Modernizim për zhvillim	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027	Po, financiare
9	Për vlerësimin e rezultateve në punë të inspektorit, si dhe përfitim dhe përditësimin e njohurive shtesë	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i tretë	Neni 20, 21 dhe 23 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Kriteret e vlerësimit të inspektorëve të Inspektoratit të Përgjithshëm dhe inspektorateve qendrore, metodologjia e vlerësimit; vlerësimi i bazuar në rezultate dhe objektiva; përcaktimi i nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional; trajnimi, testimi dhe certifikimi i inspektorëve.	Jo	Jo	Jo	Jo
10	Për përcaktimin e llojeve dhe procedurave të masave disiplinore dhe të rregullave për ngrifjen, përbërjen dhe vendimarrjen e Komisionit Disiplinor për kryeinspektorin dhe inspektorin	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i tretë	Neni 20 dhe 22 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Çështjet që lidhen me përgjegjësinë disiplinore, organet disiplinore, llojet dhe procedurat e masave disiplinore që mund të zbatohen ndaj kryeinspektorit, inspektorit qendror/rajonal dhe inspektorit të Inspektoratit të Përgjithshëm, parimet për vendosjen e masës disiplinore, duke vendosur theksin në parimin e proporcionalitetit, ankimi dhe afatet.	Jo	Jo	Jo	Jo
11	Për programimin e inspektimeve dhe metodologjinë e vlerësimit të riskut	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i tretë	Neni 32 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Programimi i inspektimeve; përcaktimi i treguesve dhe faktorëve për klasifikimin e subjekteve në kategori risku të ndryshme; metodologjia e vlerësimit të riskut; standardizimi i procedurave; përcaktimi i rolit dhe përgjegjësi të inspektorateve; sistemi elektronik "e-Inspektimi" mbi bazën e vlerësimit të riskut.	Jo	Po, Modernizim për zhvillim	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027	Jo
12	Për përcaktimin e periudhës maksimale të inspektimeve vjetore dhe mënyrën e llogaritjes	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i tretë	Neni 34 dhe 35 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Periudha maksimale e lejuar e inspektimeve vjetore; frekuenca e inspektimeve; kategorizimi i subjekteve në sistemin elektronik të inspektimeve; përcaktimi i faktorëve dhe kriterëve për inspektimin e subjektit; standardizimi i inspektimeve.	Jo	Po, Modernizim për zhvillim	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027	Jo
13	Për përcaktimin e procedurave të hollësishme për marrjen, trajtimin e mostrave dhe kryerjen e ekspertizave, si dhe miratimin e metodologjisë së llogaritjes së shpenzimeve në këto procedura	Projektvendim	ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit	Katër mujori i tretë	Neni 51 i ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"	Procedura e marrjes së mostrave për analizë; kriteret për përzgjedhjen e mostrave; trajtimi i mostrave për analizë; standardet e ruajtjes dhe transportit të mostrave; marrja dhe dorëzimi i mostrave dhe dokumentimi; procedura për kryerjen e analizës laboratorike; metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve në këto procedura.	Jo	Jo	Jo	Jo

**VENDIM****Nr. 821, datë 26.12.2024****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE DHE
TË ORGANEVE QË FUNKSIONOJNË
PRANË SAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të neneve 14, pika 5, dhe 15, pika 2, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ndryshuar, si dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe të organeve që funksionojnë pranë saj”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 360, datë 26.4.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 1 janar 2025.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

RREGULLORE**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
ARKIVAVE DHE TË ORGANEVE QË
FUNKSIONOJNË PRANË SAJ****Neni 1****Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (në vijim “DPA”) është institucion qendror, në varësi të Kryeministrit. Ajo është autoriteti më i lartë

metodiko-profesional i rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave u propozon për miratim organeve të parashikuara me ligj projektakte ligjore e nënlige për norma teknike e profesionale të punës me dokumentet arkivore dhe standardet e ruajtjes së tyre, për zbatim në të gjithë rrjetin arkivor të vendit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave raporton me shkrim për veprimtarinë e saj, një herë në vit, pranë Këshillit të Lartë të Arkivave.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka për detyrë të bëjë të njohur, në shkallë vendi, ligje, vendime, udhëzime, si dhe vendimet këshillimore (rekomandimet) të organizmave ndërkombëtarë, ku arkivat shtetërore të vendit janë anëtarë, që kanë të bëjnë me administrimin e dokumentit përgjatë gjithë ciklit të jetës së tij.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka për detyrë të bashkëpunojë me autoritetet publike, si dhe me organet joshtetërore për administrimin ligjor të pasurisë arkivore, kudo që ajo ekziston ose krijohet.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përgjigjet për plotësimin e kërkesave dhe të ankesave të qytetarëve dhe të subjekteve shtetërore e joshtetërore për shërbimin që ofrohet nga Arkivi Qendror Shtetëror, arkivat shtetërore vendore dhe arkivat e sistemit.

7. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të DPA-së (në vijim “Rregullorja e brendshme”) miratohet nga Kryeministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm.

8. DPA-ja ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e Drejtorisë përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

9. Vula e DPA-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Neni 2

Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave

Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave miratohen nga Kryeministri, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Neni 3

Drejtori i përgjithshëm

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e saj, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretë.

2. Drejtori i përgjithshëm i Arkivave, përveç detyrave të parashikuara në ligj, kryen edhe këto detyra:

a) Është kryesuesi i rrjetit arkivor dhe ushtron drejtimin metodiko-profesional të punës me dokumentet në të gjitha arkivat e përhershëm, arkivat qendrorë në veprim, si dhe në arkivat e institucioneve të administratës shtetërore në veprim, të parashikuara në ligjin “Për arkivat”;

b) Nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit ndërinstitucional;

c) Nënshkruan në emër të institucionit që drejton marrëveshje dy- ose më shumëpalëshe për bashkëpunim ndërkarkivistik me partnerë të huaj;

ç) U rekomandon organeve përgjegjëse, autoriteteve publike dhe subjekteve joshetërore ndryshimin e akteve administrative për punën me dokumente, të miratuara prej tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) Bashkërendon punën e strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, i ndihmon ato për funksionimin normal dhe zgjidh çështjet që tejkalojnë përgjegjësitë e tyre, si dhe miraton rregullore, urdhra e udhëzime për funksionimin e brendshëm të strukturave;

dh) U delegon autoritet përfaqësimi zëvendësrejtoreve të përgjithshëm ose drejtoreve të drejtorive për probleme të ndryshme të punës, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

e) Drejton dhe udhëheq veprimtarinë e trupës inspektuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, në përputhje me kërkesat e ligjit për inspektimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Drejtori i përgjithshëm i Arkivave asistohet dhe mbështetet nga dy zëvendësrejtore të përgjithshëm, të cilët bashkërendojnë dhe mbikëqyrin veprimtarinë e funksioneve të veçanta të përcaktuara në rregulloren e brendshme, ose në rregulloret që miratohen nga drejtori i përgjithshëm i DPA-së, në bazë të nenit 11, pika 1, shkronja “b” të ligjit “Për arkivat”, të ndryshuar, si dhe përfaqësojnë DPA-në me delegim të drejtorit të përgjithshëm.

Neni 4

Funksionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave ka këto funksione:

a) Kryen përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të depozituara në Arkivin Qendror Shtetëror, arkivat shtetërore vendorë dhe arkivat e sistemit, kur ato janë pranuar sipas ligjit “Për arkivat”;

b) Kryen evidencimin e fondeve arkivore, cildo qoftë bartësi material i dokumenteve të parashikuar në ligj;

c) Ndjek, zbaton dhe kontrollon kërkesat teknologjike të ruajtjes fizike të dokumenteve të fondeve që ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror (AQSH), arkivat shtetërore vendorë dhe arkivat e sistemit dhe bën shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen e dokumenteve e mikrofilmave që janë në ruajtje dhe administrim të përhershëm ose të përkohshëm në DPA; siguron ruajtjen fizike të dokumenteve e mikrofilmave, duke zbatuar rregullat për mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre;

ç) Kryen veprimet e pranimi të dokumenteve që kalojnë për ruajtje të përhershme nga autoritetet publike në AQSH, arkivat shtetërore vendorë dhe arkivat e sistemit, sipas përparësisë, si dhe kryen veprimet për marrjen në dorëzim të dokumenteve të dhuruara e të blera;

d) Bën restaurimin, trajtimin kimik dhe dezinfektimin e dokumenteve;

dh) Organizon dhe ndjek zbatueshmërinë metodologjike-profesionale të veprimtarisë arkivore në gjithë rrjetin arkivor, në arkivat shtetërore e ato joshetërore, në sekretari-arkivat e institucioneve qendrore e vendore në veprim dhe propozon



përsosjen e shërbimit për njësi të veçanta apo për gjithë rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë;

e) Kontrollon zbatimin e ligjit për arkivat, si dhe të akteve nënligjore për punën me dokumentet në gjithë rrjetin arkivor të vendit, pavarësisht nga vartësia e tyre administrative. Ajo e ushtron këtë përgjegjësi edhe në arkivat e personave juridikë e fizikë privatë, që administrojnë dokumente me rëndësi historike kombëtare;

ë) Vendos sanksione administrative, bazuar në legjislacionin në fuqi;

f) Organizon punën për hartimin e projekteve dhe paraqet për miratim standarde të reja ligjore e nënligjore, studime, literaturë teorike e mjete metodike për punën me dokumentet dhe arkivat;

g) Organizon dhe drejton përgatitjen profesionale e bashkëpunimin e arkivistëve të të gjitha niveleve në shkallë kombëtare, nëpërmjet kurseve afatshkurtra dhe afatmesme për kualifikimin e arkivistëve e të punonjësve të sekretari-arkivave; bën seminare tematike për probleme të punës arkivore në shkallë kombëtare, si dhe drejtimin e konferencave ndërkombëtare, që ndërmerren si iniciativa prej Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe partnerëve të saj;

gj) Ndjek, zbaton dhe kontrollon procedurat e krijimit, të ruajtjes dhe të aksesit të dokumenteve të digjitalizuara dhe të mikrofilmuara të fondeve që ruhen në arkivat në varësi të saj, sipas normave tekniko-shkencore të hartuara për këtë qëllim;

h) Vë në dispozicion të kërkuesve mjetet e informimit dhe shërben dokumentet në përputhje me rregulloren e shfrytëzimit. Kohëzgjatja javore e punës për nëpunësit dhe punonjësit e sallës së studimit mund të përfshijë edhe ditët e fundjavës;

i) Bën modernizimin e vijueshëm të mjeteve të kërkimit arkivor, harton, aparate informative shkencore të llojeve të ndryshme, në përputhje me skemën e klasifikimit të dokumenteve, si katalogë, udhërrëfyes, historikë fondesh, regjistra dhe botime të tjera me karakter njohës informues;

j) Përgatit dhe organizon evente të ndryshme me karakter promovues e shkencor; mirëmban muzeun, fonotekën dhe fototekën. Kohëzgjatja javore e punës për nëpunësit dhe punonjësit e sektorit përgjegjës për muzeun arkivor mund të përfshijë edhe ditët e fundjavës.

Neni 5

Trupa Inspektuese

1. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave funksionon Trupa Inspektuese, strukturë përgjegjëse për inspektimin bazuar në legjislacionin në fuqi për inspektimet.

2. Mënyra e organizimit të Trupës Inspektuese, si strukturë përgjegjëse për inspektimin, përcaktohen në strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Neni 6

Arkivat e përhershëm në përbërje të DPA-së

Arkivat e përhershëm në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave janë Arkivi Qendror Shtetëror, arkivat shtetërorë vendorë dhe arkivat e sistemit. Mënyra e organizimit të tyre përcaktohen në strukturën organizative të DPA-së.

Neni 7

Trajnimi profesional

1. DPA-ja organizon dhe drejton përgatitjen profesionale të punonjësve të sekretari-arkivave të të gjithë rrjetit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

2. DPA-ja ofron programe trajnimi arkivor, të thelluara dhe afatshkurtra, për aftësimin e nëpunësve të autoriteteve publike, si dhe për përgatitjen dhe aftësimin paraprak të individëve/personave që duan të punësohen në rrjetin arkivor.

3. DPA-ja ofron programe trajnimi pa pagesë për nëpunësit e autoriteteve publike që kryejnë detyrat e sekretari-arkivit ose që janë të ngarkuar me punën me dokumentet, si dhe për nëpunësit e tjerë që kryejnë detyra të ndryshme nga ato të sekretari-arkivit në autoritetet publike, të cilët dëshirojnë të ndjekin programet e trajnimit arkivor për përfundimin e njohurive në proceset e punës me dokumentet, në bazë të kërkesave nga subjektet apo të nëpunësve.

4. Ky shërbim ofrohet edhe për individët dhe personat që nuk janë nëpunës të autoriteteve publike, por që me kërkesën dhe vullnetin e tyre dëshirojnë të ndjekin programin e trajnimit arkivor, sipas rregullave të vendosura nga DPA-ja.

5. Programi i trajnimit arkivor i thelluar përmban 60 orë trajnimi me kohëzgjatje dyjavore, që mund të zhvillohet edhe me ditë të caktuara kalendarike brenda një muaji. Në programin e trajnimit arkivor



të thelluar përfshihen 42 orë trajnim teorik dhe 18 orë praktikë pune arkivore për përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve. Programet e trajnimit arkivor afatshkurtër mund të zhvillohen brenda një dite ose dy ditësh me 3–6 orë trajnimi në ditë, në varësi të temave të caktuara.

6. Programet dhe mënyra e organizimit të trajnimeve, të thelluara dhe afatshkurtra, përcaktohen nga DPA-ja.

7. Mënyra e organizimit dhe rregullat për programet e trajnimit që mund të zhvillohen në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë ose institucionet përgjegjëse për trajnimet, si dhe për zhvillimin e programeve akademike të institucioneve të arsimit të lartë në mjediset e DPA-së pa detyrime financiare të ndërsjella përcaktohen në marrëveshjet e nënshkruara mes dy institucioneve.

8. Për nëpunësit e autoriteteve publike, që ndjekin trajnimet e zhvilluara pranë DPA-së, ditët e pjesëmarrjes në trajnime u njihen si ditë pune.

Neni 8

Shërbimet arkivore

1. Salla e studimit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave shërben për konsultimin e të gjithë arkivave, pjesë të DPA-së. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përcakton rregullat e shërbimit arkivor nga arkivat e përhershëm në varësi të institucioneve të tjera, në përputhje me nenin 15 të ligjit “Për arkivat”. Në rast se këto rregulla parashikojnë shërbimin e integruar të dokumenteve arkivore, DPA-ja mbulon koston e digjitalizimit të dokumenteve të kërkuara prej tyre nga studiuesit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka bibliotekën, fototekën dhe arkivin audiovizual. Shërbimi i tyre kryhet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit.

3. “Muzeu arkivor” është hapësira e ekspozimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe është i hapur për publikun. Rregullat e “Muzeut arkivor” dhe mjedisëve të tjera multifunksionale përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit.

4. Në kuadër të ruajtjes së dokumenteve të Drejtorisë së Përgjithshme e Arkivave, DPA-ja, me kërkesë të qytetarëve dhe subjekteve të interesuara, mund të ofrojë restaurimin e dokumenteve të palëve të treta.

5. Shërbimet arkivore, të përshkruara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, kryhen kundrejt pagesës sipas

tarifave të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të nenit 77 të ligjit “Për arkivat”.

Neni 9

Organet që funksionojnë pranë DPA-së

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave funksionojnë:

a) Këshilli i Lartë i Arkivave (KLA);
b) Komisioni Qendror i Ekspertizës (KQE);
c) Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH);

ç) Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve të vlerësimit të Dokumenteve me RHK (KPE).

2. Mandati i anëtarëve të këtyre organeve është tre vjet dhe ndërpritet kur anëtari:

a) mungon tri herë radhazi pa arsye;
b) jep dorëheqjen;
c) nuk punon më në institucionin që e ka caktuar.

3. Caktimi i personave si anëtarë të këtyre organeve, nga pikëpamja formale-procedurale, kryhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave, pas përzgjedhjes së tyre, sipas rastit nga DPA-ja për anëtarët e brendshëm, si dhe nga institucionet e tjera për anëtarët e jashtëm. Mbledhja e parë bëhet jo më vonë se një muaj nga data e njoftimit të përbërjes nominale. Në mbledhjen e parë bëhet zgjedhja e sekretarit.

4. Mbledhja e këtyre organeve thirret nga kryetari ose nga një e treta e anëtarëve të saj. Ajo mbahet kur është e pranishme shumica e anëtarëve dhe jo më pak se një herë në vit. Rendi i ditës dhe aktet për diskutim vihen në dispozicion të anëtarëve jo më vonë se një javë para datës së mbledhjes. Çdo anëtar ka të drejtë të bëjë propozime për ndryshime e shtesa në rendin e ditës. Propozimet miratohen ose kundërshtohen me votimin e shumicës së thjeshtë të pjesëmarrësve në mbledhje. Votimi kundër i anëtarit duhet të shoqërohet me shpjegim me shkrim. Në rastet kur votimi del i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 10

Këshilli i Lartë i Arkivave (KLA)

1. KLA-ja është organ ndërinstitucional vendimmarrës, para të cilit Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave raporton për veprimtarinë e saj, një herë në vit.



2. KLA-ja përbëhet nga 17 anëtarë, 8 të brendshëm dhe 9 të jashtëm. Anëtarë të brendshëm janë drejtori i përgjithshëm i Arkivave, zëvendës drejtorët e përgjithshëm dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga drejtori i përgjithshëm nga radhët e drejtuesve të njësisë organizative të DPA-së. Anëtarët e jashtëm të KLA-së caktohen nga titullarët e institucioneve që përfaqësojnë, si më poshtë vijon:

- a) dy përfaqësues të Akademisë së Shkencave;
- b) një përfaqësues i Universitetit të Tiranës, me titull akademik në fushën e arkivistikës ose të historisë;
- c) drejtori i Arkivit Historik dhe Diplomatik;
- ç) drejtori i Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit;
- d) drejtori i Arkivit Qendror Shtetëror të Drejtësisë;
- dh) drejtori i Arkivit të Kuvendit;
- e) drejtori i Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit;
- ë) një përfaqësues i arkivave qendrorë në veprim, i zgjedhur me votim të fshehtë, nga mbledhja e drejtorëve të tyre.

3. Kryetar i KLA-së është drejtori i përgjithshëm i Arkivave. Kryetari miraton rendin e ditës të mbledhjes së KLA-së, drejton mbledhjen dhe nënshkruan vendimet e marra.

4. Sekretari i KLA-së është një prej zëvendës drejtorëve të përgjithshëm, i zgjedhur me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Ai ushtron përgjegjësinë e kryetarit për drejtimin e mbledhjes së KLA-së në mungesë dhe me urdhër të tij.

5. Këshilli i Lartë i Arkivave miraton:

- a) paraprakisht, projektaktet ligjore e nënligjore që DPA-ja rekomandon për organizimin dhe funksionimin e shërbimit arkivor kombëtar;
- b) “Listën tip” të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare të njësuar në shkallë vendi;
- c) të gjitha aktet që kanë të bëjnë me strategjinë afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit të shërbimit arkivor kombëtar;
- ç) rregullat tekniko-profesionale dhe metodologjike të punës me dokumentet (administrative, tekniko-shkencore, në figurë, zë dhe në lëvizje);
- d) rregullore me natyrë unifikuese për punën me dokumentet;
- dh) raportin e analizës vjetore të DPA-së;
- e) standardet e kutive, të dosjeve dhe mjeteve kancelarike, që ndikojnë te cilësia dhe jetëgjatësia e

dokumentit, të detyrueshme për zbatim nga të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë;

ë) standardet e kutive e të dosjeve për ruajtje të përhershme për dokumentet me RHK, për arkivat e përhershëm, arkivat qendrorë në veprim, si dhe për institucionet që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre dhe përcakton institucionet dhe tipologjinë e dokumenteve të institucioneve, që janë të detyruara të zbatojnë standardin.

Neni 11

Komisioni Qendror i Ekspertizës (KQE)

1. KQE-ja përbëhet nga 15 anëtarë, 7 të brendshëm dhe 8 të jashtëm. Anëtarë të brendshëm janë përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, të zgjedhur nga drejtori i përgjithshëm nga radhët e nëpunësve me, së paku, 10 vjet përvojë në shërbimin arkivor. Anëtarët e jashtëm të KQE-së përzgjidhen nga titullarët e institucioneve që përfaqësojnë, si më poshtë vijon:

- a) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
- b) një përfaqësues i Institutit të Statistikës;
- c) një përfaqësues i Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit;
- ç) një përfaqësues i Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit;
- d) një përfaqësues i Arkivit Historik dhe Diplomatik;
- dh) një përfaqësues i Arkivit Qendror Shtetëror të Drejtësisë;
- e) një përfaqësues i Arkivit të Kuvendit;
- ë) një përfaqësues i arkivave qendrorë në veprim, i zgjedhur me votim të fshehtë, nga mbledhja e drejtorëve të tyre.

2. Kryetar i KQE-së është zëvendës drejtori i përgjithshëm i Arkivave i emëruar nga drejtori i përgjithshëm i Arkivave. Kryetari miraton rendin e ditës të mbledhjes së KQE-së, drejton mbledhjen dhe nënshkruan vendimet e saj.

3. Sekretari i KQE-së zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Sekretar mund të zgjidhet anëtar i KQE-së që ka specializim në fushën e arkivave. Ai ushtron përgjegjësinë e kryetarit për drejtimin e mbledhjes së KQE-së në mungesë dhe me urdhër të tij.

4. KQE-ja kryen këto detyra:

- a) përgatit “Listën tip” të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare (më tej “RHK”);



b) miraton listat e dosjeve të veçuara për asgjësim, sipas vendimeve të institucioneve të përcaktuara në ligj, për dokumentet që kanë humbur vlerën e ruajtjes së mëtejshme;

c) miraton listat e dokumenteve të veçuara për asgjësim nga Arkivi Qendror Shtetëror, arkivat shtetërorë vendorë dhe arkivat e sistemit në rast të risistemimit të fondeve. Në këtë rast, vendimi merret nga Komisioni i Ekspertizës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, pas relacionit të drejtorisë përgjegjëse për përpunimin.

ç) vendimet e KQE-së u dërgohen institucioneve përkatëse dhe zbatimi i tyre ndiqet nga DPA-ja.

Neni 12

Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve për Vlerësimin e Dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (KPE)

1. KPE-ja bën vlerësimin e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare, që janë në shitje prej subjekteve private dhe miraton pranimin e dokumenteve nga qytetarët.

2. KPE-ja përbëhet nga specialistë të vlerësimit të trashëgimisë arkivistike kombëtare. KPE-ja përbëhet nga:

a) drejtori i përgjithshëm i Arkivave dhe dy anëtarë të brendshëm, të emëruar prej tij;

b) dy përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

c) dy përfaqësues të Akademisë së Shkencave, me titullin “Akademik”;

ç) dy përfaqësues të Universitetit të Tiranës.

3. Kryetar i KPE-së është një përfaqësues i Akademisë së Shkencave, me titullin “Akademik”.

4. Sekretari i KPE-së zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Sekretar mund të zgjidhet anëtari i KPE-së që ka specializim në fushën e arkivave. Ai ushtron përgjegjësinë e kryetarit për drejtimin e mbledhjes së KPE-së në mungesë dhe me urdhër të tij.

5. KPE miraton:

a) shpërndarjen në vendruajtje të fondeve të dokumenteve që administrohen nga DPA-ja;

b) matricën e njësuar të përshkrimit të dokumentit RHK, që subjekti joshtetëror privat nxjerr në shitje;

c) pranimin e dokumenteve të dhuruara;

ç) e propozon parablerjen e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare dhe negocion çmimin e

tyre. Miratimi final kryhet nga drejtori i përgjithshëm i Arkivave.

d) jep mendimin përkatës për dhënien ose jo të lejes së tregtimit të lirë të dokumenteve RHK, që subjektet joshtetërore private duan të shesin; mendimi i përcillet DPA-së për të ushtruar të drejtën e vendimmarrjes;

dh) dërgimin dhe/ose moslejimin e nxjerrjes jashtë vendit të dokumenteve RHK në pronësi të shtetit dhe/ose të subjekteve joshtetërore private, në rast se këto dokumente përbëjnë vlera unike, në kuadër të trashëgimisë arkivore të vendit, të cilat ia përcjell drejtorit të përgjithshëm të Arkivave për hartimin e propozimit drejtuar Kryeministrit, për miratim përfundimtar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimit të nenit 83, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ndryshuar;

e) kushtet e tregtimit të dokumenteve RHK, në rast të ndryshimit të pronarit privat. Këto kushte KPE-ja ia propozon DPA-së për ushtrimin e së drejtës së vendimmarrjes. Kjo e fundit mund të kufizojë shitjen e këtyre dokumenteve deri në 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit prej pronarit. Kur KPE-ja nuk arrin të marrë vendim, duke u mbështetur vetëm në përshkrimet arkivistike, për të propozuar ndalimin dhe/ose të kushtëzojë shitjen e lirë të dokumenteve RHK në pronësi të subjekteve joshtetërore private, ajo ka të drejtë të njihet me vetë dokumentin, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj. Pronari joshtetëror privat i dokumenteve RHK ka të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, sipas Kodit të Procedurave Administrative;

ë) rregullat për paraqitjen e dokumenteve arkivore në mjediset ndërkombëtare;

f) listën e pronarëve të arkivave privatë, të cilët u dhurojnë arkivave shtetërore dokumente të shpallura RHK.

Neni 13

Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH)

Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” rregullohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”.



Neni 14

Blerja e përqendruar

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave mbledh nevojat për të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për furnizimin me kuti dhe dosje të standardit të përhershëm, përfshirë edhe etiketat e tyre, dhe ia përcjell ato Operatorit të Blerjeve të Përqendruara sh.a., për prokurimin e përqendruar të tyre. Tarifa e procedurës përballohet nga buxheti i DPA-së.

2. Brenda datës 1 shkurt të çdo viti, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave njofton përmes rrugës shkresore dhe/ose elektronike autoritetet dhe entet kontraktore, për:

a) standardet kombëtare të miratuara për kutitë dhe dosjet e standardit të përhershëm;

b) çmimin për njësi të llogaritur përmes parashikimeve ligjore, e indeksuar me ndryshimet e mundshme të evidentuara gjatë studimit paraprak të tregut, të kryer prej saj.

3. Brenda datës 1 mars, autoritetet ose entet kontraktore i dërgojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave specifikimet teknike, kërkesat sasiore dhe fondin limit. Kërkesat e dërguara pas kësaj date nuk merren parasysh për prokurimin për vitin pasardhës.

4. Për çdo kontratë të lidhur nga autoritetet dhe entet kontraktore, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen verifikimin paraprak të cilësisë për sa i përket jetëgjatësisë së kutive dhe dosjeve të standardit të përhershëm, sipas udhëzimeve administrative të saj. Autoritetet ose entet kontraktore marrin në dorëzim kutitë dhe dosjet bashkë me dokumentacionin shoqërues të verifikimit paraprak të cilësisë.

Neni 15

Ndryshimi i rregullores

1. Nisma për ndryshimin e kësaj rregulloreje ndërmerret nga drejtori i përgjithshëm i Arkivave ose me propozimin e një të tretës së anëtarëve të Këshillit të Lartë të Arkivave.

2. Pas nismës për ndryshim, drejtori i përgjithshëm i Arkivave ngre një grup pune, të përbërë nga drejtorët e DPA-së dhe nga një anëtar i jashtëm i organizmave që funksionojnë pranë DPA-së. Grupi i punës drejtohet nga anëtar i jashtëm, përfaqësues i KLA-së.

3. Projektregullorja e përgatitur nga grupi i punës i paraqitet Këshillit të Lartë të Arkivave për miratim paraprak, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 16

Institucionet zbatuese

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e kësaj rregulloreje.

VENDIM**Nr. 826, datë 26.12.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 725, DATË 2.9.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË
FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË SË
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, nenit 7/1, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastruktursë dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

a) Në pikën 4, të kreut II, numri “120” zëvendësohet me “100”;

b) Titulli i kreut V, “Procedurat e rekrutimit”, zëvendësohet me “Procedurat e rekrutimit dhe nivelet e pagave të punonjësve të Agjencisë”;

c) Pas pikës 3, të kreut V, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element të tyre për punonjësit e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit janë, si më poshtë vijon:

a) Paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune dhe që përcaktohet në



kolonën 2, të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Shtesa për vjetërsi në punë, që jepet në masën:

i. 0.6 (zero pikë gjashtë) % pas çdo viti punë për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

ii. 0.8 (zero pikë tetë) % pas çdo viti punë për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

iii. 1 (një) % pas çdo viti punë për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

c) Shtesa për natyrë të veçantë pune, që përcaktohet sipas kolonës 3, të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

ç) Në pikën 1, të kreut VI, numri “120” zëvendësohet me “100”.

2. Kudo në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, përcaktimet që lidhen me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit shfuqizohen.

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA NR. 1

POZICIONI	PAGA PËR POZICION	SHTESË PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE
Drejtor i përgjithshëm	365,000	70,000
Asistent ekzekutiv	122,000	
Sekretar	110,000	
Drejtor, Drejtoria Juridike dhe e Shqyrtimit të Aplikimeve	280,000	60,000
Përgjegjës sektori, Drejtoria Juridike dhe e Shqyrtimit të Aplikimeve	250,000	45,000
Përgjegjës, Sektori i Burimeve Njerëzore, Drejtoria Juridike	135,000	
Specialist, Drejtoria Juridike dhe e Shqyrtimit të Aplikimeve	200,000	45,000
Specialist, Burimet Njerëzore, Drejtoria Juridike	112,000	
Drejtor, Drejtoria e Zhvillimit në Territor	280,000	60,000
Përgjegjës sektori, Drejtoria e Zhvillimit në Territor	250,000	45,000
Specialist, Drejtoria e Zhvillimit në Territor	200,000	45,000
Drejtor, Drejtoria e GIS-së	270,000	
Përgjegjës sektori, Drejtoria e GIS-së	220,000	
Specialist, Drejtoria e GIS-së	190,000	
Drejtor, Drejtoria e Monitorimit në Territor	270,000	
Përgjegjës sektori, Drejtoria e Monitorimit në Territor	220,000	
Specialist, Drejtoria e Monitorimit në Territor	190,000	
Drejtor, Drejtoria e Certifikatës së Përdorimit	270,000	
Përgjegjës, Drejtoria e Certifikatës së Përdorimit	220,000	
Specialist, Drejtoria e Certifikatës së Përdorimit	190,000	
Drejtor, Drejtoria e Koordinimit Ndërinstitucional	235,000	
Përgjegjës sektori, Drejtoria e Koordinimit Ndërinstitucional	180,000	
Specialist, Drejtoria e Koordinimit Ndërinstitucional	145,000	
Drejtor, Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse	235,000	
Përgjegjës sektori, Drejtoria e Financës	180,000	
Përgjegjës sektori, Shërbime Mbështetëse	135,000	
Specialist Finance Dhe Buxheti	145,000	
Specialist arkiv-protokoll	99,000	
Magaznier	69,000	8000
Pastruese	56,000	8000
Shofer	89,000	8000



VENDIM
Nr. 827, datë 26.12.2024

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR
AGJENCINË E ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT PËR VITIN 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 7/1, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), për vitin 2025,

PASQYRA NR. 1
PLANI I TË ARDHURAVE DHE I SHPENZIMEVE TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT PËR VITIN 2025

Lekë	BUXHETI 2025	
	Të ardhurat	Shpenzimet
PËRSHKRIMI		
Të ardhura të planifikuara për t'u mbledhur (2025)	11 000 000 000	
Të ardhura të akumuluar në vitin 2024	379 796 043	
Shpenzime personeli dhe shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore		316 000 000
Shpenzime korente të tjera		38 796 043
Shpenzime kapitale		25 000 000
Total AZHT	11 379 796 043	379 796 043
Të ardhura të pashpërndara (të ardhura – shpenzime)		11 379 796 043

VENDIM
Nr. 839, datë 26.12.2024

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “RRUGA
BERAT–BALLABAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e zëvendëskryeministrit

sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Të ardhurat e krijuara nga AZHT-ja deri në fund të vitit 2024 trashëgoohen në vitin buxhetor 2025 dhe përdoren nga AZHT-ja për mbulimin e kostove dhe shpenzimeve të veta.

3. Të ardhurat e arkëtuara deri në fund të vitit 2024 transferohen në llogarinë bankare të AZHT-së, në bankën e nivelit të dytë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2025.

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rruga Berat–Ballaban”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall”, “pemëtores”, “kullotë” dhe “ullishte”, me vlerë të përgjithshme prej 4 396 574 (katër



milione e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh.

4. Masa e shpërblimit për pronarët, që shpronësohen, është 4 396 574 (katër milionë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë dhe përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve” në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, si dhe regjistron aktin e kalimit në përgjegjësi administrimi për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit në përgjegjësi administrimi për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SHPRONËSIMI, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RRUGA BERAT–BALLABAN”

Nr.	Të dhënat e pronësive			Të dhënat kadastrale sipas kartelës së pasurisë							Vlerësimet për shpronësim			Vlera totale (leke)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa e pasurisë	Rrethi	Indeksi i hartës	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pas.	Sipërfaqja totale	Sip. (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Vlera (leke)		
1	RUSHIT	SEFEDIN	SALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(239-D)	1559	9/2	Ullishte	1800	472	203	95816	95,816	Konf. nga ASHK Berat
2	DURRE	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(239-D)	1559	9/3	Ullishte	2275	548	203	111244	111,244	Konf. nga ASHK Berat
3	DURRE	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(239-D) K-34-112(255-B)	1559	9/13	Ullishte	7650	1882	203	382046	382,046	Konf. nga ASHK Berat
4	MUSTAFA	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(239-D)	1559	9/14	Ullishte	850	262	203	53186	53,186	Konf. nga ASHK Berat
5	LEFTER BRAHIM	MYRTO MYRTO	ARAPI ARAPI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	16/22	Ullishte	7100	823	203	167069	167,069	Konf. nga ASHK Berat
6	LEFTER BRAHIM	MYRTO MYRTO	ARAPI ARAPI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	41/16	Ullishte	3175	409	203	83027	83,027	Konf. nga ASHK Berat
7	MALIQ ALIT	HAJDAR HAJDAR	MASKA MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	41/26	Arë	4200	332	203	67396	67,396	Konf. nga ASHK Berat
8	MALIQ ALIT	HAJDAR HAJDAR	MASKA MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	41/27	Ullishte	10500	2241	203	454923	454,923	Konf. nga ASHK Berat
9	LEFTER	MYRTO	ARAPI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/3	Ullishte	775	224	203	45472	45,472	Konf. nga ASHK Berat
10	EDLIR	SHERIF	TALLAS	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/4	Ullishte	2300	256	203	51968	51,968	Konf. nga ASHK Berat
11	TOMORR TOMORR	MEDIN MEDIN	PALLA PALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/5	Ullishte	2610	626	203	127078	127,078	Konf. nga ASHK Berat
12	PETRIT	ZARIF	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/6	Ullishte	1900	581	203	117943	117,943	Konf. nga ASHK Berat
13	SIKELQIM	MALIQ	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	55/11	Ullishte	2540	368	203	74704	74,704	Konf. nga ASHK Berat
14	ASQERI	NEXHIP	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	55/12	Arë	3875	543	203	110229	110,229	Konf. nga ASHK Berat
15	MYSTHAK THELLENXA	SERLAT	MASKA MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	55/19	Ullishte	6300	1028	203	208684	208,684	Konf. nga ASHK Berat
16	MYSTHAK THELLENXA	SERLAT	MASKA MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	54/12	Arë	3825	262	203	53186	53,186	Konf. nga ASHK Berat
17	MYSLIM	ALIT	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	54/10	Arë+truall	650	45	203	9135	9,135	Konf. nga ASHK Berat
18	HASAN	SYRJAT	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	59/5	Arë	3550	217	203	44051	44,051	Konf. nga ASHK Berat
19	MYSTHAK THELLENXA	SERLAT	MASKA MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	59/6	Arë	5175	595	203	120785	120,785	Konf. nga ASHK Berat
20	SEFER	MYFTAR	QORRI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	59/7	Arë	1400	128	203	25984	25,984	Konf. nga ASHK Berat
21	MYSTHAK	SKENDER	DELJBASHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/1	Arë+truall	600	198	203	40194	40,194	Konf. nga ASHK Berat
22	ENKELEDA	NUREDIN	TALLASI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/3	Arë	570	90	203	18270	18,270	Konf. nga ASHK Berat
23	RUSHIT	FTIT	TALLASI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/4	Arë	805	138	203	28014	28,014	Konf. nga ASHK Berat
24	QERIM	SKENDER	DELJBASHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/5	Arë+truall	728	86	203	17458	17,458	Konf. nga ASHK Berat
25	PETREF	TAJAR	SULKAJ	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/6	Arë+truall	560	164	203	33292	33,292	Konf. nga ASHK Berat
26	ENVER	MEMET	DEMIRI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/7	Arë	465	156	203	31668	31,668	Konf. nga ASHK Berat
27	PETRIT	REXHEP	ZIFJE	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/8	Arë+truall	490	115	203	23345	23,345	Konf. nga ASHK Berat
28	XHEVIT	QAMIL	ARAPI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1558	63/27	Arë	2850	100	203	20300	20,300	Konf. nga ASHK Berat
29	FADIL	SERLAT	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/10	Ullishte	500	81	203	16443	16,443	Konf. nga ASHK Berat
30	LUAN	HALIL	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/19	Ullishte	4775	16	203	3248	3,248	Konf. nga ASHK Berat
31	SALI	RUSTEM	KUÇI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	76/11	Arë	3400	35	203	7105	7,105	Konf. nga ASHK Berat
32	FAIK	YEZIDIN	BRAUSHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	76/10	Arë	2332	200	203	40600	40,600	Konf. nga ASHK Berat
33	BAFTAJAR	REXHEP	ZILFAJ	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/1	Pernëto	1615	216	203	43848	43,848	Konf. nga ASHK Berat
34	PETRIT	REXHEP	ZILFAJ	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/3	Pernëto	2370	381	203	77343	77,343	Konf. nga ASHK Berat
35	ATEM	HABIL	KATILLARI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/4	Pernëto	1840	145	203	29435	29,435	Konf. nga ASHK Berat
36	ISMAIL	ETEM	KATILLARI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/5	Pernëto	630	47	203	9541	9,541	Konf. nga ASHK Berat
37	AGRON	ILJAS	TOSKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/6	Pernëto	2609	331	203	67193	67,193	Konf. nga ASHK Berat
38	KADRI	ASLIAN	TOSKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/7	Pernëto	2325	572	203	116116	116,116	Konf. nga ASHK Berat
39	SELMAN	SKENDER	DELJBASHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	88/1	Arë	3570	327	203	66381	66,381	Konf. nga ASHK Berat
40	ENKELEDA	NUREDIN	TALLASI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	73/4	Arë	2050	52	203	10556	10,556	Konf. nga ASHK Berat
41	RAPO	SAMI	KUÇI	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	90/14	Pernëto	120	43	203	8729	8,729	Konf. nga ASHK Berat
42	SALI	XHEZO	HASANI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/2	Ullishte	1825	503	203	102109	102,109	Konf. nga ASHK Berat
43	VELI	MEHMET	HASANI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/3	Ullishte	1600	102	203	20706	20,706	Konf. nga ASHK Berat
44	FTIT	NUREDIN	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/11	Ullishte	5225	10	203	2030	2,030	Konf. nga ASHK Berat
45	ENKELEDA	NUREDIN	TALLASI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/12	Ullishte	1750	252	203	51156	51,156	Konf. nga ASHK Berat
46	ILIA DHIMITTER PELLUMB VANGJEL XHEZMILJE NEVREZE	ALUSH ALUSH ALUSH ALUSH ALUSH ALUSH ALUSH ALUSH	GJONI GJONI GJONI GJONI TOSKA BEHARI VRAPI SELFAT	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/14	Ullishte	750	153	203	31059	31,059	Konf. nga ASHK Berat



	MBARESA MIRANDA														
47	MUSTAFA	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/3	Pemëtores	825	28	203	5684	5,684	Konf. nga ASHK Berat
48	DURRE	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/4	Pemëtores	510	28	203	5684	5,684	Konf. nga ASHK Berat
49	DURRE	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/6	Pemëtores	2025	29	203	5887	5,887	Konf. nga ASHK Berat
50	GEZIM	BARJAM	KARAFILI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/7	Pemëtores	1950	113	203	22939	22,939	Konf. nga ASHK Berat
51	ARTAN	NAZIF	KARAFILI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/8	Pemëtores	2025	269	203	54607	54,607	Konf. nga ASHK Berat
52	ARBEN	NAZIF	KARAFILI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/10	Pemëtores	1000	79	203	16037	16,037	Konf. nga ASHK Berat
53	BAFTAJAR	REXHEP	ZILFAJ	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	93/1	Arë	2450	10	203	2030	2,030	Konf. nga ASHK Berat
54	SHYQO	NUREDIN	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	73/6	Arë	2350	271	203	55013	55,013	Konf. nga ASHK Berat
55	FTITM	NUREDIN	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	73/5	Arë	2060	110	203	22330	22,330	Konf. nga ASHK Berat
56	ALTIN	FAIK	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	73/2	Arë	2350	129	203	26187	26,187	Konf. nga ASHK Berat
57	MICO	XHEVAIR	TARAJ	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	90/15	Pemëtores	200	70	203	14210	14,210	Konf. nga ASHK Berat
58	ENKELEDA	NUREDIN	TALLASI	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	287/10	Pemëtores	1650	210	203	42630	42,630	Konf. nga ASHK Berat
59	ENVER	MEMET	DEMIRI	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	287/13	Pemëtores	3990	157	203	31871	31,871	Konf. nga ASHK Berat
60	AGIM	HAXHI	BOZEKU	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	300/90	Ullishte	925	345	203	70035	70,035	Konf. nga ASHK Berat
61	HASAN	SYRJAT	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/13	Ullishte	1000	308	203	62524	62,524	Konf. nga ASHK Berat
62	MYRTEZA	BRAIM	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	296/1	Arë	10200	408	203	82824	82,824	Konf. nga ASHK Berat
63	FTITM	NUREDIN	TALLA	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(15-B)	1110	287/11	Pemëtores	1700	129	203	26187	26,187	Konf. nga ASHK Berat
64	FATOS	KADRI	GERXHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/74	Pemëtores	1010	18	203	3654	3,654	Konf. nga ASHK Berat
65	KADRI	XHEVAIR	GERXHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/73	Pemëtores	3335	117	203	23751	23,751	Konf. nga ASHK Berat
66	QANI	XHEVAIR	GERXHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/72	Pemëtores	1220	7	203	1421	1,421	Konf. nga ASHK Berat
67	AGRON	MURAT	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/41	Pemëtores	1665	182	203	36946	36,946	Konf. nga ASHK Berat
68	BUJAR	MURAT	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/40	Pemëtores	400	95	203	19285	19,285	Konf. nga ASHK Berat
69	SALI	RUSTEM	KUCI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/45	Pemëtores	4500	336	203	68208	68,208	Konf. nga ASHK Berat
70	YLLI	MUHAMET	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/87	Pemëtores	2000	195	203	39585	39,585	Konf. nga ASHK Berat
71	BEHAR	MEMET	DEMIRI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/18	Ullishte	4975	65	203	13195	13,195	Konf. nga ASHK Berat
72	KUJTIM	DANE	KUCI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/15	Ullishte	600	49	203	9947	9,947	Konf. nga ASHK Berat
73	GANI	DANE	KUCI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/14	Ullishte	500	19	203	3857	3,857	Konf. nga ASHK Berat
74	BEKIM	LUTO	KUCI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/13	Ullishte	600	44	203	8932	8,932	Konf. nga ASHK Berat
75	HASAN	SYRJAT	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/12	Ullishte	6175	160	203	32480	32,480	Konf. nga ASHK Berat
76	FADIL	SERJAT	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/11	Ullishte	5200	148	203	30044	30,044	Konf. nga ASHK Berat
77	ESTREF MIRSI ANIDA ESMA EDISON	DANE SYRJAT ESTREF ESTREF ESTREF	TOSKA TOSKA TOSKA TOSKA TOSKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/4	Arë	2625	183	203	37149	37,149	Konf. nga ASHK Berat
78	SHIEME	DANE	TOSKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/3	Arë	1575	25	203	5075	5,075	Konf. nga ASHK Berat
79	DEMIR	MEMET	DEMIRI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/19	Ullishte	700	11	203	2233	2,233	Konf. nga ASHK Berat
80	SALI	RUSTEM	KUCI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/8	Ullishte	2460	138	203	28014	28,014	Konf. nga ASHK Berat
81	AGRON	MURAT	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/7	Ullishte	700	61	203	12383	12,383	Konf. nga ASHK Berat
82	SHIEME	DANE	TOSKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/12	Ullishte	4470	322	203	65366	65,366	Konf. nga ASHK Berat
83	ESTREF MIRSI ANIDA ESMA EDISON	DANE SYRJAT ESTREF ESTREF ESTREF	TOSKA TOSKA TOSKA TOSKA TOSKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/14	Ullishte	4025	172	203	34916	34,916	Konf. nga ASHK Berat
84	SPIRO	QAZIM	SINJATI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	73/1	Arë	2375	263	203	53389	53,389	Konf. nga ASHK Berat
						VLERA TOTALE							4,396,574	4,396,574	

**VENDIM****Nr. 843, datë 26.12.2024****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE,
DOKUMENTACIONIT DHE
PROCEDURAVE PËR MBLEDHJEN E
TË DHËNAVE PËR IDENTIFIKIMIN E
PERSONAVE QË U PËRKASIN
PAKICAVE KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbledhja e të dhënave për identifikimin e personave, që i përkasin pakicave kombëtare, kryhet në përputhje me të drejtën e tyre për vetidentifikim të lirë.

2. Personi, që pretendon se i përket një pakice kombëtare dhe kërkon të identifikohet si i tillë, paraqet formularin e vetidentifikimit, sipas aneksit 1, të këtij vendimi, pranë të njëjtit komision të ngritur në ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme për shqyrtimin e kërkesave për njohjen e një pakice kombëtare (në vijim komisioni). Në përbërjen e komisionit duhet të përfshihet gjithashtu një përfaqësues nga pakica kombëtare, pjesë e së cilës personi është vetidentifikuar, përveç rasteve kur kjo pakicë është e përfaqësuar në përbërjen e përhershme të komisionit.

3. Ky komision mblidhet të paktën 2 (dy) herë në vit dhe sa herë vlerësohet e nevojshme me kërkesë të 1/4 së anëtarëve të tij.

4. Komisioni pranon vetidentifikimin dhe pasqyron të dhënat në listën përkatëse për pakicat kombëtare, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga depozitimi i formularit të vetidentifikimit.

5. Në raste përjashtimore, bazuar në arsye, të cilat hedhin dyshime serioze për saktësinë e të dhënave të vetidentifikuara, mund të kërkohet verifikim i mëtejshëm i vetidentifikimit, me një shumicë prej 2/3 së anëtarëve të komisionit, në rastet kur:

a) ka paraqitje të një numri të shtuar dhe të pazakontë vetidentifikimesh, brenda një periudhe gjashtëmujore;

b) personi i vetidentifikuar banon në një njësi të vetëqeverisjes vendore, e cila, faktikisht, nuk shfaq karakteristika të dallueshme kulturore, etnike, gjuhësore, fetare apo karakteristika tradicionale, të evidentuara nga informacionet përkatëse, ndër të tjera, siç është mungesa e përfaqësimit kolektiv, përmes një mungese të qartë të pranisë aktive, të vazhdueshme dhe të konsoliduar të aktiviteteve të përfaqësimit kolektiv, përfshirë shoqatat e minoritetit kombëtar përkatës në njësinë e vetëqeverisjes vendore në fjalë etj.;

c) ka ndryshime të gjenealogjive të personit të vetidentifikuar, krahasuar me dokumente të mëparshme.

6. Komisioni mund të kërkojë, në rastet kur nis një procedurë verifikimi, informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me qëllim verifikimin e vërtetësisë së të dhënave të paraqitura, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 3, dhe të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon kërkesën për verifikim zyrës përkatëse të arkivit të gjendjes civile të degës përkatëse të qarkut, duke u bazuar në të dhënat e vetidentifikimit të personit.

8. Zyra e arkivit të gjendjes civile kryen verifikimet, nëse:

a) personi rezulton i regjistruar në regjistrin përkatës të gjendjes civile, të administruar nga zyra e arkivit të gjendjes civile, ku janë evidentuar të dhëna lidhur me përkatësinë etnike, të ndryshme nga ajo shqiptare;

b) personi ka lindur nga të paktën një prind me përkatësi etnike joshqiptare dhe në aktin e lindjes së tij rezulton e evidentuar një përkatësi etnike tjetër;

c) në aktin e lindjes së personit, përpara vitit 2011, ka qenë përcaktuar një përkatësi etnike, e ndryshme nga ajo shqiptare;

ç) në dokumentet e arkivuara të gjendjes civile për periudhat e regjistrimeve të popullsisë për shtetasit që i përkasin një pakice etnike, të ndryshme nga ajo shqiptare, ose për paralindësit e tyre, janë evidentuar të dhëna që lidhen me përkatësinë etnike, të ndryshme nga ajo shqiptare;

d) ka të dhëna plotësuese, që i referohen përkatësisë tjetër etnike, për elemente të gjendjes civile, që, gjithashtu, mund të rezultojnë në aktet e martesës dhe të vdekjes të administruara prej saj.



9. Zyra e arkivit të gjendjes civile i paraqet komisionit informacionin e mbledhur, lidhur me elementin e përkatësisë etnike. Komisioni rishikon dokumentacionin e mbledhur, sipas pikës 8, të këtij vendimi, duke i dhënë peshë vendimtare zgjedhjes subjektive të individit. Faktorë, si gjuha, feja, kultura ose traditat ofrojnë një bazë të mjaftueshme për qëllimin e vetidentifikimit. Dokumentacioni i marrë, sipas pikave 7 dhe 8, të këtij vendimi, shërben si tregues, ndihmës në marrjen e mendimit nga ana e komisionit.

10. Komisioni, në rast të mosprovimit të vetidentifikimit, sipas pikave 7 dhe 8, të këtij vendimi, u drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe institucioneve të tjera, nëse kanë dokumente zyrtare që mbështesin përkatësinë e shtetasit në një pakicë kombëtare.

11. Procedura e mbledhjes së të dhënave kryhet në përputhje me pikën 2, të nenit 6, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

12. Zyrat e arkivit të gjendjes civile në degët e qarkut lëshojnë të dhëna, që i referohen regjistrimit të shtetasve, sipas regjistrave themeltarë për periudhat e regjistrimit kur janë kryer. Përpunimi i këtij informacioni kryhet në bazë të konsultimit të të dhënave në regjistrat themeltarë, ku konfirmohen të dhënat e shtetasve me përkatësi etnike, të ndryshme nga ajo shqiptare. Personi i interesuar mund të paraqesë dokumentacione ose çdo material tjetër të nevojshëm në mbështetje të vetidentifikimit.

13. Komisioni, pasi shqyrton informacionin e marrë nga institucionet e lartpërmendura dhe nga personi për të cilin bëhet procedura e vetidentifikimit, vijon me marrjen e vendimit për konfirmimin ose jo të vetidentifikimit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e iniciimit të kryerjes së verifikimit, sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij vendimi. Periudha e nisjes së këtij afati fillon nga data e njoftimit nga komisioni për palën e interesuar. Në rast se nuk merret një vendim brenda afatit të përcaktuar, vetidentifikimi konsiderohet i konfirmuar.

14. Vendimi i arsyetuar i komisionit i njoftohet menjëherë personit për të cilin është kryer procesi i verifikimit.

15. Në rastet kur personi kërkon të apelojë vendimin e komisionit, krijohet një komision apeli.

16. Komisioni i apelit kryesohet nga përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për çështjet e brendshme dhe ka në përbërje:

a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme;

b) një përfaqësues nga Avokati i Popullit;

c) një përfaqësues nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

ç) një përfaqësues i emëruar nga Komiteti për Pakicat Kombëtare;

d) një përfaqësues nga një organizatë e shoqërisë civile, i angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në lidhje me pakicat kombëtare, të propozuar nga Komiteti i Minoriteteve Kombëtare.

17. Kundër vendimit të komisionit të apelim, personi ka të drejtë të paraqesë ankim pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

18. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme, komisioni, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, prefektët e qarqeve, zyrat e arkivit të gjendjes civile në degën e qarkut dhe institucionet e tjera shtetërore, që administrojnë dokumente, të dhëna zyrtare, në lidhje me përkatësinë e shtetasve shqiptarë në një pakicë kombëtare, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të shkronjës “a”, të pikës 5, e cila hyn në fuqi pas dy vjetësh nga botimi i këtij vendimi dhe nuk ka efekt prapaveprues për vetidentifikimet e paraqitura deri në përfundim të afatit.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

*Drejtuar Komisionit pranë Ministrisë së Brendshme*

Aneksi nr. 1

FORMULAR I VETIDENTIFIKIMIT
TË INDIVIDIT, SHTETASIT SHQIPTAR QË PRETENDON SE I PËRKET NJË PAKICE
KOMBËTARE

(emër, mbiemër)

(emri i babait)

(emri i nënës)

(data e lindjes)

(vendi i lindjes)

(gjendja civile)

(nr. i letërnjoftimit)

(vendbanimi aktual)

(pakica/at kombëtare, të cilës i përket)

(gjuha/ët e pakicës/ave kombëtare, të cilës i përket)

(A keni kryer ndryshime të emrit ose mbiemrit?)

(karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale, sipas nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”)

(nënshkrimi)



VENDIM

Nr. 845, datë 26.12.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES,
FUNKSIONEVE DHE PROCEDURËS SË
KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E
KËRKESËS PËR NJOHJEN E NJË
PAKICE KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kërkesa për njohjen formale të një pakice kombëtare sipas pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, depozitohet nga grupi i shtetasve që përbëjnë mbi 1 % të numrit të përgjithshëm të shtetasve që kanë shtetësinë shqiptare në Republikën e Shqipërisë, të cilët pretendojnë se i përkasin një pakice. Kjo kërkesë paraqitet pranë Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare, i cili ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme (në vijim referuar si “Komisioni”).

2. Dokumentacioni për njohjen formale të një pakice kombëtare përbëhet nga:

a) kërkesa e nënshkruar nga çdo pjesëtar i grupit që pretendon se i përket pakicës kombëtare që synohet të njihet;

b) formulari individual i vetëdeklarimit për secilin nga shtetasit që kanë firmosur sipas shkronjës “a”, për njohjen e statusit të pjesëtarit të pakicës kombëtare, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Komisioni kryesohet nga zëvendësministri i ministrisë përgjegjëse për çështjet e brendshme dhe ka në përbërje:

a) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në ministrinë përgjegjëse për gjendjen civile;

b) një përfaqësues nga ministri përgjegjës për pushtetin vendor;

c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme, përgjegjës për çështjet ligjore;

ç) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;

d) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme;

dh) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

e) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;

ë) një përfaqësues nga Akademia e Shkencave;

f) një përfaqësues nga Instituti i Historisë, në Akademinë e Shkencave;

g) katër përfaqësues nga Komiteti për Pakicat Kombëtare, ku njëri prej tyre është përfaqësues i pakicës kombëtare që kërkon të njihet, sipas rastit;

gj) tre përfaqësues nga shoqëria civile, të propozuar nga Komiteti për Pakicat Kombëtare, nga radhët e organizatave joqeveritare që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, përfshirë mbrojtjen e të drejtave të personave që i përkasin pakicave kombëtare.

4. Komisioni, për kryerjen e veprimtarisë së tij mbështetet nga sekretariati teknik, i cili është përgjegjës për organizimin e punës, të sigurojë komunikimin me paraqitësit e kërkesave, të koordinojë punën mes institucioneve përgjegjëse, si dhe për çdo detyrë tjetër të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Komisionit.

5. Sekretariati teknik kryesohet nga një nga përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për çështjet e brendshme dhe ka në përbërje katër anëtarë, si më poshtë vijon:

a) dy përfaqësues të caktuar nga titullari i ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme;

b) një përfaqësues i caktuar nga titullari i ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore;

c) një përfaqësues i caktuar nga titullari i Komitetit për Pakicat Kombëtare.

6. Përfaqësuesit e institucioneve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, janë të nivelit të lartë drejtues.

7. Komisioni shqyrton kërkesën e paraqitur sipas pikës 1, të këtij vendimi, dhe verifikon plotësimin e kriterëve ligjore të përcaktuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe dokumentacionin e paraqitur sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 7, të këtij ligji.

8. Komisioni shqyrton kërkesën e paraqitur sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda 9 (nëntë) muajve



nga dita e pranimet nga ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme.

9. Për shqyrtimin e kërkesës, Komisioni bashkëpunon me të gjitha institucionet publike në nivel qendror, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, të ndryshuar.

10. Vendimi arsyetohet dhe i komunikohet grupit të shtetasve apo përfaqësuesit të autorizuar prej tyre, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Kundër vendimit të Komisionit për refuzimin e kërkesës për njohje të pakicës kombëtare mund të bëhet ankim pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

11. Komisioni garanton transparencë në realizimin e veprimtarisë së tij, në përputhje me ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe programin e transparencës, duke i publikuar

aktivitetet e tij në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për çështjet e brendshme.

12. Në rastet kur Komisioni vendos pranimin e kërkesës, i dërgon ministrit përgjegjës për çështjet e brendshme propozimin, shoqëruar me relacionin e argumentuar për vijimin e procedurave për njohjen formale të pakicës kombëtare.

13. Ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme harton projektligjin për njohjen formale të pakicës kombëtare dhe propozon projektvendimin përkatës pranë Këshillit të Ministrave, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e propozimit nga Komisioni.

14. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme, ministritë dhe institucionet e parashikuara në pikën 3 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Drejtuar Komisionit pranë Ministrisë së Brendshme

Aneksi nr. 1

FORMULAR I VETIDENTIFIKIMIT

TË INDIVIDIT, SHTETASIT SHQIPTAR PËR NJOHJEN E NJË PAKICE KOMBËTARE

(emër, mbiemër)

(emri i babait)

(emri i nënës)

(data e lindjes)

(vendi i lindjes)

(gjendja civile)

(nr. i letërnjoftimit)

(vendbanimi aktual)



(shtetësia)

(pakica/at kombëtare, të cilës i përket)

(gjuha/ët e pakicës/ave kombëtare, të cilës i përket)

(karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale sipas nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”)

(nënshkrimi)

VENDIM
Nr. 850, datë 26.12.2024

**PËR DEKLARIMIN “PASURI
KULTURORE” TË ZONAVE
ARKEOLOGJIKE NËNUJORE “A” DHE
“B” TË QYTETIT TË DURRËSIT,
MIRATIMIN E ZONIFIKIMIT DHE TË
PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN
DHE ADMINISTRIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjave “a” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 9, të nënndarjes “iv”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 53, dhe të nenit 153, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin “Pasuri kulturore” të zonave arkeologjike nënujore “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit.

2. Miratimin e zonifikimit të zonave arkeologjike nënujore “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit, sipas hartës dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANI
PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E ZONAVE
ARKEOLOGJIKE NËNUJORE “A” DHE
“B” TË QYTETIT TË DURRËSIT

Neni 1
Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike nënujore “A” dhe “B” të bregdetit të Durrësit, si dhe përcaktimin e kufijve të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.



Neni 2

Hapësira arkeologjike nënujore në mbrojtje

1. Hapësira nënujore me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore e bregdetit të Durrësit, pjesë e trashëgimisë kulturore, përbëhet nga:

- a) zona arkeologjike nënujore “A”;
- b) zona arkeologjike nënujore “B”.

2. Kufijtë e zonave arkeologjike nënujore “A” dhe “B” paraqiten në hartën e zonifikimit të bregdetit të Durrësit, shoqëruar me koordinatat në sistemin referues gjeodezik zyrtar – Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare KRGJSH, pjesë përbërëse e këtij plani.

3. Hartimi dhe miratimi i instrumenteve të planifikimit, në lidhje me hapësirën arkeologjike në mbrojtje të bregdetit të Durrësit kryhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

Neni 3

Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike nënujore “A”

1. Në zonën arkeologjike nënujore “A” të qytetit të Durrësit lejohet vetëm:

a) mirëmbajtja, hulumtimi dhe muzealizimi i strukturave arkeologjike/anijeve të mbytura, si dhe i çdo potenciali arkeologjik nën ujë, pas shqyrtimit e miratimit të projekteve nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim, KKTKM);

b) kryerja e formave të testimit, të tilla si: vrojtım arkeologjik nënujor, sondazhe arkeologjike nënujore, që nuk cenojnë/dëmtojnë pasurinë arkeologjike nënujore, regjistrim digjital i gjetjeve nga institucione të specializuara ose subjekte të licencuara, të përcaktuara me vendim të KKTKM-së;

c) zbatimi i projekteve kërkimore-shkencore të miratuara nga struktura përgjegjëse për miratimin e projekteve kërkimore-shkencore pranë Akademisë së Shkencave, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja;

ç) vendosja, heqja dhe mirëmbajtja e sinjalistikës detare nga Forca Detare/Shërbimi Hidrografik në funksion të sigurisë lundrimore, në përputhje me kërkesat e standardet kombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Ndihmës në Lundrim, IALA.

2. Projektet lidhur me ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike nënujore “A”, të bregdetit të

Durrësit, të parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, shqyrtohen e miratohen nga KKTKM-ja dhe më pas vijnë në procedurën sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

3. Çdo projekt ose aktivitet i zhvilluar në hapësirën e mbrojtur nënujore “A”, pas miratimit nga KKTKM-ja, mbikëqyret nga institucione të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

4. Aktivitetet me karakter turistik zhvillohen dhe organizohen nga subjekte të licencuara nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike nënujore “B”

1. Në zonën arkeologjike “B” të bregdetit të Durrësit, përveç ndërhyrjeve që lejohen në zonën arkeologjike “A”, lejohen edhe projektet e reja zhvillimore pas miratimit nga KKTKM-ja.

2. Projektet për zhvillimet e reja shqyrtohen e miratohen nga KKTKM-ja dhe vijnë në procedurën sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

3. Zhvillimet e reja lejohen vetëm pas kryerjes së formave të testimit të përcaktuara nga KKTKM-ja, në varësi të potencialit arkeologjik që përfaqëson zona.

4. Gërmimi arkeologjik ose sondazhet arkeologjike kryhen sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku, në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim, IKTK-ja).

5. Aktivitetet me karakter turistik zhvillohen dhe organizohen nga subjekte të licencuara nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike nënujore “A” dhe “B”

1. Për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike “A” dhe “B” të bregdetit, projektet shqyrtohen e miratohen në KKTKM, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 155, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.



2. Për çdo rast, KKTKM-ja shqyrton dhe vendos për kryerjen ose jo të formave të testimit.

Testimet kryhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara në fushën e arkeologjisë. Shpenzimet për kryerjen e formave të testimit mbulohen nga investitori.

3. Testimet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 3, të këtij plani, kryhen sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku, në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është IKTK-ja.

4. Për të gjitha ndërhyrjet në zonat arkeologjike realizohet monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara, si dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet e specializuara shtetërore.

Neni 6

Procedura që ndiqet në rast ndërhyrjesh të paaautorizuara në zonat arkeologjike nënujore “A” dhe “B” të bregdetit të Durrësit

1. Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paaautorizuara brenda zonave arkeologjike nënujore “A” dhe “B”, Qendra Muzeore Durrës (QMD) dhe/apo Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) për zonën e Durrësit ka detyrimin të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e subjektit, nëpërmjet aktit të konstatimit.

2. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) dhe/apo Qendra Muzeore Durrës (QMD) njoftojnë menjëherë IKTK-në, institucionin kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

3. Në rast se subjekti nuk ndërpret veprimet brenda 24 (njëzet e katër) orëve, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për zonën e Durrësit, i drejtohet menjëherë institucionit kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionit kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, për marrjen e masave përkatëse në zbatim

të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

Neni 7

Aktivitetet e ndaluara në zonat arkeologjike nënujore “A” dhe “B” të bregdetit të Durrësit

1. Ndalohen të gjitha aktivitetet e tjera nënujore, që nuk janë parashikuar në këtë plan si:

- a) aktivitetet e peshkimit në të gjitha format e tij;
- b) aktivitetet dhe zhytjet nënujore të paaautorizuara apo të pamiratuara më parë nga institucionet përkatëse.

Neni 8

Gjetjet rastësore arkeologjike nënujore/detare

1. Klasifikohen si gjetje rastësore arkeologjike nënujore/detare objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet e tyre arkeologjike dhe strukturat arkitektonike.

2. Në rast gjetjesh rastësore arkeologjike, gjatë zbatimit të punimeve në zonat arkeologjike, punimet pezullohen menjëherë, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 160, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.


3. Në varësi të vlerave që përmbajnë gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja shprehet për procedurën e hulumtimit arkeologjike të nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.

4. Për çdo rast, veprimtaria arkeologjike realizohet sipas parashikimeve të neneve 151, 152, 153, 154, 155, 156, 158, 159 dhe 160, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

Neni 9

Trajtimi i rasteve të paparashikuara

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë plan, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara.



Zona Arkeologjike nënujore “A” – Durrës		
Koordinatat në sistemin KRGJSH		
	E	N
1	451720.1276	4576693.994
2	451246.8914	4575830.841
3	451241.0921	4574966.419
4	451176.3191	4574050.6
5	451208.5682	4573239.606
6	451467.8292	4572336.355
7	451849.5371	4571567.471
8	452649.6917	4571362.303
9	453546.8475	4571684.161
10	454284.3372	4572155.178
11	452678.11	4575167.14
12	452656.11	4575219.81
13	452682.71	4575252.57
14	452579.57	4575361.68
15	452491.65	4575476.06
16	452497.39	4575500.42
17	452508.45	4575502.66
18	452517.83	4575496.08
19	452530.43	4575511.2
20	452533.37	4575541.58
21	452463.93	4575832.64
22	452443.64	4576088.56
23	452418.72	4576145.12
24	452367.76	4576188.24
25	452342.28	4576165.56



26	452315.12	4576183.76
27	452343.82	4576224.5
28	452348.3	4576249.98
29	452307.14	4576296.04
30	452255.34	4576296.18
31	452206.76	4576428.9
32	452077.93	4576563.16
33	451985.53	4576573.52
34	451886.2	4576628.37
35	451778.4	4576639.57

	Zona arkeologjike nënujore “B” – Durrës	
	Koordinatat në sistemin KRGJSH	
	E	N
1	452678.11	4575167.14
2	454284.3372	4572155.178
3	454952.11	4572882.26
4	455427.0226	4573610.471
5	455810.3684	4574666.909
6	456065.53	4575453.06
7	455746.19	4575581.38
8	455395.77	4575658.94
9	455243.59	4575477.64
10	455239.39	4575395.74
11	455117.42	4575304.55
12	454837.84	4575316.59
13	454492.76	4574475.89
14	454428.36	4574507.39
15	454416.07	4574631.32
16	454637.13	4575325.58
17	454221.47	4575473.91
18	453953.92	4574842.48
19	454304.06	4574370.82
20	454424.32	4574331.48
21	454400.66	4574251.82
22	454080.06	4574089.49
23	453709.13	4574510.96
24	453741.89	4574695.62
25	453609.17	4574871.04
26	453442.29	4575001.66
27	453245.73	4575105.26
28	453108.5	4575122.76
29	453059.5	4574992.56
30	453022.82	4574990.32
31	452970.74	4575013.14
32	452977.27	4575159.27
33	452845.18	4575193.36
34	452718.48	4575212.54



VENDIM

Nr. 855, datë 26.12.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 597, DATË 4.9.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË
DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS
MUJORE TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS
EKONOMIKE DHE PËRDORIMIT TË
FONDIT SHITESË MBI FONDIN E
KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN
EKONOMIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, pikat 1, 4 e 5, 16, pika 2, dhe 21, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Pas pikës 3 shtohen pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, me këtë përmbajtje:

“3.1 Për familjet përfituese në skemën e ndihmës ekonomike, anëtarët madhorë orientohen me prioritet drejt programeve të nxitjes së punësimit, riintegritimit social dhe punëve publike në komunitet, me qëllim fuqizimin e familjes dhe riintegrimin e saj në shoqëri.

3.2 Anëtarit të familjes përfituese të ndihmës ekonomike, të përfshirë në këto programe punësimi, nuk i llogaritet masë përfitimi e ndihmës ekonomike sipas strukturës së familjes. Në të ardhurat e familjes nuk llogariten pagesat e anëtarëve që ndjekin formimin profesional, të ardhurat nga bursat e fëmijëve që ndjekin arsimin profesional dhe të ardhurat e fëmijëve të angazhuar në arsim dhe në formimin profesional në formën e dyfishtë.

3.3 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, monitoron ecurinë e ndjekjes së programeve nga përfituesit, përmes ndërveprimit të Regjistrat Elektronik Kombëtar të ndihmës ekonomike dhe Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Punësimit, si dhe në përputhje me mekanizmin e referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune, përfitues të skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, të miratuar çdo vit nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe ministri përgjegjës për çështjet e punësimit.”;

b) Në pikën 4.1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Për familjet në nevojë, që në përbërje të tyre kanë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuara, që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar, krahas dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4.1, të këtij kreu, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror merr vërtetimin e komisionit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, nëpërmjet ndërveprimit me Regjistrin Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar.”;

ii. shkronja “d” shfuqizohet;

iii. në shkronjën “e”, fjalët “... mesëm të lartë apo të ...” hiqen;

iv. pas shkronjës “e” shtohet shkronja “p”, me këtë përmbajtje:

“f) Familjet në nevojë, që në përbërje të tyre kanë anëtarë madhorë, paraqesin dy herë në vit vërtetimin për hyrje-daljet nga territori shqiptar, të lëshuar nga portali “e-Albania”.”;

c) Shkronja “c”, e pikës 4.2, shfuqizohet;

ç) Pas pikës 4.5 shtohet pika 4.6, me këtë përmbajtje:

“4.6 Për fëmijët e familjeve në nevojë, prindërve me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë, dhe jetimët, të cilët ndjekin arsimin bazë, vërtetimi për ndjekjen e shkollës për të përfituar pagesën shtesë merret me ndërveprim nga Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar.”.

2. Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalja e parë, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Administratori shoqëror identifikon familjet e individët në nevojë, i informon për regjistrimin si



punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës dhe për të vijuar me procedurat e punësimit përpara aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike. Administratori shoqëror referon për t'i regjistruar si punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës anëtarët madhorë në moshë aktive pune të familjeve në nevojë, që jetojnë në fshat, të cilët kanë firmosur vetëdeklarimin se janë të gatshëm për punë pranë zyrave përkatëse të punës. Individët e referuar paraqiten në zyrën e punës pranë vendbanimit të tyre brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike.”;

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat për familjet që aplikojnë për herë të parë për ndihmë ekonomike. Aplikimi vlerësohet nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar pas ofrimit nga zyra e punës të ofertave të përshtatshme të punësimit për anëtarët madhorë të familjeve aplikuese, të gatshëm për punë, por jo më vonë se deri në fund të muajit të aplikimit.”;

c) Në pikën 2, fjalët “... brenda muajit të aplikimit ...” zëvendësohen me “... brenda 20 (njëzet) ditëve të muajit të aplikimit ...”;

ç) Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, për familjet që aplikojnë për herë të parë, kryen verifikimin në terren pas vlerësimit social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror.”;

d) Në pikën 7, fjalët “... në formë shkresore dhe elektronike ...” zëvendësohen me “... në formë elektronike ...”;

dh) Shkronja “b”, e pikës 11, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Nuk tërheq ndihmën ekonomike brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga dita e depozitimit në llogarinë bankare/kryerjes së pagesave nga Posta Shqiptare sh.a., me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, si ato shëndetësore apo fatkeqësi.”;

e) Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Vërtetimi për përfitimin ose jo të ndihmës ekonomike lëshohet nëpërmjet portalit “e-Albania”.”.

II. Formulari i aplikimit “Për ndihmë ekonomike”, formulari i verifikimit të situatës social-ekonomike, bashkëlidhur vendimit nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me formularët me të njëjtët tituj, përkatësisht sipas shtojcave 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

III. Shtojca 5, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

IV. Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



FORMULAR APLIKIMI (Shtojca 1)

PËR NDIHMË EKONOMIKE

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:

Email: info@shendetesia.gov.al

Tel: +355 4 2376 178

Web: www.shendetesia.gov.al

Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri

2. Mbiemri

3. Emri i Babait

4. NID

Nr. i identifikimit personal

5. Gjinia

Mashkull

Femër

6. Datëlindja

7. Vendlindja

8. Shtetësia

9. Adresa

(Ju lutem specifikoni rrugën, bllokun, nr. e banesës/ apartamentit)

10. Qyteti

11. Rrethi

12. Rajoni:

Bregdetar

Qendror

13. Zona:

Urbane

Malor

Tirana

Rurale

14. Kodi Postar

15. E-mail

16. Nr. Celular

17. Nr. Tel. Fiks

SEKSIONI A2: INFORMACION SPECIFIK MBI ADMINISTRATORIN SOCIAL

1. Emri

2. Mbiemri

3. NID

Nr. i identifikimit personal

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

1. Grupi etnik:

Shqiptar

Grek

Rom

Maqedonas

Malazeze

Vllahe

Tjetër (specifiko)

2. Gjuha në të cilën do të dëshironi të merrni informacion të mëtejshëm nëlidhje me aplikimin tuaj:

3. A përfiton pagesë të aftësisë së kufizuar/pension invaliditeti ndonjë nga anëtarët e familjes?

Po

Jo





Certifikatë familjare:

Listoni emrat e të gjithë anëtarëve të familjes:	NID (Nr. i identifikimit personal) Shënoni N/A nëse nuk keni asnjë pjesëtar	Seksi: 1= M 2= F	Datëlindja (data/muaji/viti)	Mosha:	Marrëdhënia me kryefamiljarin: ☐ Kryefamiljari ☐ Bashkëshortja/ Partneri ☐ Fëmija/ fëmija i adoptuar ☐ Nipër ☐ Mbesa ☐ Baba/ mama ☐ Motër/ vëlla ☐ Dhëndër/ nuse ☐ Kunatë/ kunata ☐ Gjysh/ gjyshe ☐ Vjehërr/ vjehërre ☐ Të afërm të tjerë ☐ Jo të afërm	Gjendja civile: ☐ I martuar ☐ Divorcuar/ Ndarë ☐ J etojnë së bashku ☐ I ve/vejushë Beqar	A përfiton [EMRI] pagesë të aftësisë së kufizuar/ pension invaliditeti/ ndihmë ekonomike si individ? 1= Po 2=Jo	Kryerja e vaksinimit sipas kalendarit të detyrueshëm për grup moshat e fëmijëve 1= Po 2=Jo
--	--	------------------------	------------------------------	--------	---	---	---	--

ARSIMI DHE PUNËSIMI

4. Arsimi më i lartë i arritur:

- | | |
|---|--|
| ☐ Asnjë | ☐ Arsim profesional 4-5 vjet |
| ☐ Arsim fillor | ☐ Programe të Ciklit të Tretë në Shqipëri |
| ☐ Arsim bazë | ☐ Përfunduar arsimin e lartë në Shqipëri |
| ☐ Arsim i mesëm i përgjithshëm | ☐ Përfunduar arsimin e lartë jashtë Shqipërisë |
| ☐ Arsim profesional 2-3 vjet | ☐ Programe të Ciklit të Tretë jashtë Shqipërisë |



PËR TË GJITHË PERSONAT NË FAMILJE QË JANË 16 VJEÇ E LART

Nr	A jeni duke ndjekur arsimin e mesëm apo të lartë? Niveli bachelor? Niveli Master? Doktoratë?	A keni punuar në 4 javët e fundit? Përfshirë punën e papaguar në një fermë apo biznes familjar apo edhe disa orë punë si e rastësishme?	A jeni të përfshirë në Programet e Punës në Komunitet/Nxitjes së Punësimit /rinitërgjim të ofruar nga Zyrat e Punës?	Në këtë punë jeni: 1 = Një punonjës idikujt i cili nuk është anëtar i familjes; 2 = Punëtor me pagesë në një fermë familjare apo biznes tjetër; 3 = Punëdhënës; 4 = Punëtor me llogari më vete (i vetë-punësuar); 5 = Punëtor i papaguar në fermë/ biznes familjar 6 = Të tjera_	A keni të drejtë të përfitonit nga skema e sigurimeve shoqërore në këtë punë apo nga programi për gratë e papuna me tre e më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç?	Sa ishte pagesa juaj e fundit apo fitimet NETO? (Nëse i intervistuari ende nuk është paguar, PYETET: Çfarë pagese presin?) Cilën periudhë kohore mbulon kjo pagesë / apo fitim?	Sa është pagesa/ fitimi juaj i zakonshëm NETO? Çfarë periudhe kohore mbulon kjo pagesë? (merr parasysh kohën e 12 muajve të fundit, nëse Ju keni filluar punë më pak se 12 muaj më parë, merr në konsideratë mesataren qysh nga fillimi)		
		1=Po, 2=Jo	1=Po, 2=Jo		1=Po, 2=Jo				
						Njësia	në kohë	Njësia	kohore
1						Muaj	1	Muaj	1
2						15 ditë	2	15 ditë	2
3						javore	3	javore	3
4						ditore	4	ditore	4
5						Lekë	Njësia kohore	Lekë	Njësia kohore
6									
7									
8									
9									
10									

BANESA, UJË/DRITA/GAZ DHE MALLRA TË QËNDRUESHËM

5. Tipi i banesës:

☐ Shtëpi private☐ Apartament☐ Të tjera (specifikojë)

6. Numri i dhomave që ka familja

(përfshijë kuzhinën, ballkonin, korridoret dhe banjat)

7. Gjendja e njësive të banimit:

☐ Gjendje shumë e mirë☐ E përshtatshme për jetesë☐ E papërshtatshme për jetesë☐ Në ndërtim



8. Lloji i banjës që ka banesa:

Tualet brenda shtëpisë

2 ose më shumë tualete brenda shtëpisë

Të tjera (specifiko)

Tualet jashtë me kanalizim

Tualet jashtë pa kanalizim

9. Të tjera:

Kuzhinë të ndarë

Dush/vaskë të ndarë

Ballkon ose tarracë

Aneks gatimi

Papafingo

Garazh

Ashensor

10. Statusi i pronësisë së ndërtesës:

Pronar

Pronar me një hua hipotekore për ndërtesën

E marrë me qira nga një individ privat

E marrë me qira nga shteti

Jetoj falas/pa pagesë

Të tjera (specifiko)

11. Distanca më e afërt e banesës nga _____ (matësi: në minuta):

Stacion Autobusi/
Furgoni

Shkollë fillore

Ambulancë/
doktor

12. Burimi kryesor i ujit të përdorur në këtë familje:

Ujë i rrjedhshëm brenda banesës

Ujë i rrjedhshëm jashtë banesës

Lum, liqen, pellg ujqor ose diçka e tillë

Të tjera (specifiko)

Autobot me ujë

Burim ose pus

Çezmë publike

13. A ka banesa kontratë aktive me operatorin e shërbimit të furnizimit dhe kanalizime për ofrimin e shërbimit?

Po Jo

14. Nëse po, numri i kontratës për ofrimin e shërbimit të ujësjellës Kanalizimeve:

15. Matësi i ujit:

I përbashkët

Individual

Nuk ka matës

16. Burimi i ngrohjes që përdoret në familje:

Energji elektrike

Dru zjarri

Gaz

Të tjera

(specifiko)

Qymyr

Ngrohje qendrore

Naftë/vajguri

17. Matësi i energjisë elektrike:

I përbashkët

Individual

Nuk ka matës

Numri i kontratës së energjisë elektrike



18. A përdor familja juaj gaz?

Po Jo

19. Qëllimi i përdorimit të gazit:

Ndriçim

Gatim

Ngrohje

Aparate të tjera elektrike

ASETET FAMILJARE

20. Për çdo artikull të listuar më poshtë, ju lutem tregoni nëse familja juaj i zotëron ato apo jo:

Artikulli	Për çdo artikull të listuar më poshtë, J u lutem tregoni nëse familja juaj i zotëron apo jo?:
TV me ngjyra	
Tv pa ngjyra	
Video/DVD player	
Magnetofon/CD player	
Kamera/video kamera	
Frigorifer	
Frigorifer ftohës (ngjirës)	
Makinë larëse	
Pjatararëse	
Sobë me gaz/energji elektrike	
Sobë me vajguri	
Sobë me dru zjarri	
Kalorifer	
Gjenerator	
Makinë qepëse/thurëse	
Kondicioner	
Boiler	
Komputer	
Aparat marrës satelitor/aparat marrës kabllor	
Biçikletë	
Motoçikletë/ Motor me kubik të vogël	
Makinë/veturë	
Kamion	
Makinë Dumdum	
Mikrovalë	
Furnelë/ rezistencë	



21. A zotëron tokë familja juaj? Po Jo

22. A jep tokë me qera familja juaj? Po Jo

23. Cila është sipërfaqja e tokës ?

(në metra katror)

Sipërfaqja e zotëruar:

Sipërfaqja me qera:

24. A ka dikush në familjen tuaj ndonjë gjë të gjallë, shpezë, zgjua bletësh ose që angazhohet në akuakulturë?

(Nëse po, shënoni numrin e tyre)

Tipi	Numri
Lopë	
Derra	
Dele/dhi	
Shpezë	
Kuaj	
Gomar, Mushkë	
Dem	
Zgjua bletësh	
Lepuj	
Peshk (akuakulturë)	

MBROJTJA SOCIALE

25. Në 12 muajt e fundit, a ka marrë ndonjë anëtar i familjes tuaj ndonjë pagesë nga burimet e mëposhtme?

(Plotëso tabelën më poshtë për të gjitha burimet)

Burimi	1 = Po; 2 = Jo	Shuma e pagesës së fundit të familjes suaj (Lekë)	Numri i muajve që iu referohet kjo pagesë (Muaj)
Ndihma ekonomike			
Pagesa për aftësinë e kufizuar			
Pension pleqërie - Urban			
Pension pleqërie -Rural			
Pension suplementar			
Pension invaliditeti - Urban			
Pension invaliditeti- Rural			
Pension për merita të veçanta			
Pension familjar			
Pension social			
Asistencë papunësie			
Përfitime për veteranë të luftës			
Pagesa për barrë lindje (përfshin pagesat e marra gjatë lejes së lindjes)			
Kujdesi social/ shërbimet për të moshuarit dhe për personat me aftësi të kufizuar			



Pagesa të lejes së sëmundjes (1-6 muaj)			
Të tjera (specifiko)			
Total të gjitha programet			

TË ARDHURA TË TJERA

26. Në 12 muajt e fundit a keni marrë pagesë nga burimet e mëposhtme (para në dorë apo formë tjetër pagesë) ju apo ndonjë anëtar tjetër i familjes tuaj? (Plotëso tabelën më poshtë për të gjitha burimet)

Nr	Burimi	1 = Po; 2 = Jo	Shuma në total që ka marrë familja juaj në 12 muajt e fundit nga [BURIMI], përfshirë vlerën e ndonjë dhurate ose pagese në formë mallrash (Lekë)
1	Përfitime nga mbrojtja sociale (All SP)		
	Remitanca/ dërgesa në të holla/ dhurata		
2	Remitanca/ dhurata nga të afërm jashtë shtetit		
3	Dhurata nga të afërm në Shqipëri		
4	Dhurata nga të afërm të tjerë (përfshirë dhurata për një ceremoni)		
5	Dhurata/ asistencë nga institucione		
	Të ardhura nga qiratë		
6	Qira nga toka /por jo tokë bujqësore		
7	Qira nga apartamentet/shtëpia		
8	Qira nga dyqani, dyqanet etj		
9	Qira nga makina, kamioni apo automjete të tjera		
	Të ardhura nga shitjet e aseteve		
10	Shitje e pronës së patundshme shtëpi, tokë, etj		
11	Shitje e mallrave të qendrushëm të familjes		
12	Shitje e aseteve të tjera		
	Të ardhura të tjera		
13	Nga ndonjë trashëgimi		
14	Fitime nga lotaritë apo bixhozi/kumari		
15	Të ardhura të tjera		
	Të ardhura bujqësore		
16	Prodhime bujqësore të shitura /bimë bujqësore		
17	Produkte të shitura bujqësore si mjaltë, pije alkoolike (raki, verë), ushqim të përpunuar, etj		
18	Gjë e gjallë e shitur /shtazore		
19	Nënprodukte shtazore të shitura (vezë, qumësht, djath, lesh, lëkurë bagëtish, etj		
20	Të ardhura në lekë në dorë ose kontribut në natyrë nga kooperativat bujqësore apo shoqata të tilla		

27. Të ardhurat neto mujore në total të familjes
(Shuma në total e të ardhurave të anëtarëve të familjes nga pagat / rrogat, mbrojtja sociale, pensionet, asistencë)

28. Shpenzimet totale mujore të familjes

29. Tjetër
(diçka që aplikanti dëshiron të thotë)

30. Emri i kryefamiljarit/bashkëshortes që do të administrojë shumën e ndihmës



KLAUZOLA DEKLARATIVE

Autorizoj Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të dhënat konfidenciale të aplikantit:

Emri i Administratorit Social

Nr. i identitetit kombëtar të
Administratorit Social

Emri i personit që hedh
të dhënat

Vendi i intervistës

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar, autorizoj me vullnetim tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar.

☐ Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.

Nënshkrimi i aplikantit

Data	Muaji	Viti					

**FORMULAR** (Shtojca 2)

VERIFIKIMI I SITUATËS SOCIAL-EKONOMIKE

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

**Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:**

Tel: (+355) 42 22 56 831 / 38
E-mail: info.akkp@akkp.gov.al
Web: www.akkp.gov.al

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë
informacionin e kërkuar në fushat më poshtë,
Me Shkronjë të Madhe e në ngjyrë blu.

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri i Babait		4. NID Nr. i identifikimit personal	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	
7. Vendlindja		8. Shtetësia	
9. Adresa			
10. Qyteti		11. Rrethi	
12. Kodi Postar		13. E-mail	
14. Nr. Tel. Celular		15. Nr. Tel. Fiks	

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI ADMINISTRATORIN SOCIAL

1. Emri		2. Mbiemri	
4. NID Nr. i identifikimit personal			

SEKSIONI C: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN / DEMOGRAFIA E FAMILJES

Nr.	Emër, Mbiemër	ID	A është i saktë informacioni rreth anëtarëve të familjes?	A është deklaruar saktë paaftësia?	A është deklaruar saktë statusi i të punësuarit?	A është deklaruar saktë arsimimi?
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						

Ky formular është standardizuar nga ADISA



BANESA, UJË/DRITA/GAZ DHE MALLRA TË QËNDRUESHËM

19. Tipi i banesës

20. Numri i dhomave që ka familja
(përfshijë kuzhinën, ballkonin, korridoret dhe banjat)

21. Cila është gjendja e njësisë së banimit?

22. A ka banesa juaj:

- ☐ Kuzhinë të ndarë ☐ Dush/vaskë të ndarë ☐ Ballkon ose terracë ☐ Aneks gatimi
☐ Papafingo ☐ Garazh ☐ Ashensor

23. Cili është statusi i pronësisë së kësaj banese?

24. Çfarë burimi ngrohjeje përdorni kryesisht në familje?

25. A ka banesa matës në vet të energjisë elektrike?

- ☐ Po ☐ Jo

26. A përdor familja juaj gaz?

- ☐ Po ☐ Jo

Cili është qëllimi i përdorimit të gazit?

- ☐ Ndryçim ☐ Ngrohje ☐ Gatim ☐ Aparatë të tjera elektrike

ASETET FAMILJARE

27. Për çdo artikull të listuar më poshtë, ju lutem tregoni nëse familja juaj i zotëron ato apo jo

Artikulli	Kodi	Kontrollo nëse asetet janë raportuar saktë
TV	101	
Frigorifer	106	
Makinë larëse	108	
Pjatarëse	109	
Sobë me gaz/energji elektrike	110	
Sobë me vajguri	111	
Sobë me dru zjarri	112	
Mikrovalë	125	
Kalorifer	113	
Makinë qepëse/thurëse	115	
Boiler	117	
Aparat marrës satelitor/aparat marrës kabllor	119	
Biçikletë	120	
Motoçikletë/motor me kubik të vogël	121	
Autoveturë (specifiko)	122	



28. A ka dikush në familjen tuaj ndonjë gjë të gjallë?

Asete, gjë e gjallë	Sasia/Njësia
☐ Lopë	
☐ Derra	
☐ Dele/dhi	
☐ Shpezë	
☐ Kuaj	
☐ Gomar, Mushkë	
☐ Dem	
☐ Zgjuar bletësh	
☐ Lepuj	
☐ Peshk (akuakulturë)	
☐ Tjetër (specifiko)	

29. Përshkrim i shkurtër i nivelit të jetesës së aplikantit

A përputhet niveli i jetesës me të ardhurat/konsumin e deklaruar? Të ardhurat janë deklaruar më pak apo më shumë?

Nënshkrimi i anëtarit
të familjes

Data	Muaji	Viti					

Nënshkrimi i anëtarit
të familjes

Data	Muaji	Viti					

Nënshkrimi i
administratorit social

Data	Muaji	Viti					

Nënshkrimi i
administratorit social

Nënshkrimi i
punonjësit të
DRSHSSH



Shtojca 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

DREJTORIA RAJONALE _____

VENDIM

Nr. _____ datë _____

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIUdhËN _____

Duke u mbështetur në nenin 20, pika 4 të ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në RSHP”, dhe në bazë të listës së plotë të plotë të familjeve/individëve në nevojë për trajtim me ndihmë ekonomike të Bashkisë _____, Drejtoria Rajonale _____.

Vendosi:

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike pas aplikimit _____ familje, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur.
2. Individë me statusin e Jetimit _____ persona, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
3. Individë viktime të trafikimit _____ persona, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
4. Individë viktime të dhunës në familje _____, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
5. Prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh:
 - a) Trinjakë _____ familje, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
 - b) Katërnjakë _____ familje, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
 - c) Pesënjakë e më shumë njëherësh _____ familje, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
6. Fëmijë të vendosur në familje kujdestare¹ _____ aplikime, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
7. Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare² _____ aplikime, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
8. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike _____ familjet e mëposhtme, për arsytet e renditura përbri.

Emri Atësia Mbiemri i kryefamiljarit

Arsyet e daljes nga skema

1. _____

2. _____

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Drejtori Rajonal i Shërbimit Social**VULA**¹ Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSHP”, neni 24, pika 5² Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSHP”, neni 24, pika 5

**VENDIM****Nr. 858, datë 26.12.2024**

**PËR PËRCAKTIMIN E
DOKUMENTACIONIT PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË
PRIVATIZIMIT, MËNYRËN E
PËRLLLOGARITJES SË VLERËS SË
PAGESËS SË MBETUR DHE AFATET E
PAGESËS SË PRIVATIZIMIT TË
OBJEKTEVE TË ISH-NDËRMARRJEVE
BUJQËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 18/2023, “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë dokumentacionin, mënyrën e përllogaritjes së vlerës së pagesës së mbetur dhe afateve të shlyerjes së saj për objektet e ish-ndërmarrjeve bujqësore, për të cilat ka filluar procesi i privatizimit nga ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore.

2. Ky vendim nuk zbatohet dhe procesi i privatizimit nuk kryhet, kur:

a) objekti është shembur dhe nuk ekziston;

b) objekti apo truall nën objekt janë pjesë e një procesi gjyqësor, deri në marrjen e vendimit të formës së prerë.

3. Procedura për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore, për të cilat ka filluar ky proces, fillon vetëm me paraqitjen e kërkesës me shkrim nga subjektet e interesuara pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

4. Kërkesa përmban identitetin e kërkuarit, të dhënat e objektit për të cilin kërkohet përfundimi i procesit të privatizimit, kopje të kontratës së shitjes (nëse ka), mandate të pagesave të vlerës së plotë apo të pjesshme të privatizimit (nëse ka).

5. Dokumentacioni i kërkuar për përfundimin e procesit të privatizimit për objektet e përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, nenit 4, të ligjit nr. 18/2023, “Për përfundimin e procesit të privatizimit

të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, është, si më poshtë vijon:

a) akti i miratimit të privatizimit për objektin;

b) pasqyra nr. 2 për gjendjen faktike dhe llogaritjen e vlerës së privatizimit;

c) kontrata e shitjes së objektit/truallit;

ç) genplani apo planimetria e objektit/truallit;

d) mandatet e pagesës së vlerës së plotë të objektit/truallit.

6. Dokumentacioni i kërkuar për përfundimin e procesit të privatizimit për objektet e përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, nenit 4, të ligjit nr. 18/2023, “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, është, si më poshtë vijon:

a) akti i miratimit të privatizimit për objektin;

b) pasqyra nr. 2 për gjendjen faktike dhe llogaritjen e vlerës së privatizimit;

c) kontrata e shitjes së objektit apo truallit;

ç) genplani apo planimetria e objektit/ose truallit;

d) pagesat pjesore të kryera.

7. Dokumentacioni i kërkuar për përfundimin e procesit të privatizimit për objektet e përmendura në shkronjën “c”, të pikës 1, nenit 4, të ligjit nr. 18/2023, “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, është, si më poshtë vijon:

a) akti i miratimit të privatizimit për objektin;

b) pasqyra nr. 2 për gjendjen faktike dhe llogaritjen e vlerës së privatizimit;

c) genplani apo planimetria e objektit;

ç) pagesat e kryera.

8. Dokumentacioni i kërkuar për përfundimin e procesit të privatizimit për objektet e përmendura në shkronjën “ç”, të pikës 1, nenit 4, të ligjit nr. 18/2023, “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, është, si më poshtë vijon:

a) akti i miratimit të privatizimit për objektin;

b) pasqyra nr. 2 për gjendjen faktike dhe llogaritjen e vlerës së privatizimit;

c) genplani apo planimetria e objektit;

ç) pagesat pjesore të kryera.

9. Dokumentacioni i kërkuar për përfundimin e procesit të privatizimit për objektet e përmendura në shkronjën “d”, të pikës 1, nenit 4, të ligjit nr. 18/2023, “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, është, si më poshtë vijon:

a) akti i miratimit të privatizimit për objektin;



- b) akti i dorëzimit;
- c) pagesa e kryer;
- ç) genplani apo planimetria e objektit.

10. Për objektet, për të cilat janë shpallur debitorë poseduesit aktualë, procesi i përfundimit të privatizimit vijon me pagesën e vlerës së plotë të objektit, sipas vlerës fillestare të kontabilizuar. Arkëtimi i pagesave të kësteve të mbetura nga vlera e privatizimit të objektit/truallit bëhet 100% në lekë.

11. Debitorët privatë, për objektet ndërtimore të kontabilizuara, sipas vendimit nr. 403, datë 15.8.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për arkëtimin e detyrimeve financiare në ndërmarrjet në varësi të Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të NB-ve”, shlyejnë detyrimet, sipas parashikimit në pikën 1, të këtij vendimi.

12. Afati i pagesës së vlerës së kësteve të mbetura pa paguar është 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i marrjes së faturës për arkëtim të lëshuar nga ministria përgjegjëse për bujqësinë.

13. Të ardhurat e përfituara nga ky proces kalojnë në buxhetin e shtetit.

14. Kur Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, në territorin e së cilës ndodhet objekti, nuk e administron praktikën e privatizimit apo mungojnë akte ose dokumente, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural pranon dokumentacionin origjinal nga subjekti i interesuar. Subjekti paraqet deklaratë noteriale, nëpërmjet së cilës merr përsipër përgjegjësinë për origjinalitetin dhe vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar, që nuk ka transferuar të drejtat tek të tretët, si dhe që titulli i pronësisë nuk është shpallur i pavlefshëm me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

15. Gjatë kryerjes së procedurave administrative, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural verifikon në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës statusin juridik, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, nëse objekti i privatizuar apo truall i nën objektin e privatizuar është ende në pronësi shtetërore dhe nuk ka kaluar në pronësi të të tretëve.

16. Në rastet kur konstatohet se të drejtat për objektin e privatizuar apo truallin nën objektin e privatizuar janë transferuar tek të tretët, procesi i kalimit të pronësisë realizohet në favor të tyre. Subjektet paraqesin dokumentacionin, sipas pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 18/2023, “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore”.

17. Për efekt regjistrimi, një kopje e kontratës dhe planvendosjes së objektit dhe truallit funksional të tij, kur është rasti, në origjinal, i përcillet drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, që ushtron aktivitetin në territorin ku ndodhet objekti i privatizuar. Regjistrimi në regjistrat kadastralë bëhet pas paraqitjes së kërkesës së subjektit përfitues, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe me aktet nënligjore në fuqi.

18. Ngarkohen ministria përgjegjëse për bujqësinë, ministria përgjegjëse për financat, ministria përgjegjëse për ekonominë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 859, datë 26.12.2024

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2024-2030, PLANIT TË VEPRIMIT 2024-2026 NË ZBATIM TË SAJ DHE PASAPORTËS SË TREGUESVE TË PERFORMANCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030, planit të veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, ministritë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të përcaktuara në strategji, në planin e veprimit dhe në pasaportën e treguesve të performancës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2024 – 2030

PËRMBAJTJA

1. HYRJA

2. KONTEKSTI STRATEGJIK

- Qëllimi i dokumentit strategjik
- Kuadri ligjor dhe institucional në luftën kundër

korruptionit

- Deklarata e vizionit

3. QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË SNKK 2024-2030

- Qëllimi i parë i Politikës: Parandalimi i korruptionit

- Objektivi Specifik 1.1: Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korruptionit

- Objektivi Specifik 1.2: Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes

- Objektivi Specifik 1.3: Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korruptionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korruptioni)

- Objektivi Specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korruptionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore

- Objektivi Specifik 1.5: Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik

- Objektivi Specifik 1.6: Forcimi i kornizës së sinjalizuesëve për zbulimin e hershëm të korruptionit

- Objektivi Specifik 1.7: Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike

- Objektivi Specifik 1.8: Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korruptionit

- Objektivi Specifik 1.9: Promovimi i integritetit në sektorin privat

- Qëllimi i dytë i Politikës: Ndëshkimi i korruptionit

- Objektivi Specifik 2.1: Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve profesionale për hetimin efektiv administrativ të korruptionit

- Objektivi Specifik 2.2: Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korruptionit

- Objektivi Specifik 2.3: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korruptionit, krimin ekonomik dhe pastrimit të parave

- Qëllimi i tretë i Politikës: Ndërgjegjësimi dhe edukimi kundër korruptionit

- Objektivi Specifik 3.1: Rritja e ndërgjegjësimin të qytetarëve për pasojat negative të korruptionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korruptionin

- Objektivi Specifik 3.2: Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korruptionit

- Objektivi Specifik 3.3: Përfshirja e opinionit publik, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korruptionit

- Objektivi Specifik 3.4: Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korruptionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm

4. MASAT PRIORITARE PËR ZBATIMIN E SNKK 2024 – 2030

- Përcaktimi i masave prioritare të qeverisë në kuadër të Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korruptionit 2024-2030

5. ZBATIMI, LLOGARIDHËNIA DHE KOORDINIMI

- Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit

6. PLANI I VEPRIMIT DHE VLERËSIMET FINANCIARE

- Kostimi i zbatimit të Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korruptionit 2024-2030 sipas tre Qëllimeve të Politikës

Hyrje

Prej vitit 2015, Shqipëria ka miratuar dhe zbaton një kuadër strategjik në luftën kundër korruptionit, me qëllim koordinimin e të gjithë përpjekjeve të të gjitha institucioneve përgjegjëse për luftën kundër korruptionit, si institucione të Qeverisë, institucione të pavarura të veshura me kompetenca të luftës kundër korruptionit si dhe institucione ligjzbatuese dhe të gjyqësorit. Nga ana e saj, Qeveria Shqiptare ka udhëhequr përpjekjet në luftën kundër korruptionit paralelisht në disa drejtime, me fokus të veçantë shtrirjen kapilare të digjitalizimit të



shërbimeve publike, ngritjen e sistemeve funksionale të ankesave, si dhe forcimin e arkitekturës institucionale në luftën kundër korrupsionit, për të avancuar politikat antikorrupsion dhe për të vëzhguar e më pas vepruar mbi tendencat e shpërfaqjes së korrupsionit në të gjithë aparatin qeverisës. Paralelisht, të gjithë institucionet publike përgjegjëse në drejtim të parandalimit të korrupsionit, ndërgjegjësimi si dhe ndëshkimit, janë zhvilluar në drejtim të zbatimit të politikave antikorrupsion, por edhe në drejtim të rritjes së efektivitetit të hetimit dhe gjykimit të rasteve të korrupsionit.

Përgjatë këtij harku kohor, Shqipëria vendosi gurin e themelit në luftën kundër korrupsionit përmes miratimit dhe zbatimit të reformës në drejtësi, si një nga reformat më efektive në luftën kundër korrupsionit, si përmes zbatimit të sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ashtu edhe përmes ngritjes së strukturave të posaçme për hetimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, konkretisht Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Byronë Kombëtare të Hetimit, si dhe Gjykatën e Shkallës së Parë dhe atë të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Rezultatet e punës së këtyre institucioneve, janë vlerësuar pozitivisht edhe nga partnerët ndërkombëtarë, që monitorojnë progresin e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, përfshirë këtu Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të të gjitha arritjeve në luftën kundër korrupsionit, si dhe adresimin e drejtpërdrejtë të të gjitha detyrimeve që burojnë nga procesi i negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, forcimi dhe thellimi i kuadrit strategjik me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së reformave dhe vazhdimësinë e ndërhyrjeve për të reduktuar progresivisht incidencën e korrupsionit, merr rëndësi thelbësore. Lufta ndaj korrupsionit mbetet një nga sfidat kryesore të vendit, dhe për këtë arsye lind si domosdoshmëri forcimi dhe mirëkoordinimi i të gjithë përpjekjeve institucionale për të adresuar në mënyrë sistematike çdo problematikë që cenon integritetin e performancës institucionale.

Në nivel qeveritar, prioritizimi i politikave antikorrupsion është ngritur në tjetër nivel në vitin 2024 me krijimin e pozicionit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, i cili njëkohësisht ushtron edhe kompetencat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, për të sinergjizuar punën e institucioneve të ekzekutivit në raport me politikat antikorrupsion të Qeverisë dhe zbatuar të gjitha zotimet, në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies.

Në këtë kontekst, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, përfaqëson një dokument me angazhime konkrete të të gjithë institucioneve që ushtrojnë kompetenca në drejtim të parandalimit, ndëshkimit dhe ndërgjegjësimi ndaj luftës kundër korrupsionit, përfshirë këtu, institucione publike në nivel qendror dhe vendor, institucione të pavarura si dhe institucione ligjzbatuese dhe ato që i përkasin gjyqësorit.

Ngritur mbi këtë kuadër institucional, Strategjia paraqet një qasje të re me ndërhyrje sistematike në fusha vulnerabel ndaj korrupsionit, forcimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor në luftën kundër korrupsionit, shtrirjen e masave të parandalimit të korrupsionit në pushtetin vendor, promovimin e integritetit në biznes, konsolidimin e mëtejshëm të kuadrit institucional përgjegjës për hetimin dhe gjykimin e korrupsionit, si dhe promovimin e integritetit në sektorin privat, ashtu edhe ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rinjve mbi ligjshmërinë dhe integritetin. Ky kuadër i ri strategjik garanton përputhje të plotë me angazhimet e ndërmarra nga institucionet shqiptare në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe adreson në mënyrë koherente gjetjet e Komisionit Evropian në Raportin e Shqyrtimit Analitik për Grupkapitullin e Parë “Themeloret” mbi hapat e nevojshëm për të përmirësuar performancën e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, si një ndër fushat kyçe të avancimit të shtetit të së drejtës dhe vendosjen e gurëve kilometrikë drejt aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.



PARANDALIM. NDËSHKIM. NDËRGJEGJËSIM

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, përbëhet nga një strukturë të bazuar në tre qëllime politikash: Parandalim (I) – Ndëshkim (II) – Ndërgjegjësim (III).

Politika e parë, Parandalimi (I) synon konsolidimin dhe zhvillimin e instrumenteve dhe mekanizmave të parandalimit të korrupsionit, duke promovuar integritetin, transparencën dhe etikën në të gjitha nivelet e qeverisjes, si në nivel qendror ashtu edhe vendor. Parandalimi i korrupsionit ul nevojën për ndëshkim penal dhe ka një impakt më të gjerë në promovimin e besimit të publikut dhe qeverisjes së mirë të zyrtarëve publikë. Parandalimi do të fokusohet tek sektorët vulnerabël ndaj korrupsionit dhe promovimin e punës së zyrtarëve publikë mbi baza integriteti dhe llogaridhënieje. Në kuadër të parandalimit synohet gjithashtu, promovimi i mëtejshëm i përdorimit të ligjshëm të fondeve publike, transparenca e financave të partive politike, normimi i instrumentave të lobimit, etj. Një vëmendje e veçantë do i kushtohet gjithashtu edhe nxitjes së sektorit privat me qëllim promovimin e integritetit në fushën e biznesit.

Nëpërmjet **politikës së dytë, Ndëshkimit (II)** strategjia do të synojë konsolidimin e hetimit dhe ndjekjes penale të korrupsionit. Institucionet ligjzbatuese dhe organet e drejtësisë do të intensifikojnë përdorimin e mjeteve hetimore

efektive, të dedikuara për të luftuar korrupsionin, burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare në kuadër të këtij funksioni, si dhe të rrisin bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër krimit transnacional. Në këtë qëllim politikash synohet dhe plotësimi i kuadrit rregullator, strukturave operacionale dhe ndërveprimi mes strukturave përgjegjëse për hetimin penal të korrupsionit.

Nëpërmjet **politikës së tretë, Ndërgjegjësimit (III)** strategjia synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit kundër korrupsionit, përmes forcimit të edukimit mbi integritetin në sistemin arsimor parauniversitar, përgjatë niveleve arsimore, si dhe nëpërmjet forcimit të edukimit të sektorit publik, me qëllim garantimin e një sektori publik përgjegjës dhe llogaridhënës përpara shoqërisë.

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, është një dokument politikash në nivel kombëtar që nxit bashkëpunimin e organeve të pushtetit ekzekutiv, autoriteteve të pavarura kushtetuese, institucioneve jo qeveritare dhe sektorit privat.

Qeveria Shqiptare dhe të gjitha institucionet e tjera bashkëpërgjegjëse në luftën kundër korrupsionit, me këtë strategji mbeten të zotuar për të ndërmarrë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme në nivel ligjor, institucional dhe operacional, si kundërpërgjigje për të adresuar nevojat që diktohen në kuadër të luftës kundër korrupsionit.

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
ADB	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
AMP	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
AK	Autoritetet Kontraktore
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMSHC	Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
ATP	Agjencia e Trajtimit të Pronës
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPAK	Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
GJKKO	Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë



ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
INSTAT	Instituti i Statistikave
IQ	Inspektorati Qendror
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KLQJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLSH	Kontrulli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
KMSHC	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
KSHZ	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
MAPA	Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionit
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MF	Ministria e Financave
MSHMP	Ministër Shteti për Marrdhëniet me Parlamentin
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHPV	Ministër Shteti për Pushtetin Vendor
MSHSKB	Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
OSHC	Organizatrat e Shoqërisë Civile
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PSH	Policia e Shtetit
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SASPAC	Ajencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SHM	Shkolla e Magjistraturës
ZRA	Zyra e Rikuperimit të Aseteve

PJESA I KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Qëllimi i dokumentit strategjik

Qëllimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, është të orientojë politikat kryesore në drejtim të luftës kundër korrupsionit të udhëhequra nga të gjitha institucionet përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit. Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, mbështetet nga një Plan Veprimi me masa specifike zbatimi, me afate kohore të përcaktuara e përgjegjësi institucionale të parashikuara dhe garanton një mekanizëm monitorimi të këtyre masave, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe koordinimit ndërinstitutional.

Gjatë hartimit të këtij dokumenti strategjik, u vlerësuan tri mundësi:

(i) Mundësia 0: Opsioni i *status quo*-së do të ishte që në parim të linte situatën të qëndronte siç ishte në fund të vitit 2023 dhe të mos vazhdohej me procesin e reformave antikorrupsion. Përfundimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 do të rezultonte në ndërprerjen e matjes së 18

objektivave strategjikë, masave dhe aktiviteteve përbërëse, si dhe do të bënte të pamundur adresimin e mëtejshëm të objektivave që paraqesin risk të lartë, sikurse do të ndalonte vijim e reformave në këtë fushë, duke penguar dhe procesin e avancimit të negociatave të aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

(ii) Mundësia 1: Zgjatja e afatit të strategjisë aktuale dhe planit të saj të veprimit, do të ishte një alternativë e mundshme, me përfundimin e afatit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023. Ky opsion do të kursente kostot e lidhura me hartimin e një strategjie të re, por në të njëjtën kohë do të pengonte rifreskimin e vizionit për luftën kundër korrupsionit, në këtë fazë të zhvillimit të vendit, në kohën kur Shqipëria ka hapur Grupkapitullin e parë të negociatave “Themeloret”, duke e bërë më të vështirë adresimin e natyrës gjithnjë e më dinamike të fenomenit të korrupsionit, si dhe përgatitjen e një përgjigjeje koherente dhe të qartë ligjore e institucionale për sfidat aktuale.

(iii) Mundësia 2: Miratimi i një strategjie të re, me afat kohor 2024-2030, përqendron përpjekjet në



rikonceptimin e objektivave specifike, duke marrë parasysh fazën aktuale të zbatimit të SNKK 2025-2023 dhe nevojën për të përfshirë fusha dhe sektorë të rinj në vëmendje si dhe adresimin e të gjitha detyrimeve që burojnë nga procesi i negociatave me BE-në. Strategjia e re do të ofronte një programim strategjik për fusha dhe sektorë që paraqesin prioritet dhe rrezik ndaj korrupsionit, duke siguruar bashkërendimin e aktorëve të ndryshëm brenda dhe jashtë sektorit publik. Kjo do të realizohej përmes një linje të përbashkët veprimi dhe angazhimi, e cila do të promovonte një qasje të koordinuar dhe të integruar në luftën kundër korrupsionit. Kjo qasje do të përfshinte përfundimin e reformave ligjore dhe institucionale, duke vijuar me një program intensiv investimesh në institucionet që ofrojnë shërbime. Njëkohësisht, do të sigurohej përmirësimi i kapaciteteve koordinuese, menaxhuese dhe të komunikimit, për t'u përshtatur me nevojat e sektorëve deri në përfundimin e efekteve juridike të strategjisë në vitin 2030.

Pas vlerësimit të mundësive të përmendura më lart, dhe duke marrë parasysh fazën aktuale të reformës antikorrupsion, mundësia e dytë (2) konsiderohet si më e përshtatshme për zbatimin e saj.

Në këtë kuadër, procesi i hartimit të strategjisë kaloi në tre faza:

Faza I: Kjo fazë, përqendrohet në përgatitjen e terrenit për zhvillimin e një strategjie të re dhe përshtatjen e saj me zhvillimet aktuale dhe sfidat e identifikuar përgjatë procesit të negociatave veçanërisht në Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit për Grup-kapitullin e Parë të korrikut 2023 dhe detyrimet e ndërmarra në kuadër të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës. Për të analizuar ndryshimet në kontekstin e luftës kundër korrupsionit, kjo fazë u fokusua në analizimin e situatës aktuale të korrupsionit në vend, identifikimin dhe analizimin e sektorëve dhe fushave që janë më të ndjeshme ndaj rrezikut të korrupsionit dhe që kërkojnë ndërhyrje. Gjithashtu, bazuar në analizën e situatës, u përcaktuan objektivat specifike të strategjisë për periudhën 2024-2030. Këto objektiva përshkruajnë qartë synimet në luftën

kundër korrupsionit në përmbushje të plotë me vizionin e Shqipërisë 2030.


Faza II: Pas konsolidimit të bazës së orientimit strategjik të dokumentit, hapi i ardhshëm përfshinte hartimin e konceptit të strategjisë me të gjithë elementët përbërës të saj. Kjo fazë ka për qëllim zbatimin e reformave ligjore dhe institucionale për të adresuar sfidat dhe rreziqet e korrupsionit. I gjithë procesi realizohet përmes identifikimit dhe hartimit të reformave ligjore të nevojshme për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në sektorët dhe fushat e ndryshme. Për të garantuar zbatimin dhe monitorimin efektiv të këtyre reformave ligjore dhe institucionale, do të jetë e nevojshme ndërtimi i mekanizmave dhe strukturave të përshtatshme, që do të sigurojnë funksionimin e duhur dhe efektiv të këtyre ndryshimeve.

Faza III: Në fazën përfundimtare, synohet forcimi i kapaciteteve të institucioneve dhe aktorëve të përfshirë për të menaxhuar me sukses efektivitetin e strategjisë dhe për të adresuar sfidat e korrupsionit. Përmirësimi i kapaciteteve realizohet përmes zhvillimit profesional të burimeve njerëzore të angazhuara në luftën kundër korrupsionit, duke kontribuar në thellimin dhe zgjerimin e reformave. Ndryshimet e ndërmarra do të funksionojnë me efikasitet, duke mundësuar që zyrtarët publikë përgjegjës të jenë të aftë të monitorojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht proceset e punës në funksion të objektivave të kësaj strategjie.

Monitorimi dhe vlerësimi i progresit përmes krijimit të mekanizmave për arritjen e rezultateve të pritshme u është dhënë rëndësi thelbësore në këtë fazë. Strategjia përcakton objektiva specifike, programe, masa dhe aktivitete që synojnë arritjen e qëllimeve dhe rezultateve të prekshme dhe realiste, duke detajuar qartë detyrimet për çdo institucion përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kjo qasje siguron një zbatim efektiv të aktiviteteve antikorrupsion, të cilat përfshijnë një numër të madh institucionesh publike në nivel ekzekutiv, vendor, kushtetues dhe gjyqësor, dhe kërkojnë bashkëpunim të ngushtë ndërmjet tyre për t'u realizuar në mënyrë të suksesshme.

Figura nr. 1: Qëllimet e Politikave



2. Kuadri Ligjor dhe Institucional në Luftën Kundër Korrupsionit

Shqipëria ka përmirësuar gradualisht kornizën e saj ligjore dhe institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Përgjatë viteve, Shqipëria ka ratifikuar instrumente ndërkombëtare të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit si: Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,¹ Konventat e të Drejtës Civile dhe asaj Penale të Këshillit të Evropës për Korrupsionin,² Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy Protokollat e saj shtesë, Marrëveshjen midis Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për Bashkëpunim Strategjik dhe Operacional.

Kuadri ligjor i brendshëm kundër korrupsionit përmban një seri aktesh që nisin që me Kushtetutën,

legjislacionin procedural administrativ dhe penal, ligjet specifike të organizimit dhe funksionimit të institucioneve përgjegjëse në drejtim të luftës kundër korrupsionit si dhe kuadrin rregullator të instrumenteve kundër korrupsionit.

Në referencë të parashikimeve të Kodi Penal, korrupsioni është një vepër e dënueshme penalisht.³ Megjithatë, përtej këtij përcaktimi, legjislacioni shqiptar parashikon një sërë sjelljesh të cilat bazohen në kërkesën për integritet në qeverisje, transparencë institucionale dhe llogaridhënie publike si parakushte për parandalimin e korrupsionit. Më konkretisht, legjislacioni shqiptar parashikon detyrime ligjore për institucionet publike në drejtim të transparencës së punës së administratës publike,⁴ parandalimit të konfliktit të interesit,⁵ kontrollit mbi deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publikë,⁶

¹ Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC), Miratuar 2003-ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 9492, datë 13.03.2006.

² Konventa Penale për Korrupsionin dhe protokollin shtesë (1999), Këshilli i Evropës -ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 8778, datë 26.4.2001; Konventa Civile për Korrupsionin e Këshillit të Evropës (1999) -ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 8635, datë 6.7.2000.

³ Neni 244, 245, 259 dhe 260 i Kodit Penal të Republikës të Shqipërisë.

⁴ Ligji nr. 119, datë 18.9.2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar dhe Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

⁵ Ligji nr. 9367, datë 07.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

⁶ Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar.



sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesëve⁷ dhe etikën në qeverisje.⁸

Nga pikëpamja institucionale, në kuadër të reformës në drejtësi u vendos një gur kilometrik në avancimin e luftës kundër korrupsionit përmes krijimit të Prokurorisë së Posaçme për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Prej rreth 4 vitesh këto institucione po krijojnë në mënyrë progresive një historik solid (*track record*) të hetimit, gjyqimit dhe dënimit të veprave penale të korrupsionit, si dhe sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve të veprës penale të korrupsionit. Përgjatë kësaj periudhe kohe, këto institucione kanë dëshmuar dilijencë në hetimin dhe gjykimin e rasteve të zyrtarëve të lartë të dyshuar për korrupsion, duke shembur kështu mitin e pandëshkueshmërisë në abuzimin e ushtrimit të funksionit publik.

Në nivel qeveritar, përpjekjet për të luftuar korrupsionin drejtohen nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, që programon të gjitha përpjekjet qeveritare për parandalimin, ndërgjegjësimin dhe ndëshkimin e korrupsionit në administratën publike.

Shqipëria është cilësuar nga OECD Sigma, si një ndër shtetet në vijën e parë për plotësimin e standardeve të qeverisjes elektronike si dhe nga Komisioni Evropian për reduktimin e korrupsionit dhe informalitetit përmes ofrimit të shërbimeve digjitale. Kalimi nga 14 shërbime online në 2013 fillimisht vetëm për 50 mijë përdorues, në 1247 shërbime tërësisht online në 2024 për 3,1 milion përdorues të regjistruar, nga vulat dhe firmat në letër në ato elektronike është dëshmi e qartë e shkallës së penetrimit të digjitalizimit në ndërveprimin me qytetarët dhe bizneset, duke shmangur ndërveprimin fizik në sportel. Përgjatë të gjithë spektrit të shërbimeve publike, si për qytetarët dhe për bizneset, revolucionarizimi i ofrimit të shërbimeve të lidhura me kujdesin shëndetësor (sistemi i referimit, recetat elektronike, regjistri i pacientëve, rekrutimi i infermierëve), shërbimet e sistemit arsimor (rekrutimi i mësuesve, aplikimi në

shkolla dhe institucione të arsimit të lartë, regjistrat digjitalë), shërbimet e transportit rrugor (licenca dhe leje), ato të regjistrimit të bizneseve dhe fiskalizimit, kanë zvogëluar ndjeshëm hapësirat korruptive.

Falë digjitalizimit të shërbimeve dhe rritjes së numrit të sistemeve digjitale, institucionet publike janë të pajisur shumë më tepër se më parë me mundësitë që të gjurmojmë inefficiencat dhe vonesat në kthim përgjigjesh të cilat shpesh mund të bëhen shkak për korrupsion. Ndaj dhe përfitimi nga digjitalizimi në këto vitet e fundit ka qenë i dyfishtë, si në drejtim të eliminimit tërësor të korrupsionit në sportele, por edhe rritjes së llogaridhënies së brendshme dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së institucioneve shërbimofruese.

Paralelisht, 10 vitet e fundit kanë shënjuar një revolucion të të gjithë arkitekturës së funksionimit të prokurimit publik në Shqipëri. Shkalla e lartë e përafrimit me legjislacionin e BE-së dhe përdorimi i sistemeve elektronike, *open data* në prokurimin publik, janë vlerësuar si zhvillime pozitive në raportin vjetor dhe Raportin *Screening* të Komisionit Evropian për Shqipërinë. Në raportin e fundit të SIGMA fusha e prokurimit publik ka vlerësim maksimal në 3 prej treguesve të lidhur me cilësinë e kuadrit ligjor, kapacitetit qendror institucional dhe administrativ për të zbatuar dhe monitoruar politikat e prokurimit publik në mënyrë efektive dhe zhvillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesave.⁹

Një ndër treguesit kryesor antikorrupsion në proceset e prokurimit, përkatësisht numri i procedurave me negociim pa shpallje, në vitin 2013 ka qenë në masën 33.2% të totalit të procedurave të prokurimit ndërsa dekadën e fundit kjo shifër ka pësuar rënie drastike duke arritur vetëm në masën 2.9% në vitin 2023, arritje kjo e vlerësuar gjithashtu në raportet vjetore të Komisionit Evropian. Një tregues tjetër i rritjes së performancës së sistemit të prokurimit elektronik është dhe kursimi i arritur si diferencë midis fondit limit dhe fondit të shpallur fitues, i cili ishte në masën 6.6% në 2013, ndërsa në 2023 rezulton të jetë 15%, duke

⁷ Ligji nr. 60, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesëve”, i ndryshuar.

⁸ Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Këtu mund të përmendim edhe akte nënligjore dhe vendime që rregullojnë rregullat e etikës për Faqe | 26758

deputetët e Kuvendit, apo dhe për strukturat e policisë dhe subjektet e sistemit gjyqësor, gjyqtarë dhe prokurorë.

⁹ <https://www.sigmaxweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf>, fq. 155-177.



ndikuar kështu drejtpërdrejt në optimizimin e përdorimit të fondeve publike.

Megjithatë, pavarësisht arritjeve të përmendura më sipër, ka ende një sërë problematikash në drejtëm të efektivitetit të luftës kundër korrupsionit, si në drejtëm të parandalimit, hetimit dhe ndëshkimit si dhe ndërgjegjësimin lidhur me fenomenin e korrupsionit dhe natyrën gërryese të tij në shoqëri.

2.1. Lidhja me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 (SKZHI III)

Sigurimi i një kornize ligjore dhe institucionale të fortë është thelbësor për suksesin e Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit.

Nëpërmjet reformave ligjore dhe institucionale, synohet parandalimi, ndëshkimi i praktikave abuzive dhe ndërgjegjësimi për dëmet që korrupsioni shkakton në shoqëri. Përmirësimi i efikasitetit të mekanizmave përmes rolit të shtuar koordinues të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit si dhe zbatimit të monitorimit të instrumenteve antikorrupsion duhet adresuar sipas parashikimeve të SKZHI.

Në seksionin “Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë” të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030, “Transparenca dhe lufta kundër korrupsionit”, mes të tjerash, parashikohen çështjet kryesore që lidhen drejtpërdrejt me reformat kundër korrupsionit, të cilave u duhet kushtuar një vëmendje e veçantë:

- Forcimi i integritetit dhe parandalimi i korrupsionit në administratën publike dhe të gjithë segmenteve shtetërore. Fokus i veçantë i dedikohet institucioneve që ofrojnë shërbime publike për qytetarët, si prokurimet publike, shërbimet elektronike, trajtimin e rasteve dhe denoncimeve për korrupsion;

- Forcimi i zbatimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës, ndëshkimi i akteve korruptive në të cilat zyrtarët publikë mund të përfshihen dhe garantimi i integritetit të organeve shtetërore;

- Përfshirja e publikut në luftën kundër korrupsionit, duke e informuar mbi veprimtarinë shtetërore kundër korrupsionit dhe nxitur atë për të përdorur në mënyra aktive kanalet për ta denoncuar;

- Ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe edukimi i të rinjve për t'u angazhuar në mënyrë produktive në luftën kundër korrupsionit.

2.1.1. Qëllimet e politikës

Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, parashikon 3 Qëllime Politikash:

Qëllimi Politik 1: Parandalimi i korrupsionit - Forcimi i mekanizmave dhe kapaciteteve ligjore dhe institucionale për parandalimin e korrupsionit dhe forcimi i integritetit në administratën publike, me fokus në sektorët me risk të lartë korrupsioni.

Qëllimi Politik 2: Ndëshkimi i korrupsionit - Rritja e performancës së të gjitha strukturave përgjegjëse për ndjekjen, hetimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit.

Qëllimi Politik 3: Ndërgjegjësimi dhe edukimi në luftën kundër korrupsionit - Rritja e ndërgjegjësimin të qytetarëve dhe edukimi i publikut për t'u angazhuar në mënyrë proaktive në luftën kundër korrupsionit.

2.2. Lidhja e SNKK 2024-2030 me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale

Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, 2024-2030 harmonizohet me qëllimet, objektivat dhe parashikimet e strategjive të mëposhtme kombëtare:

- Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025;

- Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë 2021-2025¹⁰;

- Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030;

- Strategjia Ndërsektorale Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026;

- Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026;

- Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030 dhe Plani i Veprimit.

2.3. Lidhja me PKIE-në & Acquis e BE-së

Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030 është gjithashtu e lidhur ngushtësisht me PKIE-në & *acquis* e BE-së. Konkretisht, Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, është një kapitull thelbësor në procesin e negociatave për anëtarësim. Ky kapitull mbulon tri fusha të rëndësishme: (i) sistemin gjyqësor, (ii) politikat kundër korrupsionit dhe (iii) të drejtat themelore.

¹⁰ E rikonfirmuar me Strategjinë Ndërsektorale e Drejtësisë, 2024-2030, miratuar në dhjetor 2024, në

përputhje me prioritetet strategjike dhe angazhimet e Qeverisë shqiptare në Udhërrëfyesin Shteti i së Drejtës.



Raportet e fundit të Progresit nga Komisioni Evropian për Shqipërinë për vitet 2021-2023 vlerësojnë se Shqipëria ka arritur njëfarë niveli përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit dhe njohin përpjekjet e vazhdueshme të vendit në avancimin e kësaj agjende. Krahas vijimit me zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, theksohet se procesi i rivlerësimit kalimtar në sistemin gjyqësor ka sjellë rezultate në luftën kundër korrupsionit. Raportet njohin përparimin e arritur veçanërisht përmes vazhdimit të zbatimit të reformës gjithëpërfshirëse në drejtësi, duke evidentuar ngritjen dhe vendosjen në funksion të plotë të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), e përbërë nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimeve, si dhe ngritjen dhe funksionimin e plotë të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO). Në këtë linjë, nënvizohet veçanërisht kontributi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në përmirësimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale në çështjet e korrupsionit.

Raporti i Progresit i publikuar në vitin 2023 evidenton rritjen e numrit të denimeve për korrupsion në nivelet e larta, si një prioritet i rëndësishëm në luftën kundër kulturës së pandëshkueshmërisë. Raporti ka dhënë vlerësimet e tij edhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit (si strukturë përbërëse e Ministrisë e Drejtësisë në periudhën referencë të raportit), kapaciteti i së cilës duhet të përforcohet më tej. Vëmendje e shtuar kërkohet për sektorët më të prekshëm (vulnerabël) nga korrupsioni dhe për të cilët kërkohet të kryhen vlerësime të risqeve dhe masa për ndërhyrje të dedikuara.

Këto rekomandime nënvizohen paralelisht edhe në Raportin e korrikut 2023 të Shqyrtimit Analitik për Shqipërinë për Grup-kapitullin I “Themeloret”. Mes hapave të rëndësishme që duhen ndërmarrë për të garantuar efikasitetin e përpjekjeve parandaluese antikorrupsion, theksohen nevoja për rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit mes autoriteteve me kompetenca parandaluese dhe atyre ndëshkuese, nevoja për përmirësimin e kapaciteteve të ILDKPKI-së për verifikimin e deklaratave të pasurisë dhe interesave private, si dhe domosdoshmëria e forcimit të zbatimit efikas të kuadrit ligjor për promovimin e sinjalizimit të

praktikave korruptive dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Raporti rekomandon gjithashtu marrjen e masave të shtuara për rritjen e efikasitetit të procesit të konsultimit publik dhe forcimin e mëtejshëm të kuadrit të prokurimit publik.

Për sa i përket qasjes ndëshkuese, Raporti thekson nevojën për rritjen e kapaciteteve dhe konsolidimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) përfshirë strukturën e saj të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), duke siguruar mjetet e nevojshme të hetimit dhe një sistem modern të menaxhimit të çështjeve. Gjithashtu, theksohet forcimi i bashkëpunimit me Policinë e Shtetit dhe zgjerimi i hetimeve financiare dhe konfiskimit të aseteve. Komisioni inkurajon veçanërisht krijimin e një historiku solid të hetimit dhe ndëshkimit të korrupsionit në nivele të larta dhe rritjen e ekspertizës për sekuestrimin e aseteve brenda dhe jashtë vendit.

Në përputhje me sa më sipër, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 garanton linjëzimin e masave dhe afateve përkatëse të parashikuara me zotimet konkrete të ndërmarra nga autoritetet e përfshira në luftën kundër korrupsionit në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, miratuar me Vendim Nr.736, datë 13.12.2023, të Këshillit të Ministrave. Udhërrëfyesi adreson gjetjet dhe rekomandimet e Raportit të Shqyrtimit Analitik për Grup-kapitullin I, duke parashikuar mes angazhimeve kyçe zbatimin e qëndrueshëm dhe efikas të kuadrit strategjik dhe ligjor për korrupsionin në përputhje të plotë me standardet e BE-së. Me qëllim uljen e incidencës së korrupsionit, autoritetet janë angazhuar të trajtojnë vazhdimisht rreziqet e korrupsionit në sektorët më vulnerabël, si dhe të masin efektivitetin e këtyre masave përmes objektivave të Treguesve të Performancës së Strategjisë së re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 në baza vjetore.

Udhërrëfyesi parashikon paralelisht zbatimin e vazhdueshëm të objektivave ndërgjegjësuese të Strategjisë, duke u fokusuar veçanërisht në ndërgjegjësimin brenda institucioneve të administratës publike, si dhe pjesëmarrjen e shtuar të shoqërisë civile në procesin e politikbërjes dhe monitorimit në drejtim të luftës kundër korrupsionit. Autoritetet zotohen në garantimin e qëndrueshmërisë dhe transparencës në procesin e deklarimit të pasurisë, si dhe të konfliktit të interesit.



Njëherësh, në aspektin e bashkëpunimit ndërinstitucional, parashikohet përmirësimi i bashkëpunimit midis agjencive shtetërore dhe shërbimeve të prokurorisë, me qëllim rritjen e koherencës në luftën kundër korrupsionit. Prioritet mbetet adresimi i rekomandimeve të GRECO-s për Shqipërinë dhe konsolidimi i qëndrueshëm i agjencive ligjzbatuese të angazhuara në luftën kundër korrupsionit deri në vitin 2027.

Në qasjen ndëshkuese, angazhimet antikorrupsion të Udhërrëfyesit synojnë rritjen e kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese, veçanërisht të Prokurorisë së Posaçme – SPAK-ut, për të kryer më mirë hetime proaktive dhe ndërkufitare të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, si dhe përmirësimin e historikut të hetimeve proaktive dhe ndjekjes penale, duke përfshirë sektorët më të prirur ndaj korrupsionit dhe garantimin e dënimeve të formës së prerë për korrupsionin. Gjithashtu, autoritetet synojnë përmirësimin e performancës për ndjekjen sistematike e konfiskimit të produkteve nga veprat penale të korrupsionit deri në vitin 2030, duke ngushtuar hendekun me pasuritë e sekuestruara, mes të tjerash përmes aftësimit dhe trajnimit intensiv të zyrtarëve të përfshirë në të gjithë ciklin e identifikimit, gjurmimit, ngrirjes, konfiskimit dhe rikuperimit të aseteve, duke synuar procese gjithnjë e më efikase deri në vitin 2030.

Në linjë me sa më sipër, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, si dokumenti strategjik ombrellë në luftën kundër korrupsionit, reflekton angazhimet për një zbatim të qëndrueshëm dhe efikas të masave antikorrupsion në përputhje me standardet evropiane. Strategjia garanton përputhje të plotë me angazhimet e ndërmarra nga institucionet shqiptare në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe adreson në mënyrë koherente gjetjet e Komisionit Evropian mbi hapat e nevojshëm për të përmirësuar performancën e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit.

2.4. Lidhja me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), në mënyrë specifike objektivi nr. 16 promovon nxitjen e shoqërive gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm, ofrimin e qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Strategjia

Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 synon të forcojë strukturat institucionale, përgjegjshmërinë dhe transparencën e institucioneve. Në të tri qëllimet e politikës programohen masa për ndërhyrje në këto fusha, për të promovuar konsolidimin e një sistemi funksional në luftën kundër korrupsionit. Strategjia detajohet në 16 objektivë specifikë që janë në korrelacion të drejtpërdrejtë me objektivin nr. 16 të Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

2.5. Lidhja e SNKK 2024-2030 me marrëveshje të tjera ndërkombëtare

Rëndësia e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit theksohet nga përfshirja e këtyre çështjeve në instrumente të ndryshme ligjore ndërkombëtare, duke pasqyruar angazhimin global për të adresuar këtë fenomen. Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh të dedikuara në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkatësisht si më poshtë:

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) është një traktat ndërkombëtar shumëpalësh kundër korrupsionit i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në tetor 2003 dhe ka hyrë në fuqi në dhjetor 2005. Ajo u ratifikua nga Kuvendi i Shqipërisë më 13 mars 2006 me Ligjin nr. 9492 dhe u dekretua nga Presidenti me dekretin nr. 4820, datë 28.03.2006.

Nëpërmjet Ligjit nr. 8635, datë 6.7.2000 Shqipëria ka ratifikuar Konventën Civile të Këshillit të Evropës “Për korrupsionin”, më pas me Ligjin nr. 8778, datë 26.04.2001 u ratifikua Konventa Penale për Korrupsionin të Këshillit të Evropës dhe njëkohësisht edhe Protokollin Shtesë të Konventës Penale për Korrupsionin me Ligjin nr. 9245, datë 24.6.2004. Të tre këto instrumente ndërkombëtare synojnë të parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin, duke e vënë theksin në rëndësinë e luftës kundër korrupsionit për të mbrojtur shtetin e së drejtës dhe qeverisjen demokratike.

Në vijim, më datë 12 qershor 2006 Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit reflekton drejtimit kryesorë dhe zotimet e ndërmarra me qëllim garantimin e progresit drejt procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Gjatë zbatimit të MSA-së, Republika e Shqipërisë duhet të provojë jo vetëm se ndan të njëjtat vlera me Bashkimin



Evropian por edhe se disponon kapacitetet e nevojshme për vënien në jetë të detyrimeve të parashikuara në Marrëveshje. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit e ngarkon Shqipërinë me detyrime edhe në drejtëm të luftës kundër korrupsionit. Konkretisht, neni 4 i kësaj marrëveshje, neni 78 dhe 85 parashikojnë detyrimin e shtetit shqiptar për t'u angazhuar në mënyrë proaktive dhe bashkëpunuar me vendet e rajonit dhe BE-në në luftën kundër korrupsionit, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat, duke kontribuar kështu në përmirësimin dhe forcimin e arkitekturës institucionale dhe sundimin e shtetit të së drejtës.

Të gjithë angazhimet e sipërpërmendura i ngarkojnë institucionet publike shqiptare me përgjegjësi dhe dëshmojnë përpjekjet në më shumë se një dekadë në përmbushjen e zotimeve të ndërmarra në luftën kundër korrupsionit, si dhe për zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin ndaj luftës kundër korrupsionit.

2.6. Arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i reformës gjatë periudhës 2015-2023

Në vitin 2015, Qeveria Shqiptare miratoi Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2020, zbatimi i së cilës u shty deri në vitin 2023. Përgjatë këtyre viteve, SNKK, ka qenë dokumenti kryesor që përcaktonte politikën kundër korrupsionit në Shqipëri dhe ka orientuar veprimet kundër korrupsionit në nivel kombëtar.

Vizioni i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, synonte të siguronte *“Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm”*, dhe duke e mundur këtë me parashikimin e rezultateve dhe angazhimeve të planit të veprimit, për 18 objektive specifike. Strategjia ishte e strukturuar në tre qëllime madhore politikash: parandalimi (A), ndëshkimi (B) dhe ndërgjegjësimi (C).

Një numër i rëndësishëm reformash të planifikuara në këtë strategji ka dhënë rezultate konkrete, si më poshtë:

- Rritja e transparencës së autoriteteve publike në nivel qendror dhe vendor: 337 autoritete publike

kanë zbatuar programe transparence dhe garantojnë informimin e publikut përmes koordinatorëve të së drejtës së informimit, ndërsa 222 prej tyre kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe ankesave online.

- Harmonizim i legjislacionit të brendshëm për prokurimin publik sipas standardeve të BE dhe ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve të operatorëve: Agjencia e Prokurimit Publik ka mbajtur rregullisht elementët e ndryshuar në regjistrin e parashikimeve nën masën 20%¹¹ si dhe procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe ndryshimet e kontratave nën masën 10%.¹²

- Deklarimi i pasurive të zyrtarëve: Funksionimi i sistemit plotësisht online, duke garantuar kështu transparencë në procesin e deklarimit të pasurisë të zyrtarëve. Vënia në funksionim të plotë të këtij sistemi nga ILDKPKI ka marrë vlerësimin “zbatuar plotësisht” edhe në roundin V të vlerësimit në GRECO, që në fazën e parë të tij, në dhjetor 2022.

- Krijimi dhe zbatimi i kuadrit të parë ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve,¹³ si dhe ngritja dhe funksionimi i plotë i strukturave përgjegjëse në sektorët publik dhe privat.

- Digjitalizimi i 95% të shërbimeve publike nëpërmjet platformës kombëtare të shërbimeve e-Albania, duke eliminuar plotësisht faktorin njerëzor në ofrimin e shërbimeve, duke ofruar 1247 e-shërbime online për të gjithë qytetarët në të gjithë sektorët.

- Hartimi dhe miratimi i Planeve të Integritetit si instrumente të parandalimit të korrupsionit në ministri, institucione të varësisë së ministrive si dhe në 24 njësi të vetëqeverisjes vendore.

- Përmirësimi i inspektimeve financiare për abuzimin me fondet publike për 90% të sinjalizimeve të marra, të cilat plotësojnë kriteret ligjore.

- Mbledhja, përpunimi dhe harmonizimi i statistikave të konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar për periudha të ndërmjetme, gjashtëmujore, dhe vjetore duke integruar të dhëna nga të gjitha organet e zbatimit të ligjit, si Policia e Shtetit, prokuroritë dhe gjykatat.

dhe në masën 4.8% (ndryshimet e kontratave), Viti 2023: në masën 3% (procedura pa shpallje paraprake) dhe në masën 6.6% (ndryshimet e kontratave).

¹³ Ligji nr.60, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar.

¹¹ Viti 2021: në masën 16.1%; Viti 2022: në masën 13.61; Viti 2023: në masën 14%.

¹² Viti 2021: në masën 3% (procedura pa shpallje paraprake) dhe në masën 1% (ndryshimet e kontratave), Viti 2022: në masën 3.36% (procedura pa shpallje paraprake) Faqe | 26762



Në kuadër të qasjes ndëshkimore dhe zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, disa nga arritjet më të rëndësishme përfshijnë:

- Forcimi i kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit përfshirë këtu SPAK dhe njësinë hetimore të tij BKH, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, dhe policinë për të hetuar dhe ndjekur penalisht korrupsionin dhe krimin ekonomik.

- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar përmes rrjeteve ndërkombëtare të bashkëpunimit në kuadër të EUROJUST, Interpol, Europol, Rrjeti CARIN, etj., dhe garantimi i aksesit të drejtpërdrejtë të Policisë së Shtetit, prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe SPAK në 21 baza të dhënash shtetërore.

- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

- Ngritja e Drejtorisë së Përgjithshme e Antikorrupsionit, me mekanizmin e saj të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion ka administruar në total 1342 ankesa, në vetëm 2 vitet e para të veprimtarisë që nga ngritja e saj prej vitit 2021, duke propozuar 532 masa disiplinore për shkeljet e evidentuara, 263 rekomandime për ndryshime të natyrës ligjore/ rregullatore/ institucionale, si dhe ka referuar 48 kallëzime penale.

Përmes zbatimit të SNKK 2015-2023, disa nga arritjet kryesore në drejtim të ndërgjegjësimit janë:

- Janë zhvilluar një sërë veprimtarish për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e korrupsionit dhe ushtrimin e funksioneve publike bazuar në parime të integritetit, duke përfshirë grupe të ndryshme interesi.

- Janë hartuar dhe publikuar plane vjetore të komunikimit dhe vizibilitetit, të fokusuara në luftën kundër korrupsionit. Këto plane synojnë rritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimit publik mbi përpjekjet për të luftuar korrupsionin, angazhimin e publikut dhe komunikimin e vazhdueshëm të rezultateve.

- Janë zhvilluar, në baza vjetore, Javët e Integritetit në bashkëpunim me një sërë partnerësh ndërkombëtarë, me qëllim informimin mbi

rëndësinë e integritetit dhe nxitjen e debatit publik mbi këtë fenomen.

- Janë zhvilluar takime dhe forume bashkëpunimi me organizata biznesi, përfshirë dhoma dhe shoqata të biznesit, me fokus të veçantë në denoncimin e rasteve të korrupsionit.

- Janë përgatitur dhe shpërndarë botime për publikun që ofrojnë informacion mbi mekanizmat e denoncimit në luftën kundër korrupsionit, si për shembull: Guida Antikorrupsion dhe Fjalori për Antikorrupsionin. Gjithashtu, janë realizuar video informuese mbi mekanizmin e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, duke synuar edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për mënyrat e denoncimit të rasteve të korrupsionit dhe për përfshirjen në luftën kundër këtij fenomeni.

- Janë hartuar dhe shpërndarë, në baza mujore, instrumente të informimit elektronik si e-buletini “Antikorrupsion”, me qëllim informimin e rregullt të publikut mbi progresin, aktivitetet dhe nismat në luftën kundër korrupsionit.

- Janë zhvilluar programe antikorrupsion nga Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, të titulluara “Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut”, duke përfshirë projekte të propozuara nga organizatat e shoqërisë civile në fusha të ndryshme si prokurimet, arsimi, shëndetësia, zbatimi i ligjit dhe e drejta e informimit.

Gjithashtu, përgjatë viteve të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 është ngritur dhe zhvilluar mekanizmi i monitorimit, një drejtori e dedikuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, një strukturë e dedikuar teknike që mbledh, analizon dhe vlerëson të dhënat e zbatimit të strategjisë dhe të planeve të veprimit. Ky mekanizëm ka për qëllim zbatimin me efektivitet të masave të parashikuara në strategji, të publikuara dhe të aksesueshme për të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit që dëshirojnë të kenë një panoramë të plotë të përpjekjeve sistematike dhe performancës së përgjithshme të institucioneve përgjegjëse në përmbushjen e objektivave që kjo strategji parashikonte.

Në vijim, në vitin 2018,¹⁴u krijua Komiteti Koordinativ për zbatimin e strategjisë ndërsektoriale

¹⁴ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.241, datë 20.4.2028, “Për miratimin e planit të veprimit 2018-2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të pasaportë së indikatorëve, krijimin, funksionimin dhe detyrat e Komitetit Koordinator për

zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, dhe Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.516, datë 1.7.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për



kundër korrupsionit, në cilësinë e organit që diskuton dhe miraton raportet e monitorimit dhe adreson ndërhyrjet për veprime. Për Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 janë prodhuar 9 raporte progresi monitorimi, mbi baza vjetore dhe semestrare, mbështetur tek një metodologji konkrete me indikatorë performance të përcaktuar. Të gjitha raportet e monitorimit janë publikuar dhe janë lehtësisht të aksesueshme për qytetarët.

Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 forcoi gjithashtu bashkëpunimin midis autoriteteve publike, duke bashkërenduar urat e komunikimit midis institucioneve qendrore dhe atyre kushtetuese, që janë përgjegjëse për zbatimin e politikave në drejtim të luftës kundër korrupsionit.

Zbatimi dhe monitorimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 konsolidoi bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile që janë aktive në politikën dhe sektorin e luftës kundër korrupsionit, duke i përfshirë ato rregullisht në takimet e Komitetit Koordinativ. Kjo qasje kontribuoi në një shkëmbim më të thelluar të ideve dhe përforcimin e veprimeve të përbashkëta në luftën kundër korrupsionit.

Niveli i zbatimit të planit të masave të veprimit ka shënuar vlera të qëndrueshme zbatimi në masën 70% të strategjisë.

Megjithatë, pavarësisht arritjeve dhe zhvillimeve në drejtim të luftës kundër korrupsionit, zbatimi i SNKK 2015-2023 evidentoi edhe nevojën për adresimin e një sërë sfidash që u konstatuan në drejtim të rritjes së efektivitetit të luftës kundër korrupsionit, në këtë fazë të zhvillimit të vendit.

Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, evidentoi nevojën për të siguruar harmonizim të mëtejshëm të kuadrit ligjor me *acquis* të BE-së për antikorrupsionin, kapacitete institucionale kompetente dhe burime financiare për të parandaluar, hetuar e gjykuar korrupsionin në mënyrë efektive, në përputhje me kontekstin e brendshëm të vendit.

Harmonizimi i kuadrit ligjor dhe institucional do të duhet të shtrihet edhe në ato mekanizma të luftës kundër korrupsionit si: zbatimi i një qasjeje sektorale në luftën kundër korrupsionit, përmirësimi i

strukturave të sinjalizimit dhe mbrojtja e sinjalizuesve, ngritja e kuadrit rregullator për lobimin si instrument kundër korrupsionit apo masat ligjore kundër ryshfetit të zyrtarëve publikë të huaj. Njëherësh, është e nevojshme të ndërmerren nisma të përbashkëta me sektorin privat me qëllim ngritjen dhe promovimin e sistemeve të integritetit si dhe koordinimin e masave në raste të incidencës së korrupsionit.

Trajnimet periodike dhe të vazhdueshme për stafet antikorrupsion janë të një rëndësie thelbësore, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e performancës institucionale.

Strategjia ka nxjerrë gjithashtu në pah nevojën për një koordinim më efektiv me të gjithë aktorët e përfshirë, që nga fazat e hershme të zbatimit. Ky koordinim synon të rrisë efektivitetin dhe të sigurojë vazhdimësinë e progresit në zbatimin e masave të parashikuara, duke garantuar një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse në luftën kundër korrupsionit.

2.7. Vazhdimi i strategjisë me një fokus më të qartë

Në funksion të vazhdimësisë së ndërhyrjes strategjike, fushat e veprimeve prioritare u identifikuan bazuar në një analizë të thelluar cilësore dhe sasiore të treguesve të performancës, shtrirjes, formave dhe çështjeve të tjera që lidhen me korrupsionin në Shqipëri. Kjo qasje siguroi identifikimin e fushave me rrezik të lartë dhe përcaktimin e masave specifike për të adresuar në mënyrë efektive fenomenin e korrupsionit. Kjo analizë, u bazua në burime të ndryshme informacioni, duke përfshirë raportet e monitorimit për zbatimin e Strategjisë prej vitit 2015, raportet vjetore të Komisionit Evropian për Shqipërinë, vlerësimet e kryera në kuadër të GRECO, raportet e zbatimit të planeve të integritetit të zhvilluara në bashkëpunim me autoritetet publike, raportet e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit bazuar në hetimet administrative të kryera, analizat e perceptimit për korrupsionin, raporte të shoqërisë civile, etj.

Krahas mangësive në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, në adresimin e këtyre prioriteteve ka ndikuar edhe mospërfshirja e disa niveleve të qeverisjes dhe autoriteteve publike në dokumentin e strategjisë.



Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 fokusohej vetëm në institucionet e administratës në nivel qendror dhe nuk parashikonte një mbulim të plotë territorial duke përfshirë kështu organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore në zbatimin e masave kundër korrupsionit. Për të siguruar një veprim efektiv kundër korrupsionit, kërkohet një sinergji e veprimeve në të gjitha nivelet e qeverisjes. Kushtetuta dhe legjislacioni për vetëqeverisjen vendore i ka atribuar pushtetit vendor kompetenca të konsiderueshme normative, administrative dhe financiare që mund t'i ekspozojnë këto organe ndaj korrupsionit. Bashkitë kanë qenë të angazhuara në zhvillimin e planeve të integritetit, por në shumicën e rasteve u mungojnë kapacitetet dhe burimet e nevojshme për hartimin ose zbatimin e tyre. Për më tepër, niveli i dytë i vetëqeverisjes vendore, qarqet, nuk kanë qenë të përfshira në këtë proces.

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 nuk parashikonte gjithashtu përfshirjen e plotë të organeve rregullatore, të cilat luajnë një rol kyç në zbatimin e politikave publike dhe garantimin e respektimit të kuadrit ligjor. Këto organe janë thelbësore për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm dhe të drejtë në fushat përkatëse. Ndër institucionet rregullatore të rëndësishme mund të përmenden: Enti Rregullator i Energjisë, Enti Rregullator i Ujit, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti Rregullator i Hekurudhave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoriteti i Konkurrencës. Përfshirja e këtyre autoriteteve në strategjinë antikorrupsion është parë e domosdoshme për të siguruar një qeverisje të mirë dhe një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Këto institucione janë mbrojtësit kryesorë kundër korrupsionit në sektorët që mbikëqyrin dhe luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës dhe integritetit në shoqëri. Përmes funksioneve të tyre rregullatore, ato kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e llogaridhënies, integritetit dhe forcimin e qeverisjes së mirë.

Korrupsioni në sektorin privat nuk ka qenë pjesë e fokusit të strategjisë për periudhën 2015-2023. Në një ekonomi tregu të lirë, biznesi privat është motori i zhvillimit, kështu që sigurimi i klimës së duhur të zhvillimit të biznesit mbi baza integriteti merr rëndësi thelbësore.

Në këtë fazë të zbatimit të reformave antikorrupsion, fokusi i strategjisë do të jetë në

zbatimin e një qasjeje të qartë sektoriale për të adresuar riskun e korrupsionit në sektorë kyç si pronat, tatimet dhe doganat, shëndetësia, kontratat publike, dhe arsimi. Pavarësisht ndikimit pozitiv të digjitalizimit të shumë shërbimeve në reduktimin e korrupsionit në këto fusha, mbetet ende punë për t'u bërë për të adresuar korrupsionin në sektorët më kritik dhe për të transformuar këta sektorë në shtytës të një ekonomie të qëndrueshme dhe të shëndetshme në Shqipëri.

Strategjia ofron gjithashtu një qasje të drejtpërdrejtë ndërhyrjeje në promovimin e edukimit dhe ndërgjegjësimin kundër korrupsionit, me qëllim investimin e qëndrueshëm në mbrojtjen që në moshë të hershme me standardet e mirëqeverisjes, përmes lentes së rritjes së forcimit të edukimit për integritetin dhe ligjshmërinë, me qëllim fuqizimin e brezave të rinj që kanë si pikë reference vetëm standardet e integritetit dhe drejtësisë.

Për të garantuar qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e politikave për reduktimin progresiv të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e qeverisjes së mirë, Qeveria Shqiptare bashkërisht me të gjithë institucionet e tjera bashkëpërgjegjëse paraqet këtë strategji të re kundër korrupsionit, për periudhën 2024 - 2030.

3. Deklarata e vizionit

Vizioni

Duke marrë parasysh zhvillimet e deritanishme, vizioni i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2024-2030 është: *“Institucione publike që ushtrojnë funksionet në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike dhe ofrojnë shërbime **efiçente ndaj qytetarëve**”.*

Ky vizion synohet që të jetësohet përmes tre qëllimeve të politikës:

Qëllimi i parë: Parandalimi i korrupsionit - Forcimi i mekanizmave ligjore dhe institucionale për të parandaluar korrupsionin dhe forcuar integritetin në administratën publike, me fokus në sektorët me risk të lartë ndaj korrupsionit.

Qëllimi i dytë: Ndëshkimi i korrupsionit - Rritja e performancës së të gjithë strukturave përgjegjëse për ndjekjen, hetimin, ndëshkimin e rasteve korruptive.

Qëllimi i tretë: Ndërgjegjësimi dhe edukimi në luftën kundër korrupsionit - Rritja e ndërgjegjësimin dhe edukimit të qytetarëve për t'u angazhuar në mënyrë proaktive në luftën kundër korrupsionit.



PJESA II
QËLLIMET E POLITIKËS DHE
OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË SNKK
2024-2030

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, është e strukturuar në tri shtylla kryesore që pasqyrojnë qëllimet e politikave, përkatësisht: (I) parandalimi i korrupsionit, (II) ndëshkimi i korrupsionit, dhe (III) ndërgjegjësimi në luftën kundër korrupsionit.

Fushat e ndërhyrjes nën çdo qëllim politike përfshijnë:

(I) Zbatimi i mekanizmave efektivë dhe të standardizuar në përdorimin e instrumenteve kundër korrupsionit, në përputhje me parashikimet ligjore dhe institucionale, si dhe përmirësimi i kapaciteteve teknike dhe profesionale, mbetet një prioritet thelbësor. Gjithashtu, shtrirja e instrumenteve të integritetit në administratën publike, duke përfshirë autoritetet e pushtetit vendor, ka për qëllim forcimin e mekanizmave të kontrollit mbi përdorimin e fondeve publike. Përmirësimi dhe standardizimi i kuadrit rregullator kundër korrupsionit, përfshirë sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, rregullimin e lobimit, transparencën dhe kontrollin mbi financimin e partive politike, përbën një komponent kyç për realizimin e vizionit të SNKK 2024-2030. Po ashtu, theksohet rëndësia e zhvillimit të qëndrueshëm në sektorët më të ndjeshëm, si pronat, arsimi, shëndetësia, tatimet, doganat dhe kontratat publike, për të ulur në mënyrë efektive riskun e korrupsionit në këto fusha.

(II) Përmirësimin e koordinimit dhe rritjen e cilësisë së hetimeve administrative dhe penale kundër korrupsionit. Kjo ndërhyrje, kërkon bashkëpunim të thelluar gjyqësor dhe ngritjen e strukturave të forta për bashkëpunim operacional midis organeve ligjzbatuese. Sigurimi i një zbatimi efektiv të legjislacionit kundër korrupsionit përfshin hetimin dhe ndjekjen penale të veprave korruptive, duke garantuar gjithashtu që organet ligjzbatuese të kenë në dispozicion mjetet dhe burimet e nevojshme për hetime dhe procedura të plota dhe efektive në luftën kundër korrupsionit.

(III) Rritja e ndërgjegjësitimit dhe nivelit të edukimit të publikut kundër korrupsionit do të zhvillohet si një prioritet kyç, duke theksuar rolin e rëndësishëm që luan edukimi në parandalimin e veprimeve korruptive. Investimi në këtë drejtim

synon të informojë dhe të inkurajojë qytetarët të njohin rreziqet e korrupsionit si dhe të raportojnë rastet e korrupsionit në administratën shtetërore. Kjo ndërhyrje, konsiderohet thelbësore në forcimin e përgjegjshmërisë qytetare për luftimin e korrupsionit në të gjitha nivelet.

Të gjitha masat dhe veprimet për zbatim si dhe afatet kohore janë parashikuar në Planin e Veprimit në Aneksin nr.1.

QËLLIMI I PARË I POLITIKËS:
“PARANDALIMI I KORRUPSIONIT” – Përbën shtyllën e parë të SNKK 2024-2030 dhe përfshin 9 Objektiva Specifikë. Ky Qëllim do të fokusohet në reformimin e kuadrit ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit, si dhe forcimin e transparencës së institucioneve publike në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes. Gjithashtu, do të synohet përforcimi i sistemit të zbulimit të hershëm (sinjalizimi) dhe adresimi i korrupsionit përmes vlerësimeve sistematike të riskut të korrupsionit në sektorët e identifikuar me risk të lartë ndaj veprimeve korruptive.

Ndërhyrjet do të fokusohen paralelisht edhe në rritjen e transparencës së financimit të partive politike, mirëmenaxhimit e fondeve, burimeve financiare dhe aseteve publike. Njëkohësisht, do të synohet shtrirja e mekanizmave të korrupsionit në hallkat vendimmarrëse të pushtetit vendor, si dhe promovimi dhe ndërtimi i partneritetit për garantimin e një sektori privat që shërben si promotor i integritetit dhe bashkëpunon në mënyrë efikase me sektorin publik në luftën kundër korrupsionit.

Për zbatimin e kësaj pjese të strategjisë, Qeveria Shqiptare, nëpërmjet autoriteteve në nivel qendror dhe vendor, në bashkëpunim me organet e pavarura kushtetuese dhe organet e pushtetit gjyqësor, do të ndërmarrë ndërhyrje të dedikuara dhe do të sigurojë burimet e duhura, me qëllim zbatimin efektiv të tyre dhe matjen e progresit për secilin prej objektivave. Këto të dhëna do të analizohen mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Ky qëllim politik (I) synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

Objektivi Specifik 1.1: Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.

Objektivi Specifik 1.2: Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.



Objektivi Specifik 1.3: Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni).

Objektivi Specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Objektivi Specifik 1.5: Mbrojtja e financave dhe aseteve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Objektivi Specifik 1.6: Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit.

Objektivi Specifik 1.7: Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike.

Objektivi Specifik 1.8: Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni.

Objektivi Specifik 1.9: Promovimi i integritetit në sektorin privat.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i parë i Politikës synon forcimin e mekanizmave ligjore dhe institucionale për të parandaluar korrupsionin dhe forcuar integritetin në administratën publike. Ky qëllim politik ka veçuar me përparësi fokusin e ndërhyrjes në disa sektorë me risk të lartë ndaj korrupsionit dhe ka promovuar një grup mekanizmesh aktivë për luftën kundër korrupsionit. Politika e parandalimit përqendrohet në promovimin e institucioneve publike të mirëorganizuara dhe të qëndrueshme, si dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit.

Ky qëllim politik lidhet me objektivin nr. 16 të OZHQ: *“Paqe, siguri dhe institucione të forta dhe efektive”*.

Objektivi Specifik 1.1: Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Kuadri jonë kombëtar ligjor kundër korrupsionit përcakton të drejtat, detyrimet, kompetencat dhe procedurat në kuadër të luftës kundër korrupsionit për të gjitha institucionet zbatuese. Gjithashtu, ai rregullon bashkëpunimin dhe koordinimin midis institucioneve politikëbërëse, ekzekutive dhe atyre ligjzbatuese, duke synuar parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në mënyrë efikase. Pavarësisht faktit se aktualisht në vendin tonë ka një kuadër rregullator të ngritur në drejtim të luftës kundër

korrupsionit, ende ka nevojë për përmirësime të mëtejshme nëpërmjet miratimit të ligjeve të reja dhe përmirësimit të legjislacionit ekzistues, për të harmonizuar më tej kuadrin tonë rregullator me standardet ndërkombëtare.

Nevoja për përmirësimin e legjislacionit do të identifikohet në bazë të rekomandimeve të gjeneruara nga organizatat ndërkombëtare për Shqipërinë dhe nëpërmjet shqyrtimit të hollësishëm të legjislacionit ekzistues, me synim prioritar përafrimin e legjislacionit me *acquis*-në dhe standardet e BE-së. Në këtë proces, Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës luan një rol thelbësor, pasi parashikon miratimin e ligjit “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, deri në vitin 2025; amendimin e ligjit “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, deri në vitin 2025, me qëllim përafrimin me *acquis*-në e BE-së; miratimin e ligjit “Për Lobimin”, deri në vitin 2027; miratimin e ligjit “Për Financimin e Partive Politike”, deri në vitin 2027; si dhe ratifikimin e Konventës “Për Luftimin e Ryshfetit të Zyrtarëve Publikë të Huaj në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit”, deri në vitin 2027.

Njëkohësisht, iniciativat ligjore në kuadër të kësaj strategjie janë të linjëzuara me rekomandimet e GRECO, përkatësisht Rekomandimi nr. 3 i Raundit të V-të, të Vlerësimit të GRECO, sipas të cilit duhet të synohet harmonizimi dhe rritja e koherencës së natyrshme të kuadrit ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë. Gjithashtu, nëpërmjet miratimit të Manualit “Për Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në legjislacion për shërbimet e Kuvendit” (*Corruption Proofing of Legislation*), do të intensifikohet vlerësimi dhe kontrolli i procesit të ligjbërjes për të ulur riskun e korrupsionit që mund të vijë nga miratimi i një ligji të ri apo ndryshimit të tij, i cili do të shtrihet edhe në aktivitetin e strukturave teknike të Kuvendit.

Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit kërkon gjithashtu angazhimin e institucioneve të organizuara në mënyrë efikase me detyra dhe kompetenca të qarta, burime, njohuri dhe aftësi profesionale, dhe një shkallë të lartë bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet të gjithë aktorëve. Shqipëria ka një sistem të konsoliduar institucionesh që kanë kompetenca në drejtim të luftës kundër korrupsionit, që mbulojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të parandalimit dhe ndëshkimit të



korupsionit, me nivele të ndryshme kapacitetesh dhe ekspertize. Megjithatë, organizimi dhe angazhimi i këtyre strukturave me qëllim rritjen e efektivitetit në drejtim të luftës kundër korupsionit ka nevojë për përmirësim.

Plotësimi i kabinetit qeveritar prej janarit 2024 me pozicionin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, i cili njëkohësisht ushtron edhe kompetencat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korupsionit, konsiderohet një dëshmi e vëmendjes së shtuar ndaj prioriteteve të deklaruara, në drejtim të luftës kundër korupsionit për të sinergjizuar punën e institucioneve të ekzekutivit në raport me politikat antikorrupsion të qeverisë dhe zbatuar të gjitha zotimet, në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies. Me qëllim garantimin e zbatimit efikas të kuadrit strategjik antikorrupsion, sistemi gjithëpërfshirës i organeve që veprojnë në luftën antikorrupsion ka nevojë për forcim dhe përmirësim të bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit të mëtejshëm.

Nevoja për përmirësimin e kapaciteteve institucionale të organeve të pajisura me kompetenca në luftën kundër korupsionit do të identifikohet në bazë të vlerësimit të kapaciteteve aktuale profesionale dhe financiare të të gjitha institucioneve përgjegjëse në luftën kundër korupsionit, krahasimisht me kapacitetet e planifikuara dhe të nevojshme. Ndërkohë që, nevoja për përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit të institucioneve kundër korupsionit do të identifikohet duke vlerësuar sfidat në këto procese, bashkërisht me masat që duhet të ndërmerren për adresimin e problematikave të evidentuara. Ky bashkëpunim, do të vlerësohet në mënyrë sistematike në takimet periodike që do të zhvillohen mes autoriteteve të përfshira në luftën kundër korupsionit.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.1 synon të adresojë të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e evidentuara në

vlerësimet e performancës së institucioneve shqiptare nga mekanizmat kombëtare dhe ndërkombëtare shtetërore dhe jo-shtetërore. Këto gjetje do të reflektohen përmes miratimit dhe rishikimit të akteve ligjore dhe masave me karakter institucional që duhet të ndërmerren në vijim nga autoritetet shqiptare.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Forcimi i kuadrit ligjor për parandalimin e korupsionit.

Rezultati 2: Forcimi i vazhdueshëm i kuadrit institucional në parandalimin e korupsionit.

Rezultati 3: Struktura shtetërore të përgatitura dhe me kapacitete e mekanizma antikorrupsion në veprim.

Rezultati 4: Sigurim i procedurave administrative standarde në përgatitjen dhe miratimin e legjislacionit të parandalimit të korupsionit.

Rezultati 5: Administratë publike rezistente dhe funksionale kundër korupsionit (kapacitete teknike funksionale).

Institucione Kryesore: Koordinatori Kombëtar Kundër Korupsionit, Kuvendi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Këshilli i Ministrave, Ministritë e Linjës, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Institucionet zbatuese të SNKK, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Institucione Kontributore: Institucionet zbatuese të SNKK, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministritë e Linjës, Kuvendi, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.



Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 1.1: Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.
1.1.1	Masa: Forcimi i kuadrit ligjor për parandalimin e korrupsionit.
1.1.2	Masa: Përmirësimi i procedurave administrative në përgatitjen dhe miratimin e legjislacionit për parandalimin e korrupsionit.
1.1.3	Masa: Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale teknike për parandalimin e korrupsionit.
1.1.4	Masa: Forcimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet institucioneve parandaluese kundër korrupsionit.

Lidhja e treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të *acquis*-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.1.1 Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore (aktet e brendshme dhe marrëveshjet ndërkombëtare) të miratuara nga ato të planifikuara për t'u miratuar.	Forcimi i mekanizmave ligjore dhe institucionale për të parandaluar korrupsionin dhe forcuar integritetin në administratën publike.	1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.	KKKK Kuvendi
Rezultati	1.1.2 Përqindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë ngritur dhe vënë në funksion strukturat antikorrupsion.	Forcimi i mekanizmave ligjore dhe institucionale për të parandaluar korrupsionin dhe forcuar integritetin në administratën publike.	1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.	KKKK

Objektivi Specifik 1.2: Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes

Analiza e situatës dhe sfidat

Transparenca, përgjegjshmëria, integriteti dhe lufta kundër korrupsionit janë angazhime të qarta të Shqipërisë në kuadër të reformave dhe procesit të integritetit në Bashkimin Evropian. Në këtë drejtim, vendi ynë ka konsoliduar në mënyrë sistematike ndërhyrjet përkatëse në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke i adresuar nevojat për

përmirësim në mënyrë të vazhdueshme, për të forcuar akoma më tej luftën kundër korrupsionit, për të siguruar një parandalim dhe koordinim më efektiv të veprimeve. Në këtë kontekst, ky kuadër strategjik do të ndihmojë më tej në promovimin e një administratë publike më të përgjegjshme dhe transparente. Transparenca e institucioneve publike, në të gjitha nivelet e Qeverisjes, përbën bazën për monitorimin e punës së tyre. Llogaridhënia e autoriteteve publike parandalon abuzimin e pushtetit, teksa kryerja e veprimtarisë institucionale me integritet dhe në përputhje të plotë me kuadrin



rregullator në fuqi parandalon sjelljet joetike. Për këtë arsye, këto elementë kanë një rol thelbësor në parandalimin e korrupsionit gjatë ushtrimit të veprimtarisë shtetërore.

Transparenca e institucioneve publike në Shqipëri është përmirësuar ndjeshëm me digjitalizimin e 95% të shërbimeve publike, deri në fund të vitit 2023, teksa ka ende hapësirë dhe nevojë për vazhdimin dhe përmirësimin e aksesit të lirë në informacion dhe shtimin e numrit të institucioneve që ndjekin parimet e Qeverisjes së Hapur. Portali qeveritar e-Albania, që ofron në mënyrë elektronike shërbimet publike të ofruara dikur në zyrat dhe sportelet fizike të institucioneve, është padyshim një histori suksesi në këtë drejtim. Ky portal vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare për qytetarët dhe bizneset 24/7.

Nevoja për përmirësimin dhe standardizimin e shërbimeve në drejtim të transparencës pritet të forcohet duke ruajtur dhe përmirësuar shërbimet e ofruara deri më tani si dhe njëkohësisht, nëpërmjet rinxhinierimit të të gjithë shërbimeve publike.

Raportimi vjetor i performancës së institucioneve publike, vlerësohet gjithashtu të jetë vlerë e shtuar e transparencës në zbatim të drejtës së informimit, për të lehtësuar aksesin në informacionin publik. Megjithatë, transparenca proaktive duhet të avancojë më tej përmes nxitjes së publikimit të Regjistrave të Indekseve të Transparencës dhe përmirësimit të Manualit për të Drejtën e Informimit.

Llogaridhënia dhe kontrolli i besueshëm i ushtrimit të mekanizmave të zbatimit të instrumenteve antikorrupsion është përmirësuar gjithashtu edhe nëpërmjet dorëzimit *online* të deklarave të pasurive dhe interesave. Nevojitet ende të përmirësohet transparenca dhe aksesueshmëria e deklarave të interesave private, si dhe të forcohet në vijimësi auditimi i tyre. Deklaratat e pasurisë, regjistrat e dhuratave, ngritja dhe administrimi i tyre në kuadër të aktivitetit publik zyrtar, në ushtrim të detyrës shtetërore, janë garancia më e mirë kundër korrupsionit. Institucionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes duhet të sigurojnë zbatimin e standardeve më të larta të integritetit dhe të kontrollit, si mënyra efektive për të përballuar korrupsionin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Kjo do të kontribuojë në ndërtimin e një administrate më

të përgjegjshme dhe transparente, e cila promovon besimin e qytetarëve në institucionet publike.

Kryerja e vlerësimeve të riskut dhe përgatitja e Planeve të Integritetit në të gjithë Ministrinë e Linjës dhe institucionet e tjera, përfshirë ato të Qeverisjes Lokale ka përmirësuar garantimin e integritetit në të gjitha nivelet e qeverisjes. Megjithatë, vlerësohet se standardizimi i mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planeve të Integritetit, mbështetur në vendosjen e një pasaporte treguesish, do të rrisë efektivitetin e përdorimit të tyre dhe do të shërbejë si një bazë e mirë të dhënash për nisma të ardhshme politike, jo vetëm nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, por edhe në bashkëpunim me partnerë të shoqërisë civile. Kodet e Etikës janë aktualisht në fuqi dhe procesi për përmirësimin e zbatimit të tyre vazhdon, me mbështetjen e projekteve ndërkombëtare.

Zyrtarët janë të detyruar të raportojnë interesat e tyre në deklaratat përkatëse të interesave, dhe rastet e konfliktit të interesit i nënshtrohen hetimit administrativ. Sidoqoftë, mbetet e nevojshme vazhdimi dhe përmirësimi i këtyre proceseve për të garantuar një zbatim më të efektshëm të ligjit dhe për të rritur transparencën.

Për më tepër, procedurat për monitorimin dhe zbatimin e Kodit të Etikës në të gjitha nivelet e qeverisjes, duke përfshirë edhe rregullat e veçanta për funksionarët politikë, do të përmirësohen dhe do të përgatitet një manual i dedikuar. Ky kuadër, i harmonizuar dhe në përputhje me legjislacionin dhe institucionet që luftojnë korrupsionin dhe mbrojnë integritetin e zyrtarëve publikë dhe funksionarëve politikë, sipas kërkesave të GRECO (Raundi V për Shqipërinë), do të rrisë dhe standardizojë veprimet në këto fusha, duke kontribuar në përmirësimin e performancës institucionale dhe qeverisëse.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.2 synon të adresojë të gjitha ato rekomandime dhe ndërhyrje të pritshme dhe që mbeten në proces nga Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, për të mundësuar zbatimin efikas të mekanizmave kryesorë parandalues që prekin veprimtarinë e përditshme të organeve të administratës në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:



Rezultati 1: Rritja e transparencës dhe monitorimit në proceset administrative dhe të shërbimeve të ofruara për publikun.

Rezultati 2: Pjesëmarrja proaktive e aktorëve në institucionet publike, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike.

Rezultati 3: Përmirësimi i llogaridhënies dhe performancës publike të zyrtarëve dhe nëpunësve të shtetit.

Rezultati 4: Rritja e kapaciteteve profesionale, me qëllim rritjen e efikasitetit gjatë ushtrimit të detyrës.

Rezultati 5: Rritja e besimit qytetar në institucionet publike.

Institucione Kryesore: Ministritë e Linjës, Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Drejtoria

e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Këshilli i Ministrave/Ministër Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Kuvendi, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Institucione Kontributore: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Institucionet zbatuese të SNKK, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Akademia e Sigurisë, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Drejtësisë.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi specifik 1.2: Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.
1.2.1	<i>Masa:</i> Forcimi i transparencës së institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes.
1.2.2	<i>Masa:</i> Forcimi i llogaridhënies së institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes.
1.2.3	<i>Masa:</i> Forcimi i integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes.
1.2.4	<i>Masa:</i> Përmirësimi i bashkëpunimit midis AMP dhe Policisë Ushtarake, Drejtorisë së Tatimeve dhe struktura të tjera policore me fokus numrin e sanksioneve (masave) të dhëna për zyrtarët e agjencive të zbatimit të ligjit për shpërdorim detyrë dhe korrupsion.
1.2.5	<i>Masa:</i> Hartimi i një kuadri të harmonizuar dhe në koherencë me kuadrin ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë dhe funksionarët politikë (duke reflektuar <i>rekomandimin nr. iii</i> , të Round V të GRECO për Shqipërinë).
1.2.6	<i>Masa:</i> Module për integritetin dhe parandalimin e korrupsionit të përfshira në programin e trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të *acquis*-së së BE-së sipas MSA-së



Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.2.1 Përqindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë në përdorim regjistër elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve (trend rritës).	Institucionet publike mundësojnë pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike, përmirësimi i llogaridhënies të zyrtarëve të shtetit.	1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes.	KDIMDP
Rezultati	1.2.2 Përqindja e deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë, të dorëzuara dhe të audituara, nga numri total që duhet të dorëzohen.	Institucionet publike mundësojnë pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike, përmirësimi i llogaridhënies të zyrtarëve të shtetit.	1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes.	ILDKPKI
Rezultati	1.2.3 Përqindja e institucioneve publike, (qendrore, vendore) dhe organeve të pushtetit gjyqësor që kanë hartuar plane integriteti (kode etike) (trend rritës).	Institucionet publike mundësojnë pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike, përmirësimi i llogaridhënies të zyrtarëve të shtetit.	1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes.	KKKK

Objektivi Specifik 1.3: Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë të korrupsionit)

Analiza e situatës dhe sfidat

Pavarësisht faktit se Shqipëria ka bërë hapa të konsiderueshme në vlerësimin e riskut të korrupsionit, prevalenca mbetet e lartë në disa sektorë ku kontakti me publikun dhe grupe të caktuara interesi me institucionet është edhe më i shpeshtë. Kjo dukuri është veçanërisht e pranishme në sektorin e të drejtave të pronësisë, kujdesit shëndetësor dhe social, arsimit, kontratave publike, tatimeve dhe doganave, të cilat kanë një ndikim të madh në qeverisje, ekonomi dhe shoqëri në tërësi, veçanërisht në nivelin e besimit të publikut ndaj institucioneve publike.

Adresimi i risqeve të korrupsionit në sektorin e pronave është thelbësor për konsolidimin e një sistemi transparent dhe të përgjegjshëm për ofrimin efikas të shërbimeve kadastrale, ndërsa parandalimi i korrupsionit në sistemin e kujdesit shëndetësor dhe social është në përputhje me të drejtat themelore dhe sigurimin e aksesit të barabartë për kujdes

shëndetësor cilësor. Nga ana tjetër, kontrolli më i mirë i procedurave në shërbimet e ofruara nga administrata tatimore do të reduktojë evazionin fiskal, si dhe do të rrisë efikasitetin e monitorimit të veprimeve ose mosveprimeve të zyrtarëve në sektorin tatimor dhe përfshirjen e tyre në raste të abuzimit të detyrës. Vlerësimi i riskut të korrupsionit në sektorin e kontratave publike gjithashtu do të reduktojë problematikat dhe ankesat që vijnë nga operatorët ekonomikë dhe investitorët, vendas dhe të huaj, ndërsa parandalimi i korrupsionit në procedurat doganore, kontrollet dhe vlerësimet nga administrata doganore do të rrisë efikasitetin dhe llogaridhënien e sektorit doganor.

Nga sa më sipër, parandalimi i korrupsionit në këta sektorë do të përmirësohet duke kryer së pari, një vlerësim të thelluar dhe të detajuar të riskut të korrupsionit për secilin sektor për identifikimin e proceseve dhe procedurave më të ekspozuara ndaj korrupsionit, si dhe formave të shfaqjes së tij. Për këtë qëllim, do të zhvillohet një metodologji për kryerjen e vlerësimit të riskut të korrupsionit në sektorin publik, e përshtatur më pas për vlerësimet e riskut në secilin sektor, veçanërisht në sektorët e



evidentuar me risk të lartë ndaj incidencës së korrupsionit.

Zbatimi i metodologjisë do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe institucioneve shtetërore përkatëse që janë përgjegjëse për këta sektorë.

Pas kryerjes së vlerësimeve të riskut në të gjithë sektorët, do të hartohen masa të posaçme për parandalimin e korrupsionit në shërbime dhe procedura, të cilat do të adresojnë hapësirat abuzive të identifikuara në mangësitë e ofrimit të shërbimeve. Qëllimi është të sigurohet një trajtim sistemik i të gjitha mundësive potenciale për korrupsion. Të gjithë mekanizmat parandalues do të sistematizohen në Plane Veprimi për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk të lartë. Zbatimi i masave antikorrupsion në sektorët vulnerabël, si menaxhimi i pronës, kujdesi shëndetësor dhe social, arsimi, prokurimet publike, partneritetet publike-private, taksat dhe doganat, do të përfshijë zbatimin, monitorimin e vazhdueshëm, raportimin, ngritjen e kapaciteteve, angazhimin e palëve të interesuara dhe ndërgjegjësimin publik. Ky proces do të zhvillohet në përputhje me masat dhe aktivitetet e tjera të parashikuara në strategji, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme për parandalimin e korrupsionit në këta sektorë të rëndësishëm.

Këto masa pritet të krijojnë një qasje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk të lartë dhe të japin një kontribut të rëndësishëm në reformat antikorrupsion, duke synuar mirëfunksionimin e administratës publike. Një përparësi e rëndësishme për Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit (KKKK) do të jetë sigurimi që parandalimi i korrupsionit të integrohet në mënyrë të plotë përmes hartimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve (planeve të veprimit), si dhe përmes vlerësimit të tyre të vazhdueshëm.

Kjo do të arrihet përmes një rivlerësimi të plotë në përfundim të ciklit tre-vjeçar të zbatimit të masave, duke identifikuar risqet e korrupsionit në sektorë të tjerë potencialë, siç janë ndërmarrjet shtetërore, infrastruktura dhe mjedisi. Ky proces do të sigurojë që masat antikorrupsion të jenë të përshtatshme dhe efektive në parandalimin e korrupsionit në sektorë të ndryshëm dhe që u përgjigjen dinamikave të zhvillimit në këta sektorë.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.3 synon të adresojë të gjitha ato rekomandime dhe kërkesa të evidentuara në raport progreset e KE për vendin, angazhimet e marra në komponentin antikorrupsion të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, por edhe raporte vlerësimi të tjera, për të mundësuar ndërhyrjen, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike dhe kthimin e besimit të qytetarëve në luftën ndërinstitucionale kundër korrupsionit.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Krijimi i mekanizmave standardë për vlerësimin periodik dhe të rregullt të korrupsionit në sektorët me risk dhe përhapje të lartë të korrupsionit.

Rezultati 2: Monitorimi i rregullt i sektorëve më të cenueshëm e të prekur nga korrupsioni për të identifikuar dhe zbatuar ndërhyrjen e përshtatshme me qëllim zbulimin, parandalimin dhe/ose ndëshkimin e korrupsionit.

Rezultati 3: Hulumtimi i vazhdueshëm dhe analiza për të vlerësuar rezultatet e ndërhyrjeve në sektorët/institucionet që janë më të rrezikuara ose të cenueshëm ndaj korrupsionit.

Rezultati 4: Ofrimi i shërbimeve kadastrale efikase dhe transparente.

Rezultati 5: Rritje e konkurrencës së ndershme gjatë proceseve të prokurimeve publike.

Rezultati 6: Ofrimi i shërbimeve tatimore dhe doganore proceduralisht të mirëregulluara dhe të kontrolluara për të siguruar transparencë dhe efikasitet.

Rezultati 7: Arsimit dhe sistematizimi shëndetësor cilësor dhe efikas për qytetarët.

Institucione Kryesore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Institucionet e varësisë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Institucione Kontributore: Agjencia e Trajtimit të Pronës, Dhoma të Tregtisë dhe Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Ministrinë e Linjës, Autoritetet Kontraktore, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik.



Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi specifik 1.3: Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni)
1.3.1	<i>Masa:</i> Parandalimi i korrupsionit në sektorin publik.
1.3.2	<i>Masa:</i> Parandalimi i korrupsionit në menaxhimin e sektorit të pronave.
1.3.3	<i>Masa:</i> Parandalimi i korrupsionit në sistemin shëndetësor dhe kujdesin social.
1.3.4	<i>Masa:</i> Parandalimi i korrupsionit në fushën e arsimit parauniversitar.
1.3.5	<i>Masa:</i> Parandalimi i korrupsionit në fushën e prokurimeve publike.
1.3.6	<i>Masa:</i> Parandalimi i korrupsionit në fushën e partneritetit publik - privat.
1.3.7	<i>Masa:</i> Parandalimi i korrupsionit për administratën tatimore.
1.3.8	<i>Masa:</i> Parandalimi i korrupsionit në sistemin e doganave.
1.3.9	<i>Masa:</i> Parandalimi i korrupsionit në sektorë të tjerë publikë, të ndjeshëm për ekonominë dhe publikun.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të *acquis*-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.3.1 Raporti i numrit të vlerësimeve të riskut të korrupsionit të kryera me numrin e sektorëve/institucioneve me rrezik të lartë për korrupsion (trend rritës).	Monitorimi i rregullt i sektorëve më të cenueshëm/prekur nga korrupsioni për të identifikuar dhe zbatuar ndërhyrjen e përshtatshme me qëllim zbulimin, parandalimin dhe/ose ndëshkimin e korrupsionit.	1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë të korrupsionit).	KKKK
Rezultati	1.3.2 Raporti i numrit të planeve të veprimit të kryera për parandalimin e korrupsionit, nga numri i sektorëve/institucioneve me rrezik të lartë për korrupsion (trend rritës).	Monitorimi i rregullt i sektorëve më të cenueshëm/prekur nga korrupsioni për të identifikuar dhe zbatuar ndërhyrjen e përshtatshme me qëllim zbulimin, parandalimin dhe/ose ndëshkimin e korrupsionit.	1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë të korrupsionit).	KKKK



Objektivi Specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Analiza e situatës dhe sfidat

Decentralizimi i qeverisjes vendore garanton ushtrimin e kompetencave vendimmarrëse dhe administrative në nivel lokal, duke ofruar një gamë të gjerë instrumentesh financiare për shfrytëzim nga autoritetet vendore. Megjithatë, me këtë zgjerim të kompetencave, rritet edhe ndjeshmëria ndaj korrupsionit. Shqipëria ka bërë përparime të vazhdueshme në rritjen e kapaciteteve të autoriteteve vendore për të luftuar praktikën korruptive, edhe pse mbetet ende punë për t'u bërë në drejtim të konsolidimit të tyre. Në këtë kontekst, janë kryer vlerësime të kornizës rregulatore dhe konsultime të gjera me institucionet e vetëqeverisjes vendore, duke u fokusuar në promovimin e sjelljes etike dhe integritetit. Vendosja e parimeve të qarta të sjelljes etike dhe krijimi i një kulture integriteti janë elementë kyç për të forcuar luftën kundër korrupsionit në nivel lokal.

Procesi i decentralizimit kontribuon në forcimin e llogaridhënies duke e afruar qeverisjen me qytetarët. Megjithatë, rritja e kontakteve midis zyrtarëve vendorë dhe qytetarëve gjatë këtij procesi mund të rrisë edhe rrezikun e sjelljeve joetike dhe mungesës së integritetit, duke rritur kështu mundësinë e shfaqjes së praktikave që minojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë. Për këtë arsye, është thelbësore që të ndërmerren masa menaxhuese proaktive për të parandaluar dhe menaxhuar këto risqe, duke krijuar një qasje të qëndrueshme ndaj integritetit dhe llogaridhënies në qeverisjen vendore. Në këtë kontekst, hartimi i Planeve të Integritetit dhe planeve të veprimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe monitorimi i realizimit të tyre, ofrojnë një kuadër konceptual të qartë për zhvillimin e politikave dhe masave që synojnë parandalimin e shkeljeve të integritetit të zyrtarëve publikë. Këto plane shërbejnë si mjete konkrete për adresimin dhe menaxhimin e risqeve të lidhura me integritetin, duke përmirësuar transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë në nivelin vendor, duke siguruar që zyrtarët publikë të përmbushin standardet e larta etike gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

Instrumentet e integritetit kanë filluar tashmë të hartohen dhe miratohen në nivel vendor, si një mekanizëm për të kuptuar dhe adresuar më mirë

rrezikun e korrupsionit brenda institucionit, duke rritur angazhimin e administratës publike për transparencë dhe llogaridhënie. Deri në fund të vitit 2023, 24 nga 61 bashki, miratuan Planet e Integritetit dhe njëkohësisht kanë caktuar koordinаторët e integritetit si mekanizma për të siguruar zbatimin e tyre.

Për të përmirësuar parandalimin e korrupsionit në të gjitha nivelet e Qeverisjes, vendi duhet të vazhdojë përpjekjet e tij për të forcuar kapacitetet e autoriteteve të vetëqeverisjes vendore në luftën kundër korrupsionit, së bashku me instrumentet lidhëse midis instucioneve qendrore dhe vendore në këtë fushë. Kjo do të arrihet përmes një vlerësimi të detajuar të gjendjes aktuale të çështjeve në parandalimin e korrupsionit në nivel vendor, veçanërisht në lidhje me vlerësimin e kryer të riskut të korrupsionit dhe planeve të integritetit të përgatitura dhe të miratuara.

Kryerja e vlerësimit të riskut në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku nuk janë kryer ende, do të nxitet dhe mbështetet duke përdorur një metodologji që do të përshtatet me specifikat për kryerjen e një vlerësimi të tillë në nivel vendor. Kjo do të pasohet nga përgatitja gjithashtu e një modeli të Planit të Integritetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore që do të marrë parasysh të gjitha gjetjet nga vlerësimet e riskut dhe praktikën më të mira në nivel vendi, por edhe eksperiencat rajonale dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

Për të kryer dhe mbështetur këto procese, është e domosdoshme të rriten kapacitetet profesionale të stafëve teknike të bashkive dhe qarqeve, me njohuri konkrete dhe të vazhdueshme në parandalimin e korrupsionit dhe të kuadrit ligjor dhe rregullator për integritetin. Në këtë drejtim, roli i pikave të kontaktit antikorrupsion bëhet vendimtar për koordinimin ndërinstitucional. Pika të kontaktit antikorrupsion në bashki dhe qarqe do të konsiderohen stafet teknike që do të jenë përgjegjëse për zbatimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit dhe raportimin e zbatimit të saj, sikurse koordinatoret e integritetit që janë persona të ngarkuar me ndjekjen dhe zbatimin e instrumenteve të integritetit dhe koordinatoret e të drejtës së informimit. Strukturat e burimeve njerëzore pranë tyre duhet të jenë të informuara për ngritjen dhe administrimin e instrumenteve parandalues të korrupsionit, përfshirë këtu regjistrin e dhuratave, deklarimit të konfliktit të interesave, apo sinjalizimit.



Për realizimin e këtij qëllimi, merr një rëndësi të veçantë forcimi i bashkëpunimit mes Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencisë së Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe institucioneve të tjera antikorrupsion në bashkitë dhe qarqet përmes emërimit të pikave të kontaktit antikorrupsion. Rritja e komunikimit dhe vizibilitetit, me qëllim rritjen e transparencës të aktivitetit të bashkive dhe qarqeve konsiderohet gjithashtu një vlerë e shtuar dhe siguron zbatimin e mirë të mekanizmave antikorrupsion, duke bërë partnerë direkt edhe organet kolegjiale të Këshillave Bashkiakë, si autoritetet ku miratohen politikat e integritetit dhe monitorhet zbatimi i tyre.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.4 synon adoptimin dhe integrimin në veprimtarinë institucionale të politikave të luftës kundër korrupsionit edhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto njësi duhet të kenë të ngritura mekanizmat dhe të kenë në zbatim instrumente antikorrupsioni njësoj sikurse ato që aplikohen edhe në organet e administratës qendrore.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektivi Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
1.4.1	<i>Masa:</i> Identifikimi i mënyrave për të përmirësuar parandalimin e korrupsionit në të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.
1.4.2	<i>Masa:</i> Fuqizimi i mekanizmave për parandalimin efektiv të korrupsionit në të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.
1.4.3	<i>Masa:</i> Zbatimi i mekanizmave parandalues të përshtatur me specifikat e Vetëqeverisjes Vendore.

Rezultate të pritshme për këtë objektivi përmenden:

Rezultati 1: Forcimi i përgjithshëm i kapaciteteve për të koordinuar zbatimin e politikës antikorrupsion në nivel vendor.

Rezultati 2: Forcimi i mekanizmave të pushtetit vendor në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin periodik të strategjisë kundër korrupsionit dhe kornizës kundër korrupsionit.

Rezultati 3: Krijimi i Rrjetit të Pikave të Kontaktit Antikorrupsion në institucionet e pushtetit me kompetenca vendore.

Rezultati 4: Rritja e rolit të Këshillave Bashkiakë në forcimin e integritetit dhe zbatimin e politikave antikorrupsion në nivel vendor.

Institucione Kryesore: Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Bashkitë, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Institucione Kontributore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Qarqet, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të *acquis*-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.4.1 Raporti i numrit të bashkive dhe qarqeve që kanë kryer vlerësime të riskut të korrupsionit nga numri i atyre që ende nuk e kanë kryer (trend rritës).	Forcimi i përgjithshëm i kapaciteteve për të koordinuar zbatimin e politikës antikorrupsion në nivel vendor.	1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në qeverisjen vendore.	AMVV Bashkitë Qarqet
Rezultati	1.4.2 Raporti i numrit të bashkive dhe qarqeve që kanë përgatitur Plane Integriteti nga numri i atyre që ende nuk e kanë përgatitur (trend rritës).	Forcimi i përgjithshëm i kapaciteteve për të koordinuar zbatimin e politikës antikorrupsion në nivel vendor.	1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në qeverisjen vendore.	AMVV Bashkitë Qarqet

Objektivi Specifik 1.5: Mbrojtja e financave dhe aseteve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik

Analiza e situatës dhe sfidat

Besimi tek institucionet dhe organet që ushtrojnë kompetenca kontrolli dhe vlerësimi ka një ndikim thelbësor në rritjen e besueshmërisë së reformave të ndërmarra nga Shqipëria për luftën kundër korrupsionit. Ky besim kontribuon në legjitimitetin e këtyre reformave, duke siguruar që qytetarët të shohin përpjekjet e qeverisë si të besueshme dhe të efektshme. Për më tepër, organet e kontrollit dhe vlerësimit luajnë një rol kyç në sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës, të cilat janë shtylla kryesore në luftën kundër korrupsionit dhe përforcimin e qeverisjes së mirë.

Përgjatë viteve, janë ndërmarrë disa hapa për të forcuar kuadrin institucional dhe për të përmirësuar mekanizmat e mbikëqyrjes financiare dhe ekonomike, mes të cilave vlen të përmenden përmirësimi i auditimeve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar më shumë transparencë dhe përgjegjshmëri në përdorimin e fondeve publike. Ministria e Financave ka konsoliduar një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin e korrupsionit dhe kontrollin e keqmenaxhimit të aseteve publike.

Nëpërmjet krijimit të mekanizmave të inspektimit në institucionet publike dhe përmirësimeve në planifikimin dhe menaxhimin financiar, përfshirë edhe kontrollin e proceseve të prokurimit, është rritur gradualisht efikasiteti i përgjithshëm i investimeve publike. Këto masa kanë ndihmuar në instalimin e një politike të tolerancës zero ndaj korrupsionit, duke forcuar transparencën dhe përgjegjshmërinë në menaxhimin e burimeve publike.

Qeveria Shqiptare ka miratuar Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe Planin e Veprimit 2023-2026,¹⁵ të cilat cila parashikojnë krijimin e një sistemi të menaxhimit të financave publike bazuar në transparencë, llogaridhënie, disiplinë fiskale, efikasitet dhe barazi në përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara dhe sigurimin e një zhvillimi ekonomik sipas standardeve të BE-së. Sistemet për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik janë përmirësuar duke siguruar mekanizmat e menaxhimit të shëndoshë financiar. Koncepti i llogaridhënies menaxheriale dhe delegimit të autoriteteve është forcuar duke adresuar mangësitë

¹⁵ Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 390, datë 12.6.2024, “Për miratimin e strategjisë sektoriale të menaxhimit të financave publike, 2023-2030”.



e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në institucionet publike.

Auditimet e brendshme zhvillohen në të gjitha institucionet publike në përputhje me standardet ligjore në fuqi. Rastet e mashtrimit dhe parregullsive në administratën publike trajtohen në mënyrë efektive nga Inspektimi Financiar Publik dhe Rrjeti i Shërbimit të Koordinimit Kundër Mashtrimit. Për këtë qëllim, janë krijuar sisteme të përshtatshme të menaxhimit financiar për të përthithur në mënyrë sa më efçente mbështetjen financiare të IPA-III dhe IPA-ve të ardhshme të BE-së.

Njëkohësisht, gjatë viteve, funksioni i pavarur i Kontrollit të Lartë të Shtetit është zbatuar në mënyrë të rregullt dhe të qëndrueshme, në përputhje me parimet e Organizatës Ndërkombëtare të Standardeve të Auditimit (ONISA) dhe standardet ndërkombëtare të auditimit. Kjo ka siguruar që aktivitetet e auditimit të jenë transparente, të paanshme dhe në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, duke kontribuar në përmirësimin e menaxhimit të burimeve publike dhe rritjen e llogaridhënies në administratën publike. Raportimi vjetor i Kontrollit të Lartë të Shtetit në Kuvend dhe bashkëpunimi me strukturat parlamentare është intensifikuar, duke i mundësuar Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat të ushtrojë në mënyrë më efektive rolin e tij mbikëqyrës dhe kontrollues.

Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik ka qenë një nga fushat prioritare të mbuluara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, nga ku rezulton se, institucionet buxhetore kanë vijuar të zhvillojnë dhe zbatojnë Plane për Përmirësimin e Sigurimit të Cilësisë (PPSC) dhe të ofrojnë Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) dhe trajnime të tjera për audituesit e brendshëm përmes programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të trajnimit (CEF). Audituesit e brendshëm në vend, prej të cilëve 90% janë të certifikuar, luajnë një rol kyç në mbrojtjen e financave dhe asetëve publike. Ky proces, është thelbësor për garantimin e cilësisë dhe efektivitetit të mekanizmave të kontrollit, si në nivelin e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm. Në këtë kuadër, mbrojtja e financave publike shihet si një komponent thelbësor i luftës kundër korrupsionit, duke forcuar strukturat e kontrollit dhe rritjen e llogaridhënies në sektorin publik. Kontrolli i

brendshëm dhe i jashtëm përbëjnë format më efektive të parandalimit të abuzimeve financiare, duke ndihmuar në rritjen e transparencës dhe efikasitetit në menaxhimin e burimeve publike.

Lufta kundër korrupsionit në menaxhimin e financave publike duhet vlerësuar edhe si një angazhim gjithëpërfshirës i autoriteteve publike që kanë rol në monitorimin dhe rregullimin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë dhe socialë. Përgjithësisht organet me kompetenca të zbatimit të politikave siç janë entet rregullatorë duke përmendur si: Enti Rregullator i Energjisë, Enti Rregullator i Ujit, Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti Rregullator i Hekurudhave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës. Këto organe janë krijuar dhe sigurojnë që veprimtaritë në tregje të caktuara të zhvillohen në mënyrë transparente e ligjore për të mbrojtur interesat e konsumatorëve, që janë qytetarët e vendit, duke promovuar konkurrencën e lirë, si parakusht për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të vendit. Për këtë qëllim synohet që kapacitet teknike e profesionale të enteve rregullatore, duhet të mbahen në të njëjtat standarde, duke u mbështetur në të njëjtin përkushtim për parandalimin e korrupsionit, por edhe zbatimin e rregullave ligjore, si dhe ngritjen e ekipeve të ekspertizës së nivelit të lartë.

Një nga risitë e rëndësishme të kësaj strategjie është përfshirja e qasjes antikorrupsion në punën e inspektorateve. Për të siguruar një zbatim efektiv të këtij angazhimi, do të realizohet identifikimi i mundësive për integrimin e kuadrit antikorrupsion në aktivitetet e tyre inspektuese. Bazuar në këto gjetje, do të përgatitet një manual i posaçëm për përfshirjen e qasjes antikorrupsion në punën e inspektorateve, duke përfshirë udhëzimet për mënyrat e komunikimit, koordinimit dhe raportimit. Për më tepër, do të organizohen trajnime të dedikuara për stafin, me qëllim forcimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e një qasjeje të integruar në proceset inspektuese.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me objektivin specifik

Objektivi Specifik 1.5 synon të sigurojë normimin dhe zbatimin e kontrollit të rregullt për përdorimin e fondeve të buxhetit e financave të shtetit. Riorganizimi i strukturave të inspektimit dhe rritja e frekuencës së kontrolleve do të përbëjë



garanci të shtuar për përdorimin cilësor dhe në kohë të fondeve të planifikuara.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Forcimi i efektivitetit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe të kontrollit financiar.

Rezultati 2: Forcimi i kapaciteteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, dhe inspektorëve financiarë.

Rezultati 3: Monitorim i përmirësuar i procedurave të prokurimit publik dhe të shpenzimeve publike.

Institucione Kryesore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Inspektorati Qendror, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Ministria e Financave, Kontrolli i Lartë i Shtetit, entet rregullatore.

Institucione Kontributore: Institucionet zbatuese të SNKK, Ministrinë e Linjës, Bashkitë, Akademia e Sigurisë, Shkolla e Magjistraturës, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Ministria e Financave, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, entet rregullatore, sektori privat.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 1.5. Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik
1.5.1	Masa: Forcimi i rolit të inspektimeve në parandalimin e korrupsionit.
1.5.2	Masa: Forcimi i rolit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme në parandalimin e korrupsionit.
1.5.3	Masa: Forcimi i rolit të enteve rregullatore në parandalimin e korrupsionit.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të *acquis*-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.5.1 Rritja e auditimeve në fushat me ndjeshmëri publike për të nxitur përdorimin efektiv të fondeve publike, forcimin e llogaridhënies dhe integritetit të administratës.	Forcimi i efektivitetit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, sidhe kontrolli financiar.	1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik.	KLSH MF
Rezultati	1.5.2 Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga institucionet publike nga numri total i rekomandimeve të dhëna (trend rritës).	Forcimi i efektivitetit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, sidhe kontrolli financiar.	1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik.	MF KLSH



Objektivi Specifik 1.6: Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Sinjalizimi luan një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit, pasi mundësia e raportimit të tij ndikon në shmangien e keqpërdorimit të pushtetit nga nëpunësit publikë të zgjedhur dhe të emëruar. Shqipëria ka hartuar dhe miratuar kornizën ligjore që rregullon sinjalizimin, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private, për të ngritur dhe bërë plotësisht funksionale këto struktura ose njësi. Duke e adresuar në mënyrë të dedikuar në një objektiv specifik sinjalizimin, strategjia synon të përmirësojë kuadrin ligjor për sinjalizimin përmes rishikimit të tij me qëllim përmirësimin e mbrojtjes ligjore të parashikuar për sinjalizuesit si dhe përditësimin e legjislacionit të vendit me zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian.¹⁶

Kuadri ligjor në fuqi për sinjalizimin ka të parashikuar organizimin dhe funksionimin e njërive të sinjalizimit dhe procedurat për ushtrimin e këtij mekanizmi. Përmirësimi i mëtejshëm i arritjeve në këtë fushë do të mundësohet përmes rishikimit të legjislacionit me synim harmonizimin me Direktivën (BE) 2019/1937. Ky proces do të shoqërohet edhe me miratimin e akteve nënligjore që do të rezultojnë si pasojë e përafrimit të ligjit kuadër për sinjalizimin, brenda vitit 2025. Përafrimi i ligjit me Direktivën do të garantojë mbrojtje më efektive për ata që raportojnë veprimet e supozuara korruptive. Përafrimi i ligjit me Direktivën do të garantojë mbrojtje më efektive për njerëzit që raportojnë veprat e korrupsionit. Ky fakt do të inkurajojë qytetarët që të raportojnë në mënyrë proaktive veprat korruptive, duke kontribuar kështu në përmirësimin e efektivitetit të hetimeve kundër korrupsionit. Përmirësimi i rrjetit të sinjalizimit do të rrisë besueshmërinë dhe llogaridhënien, duke mundësuar një trajtim më të shpejtë dhe më të saktë të rasteve të raportuara.

Forcimi i të drejtave dhe mbrojtjes së sinjalizuesve duhet të zhvillohet paralelisht me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit publik.

Këto fushata mund të kontribuojnë më tej në arritjen e qëllimit kryesor: krijimi i një mjedisi pune ku korrupsioni identifikohet dhe raportohet që në fazat e hershme të abuzimit. Kjo qasje ndihmon në zbutjen dhe frenimin e efekteve të korrupsionit në shoqëri, duke forcuar transparencën dhe llogaridhënien në sektorin publik dhe privat. Krijimi i një mjedisi të tillë, ku sinjalizimi është inkurajuar dhe mbrojtur, është një hap i rëndësishëm drejt parandalimit efektiv të korrupsionit.

Njëkohësisht me përmirësimin ligjor, kuadri institucional për sinjalizimin do të forcohet bazuar në vlerësimin e rrjetit të personave përgjegjës për marrjen e denoncimeve dhe raporteve të korrupsionit, pozicionin e tyre, mënyrën e komunikimit, bashkëpunimin dhe raportimin. Gjetjet do të përdoren për iniciimin dhe nxitjen e krijimit të mënyrave për raportimin e korrupsionit në institucionet që e kanë këtë detyrim ligjor, por që ende nuk kanë caktuar persona përgjegjës për marrjen e denoncimeve dhe raporteve të korrupsionit, apo ku ndryshimi i tyre është i shpeshtë. Për më tepër, aftësimi profesional i këtyre personave do të forcohet përmes trajnimeve të shoqëruara me përmirësimin e shkëmbimit të informacionit mbi denoncimet dhe raportimin e korrupsionit midis ILDKPKI dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Gjithashtu, instrumentet për raportimin e korrupsionit dhe inkurajimin e gjerë të shoqërisë për të raportuar korrupsionin do të përmirësohen bazuar në vlerësimin e instrumenteve ekzistuese për të denoncuar dhe raportuar korrupsionin në institucionet e të gjitha niveleve.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.6 synon të përmirësojë më tej kuadrin ligjor për antikorrupsionin përmes harmonizimit të mëtejshëm të *acquis*-së së BE-së për përdorimin me efikasitet të mekanizmit të sinjalizimit, me synim final parandalimin e korrupsionit.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

¹⁶ Direktiva (BE) 2019/1937 e datës 23 tetor 2019 “Për mbrojtjen e personave që raportojnë shkeljet e ligjit të Bashkimit”.



Rezultati 1: Përafrimi i legjislacionit për sinjalizimin me Direktivën e Bashkimit Evropian për sinjalizimin.

Rezultati 2: Rritja e informimit të qytetarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore mbi sinjalizimin.

Institucione Kryesore: Këshilli i Ministrave, Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Inspektorati i Lartë i Deklarimit

dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Institucione Kontributore: Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi specifik 1.6: Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit
1.6.1	<i>Masa:</i> Forcimi i kuadrit ligjor për sinjalizimin.
1.6.2	<i>Masa:</i> Forcimi i kuadrit institucional për sinjalizimin.
1.6.3	<i>Masa:</i> Përmirësimi i mjeteve për raportimin e korrupsionit dhe inkurajimi për raportimin e korrupsionit.
1.6.4	<i>Masa:</i> Përmirësimi i mbrojtjes për individët që raportojnë korrupsionin (sinjalizimi).

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të *acquis*-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.6.1 Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, të miratuara, nga ato që janë planifikuar të miratohen (trend rritës).	Rritja e kontributit të sinjalizimit si një mjet për ndërtimin e integritetit dhe antikorrupsionit.	1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit.	Kuvendi KM

**Objektivi Specifik 1.7: Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike****Analiza e situatës dhe sfidat**

Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike është një element thelbësor për sundimin e ligjit dhe parandalimin e korrupsionit, për shkak të shkallës së lartë të pjesëmarrjes së partive politike në të gjitha proceset vendimmarrëse. Shqipëria ka përparuar në vitet e fundit në drejtim të forcimit të transparencës financiare dhe integritetit të partive politike falë përmirësimit të kuadrit ligjor për financimin e partive politike dhe detyrimit që ato kanë për të deklaruar publikisht burimet e financimit dhe shpenzimet.

Në nëntor të vitit 2020, Kuvendi miratoi ndryshimet në Ligjin për Partitë Politike duke mundësuar që ky akt të jetë në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor. Këto ndryshime ndihmuan në rregullimin e financimit publik të partive politike, trajtimit të donacioneve private dhe huave, si dhe ndalimin e përdorimit të burimeve publike për subjektet zgjedhore. Ligji gjithashtu përcakton procedurat për raportimin, publikimin, auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës, si dhe sanksionet në rast shkeljeje. Komisioni Evropian vlerësoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për përpjekjet e tij në fuqizimin e rolit mbikëqyrës për financimin e fushatave zgjedhore, në përputhje me rekomandimet e ODIHR-it.¹⁷

Masat e marra për kontrollin e financave të partive politike kanë kontribuar në uljen e ndikimit të kontributeve të panjohura, të paidentifikuara dhe ndonjëherë edhe të paligjshme në financimin e partive politike. Këto masa kanë përmirësuar transparencën dhe kanë rritur përgjegjshmërinë e partive politike në raport me burimet e tyre financiare. Ky informacion është gjithashtu i aksesueshëm dhe në dispozicion të publikut¹⁸ për të gjitha partitë politike, në faqen zyrtare të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Strategjia synon të ofrojë një perspektivë më të gjerë për mekanizmat e kontrollit, raportimin financiar, ndjekjen dhe identifikimin e donatorëve dhe të shpenzimeve, si dhe aksesin e qytetarëve në informacion mbi financat e partive politike, duke

respektuar dhe detyrimet që burojnë nga Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës për miratimin e Ligjit për Financimin e partive politike brenda vitit 2027.

Me qëllim avancimin e mëtejshëm në forcimin e transparencës financiare të partive politike, parashikohet të ndërhyhet edhe në zbatimin rigoroz të rregulloreve ekzistuese, si dhe të normohen dhe zbatohen sanksione më të forta, monitorim i shtuar, si dhe auditim më gjithëpërfshirës i financave të partive politike. Këto masa synojnë të parandalojnë korrupsionin dhe pastrimin e parave, duke rritur llogaridhënien dhe transparencën e partive në lidhje me burimet e tyre financiare.

Ndërhyrjet synojnë të kontrollojnë dhe kufizojnë ndikimin e burimeve financiare dhe njerëzore të administratës publike gjatë fushatave zgjedhore dhe periudhave zgjedhore, duke siguruar që ato të mbahen larg ndikimeve politike. Këto masa janë të domosdoshme për të ruajtur integritetin e procesit zgjedhor dhe për të garantuar se administrata publike nuk përdoret për qëllime elektorale, duke kontribuar kështu në zhvillimin e një demokracie më të fortë dhe më transparente.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.7 synon të rrisë kontrollin e financave të partive politike, për të gjitha burimet e tyre financiare, për të garantuar pastërtinë e figurës dhe promovimin e integritetit personal dhe politik në jetën politike në vend, të personave me vlera qytetare, të arsimuara dhe me kontribute në jetën publike.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Forcimi i transparencës dhe kontrollit të burimeve të financimit të partive politike.

Rezultati 2: Rritja e besimit të qytetarëve te partitë politike.

Institucione Kryesore: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Institucione Kontributore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Organizata të Shoqërisë Civile.

¹⁸ Raportet financiare të partive politike dhe ato të auditimeve të kryera për to gjenden të publikuara në faqe: <https://fpp.kqz.gov.al/kreu/reports>.



Masat dhe aktivitetet

Ky objektiv specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 1.7: Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike
1.7.1	Masa: Forcimi i transparencës financiare të partive politike.
1.7.2	Masa: Promovimi i rëndësisë së transparencës financiare dhe integritetit të partive politike.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të *acquis*-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.7.1 Hartimi i draftit të Ligjit për Financimin e Partive Politike.	Partitë politike të mundësojnë transparencë dhe kontroll të burimeve të financimit.	1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike.	KSHZ

Objektivi Specifik 1.8: Ngritja e kuadrit ligjor dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni

Analiza e situatës dhe sfidat

Me qëllim forcimin e besimit të publikut te institucionet e administratës publike, vendimmarrja gjatë ushtrimit të funksioneve në të gjitha fazat e saj duhet të jetë sa më transparente. Qytetarëve duhet t'u garantohet e drejta për t'u informuar rreth aktorëve që kanë akses dhe ushtrojnë ndikim mbi vendimmarrjen qeveritare. Transparenca në këtë aspekt është thelbësore për të ruajtur besimin publik ndaj institucioneve shtetërore. Në të kundërt, nëse forma të tilla ndikimi ushtrohen pa transparencë dhe llogaridhënie të plotë, mund të krijohen dyshime te publiku, duke dëmtuar demokracinë dhe integritetin e procesit vendimmarrës.

Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa paraprakë për të formësuar një kuadër nënligjor dhe institucional për lobimin, duke synuar rritjen e transparencës dhe garantimin e integritetit të zyrtarëve publikë dhe politikë në marrëdhëniet e tyre me lobistët dhe grupet e interesit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Avancimi i këtyre ndërhyrjeve përmes parashikimit

të instalimit të instrumentit të lobimit dhe krijimit të një kuadri të posaçëm ligjor do të ndihmojë në kufizimin e konflikteve të interesit dhe në garantimin e deklaramit të aktiviteteve të zyrtarëve. Ky kuadër ligjor do t'u japë autoriteteve përgjegjëse mundësinë për të mbikëqyrur dhe monitoruar me vigjilencë aktivitetet, takimet dhe komunikimet e zyrtarëve me lobistët. Kjo qasje synon zbulimin dhe parandalimin e rasteve të korrupsionit, duke siguruar që ndërveprimet midis zyrtarëve publikë dhe lobistëve të jenë transparente dhe të rregulluara sipas ligjit.

Në Raportin e Zbatueshmërisë të Raundit V të Vlerësimit për Shqipërinë, të miratuar nga GRECO në datë 2 dhjetor 2022, rekomandohet që Shqipëria ta formalizojë instrumentin e lobimit dhe që anëtarët e Qeverisë të angazhohen në publikimin e kontakteve të tyre me lobistët dhe palët e treta të zhvilluara përmes mënyrave të ndryshme të komunikimit (e-mail, telefonata dhe mesazhet).

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, bazuar në Vendimin nr. 61/2018, datë 05.04.2018 “Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë”, në zbatim të nenit 22, ka



krijuar një regjistër të posaçëm për lobimin, grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile që mbajnë marrëdhënie me deputetët dhe komisionet parlamentare. Ky regjistër synon të rrisë transparencën dhe të përfshijë publikun në procesin legjislativ, duke lehtësuar ndërveprimin e qeverisë me aktorët e ndryshëm të shoqërisë dhe duke siguruar që këto marrëdhënie të jenë të hapura dhe të ndershme.

Parandalimi i korrupsionit përmes rregullimit të lobimit do të forcohet nëpërmjet krijimit të një kuadrit të dedikuar ligjor dhe ngritjes së strukturave institucionale të specializuara për zbatimin e tij. Kjo do të përfshijë krijimin e një organi ose institucioni të ri përgjegjës për monitorimin e lobimit, me kompetenca të qarta dhe procedura të përcaktuara mirë. Ky organ do të sigurojë që aktivitetet e lobimit të jenë transparente, të monitoruara dhe të raportuara në përputhje me ligjin.

Hartimi i këtij kuadri ligjor do të bazohet në një shqyrtim të thelluar të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira për lobimin transparent, duke marrë parasysh rekomandimet nga organizatat

ndërkombëtare që operojnë në këtë fushë. Këto rekomandime do të ndihmojnë në ndërtimin e një sistemi të besueshëm që siguron rregullimin e drejtë të lobimit, duke ndihmuar në parandalimin e korrupsionit dhe garantimin e integritetit në vendimmarrjen publike.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objekivi Specifik 1.8 synon parandalimin e korrupsionit përmes rregullimit të lobimit me krijimin e kuadrit të dedikuar ligjor.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Ngritja dhe funksionimi efikas i kuadrit ligjor për lobimin, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Institucione Kryesore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Institucionet zbatuese të SNKK.

Institucione Kontributore: Këshilli i Ministrave, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Masat dhe aktivitetet

Ky objektiv specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objekivi Specifik 1.8: Ngritja e kuadrit ligjor dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni
1.8.1	Masa: Krijimi i kornizës legjislative dhe institucionale për lobim.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të *acquis*-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.8.1 Raporti i numrit të akteve ligjore dhe nënligjore për lobimin të hartuara nga numri i atyre të planifikuara për miratim (trendi rritës).	Lobim transparent, i përgjegjshëm dhe i verifikueshëm për publikun.	1.8 Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument për parandalimin e korrupsioni.	KKKK



Objektivi Specifik 1.9: Promovimi i integritetit në sektorin privat

Analiza e situatës dhe sfidat

Sektori privat luan një rol të rëndësishëm në parandalimin e korrupsionit, veçanërisht për shkak të ndikimit të tij potencial në marrëdhëniet që mund të krijojnë situata korruptive. Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka adoptuar një qasje bashkëpunuese horizontale me sektorin privat, duke përfshirë përfaqësuesit e tij në tryeza dhe forume me karakter informativ. Këto takime kanë shërbyer si një platformë për diskutimin e masave antikorrupsion dhe promovimin e integritetit në sektorin privat. Përveç kësaj, janë zhvilluar takime gjithëpërfshirëse dhe periodike për ndarjen e amendamenteve teknike të sektorit privat me strukturat e administratës publike, në funksion të forcimit të luftës kundër korrupsionit dhe rritjes së integritetit.

Në një ekonomi tregu të lirë, biznesi privat është motori i zhvillimit, kështu që sigurimi i klimës së duhur të biznesit është thelbësor në rregullimin e tregut. Duke njohur rëndësinë e prezencës së këtij sektori në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike që ndikojnë edhe në parimet e një qeverisjeje demokratike, parandalimi i korrupsionit kërkon ndërhyrje edhe në këtë sektor.

Integriteti në sektorin privat është thelbësor për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrueshmërinë e tregut. Kompanitë që veprojnë me integritet ndërtojnë besim te klientët, partnerët dhe investitorët, duke forcuar kështu reputacionin e tyre në treg dhe përmirësuar performancën financiare. Për të forcuar integritetin në sektorin privat, është thelbësore zbatimi i politikave të etikës së biznesit, garantimi i transparencës në menaxhimin financiar dhe krijimi i një kulture korporative që promovon ndershmërinë dhe përgjegjësinë. Me këtë qasje, bizneset jo vetëm që ndërtojnë besim te klientët, partnerët dhe investitorët, por gjithashtu kontribuojnë në mënyrë të ndjeshme në parandalimin e korrupsionit dhe abuzimeve me detyrën. Lufta kundër ryshfetit dhe praktikave të tjera korruptive është gjithashtu jetike për mbrojtjen e sipërmarrësve dhe aktorëve të biznesit, taksapaguesve dhe të subjekteve që preken në mënyrë të rëndësishme nga transaksionet e biznesit.

Promovimi i integritetit në sektorin privat¹⁹ do të realizohet në bashkëpunim me dhomat e tregtisë në vend dhe shoqatat e tyre, të cilat kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta me bizneset, me qëllim identifikimin e sfidave dhe pengesave përkatëse për rritjen e integritetit në sektorin privat, si dhe mënyrave për t'i kapërcyer ato. Përkëtë qëllim, si dhe për të promovuar zgjidhjet për kapërcimin e sfidave të identifikuara, do të organizohen aktivitete publike në mënyrë sistematike që theksojnë nevojën për integritet në sektorin privat. Njëherësh, modeli i Kodit të Etikës dhe Planit të Integritetit për kompanitë private do të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me dhomat e tregtisë dhe me kompanitë e mëdha që tashmë kanë ngritur dhe zbatojnë mekanizma të integritetit.

Në disa sektorë, korrupsioni në sektorin privat paraqet një rrezik të vërtetë dhe kërkon vëmendje të shtuar. Transaksionet abusive ndërmjet subjekteve private jo vetëm që ndikojnë në këto biznese individuale, por prekin të gjithë zinxhirin e furnizimit, duke deformuar tregjet, minuar konkurrencën e ndershme dhe rritur kostot për kompanitë. Këto praktika minojnë standardet e përgjithshme të biznesit, duke ulur nivelin e transparencës në transaksionet ekonomike dhe duke dëmtuar besimin e përgjithshëm të aktorëve ekonomikë të tregjet. Korrupsioni në sektorin privat ka ndikime të mëdha mbi aftësinë e tregjeve për të tërhequr investime të huaja dhe për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me partnerë ndërkombëtarë. Ai kufizon mundësitë e tregjeve për të funksionuar në mënyrë të hapur dhe të drejtë, duke i bërë më pak tërheqëse për investitorët që kërkojnë stabilitet dhe qeverisje të mirë.

Për këtë arsye, zbatimi i mekanizmave të fortë kundër korrupsionit në sektorin privat është thelbësor për të garantuar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Këto mekanizma ndihmojnë në ruajtjen e standardeve të integritetit dhe transparencës, duke siguruar që tregjet të funksionojnë me drejtësi dhe besueshmëri për të gjithë aktorët ekonomikë. Një mjedis i tillë rrit *atraktivitetin* e tregjeve për investimet e huaja dhe krijon një platformë të fortë për marrëdhënie të qëndrueshme me partnerë ndërkombëtarë.

¹⁹ Një nxitje në parashikim që vjen edhe nga UNCAC (Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit) e cila e parashikon korrupsionin si në sektorin privat, ashtu edhe në sektorin publik. Iniciativa të tjera ndërkombëtare që

ofrojnë udhëzime për etikën në biznes, si: Forumi Ekonomik Botëror, *Transparency International*, OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik), dhe G20.



Përkufizimi i OECD-së për fushat kyçe për sektorin privat, si qeverisja e korporatave, antikorrupsioni, përgjegjësia sociale, digjitalizimi dhe inovacioni, ofron udhëzime të rëndësishme për garantimin e efikasitetit të përpjekjeve antikorrupsion në këtë fushë. Dispozitat e Konventës së OECD-së “Për luftën kundër rryshfetit të zyrtarëve të huaj në transaksionet ndërkombëtare të biznesit” janë krijuar për të luftuar korrupsionin në transaksionet ndërkombëtare të biznesit, duke synuar përmirësimin e integritetit në operacionet ndërkufitare të sektorit privat. Përmirësimi i transparencës në prokurimet publike është një komponent thelbësor për reduktimin e rreziqeve të korrupsionit, duke ndihmuar që bizneset të ndërgjegjësohen për rëndësinë e rritjes së integritetit dhe zhvillimit të programeve të brendshme për parandalimin e korrupsionit. Në këtë kontekst, sektorët privatë po inkurajohen vazhdimisht që të adoptojnë politika të qarta për menaxhimin e rreziqut të korrupsionit, të përmirësojnë sistemet e raportimit të abuzimeve dhe të ndërmarrin masa për raportimin e çdo veprimtarie të dyshimtë. Këto përpjekje janë në linjë me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe ofrojnë një rrugë të qartë për rritjen e përgjegjësisë dhe ndershmërisë në sektorin privat, duke krijuar një mjedis biznesi më të qëndrueshëm dhe të besueshëm, i cili është i mbrojtur ndaj praktikave korruptive.

Nëpërmjet koordinimit të fushatave të sensibilizimit, qeveria jo vetëm që i bën qytetarët dhe bizneset më të vetëdijshëm për rreziqet e korrupsionit, por gjithashtu krijon një mjedis të

favorshëm për zhvillimin e politikave të qëndrueshme kundër korrupsionit. Aksionet kolektive, të cilat përfshijnë bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile dhe sektorin privat, janë jetike për të ndërtuar një infrastrukturë të fortë të integritetit dhe përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.9 sjell një qasje inovative në kuadrin strategjik antikorrupsion për vitet në vijim, duke përfshirë masa dhe mekanizma të rinj që synojnë përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies edhe në sektorin privat. Sektori privat luan një rol të rëndësishëm në programimin strategjik të vendit, duke kontribuar në standardizimin e ndërhyrjeve dhe veprimeve në përputhje me kuadrin rregullator ndërkombëtar.

Rezultate të pritshme për këtë objektivi përmenden:

Rezultati 1: Identifikimi i nevojës për integritet të shtuar dhe për vlerësime të rreziqut të korrupsionit në sektorin privat.

Rezultati 2: Fuqizim i kapaciteteve profesionale për bashkëpunim në analiza dhe kërkime mbi korrupsionin në sektorin privat.

Institucione Kryesore: Koordinator i Kombëtar Kundër Korrupsionit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Autoriteti i Konkurrencës.

Institucione Kontributore: Dhomat e Tregtisë dhe Biznesit, Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

Masat dhe aktivitetet

Ky objektivi specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 1.9: Promovimi i integritetit në sektorin privat
1.9.1	<i>Masa:</i> Promovimi i kërkesës për integritet në sektorin privat.
1.9.2	<i>Masa:</i> Parandalimi i korrupsionit në sektorët privatë me rreziq/prevalencë të lartë të korrupsionit.



Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të *acquis*-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me objektivin specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.9.1 Përqindja e subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë vendosur bashkëpunime për ngritjen dhe promovimin e integritetit në sektorin privat nga numri i bashkëpunimeve të vendosura vitin e kaluar (trend rritës).	Përditësimi mbi rregullimin e integritetit dhe rreziqet e korrupsionit në sektorin privat të kryhet rregullisht.	1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat.	KKKK MEKI MF

QËLLIMI I DYTË I POLITIKËS: “NDËSHKIMI I KORRUPSIONIT” - Përbën

shtyllën e dytë të SNKK 2024-2030 dhe përfshin 3 Objektiva Specifikë. Ky Qëllim do të fokusohet në reformimin e kuadrit ligjor dhe institucional, përmes aplikimit të një qasjeje represive për të maksimizuar ndikimin në luftën kundër korrupsionit. Disa nga ndërhyrjet e parashikuara në këtë kontekst, lidhen me hetimin administrativ, hetimin penal, bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, si dhe ngritjen dhe funksionimin e rrjeteve të komunikimit për forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe mundësimin e një historiku solid (*track record*) të hetimit.

Për këtë qëllim të strategjisë, Qeveria Shqiptare, nëpërmjet autoriteteve përgjegjëse në nivel administrativ, organeve ligjzbatuese dhe institucioneve të pushtetit gjyqësor, do të zbatojë ndërhyrje të dedikuara për të përmbushur objektivat antikorrupsion. Ato do të sigurojnë burimet e nevojshme për të garantuar zbatimin efektiv të masave dhe për të matur progresin në përmbushjen e qëllimeve strategjike.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të këtyre masave do të bazohet në një analizë periodike, e cila do të kryhet çdo gjashtë muaj dhe çdo vit, duke synuar evidentimin e progresit dhe sfidave në zbatimin e masave të parashikuara. Të dhënat e mbledhura nga këto analiza do të ndihmojnë në përshtatjen dhe përmirësimin e strategjisë gjatë fazës së saj të zbatimit, duke garantuar që objektivat të

jenë të arritshme dhe të matshme në mënyrë të vazhdueshme.

Ky qëllim politik (II) synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

Objektivi Specifik 2.1: Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve profesionale për hetimin efektiv administrativ të korrupsionit.

Objektivi Specifik 2.2: Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit.

Objektivi Specifik 2.3: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektiveve të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i dytë i Politikës synon rritjen e performancës së të gjitha strukturave përgjegjëse për verifikimin dhe inspektimin administrativ, ndjekjen penale, hetimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit në sektorin publik. Politika e ndëshkimit synon krijimin e kushteve për një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe qasje në drejtësi për të gjithë, si dhe të kontribuojë në ngritjen e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.



Ky Qëllim Politike lidhet me objektivin 16 të OZHQ: “*Page, siguri dhe institucione të forta dhe të efektive*”.

Objektivi Specifik 2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Përveç parandalimit të korrupsionit, Shqipëria ka zhvilluar gradualisht në vitet e fundit një arkitekturë të mirë institucionale për të ndihmuar në identifikimin dhe verifikimin administrativ për qëllime ndëshkimi të çdo rasti korrupsioni të lidhur me aktivitetin e administratës publike.

Në tetor të vitit 2021, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 618, datë 20.10.2021,²⁰ u krijua Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion. Kjo strukturë u themelua për të centralizuar hartimin e politikave antikorrupsion dhe për të koordinuar hetimin administrativ të rasteve të korrupsionit në organet e administratës publike, të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët. Gjatë funksionimit të saj, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka adresuar rekomandime konkrete për institucionet publike, me qëllim përmirësimin e performancës institucionale dhe procesit të ofrimit të shërbimeve kah qytetarëve. Përveç kësaj, ajo ka marrë masa administrative dhe ka depozituar kallëzime penale pranë organeve të zbatimit të ligjit, në rastet ku është konstatuar përgjegjësi penale. Këto veprime synojnë forcimin e integritetit në administratën publike dhe parandalimin e rasteve të korrupsionit nëpërmjet një qasjeje të strukturuar dhe të qëndrueshme.

Gjithashtu, në muajin nëntor 2021, është miratuar ligji “Për Bashkëqeverisjen”, i cili ridimensionoi platformën “Shqipëria që duam”, ku nëpërmjet seksionit “Denonco korrupsionin”, të gjithë qytetarët që konstatojnë elemente të një akti korruptiv, mund t’i denoncojnë ato.

Ridimensionimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të forcuar koordinimin mes strukturave shërben maksimalisht në funksion të parandalimit të korrupsionit në administratën publike, duke synuar

kryerjen e hetimeve efektive dhe të pavarura, të cilat janë thelbësore për parandalimin e veprave penale të korrupsionit nga punonjësit e administratës publike. Funksioni kryesor i veprimtarisë së hetimit administrativ, është së pari, evidentimi i praktikave abuzive, me qëllim ndërmarrjen e masave me natyrë sistematike dhe jo sporadike. Bazuar në praktikën e deritanishme të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, synimi në periudhën në vijim do të jetë, adresimi i problematikave në efikasitetin institucionale të cilat bëhen shkak për hapësira korruptive.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 2.1 ridimensionon kuadrin e hetimeve administrative dhe ndjekjen e denoncimeve dhe ankesave nga strukturat e brendshme të marrjes së ankesave dhe rasteve korruptive, me qëllim orientimin e marrjes së masave me natyrë sistematike.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Forcimi i përgjithshëm i kapaciteteve të strukturave të përfshira në verifikimin dhe hetimin administrativ të rasteve të korrupsionit në administratë.

Rezultati 2: Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit të organeve që kryejnë verifikimin dhe hetimin administrativ të korrupsionit.

Rezultati 3: Krijimi dhe konsolidimi i një sistemi që adreson në mënyrë sistematike rastet e hetimit administrativ të korrupsionit.

Institucione Kryesore: Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Institucione Kontributore: Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

²⁰ Ky Vendim i Këshillit të Ministrave është shfuqizuar pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 436, datë 26.06.2024 “Për Faqe| 26788

krijimin, organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”.



Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 2.1: Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit
2.1.1	<i>Masa:</i> Forcimi i kuadrit institucional dhe koordinimit për hetimin dhe verifikimin administrativ të korrupsionit.
2.1.2	<i>Masa:</i> Forcimi i kapaciteteve institucionale për hetimin dhe verifikimin administrativ të korrupsionit.
2.1.3	<i>Masa:</i> Rritja e performancës së strukturave përgjegjëse për hetimin dhe verifikimin administrativ të korrupsionit.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të *acquis*-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	2.1.1 Përqindja e analizave në vijim të hetimeve adminstrative me qëllim marrjen e masave sistemike (në rritje).	Forcimi i përgjithshëm i kapaciteteve të strukturave të përfshira në verifikimin dhe hetimin administrativ të rasteve të korrupsionit në administratë.	2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit.	DPAK

Objektivi Specifik 2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Lufta kundër korrupsionit kërkon një sistem drejtësie të pavarur dhe efikas, si dhe organe ligjzbatuese të pajisura me burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe teknologjike. Këto struktura duhet të kenë aftësinë për të përdorur mjetet digjitale në mënyrë efektive, për të siguruar zbatimin e legjislacionit antikorrupsion, të mbështetur nga hetime dhe ndjekje penale të paanshme.

Shqipëria, gjatë viteve të fundit, ka treguar përparime të rëndësishme në këtë drejtim, duke demonstruar rezultate të qëndrueshme në hetimin dhe gjykimin e krimeve të korrupsionit. Vlerësimet ndërkombëtare kanë theksuar në mënyrë të veçantë rolin e Prokurorisë së Posaçme Kundër

Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), si dhe organeve të tjera ligjzbatuese, të cilat janë vlerësuar për ndjekjen penale efektive dhe gjykimin e suksesshëm të çështjeve të korrupsionit. Në këtë kuadër, evidentohet roli dhe aktiviteti i BKH si institucion kontribues përgjatë periudhës 2022 – 2023, me një total prej 17 referimesh për korrupsion në Prokurorinë e Posaçme.

Në vitet e fundit, organet e ndjekjes penale kanë përmirësuar ndjeshëm performancën e tyre nëpërmjet zbatimit të metodave të hetimit proaktiv, si përgjimet telefonike, si dhe metodave të posaçme, përfshirë vëzhgimet, simulimet, kontrollet, sekuestrimin e provave materiale, letërporositë dhe përdorimin e agentëve të infiltuar. SPAK regjistroi një rritje të aktivitetit prej 16% gjatë vitit 2023, duke regjistruar 67 procedime penale, krahasuar me 28 procedime të regjistruara në vitin 2022. Në total,



janë hetuar 447 çështje të lidhura me korrupsionin, nga të cilat 38 janë dërguar për gjykim.

Gjatë vitit, metodat e hetimit proaktiv janë përdorur intensivisht, përfshirë përgjimet dhe veprimet e posaçme si vëzhgimet dhe simulimet. Përgjimet janë aplikuar në 186 procedime, një rritje e ndjeshme krahasuar me vitin e kaluar. Po ashtu, organet e tjera raportuan rritje të dukshme në ndjekjen dhe ndëshkimin e veprave penale të korrupsionit. Policia e Shtetit identifikoi gjithsej 443 vepra penale, me një shkallë zbulueshmërie prej 84.19%. Sa i përket veprave penale të korrupsionit, janë evidentuar 194 raste, nga të cilat 167 janë zbuluar, duke shënuar një shkallë zbulueshmërie prej 86.8%. Gjithashtu, janë zhvilluar 20 procedime penale ndaj zyrtarëve të lartë, duke përfshirë 22 persona të cilët janë nën hetim ose në proces gjyqësor.²¹

SPAK, gjatë viteve 2021 dhe 2022, ka sekuestruar dhe konfiskuar përkatësisht 21 milionë euro dhe 31 milionë euro pasuri të përfituara nga aktivitete kriminale. Në vitin 2023, SPAK ka paraqitur në gjykatë 8 kërkesa për sekuestrimin e vlerave monetare, subjekteve tregtare, pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, nga të cilat 7 janë miratuar nga gjykata, duke përfshirë pasuri të vlerësuara në rreth 275,553,016 lekë. Njëkohësisht, janë paraqitur 6 kërkesa për konfiskim, të cilat janë pranuar nga gjykata, me një vlerë totale prej 64,341,850 lekë.²²

Zbatimi i sanksioneve efektive, proporcionale dhe të ligjshme për korrupsionin, si dhe rikuperimi dhe konfiskimi i të ardhurave të përfituara nga këto aktivitete kriminale, kontribuojnë në rritjen e besueshmërisë së drejtësisë dhe zbatimit të ligjit, duke shërbyer njëkohësisht si një masë parandaluese për krimet e ardhshme. Ndërhyrja strategjike synon përmirësimin e kapaciteteve, burimeve dhe performancës, për të rritur efikasitetin në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit. Ky plan synon përmirësimin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë, duke lehtësuar zbulimin, hetimin dhe ndëshkimin e çdo aktiviteti të paligjshëm në këtë fushë. Përmirësimi i kapaciteteve profesionale do t'u mundësojë organeve të zbatimit të ligjit të kryejnë hetime sipas standardeve më të larta të përcaktuara nga legjislacioni penal dhe konventat ndërkombëtare, si dhe të sigurojnë prova të

mjaftueshme për ndjekjen penale të personave të përfshirë në korrupsion.

Qëllimi për të forcuar kapacitetet, burimet dhe performancën në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit është thelbësor për procesin e integritetit evropian të Shqipërisë, duke pasur parasysh rëndësinë e rritjes së integritetit të institucioneve vendase dhe demonstrimin e aftësive të tyre në luftën kundër korrupsionit. Si një kërkesë kyçe e këtij procesi, është e domosdoshme të sigurohet fuqizimi i sistemit të drejtësisë, në mënyrë që ai të jetë i aftë për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e korrupsionit, veçanërisht ato të nivelit të lartë. Në këtë kontekst, SPAK, përfshirë strukturat profesionale-teknike të saj që kanë kompetenca hetimore si Byroja Kombëtare e Hetimit luajnë një rol kryesor. Arritja e këtij qëllimi do të konsolidojë jo vetëm besueshmërinë e sistemit të drejtësisë, por edhe avancimin e Shqipërisë në rrugën e saj drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 2.2 ka një rëndësi të veçantë brenda kuadrit strategjik ndërsektorial kundër korrupsionit në fushën e zbatimit të ligjit, pasi synon garantimin e vendosjes së sanksioneve efektive dhe proporcionale nga autoritetet kompetente ndaj veprave penale të korrupsionit.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit.

Rezultati 2: Forcimi i kapaciteteve profesionale të autoriteteve ligjzbatuese në menaxhimin dhe përdorimin e njohurive për hetimin penal të korrupsionit dhe rasteve të korrupsionit në sektorë të tjerë.

Rezultati 3: Rritja e cilësisë së hetimit efektiv penal, ndjekjes penale dhe sanksionimi i krimit të korrupsionit.

Rezultati 4: Rritja e numrit të operacioneve antikorrupsion me përdorimin e teknikave speciale hetimore dhe proaktive.

Institucione Kryesore: Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Ministrave, Kuvendi, Ministria e Brendshme, SPAK, Policia e Shtetit, Akademia e

²¹ Raporti vjetor 2023, i monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023.

²² Raporti vjetor i SPAK, 2023.



Sigurisë, Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Shkolla e Magjistraturës, Byroja Kombëtare e Hetimit, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Agjencia e Inteligjencës Financiare.

Institucione Kontributore: Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë Prokurorisë, Shkolla e Magjistraturës, SPAK, Prokuroria e Përgjithshme, Akademia e Sigurisë, Byroja Kombëtare e Hetimit, Policia e Shtetit.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 2.2: Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit
2.2.1	<i>Masa:</i> Forcimi i kornizës legjislative për sigurimin e një veprimtarive efëente të hetimit e ndëshkimit penal të korrupsionit.
2.2.2	<i>Masa:</i> Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale të organeve ligjzbatuese dhe stafeve pranë tyre, me fokus hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit.
2.2.3	<i>Masa:</i> Konsolidimi i qëndrueshëm i strukturave të agjencive ligjzbatuese për të siguruar hetime proaktive kundër korrupsionit (përmirësim i performancës).
2.2.4	<i>Masa:</i> Rritja e performancës së agjencive ligjzbatuese për hetimin penal të korrupsionit nëpërmjet bashkëpunimit institucional, komunikimit me publikun dhe administrimit të informacionit statistikor.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të *acquis*-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	2.2.1 Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara për hetimin penal të korrupsionit nga ato të planifikuara për t'u miratuar.	Rritja e cilësisë së hetimit efektiv penal, ndjekjes penale dhe sanksionimi i krimin të korrupsionit.	2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit.	Kuvendi KM
Rezultati	2.2.2 Raporti i hetimeve penale të përfunduara për korrupsion nga hetimet ende në vijim (zvogëlimi i backlogut) (trend rritës).	Rritja e cilësisë së hetimit penal, ndjekjes penale dhe sanksionimi i krimin të korrupsionit.	2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës në hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit.	SPAK PP
Rezultati	2.2.3 Përqindja e vlerës së pasurive të sekuestruara si rezultat i hetimit të rasteve të korrupsionit nga vlera mesatare e pasurive të sekuestruara në tre vitet e fundit (trend rritës).	Rritja e cilësisë së hetimit efektiv penal, ndjekjes penale dhe sanksionimi i krimin të korrupsionit.	2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit.	SPAK AAPSK



Objektivi Specifik 2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të agjencive ligjzatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave

Analiza e situatës dhe sfidat

Korrupsioni nuk mund të luftohet në mënyrë të izoluar. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave, si dhe dialogu i vazhdueshëm ndërmjet shteteve dhe institucioneve të tyre ligjzatuese, përmes rrjeteve të bashkëpunimit mbi zhvillimin dhe zbatimin e reformave dhe masave për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit, janë elemente thelbësore për një luftë efektive kundër këtij fenomeni.

Bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet agjencive ligjzatuese dhe institucioneve të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit, përfshirë krimin ekonomik dhe pastrimin e parave, ka një rëndësi kritike, duke pasur parasysh nevojën për të adresuar krimin transnacional. Krimi ekonomik mund të ketë ndikime të mëdha në stabilitetin financiar të vendit. Në këtë kontekst, bashkëpunimi ndërkombëtar mundëson shkëmbimin e informacionit për ndalimin në kohë dhe në mënyrë efektive të aktiviteteve kriminale në shkallë globale.

Shqipëria është një partner i rëndësishëm në bashkëpunimin ndërkombëtar, me një komunikim të shtuar të SPAK me autoritetet homologe evropiane, amerikane, dhe ato të Amerikës Qendrore dhe Jugore. Këto komunikime të drejtpërdrejta janë rritur çdo vit. Shkëmbimi i shpeshtë i informacionit është realizuar edhe përmes rrjeteve si Eurojust, Interpol, Europol dhe me oficerët ndërlidhës të atashuar pranë ambasadave të huaja në Tiranë. Përmendim, specifikisht, që në vitin 2023, njësi hetimore pranë SPAK, BKH, ka realizuar në total 39 shkëmbime informacioni me DEA, Europol, Italinë, vendet nordike dhe me 10 shtete të tjera evropiane.

Të dhënat për dy vitet e fundit tregojnë se Policia e Shtetit ka realizuar 405 shkëmbime informacioni me Interpolin, 2740 korrespondenca me Europolin dhe 77 shkëmbime me rrjetin CARIN gjatë vitit 2022. Gjatë vitit 2023, janë realizuar 443 shkëmbime informacioni me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë 266 me Interpolin, 79 me Europolin dhe 88 me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Përmirësimi i mëtejshëm i performancës dhe rritja e rezultateve pozitive në

fushën e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave mbetet një prioritet.

Organet kombëtare të hetimit dhe ndjekjes penale, si SPAK, Prokuroria e Përgjithshme dhe Policia e Shtetit, janë anëtare të Rrjetit GlobE - Rrjeti Operacional Global i Autoriteteve Ligjzatuese, i krijuar nga UNODC për të lehtësuar bashkëpunimin ndërkombëtar në rastet e korrupsionit. Ky rrjet ofron mundësi për trajtimin e rasteve dhe shkëmbimin e përvojave midis prokurorëve dhe oficerëve të policive gjyqësore. Për më tepër, krijimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve, përmirësimi i databazave shtetërore për të cilat kanë akses organet ligjzatuese dhe zgjidhja e sfidave në raportimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet policisë, prokurorisë dhe Agjencisë së Inteligjencës Financiare, janë zhvillime të rëndësishme në forcimin e hetimit penal.

Efektiviteti i veprimeve të ndërmarra për zbatimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe mbështetja e përpjekjeve të vendeve partnere, varet nga reputacioni dhe profesionalizmi i institucioneve dhe agjencive ligjzatuese. Për të përmirësuar këto rezultate dhe për të rritur ndikimin e organeve ligjzatuese, do të intensifikohen përpjekjet për të lehtësuar dhe koordinuar veprimet në forume shumëpalëshe, përveç angazhimit aktiv në konventën UNCAC.

Bashkëpunimi i ndërsjellë midis vendeve partnere, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve për zbulimin e rrjeteve kriminale, mund të përmirësojë rezultatet e Shqipërisë në drejtim të luftës kundër korrupsionit. Në këtë mënyrë, Shqipëria bëhet një partner më i besueshëm dhe më efektiv në rrjetin global të luftës kundër korrupsionit, duke kontribuar jo vetëm në përmirësimin e kontekstit kombëtar, por edhe në stabilitetin rajonal dhe përtej tij.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 2.3 angazhon organet ligjzatuese në bashkëpunimin ndërkombëtar, duke pasur parasysh natyrën shpesh ndërkufitare të krimit të korrupsionit. Për të përmirësuar performancën e autoriteteve shqiptare në bashkëpunimin ndërmjet shteteve dhe me misionet e huaja, nevojiten kapacitete profesionale të përshtatshme dhe mjete të mjaftueshme.

Rezultate të pritshme për këtë objektivi përmenden:



Rezultati 1: Promovim i hetimeve efektive të korrupsionit dhe krimit ekonomik nga organet ligjzbatuese dhe ato gjyqësore shqiptare në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtare shumëpalëshe (EUROJUST, EUROPOL, CARIN, UNODC, GlobE, etj.).

Rezultati 2: Forcimi i kornizës dhe kapaciteteve për bashkëpunim dypalësh dhe shumëpalësh për hetimin e korrupsionit dhe krimit ekonomik.

Rezultati 3: Ofrimi i programeve të zhvillimit të aftësive të avancuara për agjencitë e zbatimit të ligjit dhe prokurorët për hetimin e korrupsionit dhe krimit ekonomik dhe financiar.

Institucione Kryesore: Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, SPAK, Prokuroria e Përgjithshme, Zyra e Rikuperimit të Aseteve, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Institucione Kontributore: -

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 2.3: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave
2.3.1	<i>Masa:</i> Përmirësimi dhe evidentimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të organeve ligjzbatuese (të juridiksionit të posaçëm dhe ato të juridiksionit të zakonshëm), për hetimin dhe ndëshkimin e krimit të korrupsionit dhe të krimeve me natyrë ekonomike.
2.3.2	<i>Masa:</i> Vendosje e bashkëpunimit ndërkombëtar midis Zyrave të Rekuperimit të Aseteve për gjurmimin e informacionit për pasuri dhe asete të vëna nga krimi i korrupsionit dhe krimet me natyrë ekonomike.
2.3.3	<i>Masa:</i> Ngritja e kapaciteteve, shkëmbimi i informacionit dhe aktivitete të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e luftës kundër korrupsionit.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

00	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	2.3.1 Raporti i numrit të operacioneve të nisura nga Eurojust, Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë nga numri mesatar i këtyre operacioneve në tre vitet e kaluara (trend rritës).	Hetime efektive të korrupsionit dhe krimit ekonomik nga organet ligjzbatuese dhe gjyqësore shqiptare në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtare.	2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave.	PSH SPAK



QËLLIMI I TRETË I POLITIKËS: “NDËRGJEGJËSIMI DHE EDUKIMI KUNDËR KORRUPSIONIT” - Shtylla e tretë e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2024-2030 përmban katër Objektiva Specifikë dhe ka për qëllim promovimin e rolit edukues dhe aktivitetet sociale të grupeve të interesit në luftën kundër korrupsionit. Kjo shtyllë synon të mobilizojë të rinjtë, shoqërinë civile, sektorin privat dhe administratën publike si promotorë të luftës kundër korrupsionit, duke ndihmuar në ngritjen e kulturës së integritetit në veprimtaritë publike dhe në ofrimin e shërbimeve.

Për zbatimin e këtij qëllimi, Qeveria shqiptare dhe administrata publike synojnë të ndërtojnë partneritete të qëndrueshme dhe të integrojnë parimet e bashkëpunimit institucional dhe ndërinstitutional midis aktorëve publikë dhe jo-publikë. Për të monitoruar progresin në zbatimin e masave të parashikuara, të dhënat përkatëse do të analizohen në mënyrë periodike, mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Ky qëllim politik (III) synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

Objektivi Specifik 3.1: Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin.

Objektivi Specifik 3.2: Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit.

Objektivi Specifik 3.3: Përfshirja e opinionit publik, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit.

Objektivi Specifik 3.4: Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i tretë i Politikës synon ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe edukimin e të rinjve, grupeve të interesit, publikut dhe shoqërisë së gjerë për t’u angazhuar në mënyrë proaktive në luftën kundër korrupsionit. Politika e edukimit dhe ndërgjegjësimit fokusohet në krijimin e partneriteteve dhe ndërmarrjen e veprimeve kolektive në përpjekjet për të luftuar korrupsionin.

Ky qëllim politik lidhet me objektivin 16 të OZHQ: “*Paqe, siguri dhe institucione të forta dhe efektive*”.

Objektivi Specifik 3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin

Analiza e situatës dhe sfidat

Ndërgjegjësimi ndaj korrupsionit është një hap i rëndësishëm dhe një element strategjik kyç në avancimin e përpjekjeve kundër korrupsionit. Kur qytetarët janë të mirëinformuar mbi pasojat negative të korrupsionit, ata janë më të përgatitur për të kundërshtuar dhe raportuar rastet korruptive. Përmes informimit dhe ndërgjegjësimit, qytetarët fuqizohen si partnerë të rëndësishëm në përpjekjen e përbashkët për një shoqëri të drejtë, të udhëhequr nga parimet e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit. Kjo ndihmon në krijimin e një mjedisi motivues, që përmirëson transparencën dhe llogaridhënien në administratën publike dhe në institucionet shtetërore në përgjithësi.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë iniciativash për rritjen e ndërgjegjësimit kundër korrupsionit, ku Ministria e Drejtësisë, si Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit (deri në vitin 2023), ka investuar me prioritet në orientimin e vëmendjes së opinionit publik në këtë drejtim. Në periudhën 2022-2023, janë zhvilluar tre fushata vjetore ndërgjegjëse, duke përfshirë promovimin e Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit përmes videove të shpërndara për publikun, bashkëpunimin me botën akademike, si dhe konsolidimin e traditës së mbajtjes së edicioneve të “Javës së Integritetit”.

Gjatë vitit 2023, janë publikuar 15 video udhëzuese për të promovuar raportimin e korrupsionit dhe mekanizmat ekzistues për denoncimin e tij. Krahas këtyre aktiviteteve, edhe një sërë institucionesh të tjera kanë ndërmarrë fushata për rritjen e ndërgjegjësimit dhe aktivizimin e mekanizmave për raportimin e korrupsionit. Në kontekstin e integritetit evropian të Shqipërisë, përmirësimi i sundimit të ligjit dhe funksionimi efikas i administratës publike përbëjnë kërkesa thelbësore. Në këtë drejtim, rritja e ndërgjegjësimit kundër korrupsionit dhe promovimi i llogaridhënies janë faktorë kyç për përmbushjen e këtyre kërkesave dhe për avancimin e Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.



Ndërgjegjësimi dhe informimi i vazhdueshëm për të nxitur denoncimin e rasteve të korrupsionit synon të promovojë vlerat e etikës dhe integritetit, si dhe ndihmon në zhvillimin e një kulture të ligjshmërisë që në gjenezë, përmes edukimit në institucionet arsimore. Ky proces është i rëndësishëm, pasi në këtë periudhë formësohet karakteri i fëmijëve dhe të rinjve.

Ndërgjegjësimi i të rinjve për rëndësinë e integritetit është jetik për ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe transparente. Të rinjtë, si e ardhmja e shoqërisë tonë, luajnë një rol vendimtar në formësimin e një kulture që promovon ndershmërinë dhe përgjegjshmërinë në shoqëri. Kur të rinjtë janë të mirëinformuar dhe të ndërgjegjësuar për vlerat e integritetit, ata janë më të përgatitur për të identifikuar dhe kundërshtuar sjelljet joetike dhe korruptive. Kjo qasje ndihmon në krijimin e një mjedisi ku respektohen rregullat dhe ligjet, duke forcuar besimin e qytetarëve tek institucionet dhe duke kontribuar në një të ardhme ku transparenca dhe llogaridhënia mbeten parime themelore. Edukimi për integritetin, që në moshë të re, i pajis të rinjtë me aftësitë e nevojshme për të qenë qytetarë të përgjegjshëm dhe mbrojtës të parimeve të drejta në jetën e tyre shoqërore dhe profesionale.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, në bashkëpunim të ngushtë me partnerë nga sektori publik dhe aktorë të tjerë, do t'i japë përparësi fushatave ndërgjegjëse dhe programeve të edukimit qytetar. Këto programe synojnë të theksojnë rolin thelbësor që çdo individ luan në promovimin e një kulture të integritetit, duke nxitur përfshirjen aktive të qytetarëve në luftën kundër korrupsionit. Një nga elementët kryesorë të këtij angazhimi do të jetë eksplorimi i mënyrave se si pjesëmarrësit e këtyre programeve mund të veprojnë si “ambasadorë të integritetit,” duke u bërë shembuj të gjallë të praktikave të mira dhe duke

shumëfishuar ndikimin pozitiv të këtyre përpjekjeve brenda komuniteteve të tyre.

Përveç kësaj, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit do të përqendrohet në hartimin e mundësive të reja për bashkëpunim në fushën e edukimit kundër korrupsionit. Këto përpjekje do të synojnë t'u ofrojnë qytetarëve dhe publikut të gjerë informacion më të qartë dhe të arritshëm për rëndësinë e luftës kundër korrupsionit, duke siguruar që mesazhet dhe përpjekjet e tyre të jenë të përputhura dhe të koordinuara me ato të mjeteve të informimit publik. Kjo qasje synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të krijojë një pozicionim më koherent për të fuqizuar qytetarët në luftën për transparenca dhe integritet.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 3.1 synon të nxisë qytetarët dhe publikun e gjerë për të raportuar në mënyrë të shpejtë dhe në kohë reale rastet e korrupsionit. Kjo qasje ndaj raportimit të rasteve korruptive shihet si një urë bashkëpunimi me administratën publike dhe një instrument aktiv për ndërtimin e institucioneve efikase.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Informimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për mundësitë për përdorimin proaktiv të kanaleve të raportimit të korrupsionit.

Rezultati 2: Rritja e besimit të publikut të gjerë në luftën kundër korrupsionit.

Rezultati 3: Rritja e pjesëmarrjes qytetare dhe diskutimit publik mbi rrezikun e korrupsionit dhe integritetin.

Institucione Kryesore: Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Institucione Kontributore: Organizata të Shoqërisë Civile dhe media.

Masa dhe aktivitete

Ky Objektivi Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi specifik 3.1: Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin
3.1.1	Masa: Rritja e ndërgjegjësimit dhe komunikimit të vazhdueshëm të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit në shoqëri.



3.1.2	Masa: Promovimi i mënyrave të raportimit të korrupsionit dhe inkurajimi i qytetarëve për ta denoncuar atë.
-------	---

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	3.1.1 Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit.	Rritja e besimit të publikut të gjerë në luftën kundër korrupsionit.	3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin.	KKKK

Objektivi Specifik 3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Synimi për të promovuar edukimin e të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit është rezultat i një qasjeje të kujdesshme, të ndjekur gjatë zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 nga Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Ky synim ka rëndësi të veçantë për ndërgjegjësimin dhe përgatitjen e të rinjve, duke i bërë ata të kontribuojnë në mënyrë efektive në parandalimin dhe reduktimin e korrupsionit në shoqëri. Ndërmarrja e hapave të nevojshëm konsiderohet si një praktikë e suksesshme për përfshirjen e kurrikulave të përshtatshme në institucionet e arsimit parauniversitar, të cilat përfshijnë vlerat e etikës dhe integritetit.

Projekti pilot, i realizuar gjatë viteve 2020-2021 nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ambasada Italiane në Shqipëri, i fokusuar në zbatimin e një moduli edukativ antikorrupsion në 4 shkolla të arsimit të mesëm të lartë në Tiranë, synohet të shtrihet në të gjithë vendin. Ky projekt u riaplikua në vitin shkollor 2023-2024 në 12 shkolla të mesme dhe u vlerësua si një bazë solide për zhvillimin e mëtejshëm të kurrikulës për integritetin dhe antikorrupsionin. Projekti është një rezultat i suksesshëm i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet

Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me mbështetjen e Ambasadës së Italisë në Tiranë. Ky projekt do të vazhdojë edhe në vitet mësimore 2024-2025 dhe 2025-2026 në shkollat e mesme të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Vlorës, Korçës dhe Gjirokastrës.

Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit është ngushtësisht i lidhur me procesin e integritetit evropian të vendit dhe përfaqëson një angazhim të Shqipërisë për të avancuar në këtë drejtim. Përmes përgatitjes së një brezi të ri qytetarësh të ndërgjegjësuar për këto vlera, synohet të garantohet që të rinjtë dhe fëmijët të pajisen me informacionet e duhura dhe të përshtatshme për ta.

Krijimi i një kulture të tillë kërkon veprime të koordinuara në disa drejtime: nga integriteti i etikës dhe integritetit në pritshmëritë e të rinjve përmes edukimit të tyre, deri tek lehtësimi i shkëmbimeve midis aktorëve në nivel kombëtar për të forcuar kuptimin e sfidave dhe për të nxitur angazhimin e tyre për të vepruar dhe reaguar. Kjo qasje synon gjithashtu të përcjellë frymën e mospranimi të korrupsionit tek familjet dhe komunitetet e tyre.

Në një perspektivë afatgjatë, synohet formimi i një brezi të ri qytetarësh të ndërgjegjësuar dhe të përgatitur për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie me integritet. Ky grup i synuar është pjesë e një strategjie më të gjerë për luftën kundër korrupsionit, e cila i kushton një rëndësi të veçantë



brezit të ri si një faktor ndryshimi për të ardhmen e shoqërisë shqiptare. Zbatimi i kësaj qasjeje ka për qëllim krijimin e kushteve për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, përmes përfshirjes së të rinjve si pjesë aktive në përpjekjet për transparencë dhe llogaridhënie.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 3.2 fokusohet në nxitjen e të rinjve dhe grupeve të reja shoqërore për të konsoliduar sjelljen etike, integritetin dhe parimet e besueshmërisë në luftën kundër korrupsionit. Ndërhyrjet e planifikuara do të përqendrohen kryesisht në përmirësimin e kurrikulave arsimore, zhvillimin e bashkëpunimeve me median dhe realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit.

Masa dhe aktivitete

Ky Objektivi Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 3.2: Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit
3.2.1	<i>Masa:</i> Forcimi i komponentit të etikës dhe integritetit në kurrikulat në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.
3.2.2	<i>Masa:</i> Forcimi i aspektit të etikës dhe integritetit në programet edukative të medias (TV dhe radio).
3.2.3	<i>Masa:</i> Promovimi i rëndësisë së angazhimit proaktiv të të rinjve në antikorrupsion.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	3.2.1 Përqindja e shkollave në të cilat është zbatuar kurrikula e etikës nga mesatarja e shkollave ku këto kurrikula janë zbatuar në tre vitet e fundit (trend rritës).	Nivel më i lartë ndërgjegjësimi mbi etikën, integritetin, dhe luftën kundër korrupsionit.	3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit.	KKKK



Objektivi Specifik 3.3 Përfshirja e të gjithë shoqërisë, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Lufta efektive kundër korrupsionit kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve të shoqërisë. Përfshirja e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve akademike është thelbësore për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës, ku të gjitha palët të kontribuojnë në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Përfshirja e të gjitha sferave shoqërore, përmes organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fusha të ndryshme, është adresuar edhe në Strategjinë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023. Në këtë kuadër, AMSHC ka punuar drejt thirrjeve të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, si pjesë e programit antikorrupsion dhe riprogramimit të fondeve për këtë qëllim.

Duke bashkuar të gjithë aktorët, ky objektiv promovon një qasje të bashkërenduar midis tyre në luftën kundër korrupsionit, me synimin për të garantuar një shoqëri më të drejtë, më transparente dhe që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme. Përfshirja e kësaj qasjeje përfaqëson një risi në krahasim me strategjinë e mëparshme, duke marrë parasysh rëndësinë e kontributit të këtyre aktorëve në përmirësimin e institucioneve, zbatimin e ligjit dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Sektori privat ka një rol thelbësor në promovimin e transparencës, etikës dhe menaxhimit të rrezikut të korrupsionit në biznes, duke ndihmuar kështu në krijimin e një mjedisi që nxit konkurrencën e ndershme. Përdorimi i metodave të përbashkëta të komunikimit, nëpërmjet botimeve dhe mjeteve të cilat kanë interes dhe ndikim publik, do të përforcojë ndërveprimin ndërmjet nismave antikorrupsion të sektorit publik dhe atij privat.

Akademia, nga ana e saj, mund të kontribuojë me ekspertizë dhe kërkime të thelluara shkencore për të analizuar dhe zhvilluar metodat më efektive për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe për të mbështetur hartimin e politikave dhe strategjive të mirëfillta antikorrupsion.

Shoqëria civile do të avancojë përmes mekanizmave të rinj të bashkëpunimit, ku Koalicioni Kundër Korrupsionit dhe Rrjeti i Organizatave të Shoqërisë Civile do të

institucionalizohen, duke krijuar impakte të qëndrueshme. Nismat si Pakti i Integritetit, të testuara në disa vende të BE-së, shihen si mekanizma të fuqishëm kontrolli dhe auditimi për të siguruar menaxhimin e drejtë të fondeve dhe buxhetit publik nga sektori publik.

Bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat, shoqërisë civile, akademisë, ekspertëve të kërkimit dhe mediave, si grupe interesi me kontribute të rëndësishme dhe burime programore, është kyç për krijimin e një kulture integriteti përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse në shoqëri. Angazhimi dhe ndarja e qartë e përgjegjësisë ndërmjet këtyre aktorëve dhe Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit paraqet një mundësi të rëndësishme për përparimin e përpjekjeve kundër korrupsionit, duke siguruar një sinkronizim të veprimtarive dhe kontributit të secilit aktor në mënyrë të harmonizuar dhe të koordinuar. Kjo qasje mund të çojë në rritjen e efektivitetit dhe ndikimit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me objektivin specifik

Objektivi Specifik 3.3 orienton përpjekjet kundër korrupsionit drejt forcimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile, sektorin privat, si dhe me akademinë dhe studentët si promotorë të ndryshimit. Ky objektiv synon krijimin e një aleance të fuqishme ku liria e mendimit, forca shtytëse e zhvillimit ekonomik dhe iniciativat krijuese bashkohen për të maksimizuar ndërhyrjet dhe për të arritur rezultate më të mira në luftën kundër korrupsionit. Kjo qasje gjithëpërfshirëse ka për qëllim të krijojë një ndikim të qëndrueshëm dhe të prekshëm në përmirësimin e transparencës dhe integritetit në shoqëri.

Masat do të zbatohen për të arritur këto rezultate:

Rezultati 1: Rritja dhe përfshirja e gjerë shoqërore e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në fuqizimin e transparencës dhe integritetit.

Rezultati 2: Nisma, veprimtari politikash dhe kërkimi mbështetur në hulumtime shkencore dhe ekspertizë të kualifikuar.

Rezultati 3: Rritje e përgjegjësisë së institucioneve dhe zyrtarëve publikë mbështetur në bashkëpunime me ekspertizën e pavarur.

Institucione Kryesore: Ministrinë e Linjës, Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit,



Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Institucione Kontributore: Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Ministria e Financave,

Agjencia e Prokurimit Publik, Organizata të Shoqërisë Civile, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sektori privat, autoritete publike.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneks nr. 1.

	Objektivi Specifik 3.3 Përfshirja e të gjithë shoqërisë, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit
3.3.1	<i>Masa:</i> Përfshirja aktive dhe e zgjeruar e sektorit privat në luftën kundër korrupsionit.
3.3.2	<i>Masa:</i> Përfshirja aktive dhe e zgjeruar e organizatave të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit.
3.3.3	<i>Masa:</i> Përfshirja e akademisë në luftën kundër korrupsionit.
3.3.4	<i>Masa:</i> Përfshirja e medias dhe gazetarisë në luftën kundër korrupsionit.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me objektivin specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	3.3.1 Përqindja e fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të institucioneve publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademinë dhe median, nga mesatarja e regjistruar në tre vitet e fundit (trend rritës).	Përfshirja e gjerë shoqërore, sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në fuqizimin e transparencës dhe integritetit.	3.3 Përfshirja e opinionit publik dhe veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit.	KKKK



Objektivi Specifik 3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm

Analiza e situatës dhe sfidat

Aspektet gjinore janë tejet të rëndësishme dhe duhet të integrohen në hartimin dhe programimin e politikave kundër korrupsionit, pasi gratë dhe burrat preken nga korrupsioni në mënyra të ndryshme dhe përfshijnë forma të ndryshme të praktikave dhe sjelljeve korruptive.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka arritur nivele të larta të përfaqësimit të grave dhe vajzave, duke ulur ndjeshëm hendekun gjinor dhe pasojat e tij për gjininë më pak të përfaqësuar. Aktualisht, 66% e anëtarëve të Këshillit të Ministrave janë gra, duke treguar një përfaqësim të balancuar në nivelet më të larta të drejtimit. Për më tepër, Shqipëria ka zbatuar një sërë projektesh dhe programesh të përqendruara në qasjen gjinore dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive të grave dhe vajzave në luftën kundër korrupsionit.

Gjatë viteve, janë realizuar një sërë aktiviteteve ndërgjegjëse për të sensibilizuar opinionin publik dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi ndikimin që korrupsioni ka në jetën e grave. Megjithë përparimet pozitive, ende mungojnë të dhëna të qëndrueshme dhe të detajuara mbi numrin e grave që raportojnë korrupsionin dhe përfshirjen e tyre, qoftë në mënyrë aktive apo pasive, në luftën kundër këtij fenomeni.

Përfshirja e grave në identifikimin dhe luftën kundër korrupsionit përfaqëson një hap të domosdoshëm drejt arritjes së barazisë gjinore. Integrimi i perspektivës gjinore në agjendën antikorrupsion ndërinstitucionale ndihmon në evidentimin e aspekteve të veçanta të korrupsionit që prekin në mënyrë specifike gratë dhe vajzat, ndryshe nga përvoja e pjesës tjetër të shoqërisë. Kjo përfshin forma të rryshfetit, dhunën me bazë gjinore të lidhur me korrupsionin dhe sfida të tjera që shfaqen përmes një lenteje gjinore.

Pjesëmarrja e grave në procesin e identifikimit dhe përparimin e luftës kundër korrupsionit është jetike për thellimin e përpjekjeve në këtë fushë. Ky Objektiv Specifik i Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 synon të adresojë këtë sfidë, duke njohur dimensionin socio-kulturor të thellë të korrupsionit, përveç atij ligjor, dhe duke nënvizuar rolin e rëndësishëm të grave në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të qëndrueshme.

Kjo qasje krejtësisht e re strategjike synon të rrisë në mënyrë të konsiderueshme vetëdijen mbi ndikimin e korrupsionit tek gratë dhe vajzat. Përfshirja e komponentit gjinor në projektet e mbështetjes së shoqërisë civile do të sigurojë që një pjesë e masave kundër korrupsionit të jenë të drejtuara posaçërisht ndaj nevojave dhe shqetësimeve të grave dhe vajzave, duke i adresuar ato në mënyrë të veçantë.

Rritja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në identifikimin dhe luftimin e korrupsionit ka për qëllim të përmirësojë përfshirjen e tyre në këto përpjekje, të rrisë ndërgjegjësimin publik, të identifikojë aspekte specifike të korrupsionit dhe të forcojë politikat publike. Në të njëjtën kohë, kjo nismë synon të nxisë më tej transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve.

Bashkëpunimi me organizatat që promovojnë barazinë gjinore dhe ndërveprimi me to për matjen e korrupsionit do të ndihmojë në hedhjen dritë mbi natyrën dhe ndikimin specifik të korrupsionit tek gratë dhe vajzat. Prandaj, themeli i kësaj qasjeje qëndron tek parashikimet e bëra në këtë strategji, duke garantuar përfshirjen e perspektivës gjinore në luftën kundër korrupsionit.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me objektivin specifik

Objektivi Specifik 3.4 thekson rëndësinë e rolit të grave dhe vajzave në promovimin dhe intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, duke kontribuar gjithashtu në mbledhjen e të dhënave që ndihmojnë në identifikimin e përhapjes dhe prirjeve të këtij fenomeni. Ky objektiv synon të ilustrojë shkallën dhe shtrirjen e formave specifike të korrupsionit, duke përfshirë analizën e llojeve të veçanta të korrupsionit që prekin gratë dhe vajzat, për të ndihmuar në zhvillimin e politikave efektive në këtë fushë.

Masat që do të zbatohen për të arritur këto rezultate:

Rezultati 1: Angazhim dhe përfshirje e organizatave me bazë gjinore me projekte në luftën kundër korrupsionit.

Rezultati 2: Vijim i programit antikorrupsioni nga AMSHC.

Rezultati 3: Dialogim dhe bashkëpunim me perspektivë gjinore në luftën kundër korrupsionit.

Institucione Kryesore: Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile, Koordinatori



Kombëtar Kundër Korrupsionit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Institucione Kontributore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Statistikave, Organizata të Shoqërisë Civile.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm
3.4.1	Masa: Përfshirja e komponentit gjinor në termat e referencës dhe përcaktimi i një buxheti specifik për projektet e integritetit dhe të antikorrupsionit, të shpallura nga AMSHC.
3.4.2	Masa: Organizimi i aktiviteteve komunikuese dhe ndërgjegjësuere me palë të interesuara me fokus perspektivën gjinore në forcimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	3.4.1 Raporti i numrit të projekteve kundër korrupsionit me orientim gjinor në krahasim me numrin tyre në tre vitet e fundit.	Angazhimi i shtuar i grave në pjesëmarrjen politike dhe ekonomike të vendit.	3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm.	AMSHC

PJESA III MASAT PRIORITARE TË QEVERISË PËR ZBATIMIN E DOKUMENTIT STRATEGJIK

Në kuadër të zbatimit të tre Qëllimeve të Politikave dhe të Objektiveve Specifike prioritarë që adresojnë ndërhyrjet posaçërisht të kërkuara për reformën kundër korrupsionit, janë parashikuar këto masa prioritarë të qeverisë në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030:

(Masa 1.2.5) Hartimi i një kuadri të harmonizuar dhe në koherencë me kuadrin ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë dhe funksionarëve

politikë (duke reflektuar rekomandimin iii) të Raund V të GRECO për Shqipërinë).

(Masa 1.3.2- 1.3.8) Parandalimi i korrupsionit në menaxhimin e sektorëve të pronave/ sistemin shëndetësor dhe kujdesin social/arsimit/prokurimeve publike/partneritetin publik-privat/administratën tatimore/sistemin e doganave.

(Masa 1.6.1) Forcimi i kuadrit ligjor për sinjalizimin.

(Masa 1.8.1) Krijimi i kornizës legjislative dhe institucionale për lobimin.

(Masa 2.2.1) Forcimi i kornizës legjislative për garantimin e një veprimtarive efçente për hetimin e ndëshkimin penal të korrupsionit.



(Masa 2.2.2) Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale të organeve ligjzbatuese dhe stafeve pranë tyre, me fokus hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit.

(Masa 3.1.1) Rritja e ndërgjegjësimit dhe komunikimit të vazhdueshëm të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit në shoqëri.

(Masa 3.2.1) Forcimi i komponentit të etikës dhe integritetit në kurrikulat në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

PJESA IV ZBATIMI, LLOGARIDHËNIA DHE KOORDINIMI

Zbatimi koherent, efektiv dhe i suksesshëm i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 synohet të arrihet përmes një qasjeje të përmirësuar zbatimi, nëpërmjet koordinimit ndërinstitucional të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe zbatimit të detyrave funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit. Kjo drejtori është përgjegjëse për koordinimin, hartimin dhe ndjekjen e instrumenteve të nevojshme për zbatimin e politikave antikorrupsion, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 26.06.2024, për ngritjen dhe organizimin e saj. Përtej monitorimit, vlerësimit dhe raportimit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit do të jetë institucioni përgjegjës për zbatimin e plotë të strategjisë, duke përfshirë ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna ndaj institucioneve, implementimin e politikave prioritare, dhe përpilimin e raporteve të monitorimit, të cilat do të vlerësojnë dhe reflektojnë rezultatet e arritura.

Për të siguruar zbatimin efektiv të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe arritjen e rezultateve të synuara, është e nevojshme një largim nga monitorimi tradicional, duke kaluar drejt një qasjeje proaktive. Kjo qasje përfshin planifikimin në kohë dhe realizimin efikas të masave dhe aktiviteteve të tyre (produkteve), të mbikëqyrura nga një zyrë qendrore. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, nën udhëheqjen e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, për shkak të kompetencave, hierarkisë në strukturat kundër korrupsionit dhe përvojës së saj në zbatimin e strategjive të mëparshme, përbën një zgjedhje logjike dhe të përshtatshme për këtë rol.

Për të arritur këtë qëllim, do të përmirësohet koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve me kompetenca kundër korrupsionit (DPAK, ILDKPKI, KDIMDP, KLSH, APP) në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe politikave të tjera antikorrupsion. Zbatimi i aktiviteteve do të sigurohet përmes hartimit të një plani për periudhën e ardhshme të raportimit, i cili do të përgatitet nga pikat e kontaktit për zbatimin e strategjisë dhe do të miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Për të rritur kapacitetet dhe për të zgjeruar fushën e ekspertizës, është e domosdoshme përfshirja aktive e koordinatorëve kundër korrupsionit, koordinatorëve të integritetit, koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe specialistëve të burimeve njerëzore në institucione. Ata do të ofrojnë mbështetje për pikat e kontaktit kundër korrupsionit në institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të strategjisë, duke kontribuar aty ku aktivitetet lidhen me fushën e tyre të ekspertizës dhe përgjegjësisë.

Zbatimi efektiv dhe i suksesshëm i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 synohet të realizohet përmes një sistemi të monitorimit dhe vlerësimit, i cili është në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)”. Për përgatitjen e Raporteve të Monitorimit, do të ndiqet një proces me disa faza, me qëllim verifikimin e progresit në zbatimin e Objektivave Specifike dhe masave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të miratohet nga Ekipi Tematik Antikorrupsion, në përputhje me parashikimet e urdhrit të Kryeministrit Nr. 90, datë 1.8.2023. Ky proces menaxhohet nga Njësia e Mirëqeverisjes pranë Kryeministrit, e cila vepron si sekretariat teknik për Drejtësinë dhe Demokracinë, dhe nga SASPAC, që shërben si njësia përgjegjëse për koordinimin qendror të Grupeve të Integruara të Menaxhimit të Politikave.

Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) në fushën prioritare “Demokracia, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë” operon në nivel teknik përmes 8 ekipeve tematike, ku përfshihet edhe Ekipi Tematik për Antikorrupsionin.

Në mbledhjet e ekipeve tematike, do të trajtohen raportet, problematikat dhe pengesat e hasura gjatë



zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) dhe funksionimit të aktiviteteve institucionale, të cilat kërkojnë një qasje të përbashkët për zgjidhje. Gjithashtu, do të përcaktohen hapat e mëtejshëm për të siguruar realizimin efektiv të këtyre aktiviteteve.

Një tjetër prioritet do të jetë koordinimi ndërinstitucional në zbatimin e strategjisë. Në këto takime do të marrin pjesë edhe organizata të shoqërisë civile, aktive në fushën e antikorrupsionit, të cilat do të kontribuojnë me mendime dhe vlerësime mbi monitorimin dhe rezultatet e procesit.

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit do të përgatisë raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin e progresit në zbatimin e Strategjisë, duke u mbështetur në standardet e përcaktuara nga Metodologjia IPSIS për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike. Këto raporte do të ofrojnë informacion të plotë dhe të përditësuar për politikëbërësit lidhur me ecurinë e zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit të SNKK-së për periudhën e ardhshme 7-vjeçare.

Plani i Veprimit i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit do të rishikohet çdo tre vjet, me qëllim që të sigurohet një vlerësim i saktë dhe i përgjegjshëm për progresin e realizimit të tij, duke pasur parasysh gjithashtu nivelin e financimit.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë do të mbështetet në një sistem të unifikuar dhe të strukturuar të raportimit të të dhënave nga të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e SNKK-së 2024-2030. Çdo institucion do të raportojë në mënyrë sistematike mbi nivelin e zbatimit të çdo objekti dhe mase, mbi burimet buxhetore të alokuara, sfidat e hasura gjatë procesit dhe vlerësimin e përgjithshëm të ecurisë së Strategjisë.

Përpunimi statistikor i të dhënave do të kryhet me anë të shifrimit të përgjigjeve sipas raporteve të marra nga institucionet zbatuese. Këto raporte janë kryesisht të karakterit narrativ, por edhe statistikor, duke raportuar Tregues të Performancës për të matur progresin e zbatimit të masave.

Në përputhje me procedurat që do të ndiqen për raportimin dhe monitorimin e Strategjisë, në zbatim të VKM-së Nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar

(SIPI/IPSIS)”, procesi i përgatitjes së Raporteve të Monitorimit do të ndjekë fazat e mëposhtme:

Faza 1: Marrja e kontributeve nga të gjitha institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit.

Faza 2: Dërgimi i paketës së plotë raportuese për vlerësim pranë SASPAC, në përputhje me standardet e sistemit. Paketa e plotë duhet të përfshijë materialet e mëposhtme:

a) Raportin e konsoliduar për progresin në zbatimin e Strategjisë në përputhje me standardet e sistemit IPSIS.

b) Planin e zbatueshmërisë së masave për periudhën referuese në përputhje me standardet e sistemit.

c) Pasaportën e Treguesve në përputhje me standardet e sistemit për periudhën referuese.

Faza 3: Konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të dërguara nga SASPAC.

Faza 4: Organizimi i mbledhjes së Ekipit Tematik për Antikorrupsionin.

Faza 5: Reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së raportit të monitorimit.

Faza 6: Publikimi i raportit të monitorimit.

Faza 7: Përcjellja e procedurave (shënimet e takimit dhe konkluzionet operacionale) të mbledhjes së ETA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Njesisë së Mirëqeverisjes në Kryeministri dhe në SASPAC.

PJESA V

PLANI I VEPRIMIT DHE VLERËSIMET FINANCIARE

Plani i detajuar i Veprimit, bashkangjitur si aneks 1 i këtij dokumenti strategjik, është hartuar në përputhje me metodologjinë e sistemit IPSIS. Ai është kostuar dhe buxhetet e detajuara parashikohen në të njëjtën mënyrë në sistemin IPSIS, duke ofruar edhe ndarjen e duhur për programet buxhetore sipas institucioneve.

Në këtë kapitull jepet informacion në lidhje me financimin e Planit të Veprimit, 2024-2026, të SNKK-së, 2024-2030, me qëllim arritjen e tre qëllimeve të politikës dhe objektivave specifike. Për këtë arsye, në këtë pjesë do të jepet informacion mbi alokimin e burimeve financiare për Qëllimet e Politikave, si dhe nevoja financiare që mund të lindë në të ardhmen. Financat do të mbulohen nga buxheti i shtetit, nga donatorët në formën e granteve, kredive ose çdo fondi tjetër kapital apo



asistencë teknike të parashikuar. Kostoja totale për zbatimin e Strategjisë jepet në lekë. Masat e kostuara në Planin e Veprimit 2024-2026, të cilat janë planifikuar të mbulohen nga fondet e buxhetit të shtetit, janë brenda fondeve të caktuara për institucionet përgjegjëse.

Në vijim, jepet i detajuar financimi, burimet e tij dhe nevojat për financim për secilin nga Qëllimet e Politikës së këtij dokumenti. Në kostimin e masave, objektiveve dhe qëllimeve të strategjisë është ndjekur metodologjia e kostimit sipas standardeve IPSIS dhe nuk ka dublikim masash me strategji të tjera kombëtare sektoriale apo ndërsektoriale. Gjatë procesit të detajimit të fondeve janë hasur vështirësi në përcaktimin e plotë dhe të saktë të fondeve të alokuara nga donatorë të ndryshëm për masat specifike të dokumentit strategjik. Duke mbledhur gjithë informacionin specifik mund të merret buxheti i plotë për të realizuar të gjitha politikat e planifikuara.

Si më poshtë, pasyrohet shpërndarja e burimeve të financimit sipas burimeve të financimit për qëllimet e identifikuar në strategji. Gjithashtu për secilin nga qëllimet jepet edhe hendeuku financiar dhe nevojat e paplotësuara. Burimet e financimit të hendeikut financiar të çdo Qëllimi Politike janë buxheti i shtetit, donatorët nëpërmjet granteve apo edhe fonde të tjera të asistencës teknike.

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit janë institucionet përgjegjëse për koordinimin e veprimeve për të

mundësuar realizimin me sukses të masave të parashikuara në strategji.

Hendeuku i financimit lidhet me politikat e reja që do ndiqen në lidhje me shtrirjen e qasjeve edhe në sektorë specifikë apo edhe tek biznesi. Ato lidhen me shpenzimet e trajnimit, studim i situatës aktuale apo perceptimit për fenomene të ndryshme, shpërndarje informacioni, platforma online apo faqe web dhe ndryshime strukturash.

Kosto totale e Planit të Veprimit të strategjisë për periudhën 2024 - 2026 është **991.76 milion** lekë dhe hendeuku financiar është 9.9%. Si vlerë hendeuku financiar në total është **98.064 milion** lekë.

Nëse analizohet hendeuku financiar sipas Qëllimeve të Politikës vihet re se për Qëllimin e parë ai është në vlerën 24.13 milion lekë, për Qëllimin e dytë është në vlerën 55.4 milion lekë dhe për Qëllimin e tretë është në vlerën 18.53 milion lekë.

Identifikimi i shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale bëhet i mundur pas përcaktimit të kuadrit strategjik, sipas qëllimeve, objektiveve specifike dhe masave të strategjisë.

Ky dokument strategjik ka si burim kryesor financimi buxhetin e shtetit me rreth **87.6%**. Financimi i dedikuar dhe konfirmuar nga donatorët specifikisht për masat e strategjisë është **2.5%**. Donatorët janë Bashkimi Evropian, Banka Botërore, mbështetja e qeverisë zviceriane etj.²³

Duke pasur parasysh këtë përbërje të shpenzimeve totale, mund të thuhet se në koston e secilit nga Qëllimet, peshën më të madhe e zenë shpenzimet për paga dhe ato për shpenzime të tjera korrente.

Tabela nr. 1: Kosto sipas Qëllimeve të Politikës (në lekë)

	Paga dhe sigurime shoqërore	Shpenzime korrente të tjera	Shpenzime kapitale	Totali
Qëllimi 1- Parandalimi i korrupsionit	638,089,173	215,427,450	0	853,516,623
Qëllimi 2 - Ndëshkimi i korrupsionit	85,606,955	26,566,000	1,380,000	113,552,955
Qëllimi 3 - Ndërgjegjësimi dhe edukimi në luftën kundër korrupsionit	2,560,539	20,980,000	1,150,000	24,690,539
Totali	726,256,667	262,973,450	2,530,000	991,760,117

²³Për arsye të mos detajimit sipas masave, në fondet e mbuluara nga donatorët nuk është përfshirë vlera 3.85 milion euro e mbështetjes teknike nga BE për institucionet
Faqe | 26804

e drejtësisë si SPAK, BKH dhe të tjerat, që do fillojë në vitin 2025.



Siç vihet re, fokusi është vendosur tek ngritja e infrastrukturës, institucioneve dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore për parandalimin e korrupsionit. Kostot e realizimit të Qëllimit të parë janë ato që zenë peshën më të madhe me 86.1% të kostove totale. Kostot për realizimin e Qëllimit të dytë zenë rreth 11.4% të kostove totale. Ndërkohë kostot e realizimit të Qëllimit të tretë zenë 2.5% të kostove totale.

Tabela e mëposhtme jep alokimin në vite të shpenzimeve totale. Në tabelë vihet re synimi për rritjen e mbështetjes së masave për parandalimin e korrupsionit dhe ndërgjegjësimin dhe edukimin në luftën kundër korrupsionit, e cila reflekton rritje përgjatë viteve të zbatimit të strategjisë.

Tabela nr. 2: Shpërndarja në vite e kostove të parashikuara në planin e veprimit (në lekë)

	2024	2025	2026
Qëllimi 1- Parandalimi i korrupsionit	266,910,307	328,604,188	258,002,128
Qëllimi 2 - Ndëshkimi i korrupsionit	33,727,863	39,975,327	39,849,766
Qëllimi 3 - Ndërgjegjësimi dhe edukimi në luftën kundër korrupsionit	4,348,944	3,120,798	17,220,798
Totali	304,987,114	371,700,312	315,072,691

Përsa i përket burimit të financimit, buxheti i shtetit mbulon përqindjen më të madhe të shpenzimeve. Informacioni për secilin nga qëllimet e politikës jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 3: Burimi i financimit (në lekë)

	Buxheti i Shtetit	Donatorë	Hendek financiar
Qëllimi 1- Parandalimi i korrupsionit	813,581,055	15,806,000	-24,129,568
Qëllimi 2 - Ndëshkimi i korrupsionit	52,478,102	5,670,000	-55,404,854
Qëllimi 3 - Ndërgjegjësimi dhe edukimi në luftën kundër korrupsionit	2,560,538	3,600,000	-18,530,001
Totali	868,619,695	25,076,000	-98,064,423

Në këtë dokument strategjik janë përcaktuar 9 objektiva të politikës në Qëllimin e parë, 3 objektiva të politikës për Qëllimin e dytë dhe 4 objektiva të politikës për Qëllimin e tretë. Ndër këta objektiva, Objektivi 1.2: *Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes*, zë peshën më të madhe në koston totale të strategjisë me 78.5% të koston totale dhe Objektivi 2.2: *Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit*, zë 9.7% të koston totale.

Ndërkohë objektivat që zënë peshën më të vogël janë Objektivi specifik 3.4: *Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm* me 0.16% dhe Objektivi specifik 3.3: *Përfshirja e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë me rol ndërgjegjësuës luftën kundër korrupsionit* me një peshë në koston totale prej 0.11%.



PJESA VI PASAPORTA E TREGUESVE

Treguesit e monitorimit të dokumentit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030

Treguesit e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) do të bazohen në një sërë treguesish kryesorë të performancës, të lidhur me qëllimet e politikës dhe objektivat specifike të Planit të Veprimit, siç janë pasqyruar në këtë dokument.

Progresi i zbatimit të SNKK-së do të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë periodike duke matur këta tregues, të cilët janë vendosur në përputhje me qëllimet dhe objektivat e politikës përkatëse. Gjithashtu, vlerat e synuara (targetet) mund të rishikohen nga Ekipi Tematik për Antikorrupsionin, me qëllim arritjen e tyre në mënyrë më efektive.

Pasaporta e Treguesve të Performancës, e cila përfshin tre qëllimet e politikës së SNKK-së, së bashku me përshkrimin e metodologjisë përkatëse dhe vlerat e synuara, janë paraqitur në Aneksin 2 të bashkëlidhur me këtë dokument.



Aneks 1

PLANI I VEPRIMIT 2024-2026, NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2024-2030									
Qëllimi Politik I: Parandalimi i korrupsionit									
Qëllimi Politik II: Ndëshkimi i korrupsionit									
Qëllimi Politik III: Ndërgjegjësimi dhe edukimi në luftën kundër korrupsionit									
Nr.	Masat në zbatim të Objektivave Specifike	Institucionet përgjegjëse (kryesore + kontributore)	Afati i zbatimit (për vitet e PBA 1-3 të specifikuar në baza 3 mujore; për vitet përtej PBA të specifikuar mundësisht në baza 6 mujore)		Kosto indikative (në lekë) (keto kosto janë totale, përlogaritur sipas formateve të kostimit Formatit Kostimit IPSIS)	Burimi i mbulimit		Hendeku financiar	
			Afati Fillimit	Afati Mbarimit		Buxhet Shteti	Financim i Huaj		
Qëllimi Politik I: Parandalimi i korrupsionit									
Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: 01110 Planifikim, Menaxhim Administrimi i Kuvendit, MD, MF, KMDIDHP, 01150 i DPAK dhe 01610 KSHZ									
					853,516,622.96	813,581,055	15,806,000	(24,129,568)	
	OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1: Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit	Kryesore: KKKK, KSHZ, MD, MF, KM, ML, DPAK, Institucionet zbatuese të SNKK, AMVV, KDIMDP, ASPA	Kontributore: Institucionet zbatuese të SNKK, KDIMDP, ML, Kuvendi, MEPJ, ASPA	2024	2026	20,524,693	16,570,693	2,730,000	-1,224,000
1.1.1	Forcimi i kuadrit ligjor për parandalimin e korrupsionit	KKKK, Kuvendi, KSHZ, MD, MF, KM	ML, Kuvendi, MEPJ	2024	2026	5,325,763	4,305,764	0	-1,020,000
1.1.1.1	Identifikimi i nevojës dhe parashikimi i projektligjeve dhe akteve nënligjore të nevojshme për parandalimin e korrupsionit, bazuar në rekomandimet e dhëna Shqipërisë (raport vlerësimi)	KKKK	Institucionet zbatuese të SNKK	6M2 2024	6M2 2024	1,961,724	1,541,724	0	-420,000
1.1.1.2	Miratimi i ndryshimeve ligjore dhe akteve nënligjore (të parashikuara) për parandalimin e korrupsionit, duke përmendur: - Ligji për Zyrën e Rekuperimit të Aseteve - Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve - Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike, si dhe çdo akt tjetër (ligjor dhe nënligjor) lidhur me fushën antikorrupsion	Ministritë e Linjës	Kuvendi	6M2 2024	6M2 2026	0	0	0	0
1.1.1.3	Kryerja e një analize dhe hartimi i draftit fillestar mbështetur mbi modelet e vendeve të BE të legjislacionit për transparencën e financimit të partive politike, si dhe paraqitja e propozimeve komisioneve të Kuvendit	KSHZ, MD, KM	Kuvendi	6M1 2025	6M1 2026	792,977	792,977	0	0
1.1.1.4	Kryerja e analizës së aderimit të Shqipërisë në "Konventën për luftën kundër korrupsionit të zyrtarëve publikë të huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar"	MD, MF, KM	MEPJ	6M1 2026	6M2 2026	2,571,063	1,971,063	0	-600,000
1.1.2	Përmirësimi i procedurave administrative në përgatitjen dhe miratimin e legjislacionit të parandalimit të korrupsionit	Kuvendi, ML, MD, DPAK	MD, ASPA, ML	2024	2026	7,834,721	6,898,721	840,000	-96,000
1.1.2.1	Metodologji (Manual) për Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në ligje (Corruption Proofing of Legislation), për shërbimet e Kuvendit (miratimi i Manualit)	Kuvendi		6M2 2024	6M2 2025	600,000	0	600,000	0
1.1.2.2	Kryerja e vlerësimit sipas Metodologjisë së hartuar në aktivitetin 1.1.2.1, të ligjeve dhe opinione /analiza të hartuara	Kuvendi		6M2 2024	6M2 2026	1,971,063	1,971,063	0	0
1.1.2.3	Kryerja e procesit të Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion gjatë hartimit të akteve nga strukturat e përfshira në proces (në zbatim të Manualit të Hartimit të Legjislacionit)	Ministritë e Linjës	MD	6M2 2024	6M2 2026	4,927,658	4,927,658	0	0
1.1.2.4	Forcimi i kapaciteteve të stafave teknike të drejtorive juridike dhe të politikave pranë ministrave dhe të shërbimeve të Kuvendit, për procesin e Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion në Legjislacion	MD, Kuvendi	ASPAs	6M2 2025	6M2 2026	336,000	0	240,000	-96,000
1.1.3	Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale teknike për parandalimin e korrupsionit	Institucionet zbatuese të SNKK, KKKK, KDIMDP, AMVV, ASPA, DPAK	Institucionet zbatuese të SNKK, KDIMDP	2024	2026	5,804,846	4,436,846	1,260,000	-108,000
1.1.3.1	Vlerësim i kuadrit institucional dhe organizativ të institucioneve me kompetenca në luftën kundër korrupsionit (raport/analizë vlerësimi)	Institucionet zbatuese të SNKK		6M2 2024	6M1 2025	3,468,878	3,468,878	0	0



1.1.3.2	Identifikimi i nevojave për përmirësimin e burimeve njerëzore, teknike dhe financiare të institucioneve përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit	Institucionet zbatuese të SNKK		6M1 2025	6M1 2025	0	0	0	0
1.1.3.3	Institucionalizimi i Pikave të Kontaktit Antikorrupsion në institucionet publike (nivël qeveritar, të pavarur dhe ligjzbatues), si agjentët e parë të ndryshimit në politikat antikorrupsion	KKKK	Institucionet zbatuese të SNKK	6M2 2024	6M2 2024	0	0	0	0
1.1.3.4	Identifikimi i institucioneve në të gjitha nivelet, ku nuk janë emëruar (mungojnë) koordinatorët antikorrupsion, pikat e kontaktit kundër korrupsionit, koordinatorët e integritetit dhe koordinatorët e së drejtës për informim dhe uniformizimi i procesit t[ë] ca	DPAK KDIMDP AMVV		6M2 2024	6M2 2024	770,862	770,862	0	0
1.1.3.5	Emërimi i koordinatorëve antikorrupsion, të pikave të kontaktit antikorrupsion, të koordinatorëve të integritetit dhe koordinatorëve të së drejtës për informim	Institucionet zbatuese të SNKK	KDIMDP	6M2 2024	6M2 2025	0	0	0	0
1.1.3.6	Udhëzime dhe takime informuese (2 takime/vit) me Pikat e Kontaktit Antikorrupsion mbi analizat antikorrupsion	DPAK	Institucionet zbatuese të SNKK	6M2 2024	6M2 2026	147,830	147,830	0	0
1.1.3.7	Identifikimi i nevojave për trajnime të koordinatorëve antikorrupsion, pikave të kontaktit antikorrupsion, koordinatorëve të integritetit dhe koordinatorëve të së drejtës për informim, bashkëpunim dhe koordinim	ASPA		6M1 2024	6M2 2026	1,309,277	49,277	1,260,000	0
1.1.3.8	Rritje kapacitetshe dhe kualifikim të vazhdueshëm për koordinatorët antikorrupsion, pikave të kontaktit antikorrupsion, koordinatorëve të integritetit dhe koordinatorëve të së drejtës për informim (trajnime dhe sesione informimi të kryera)	ASPA		6M1 2024	6M2 2026	108,000	0	0	-108,000
1.1.4	Forcimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet institucioneve parandaluese kundër korrupsionit	Institucionet zbatuese të SNKK, DPAK		2024	2026	1,559,362	929,362	630,000	0
1.1.4.1	Identifikimi i fushave dhe procedurave për bashkëpunim, koordinim dhe shkëmbim informacioni, ndërmjet të gjitha institucioneve parandaluese të korrupsionit të përmendura në strategji	Institucionet zbatuese të SNKK		6M1 2025	6M2 2025	692,143	62,143	630,000	0
1.1.4.2	Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit (dy-palëshe dhe shumë-palëshe) mes institucioneve me kompetenca parandalimi kundër korrupsionit	Institucionet zbatuese të SNKK		6M2 2024	6M2 2026	0	0	0	0
1.1.4.3	Fuqizim i Ekipit Tematik Antikorrupsion (anëtar të institucioneve zbatuese të SNKK) për koordinimin të informacioneve dhe të dhënave të raportit të monitorimit	DPAK		6M2 2024	6M2 2026	0	0	0	0
1.1.4.4	Takime dhe forume teknike diskutimi të anëtarëve të Ekipit Tematik Antikorrupsion (anëtar të institucioneve zbatuese të SNKK) në pararendje të finalizimit të raporteve dhe të dhënave	DPAK		6M2 2024	6M2 2026	867,220	867,220	0	0
Qëllimi Politik I: Parandalimi i korrupsionit									
Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: 01110 MD dhe ministritë e tjera të linjës, PP, KMSHC, KMDIDHP, ILDKPKI, 1087027 e-Qeverisja, 01330 ASPA, 03310 i KLGJ, 01330 ASPA, 01150 i DPAK dhe 09820 Shkolla e Magjistraturës									
	OBJEKTIVI SPECIFIK 1.2: Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes	Kryesore: ML, MSHSKB, AKSHI, KDIMDP, ASPA, DPAK, ILDKPKI, KM/MSHMP, MAPA (KKKK), MEKI, AMP, DPT, DPD	Kontributore: AKSHI, KDIMDP, ML, ASPA, DPAK, Institucionet zbatuese të SNKK, Akademia e Sigurisë, ILDKPKI, DAP, MD, KLP, KLGJ	2024	2026	778,689,675	769,881,225	3,050,000	(5,758,450)
1.2.1	Forcimi i transparencës së institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes	MD, MSHSKB, AKSHI, KDIMDP, ASPA, DPAK	AKSHI, KDIMDP, ASPA, DPAK	2024	2026	22,443,215	21,843,215	600,000	0
1.2.1.1	Identifikimi i institucioneve që kanë shërbime dhe procedura që janë ende të padigjitalizuara (1); mund të digjitalizohen (2) dhe vijimi i digjitalizimit të tyre (3)	MD MSHSKB	AKSHI	6M2 2024	6M2 2024	2,237,139	2,237,139	0	0
1.2.1.2	Statistika përdorimi të platformës e-Albania për shërbimet publike nga qytaterët mbi baza 6-mujore	AKSHI		6M1 2024	6M2 2026	17,897,112	17,897,112	0	0
1.2.1.3	Instalimi i Regjistrimit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të drejtën e informimit në autoritetet publike përcaktuar sipas vlerësimit të Komisionit për të Drejtën e Informimit, për të gjitha nivelet e qeverisjes	KDIMDP		6M2 2024	6M2 2026	578,146	578,146	0	0
1.2.1.4	Përgatitja dhe publikimi i një Udhëzuesi (Manual) për përdoruesit për të drejtën e informimit (shpjegimi i të drejtave të qytetarëve dhe procedurën për qasje të lirë në informacion)	KDIMDP		6M2 2025	6M2 2025	637,286	37,286	600,000	0
1.2.1.5	Hartimi i një përmbledhjeje të vendimmarrjes së Komisionit për të Drejtën e Informimit për çështje me interes publik dhe rastet e kufizimit të informacionit, konceptet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (vijtohet)	KDIMDP		6M2 2024	6M2 2026	985,532	985,532	0	0
1.2.1.6	Trajnime të vazhdueshme/sesione informimi mbi të drejtën e informimit ndaj organeve të administratës dhe publikut	ASPA KDIMDP		6M2 2024	6M2 2026	108,000	108,000	0	0
1.2.2	Forcimi i llogaridhënies së institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes	ILDKPKI, DPAK, KM/MSHMP, MF, ASPA, Institucionet	Institucionet zbatuese të SNKK, DPAK, ILDKPKI	2024	2026	692,876,345	687,158,345	1,260,000	-4,458,000



		zbatuese të SNKK							
1.2.2.1	Monitorimi i vazhdueshëm i dorëzimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave private për të gjithë subjektet deklarues nëpërmjet sistemit EACIDS	ILDKPKI		6M1 2024	6M2 2026	689,796,000	686,796,000	0	-3,000,000
1.2.2.2	Përmirësimi i metodologjisë së verifikimit dhe kontrollit të plotë të deklaratave të pasurisë dhe interesave private	ILDKPKI		6M1 2025	6M2 2025	2,460,000	0	1,260,000	-1,200,000
1.2.2.3	Ngritja e regjistrave të dhuratave dhe favoreve që u jepen nëpunësve dhe zyrtarëve publikë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (hartimi i një modeli regjistri dhe dërgimi i tij për zbatim tek institucionet)	DPAK	Institucionet zbatuese të SNKK	6M1 2025	6M2 2026	308,345	308,345	0	0
1.2.2.4	Forcimi i rolit të auditimit të brendshëm të institucioneve nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për antikorrupsion (1) dhe aksesit në informacion (2)	MF		6M2 2024	6M2 2026	150,000	0	0	-150,000
1.2.2.5	Kualifikimi i stafit të burimeve njerëzore në forcimin e llogaridhënies institucionale për çështje të etikës, informimi, dhe mekanizmat e antikorrupsionit nëpërmjet trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme	ASPA	DPAK	6M2 2024	6M2 2026	108,000	0	0	-108,000
1.2.2.6	Sesione informimi për konfliktin e interesit dhe deklarin e pasurisë për të gjitha nivelet e qeverisjes dhe nëpunësit që kanë detyrimin ligjor për to	ASPA	ILDKPKI DPAK	6M2 2024	6M2 2026	54,000	54,000	0	0
1.2.3	Forcimi i integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes	DPAK, KKKK		2024	2026	2,078,835	2,078,835	0	0
1.2.3.1	Vlerësimi i detajuar i numrit të institucioneve që kanë përgatitur vlerësimin e risikut të korrupsionit dhe kanë miratuar Plane Integriteti, në të gjitha nivelet e qeverisjes	DPAK		6M2 2024	6M2 2025	770,862	770,862	0	0
1.2.3.2	Përgatitja e ndryshimeve në Kodin Etik Ministror, për plotësimin e rregullave për kuadrin etik dhe të integritetit, lobimin dhe organizimin e tij	KKKK		6M2 2024	6M2 2025	1,307,974	1,307,974	0	0
1.2.4	Përmirësimi i bashkëpunimit midis AMP dhe Policisë Ushtarake, Drejtorisë së Tatimeve dhe struktura të tjera policore me fokus numrin e sanksioneve (masave) të dhëna për zyrtarët e agjencive të zbatimit të ligjit për shpërdorim detyre dhe korrupsion	AMP DPT DPD Policia të tjera	Akademia e Sigurisë	2024	2026	360,000	0	0	-360,000
1.2.4.2	Trajnime të përbashkëta (vjetore) me pjesëmarrës nga AMP, Policia e Shtetit, Policia Ushtarake, Drejtoria e Doganave, Drejtoria e Tatimeve dhe struktura të tjera policore për integritetin dhe informimin në luftën kundër korrupsionit	AMP DPT DPD Policia të tjera	Akademia e Sigurisë	6M2 2024	6M2 2026	360,000	0	0	-360,000
1.2.5	Hartimi i një kuadri të harmonizuar dhe në koherencë me kuadrin ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë dhe funksionarëve politikë (duke reflektuar rekomandimin iii) të Raund V të GRECO për Shqipërinë)	DPAK, MAPA (KKKK), MB, MEK	ILDKPKI DAP, KM, DPAK, ML	2024	2026	59,990,830	58,800,830	1,190,000	0
1.2.5.1	Manual (rulebook) për konfliktin e interesit, etikën dhe parandalimin e korrupsionit për të gjithë funksionarët e administratës publike, në përputhje me kërkesat e rekomandimit iii) të GRECO, i miratuar dhe i informuar	DPAK	ILDKPKI DAP	6M1 2025	6M1 2025	1,190,000	0	1,190,000	0
1.2.5.2	Përcaktimi i rregullave të pas-punësimit për funksionarët politikë (përgatitje për ndryshimin e rregullave)	KKKK		6M2 2024	6M2 2025	192,715	192,715	0	0
1.2.5.3	Përfshirja e informacionit të Manualit për konfliktin e interesit, etikën dhe parandalimin e korrupsionit, në programet e ofruara nga ASPA për funksionarët e administratës publike	ASPA		6M1 2026	6M2 2026	30,000	30,000	0	0
1.2.5.4	Rishikimi i përbërjes së Komisionit të Etikës të Këshillit të Ministrave	MAPA (KKKK)	KM	6M2 2024	6M2 2024	867,220	867,220	0	0
1.2.5.5	Zbatimi i Rekomandimeve të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) si dhe shtimi i përpjekjeve institucionale për zbatimin në kohë të planit përkatës të veprimit (rekomandimet e mbetura për zbatim pas fazës së parë të vlerësimit të vendit)	MAPA (KKKK)	DPAK	6M2 2024	6M2 2024	0	0	0	0
1.2.5.6	Kryerja e analizës mbi kuadrin ligjor për donacionet dhe sponsorizimet në Policinë e Shtetit (raport vlerësimi)	MB		6M1 2025	6M2 2025	1,541,724	1,541,724	0	0
1.2.5.7	Përgatitja e ndërhyrjeve në ligj për donacionet dhe sponsorizimet dhe konsolidimi i një kuadri ligjor	MB	Ministritë e Linjës	6M2 2025	6M2 2026	4,625,171	4,625,171	0	0
1.2.5.8	Ngritja e Këshillave Konfidencialë në Policinë e Shtetit për të ofruar këshillim konfidencial për punonjësit e policisë mbi çështjet e etikës, integritetit, korrupsionit, konfliktit të interesit, konfidencialitetit dhe çështje të tjera të lidhura me to.	MB,PSH	PSH	6M2 2025	6M2 2025	51,544,000	51,544,000	0	0
1.2.6	Module për integritetin dhe parandalimin e korrupsionit të përfshira në programin e trajnimeve të Shkollës së Magistraturës	SHM	KLP; KLGJ	2026	2026	940,450	0	0	-940,450
1.2.6.1	Module trajnimi mbi pamjet e integritetit dhe risqet e korrupsionit, për gjyqtarë dhe prokurorë, të mbështetur tek Manuali për konfliktin e interesit, etikën dhe parandalimin e korrupsionit, hartuar dhe miratuar	SHM	KLP; KLGJ	6M1 2026	6M2 2026	100,000	0	0	-100,000
1.2.6.2	Sesione trajnimi për integritetin, për gjyqtarë, prokurorë dhe ndihmës ligjorë, të kryera	SHM	KLP; KLGJ	6M1 2026	6M2 2026	840,450	0	0	-840,450
Qëllimi i Politikës: Qasja parandaluese									
Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: 01110 KM, 01150 i DPAK, MD dhe ministritë e tjera të linjës, PP, 01330 ASPA, 01140 01150 i MF, 09120, 09230 dhe 09450 MAS									
	OBJEKTIVI SPECIFIK 1.3: Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni)	Kryesore: DPAK ASHK, MSHMS, MAS, MFA, ATRAKO, DPT, DPD, institucionet e varësisë së MAS	Kontributore: ATP Dhoma të Tregtisë dhe Biznesit, DPAK, ASPA, ML, AK, MF, APP	2024	2026	24,166,235	5,785,746	6,396,000	-11,984,489
1.3.1	Parandalimi i korrupsionit në sektorin publik	DPAK		2024	2025	2,268,000	0	2,268,000	0
1.3.1.1	Rishikimi i metodologjisë së Vlerësimit të Risikut të Korrupsionit në Sektorin Publik	DPAK		6M2 2024	6M1 2025	1,008,000	0	1,008,000	0



1.3.1.2	Organizimi i trajnimeve me koordinatorët kundër korrupsionit dhe punonjësit/stafin e DPAK për zbatimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik	DPAK		6M1 2025	6M1 2025	1,260,000	0	1,260,000	0
1.3.2	Parandalimi i korrupsionit në menaxhimin e sektorit të pronave	DPAK, ASHK	ATP, Dhoma të Tregtise dhe Biznesit, DPAK, ASPA	2024	2026	7,175,552	1,971,063	3,120,000	-2,084,489
1.3.2.1	Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e risqeve të korrupsionit mbi baza funksionesh/veprimtarie në fushën e pronave, si seksion i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik	DPAK ASHK	ATP	6M2 2024	6M1 2025	840,000	0	840,000	0
1.3.2.2	Regjistri i riskut të sektorit të pronës, i publikuar dhe informuar, për publikun (vjetore)	ASHK		6M2 2024	6M1 2026	492,766	0	0	-492,766
1.3.2.3	Vlerësim i thelluar i riskut të korrupsionit në fushën e pronave (faktorët e riskut)	DPAK ASHK	ATP	6M1 2025	6M2 2026	1,050,000	0	1,050,000	0
1.3.2.4	Vlerësimi i riskut të integritetit dhe Plani i Integritetit i ASHK, i miratuar dhe i publikuar	ASHK	DPAK	6M2 2024	6M2 2025	1,585,532	985,532	600,000	0
1.3.2.5	Miratimi i një Plani Veprimi për parandalimin e korrupsionit në sektorin e pronave, pas kryerjes së vlerësimit të riskut të korrupsionit, si pjesë përbërëse e Planit të Veprimit të SNKK	ASHK	DPAK	6M1 2025	6M2 2025	1,615,532	985,532	630,000	0
1.3.2.6	Hartimi i programeve të trajnimit të dedikuara për personelin e kadastrës	ASHK	ASPA	6M2 2024	6M2 2026	50,000	0	0	-50,000
1.3.2.7	Raporte (vjetore) për vlerësimin e risqeve të korrupsionit në sektorin e pronës	DPAK ASHK		6M2 2026	6M2 2026	1,541,724	0	0	-1,541,724
1.3.3	Parandalimi i korrupsionit në sistemin shëndetësor dhe kujdesit social	MSHMS, DPAK, institucionet në varësi të MSHMS	Institucionet në varësi të MSHMS, DPAK, ASPA	2024	2026	3,191,724	1,541,724	0	-1,650,000
1.3.3.1	Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e risqeve të korrupsionit mbi baza funksionesh/veprimtarie në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, si seksion i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik	MSHMS DPAK	Autoritetet në varësi të MSHMS	6M2 2025	6M1 2026	600,000	0	0	-600,000
1.3.3.2	Vlerësim i thelluar i riskut të korrupsionit në shërbimet shëndetësore dhe mbrojtjen sociale (faktorët e riskut)	MSHMS DPAK	Autoritetet në varësi të MSHMS	6M1 2026	6M2 2026	1,050,000	0	0	-1,050,000
1.3.3.3	Miratimi i një Plani Veprimi për parandalimin e korrupsionit në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, si pjesë përbërëse e Planit të Veprimit të SNKK	MSHMS Autoritetet në varësi të MSHMS	DPAK	6M1 2026	6M2 2026	0	0	0	0
1.3.3.4	Raporte (vjetore) për vlerësimin e risqeve të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë	MSHMS DPAK		6M2 2026	6M2 2026	1,541,724	1,541,724	0	0
1.3.4	Parandalimi i korrupsionit në fushën e arsimit	MAS, DPAK, Institucionet në varësi të MAS	MAS, DPAK, ASPA, OSHC	2024	2026	2,271,428	621,428	0	-1,650,000
1.3.4.1	Hartimi i metodologjisë të vlerësimit të riskut të korrupsionit për funksionimin e sistemit arsimor, si seksion i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik	MAS DPA		6M2 2025	6M2 2025	600,000	0	0	-600,000
1.3.4.2	Vlerësim i thelluar i riskut të korrupsionit në sistemin arsimor (faktorët e riskut)	MAS DPA	Autoritetet në varësi të MAS	6M1 2026	6M1 2026	1,050,000	0	0	-1,050,000
1.3.4.3	Miratimi i një Plani Veprimi për parandalimin e korrupsionit në arsim si pjesë përbërëse e Planit të Veprimit të SNKK	MAS Autoritetet në varësi të MAS	DPAK	6M1 2026	6M1 2026	0	0	0	0
1.3.4.4	Vlerësim i kurrikulës arsimore për rishikimin e programit për përfshirjen e tematikave antikorruptsi	MAS DPAK		6M1 2024	6M2 2025	621,428	621,428	0	0
1.3.5	Parandalimi i korrupsionit në fushën e prokurimeve publike	DPAK, APP	AK, MF, DPAK, ASPA	2024	2026	2,724,000	666,000	1,008,000	-1,050,000
1.3.5.1	Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimeve publike	DPAK APP		6M1 2024	6M2 2024	600,000	600,000	0	0
1.3.5.2	Vlerësim i riskut të korrupsionit për fushën e prokurimeve publike (faktorët e riskut)	DPAK APP	AK MF	6M2 2024	6M1 2025	1,050,000	0	0	-1,050,000
1.3.5.3	Hartimi dhe miratimi i një Plani Veprimi për parandalimin e korrupsionit në sektorin e prokurimit publik, si pjesë përbërëse e Planit të Veprimit të SNKK	APP	DPAK	6M1 2025	6M2 2025	1,008,000	0	1,008,000	0
1.3.5.4	Përfshirja në kurrikulën e trajnimit të një moduli për integritetin në prokurimin publik si dhe zhvillimi i programeve të trajnimeve për administratën publike ku të adresohen çështjet e integritetit në prokurimet publike	APP	ASPA	6M1 2025	6M1 2026	66,000	66,000	0	0
1.3.5.5	Marrëveshje Bashkëpunimi në luftën kundër korrupsionit në administratën publike në fushën e prokurimeve publike (nënshkruar marrëveshje) midis DPAK dhe APP	APP DPAK		6M2 2024	6M2 2024	0	0	0	0
1.3.6	Parandalimi i korrupsionit në fushën e partneritetit publik - privat	MF, DPAK, ATRAKO	APP, DPAK, ASPA, institucionet zbatuese të SNKK	2025	2026	2,635,532	985,532	0	-1,650,000
1.3.6.1	Hartimi i metodologjisë së vlerësimit të riskut të korrupsionit për çështjet dhe sektorët ku aplikohet partneriteti publik-privat	MF DPAK ATRAKO	APP	6M2 2025	6M2 2025	600,000	0	0	-600,000
1.3.6.2	Vlerësimi i thelluar i riskut të korrupsionit, mbi partneritetin publik-privat (faktorët e riskut)	MF ATRAKO DPAK	APP	6M1 2026	6M1 2026	1,050,000	0	0	-1,050,000



1.3.6.3	Miratimi i një Plani Veprimi për parandalimin e korrupsionit në fushën e partneritetit publik-privat, si pjesë përbërëse e Planit të Veprimit të SNKK	MF ATRAKO	DPAK	6M1 2025	6M2 2025	0	0	0	0
1.3.6.4	Raporte (vjetore) për vlerësimin e risqeve të korrupsionit në fushën e partneritetit publik-privat	MF ATRAKO DPAK		6M2 2026	6M2 2026	985,532	985,532	0	0
1.3.7	Parandalimi i korrupsionit për administratën tatimore	MF, DPT, DPAK	DPAK, ASPA	2024	2026	1,650,000	0	0	-1,650,000
1.3.7.1	Hartimi i metodologjisë së vlerësimit të riskut të korrupsionit në sektorin e tatimeve, si seksion më vehte i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik	MF DPT DPAK		6M2 2025	6M2 2025	600,000	0	0	-600,000
1.3.7.2	Vlerësim i thelluar i riskut të korrupsionit, për fushën dhe veprimtarinë e organeve tatimore	MF DPT DPAK		6M1 2026	6M2 2026	1,050,000	0	0	-1,050,000
1.3.7.3	Miratimi i një Plani Veprimi për parandalimin e korrupsionit në administratën tatimore, si pjesë përbërëse e Planit të Veprimit të SNKK	MF DPT	DPAK	6M1 2025	6M2 2025	0	0	0	0
1.3.8	Parandalimi i korrupsionit në sistemin e doganave	MF, DPD, DPAK	DPAK, ASPA	2024	2026	1,650,000	0	0	-1,650,000
1.3.8.1	Hartim i metodologjisë së vlerësimit të riskut të korrupsionit në sektorin e doganave, si seksion i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik	MF DPD DPAK		6M2 2025	6M1 2026	600,000	0	0	-600,000
1.3.8.2	Vlerësim i thelluar i riskut të korrupsionit, për fushën dhe veprimtarinë doganore (faktorët e riskut)	MF DPT DPAK		6M1 2026	6M2 2026	1,050,000	0	0	-1,050,000
1.3.8.3	Miratimi i një Plani Veprimi për parandalimin e korrupsionit në administratën doganore, si pjesë përbërëse e Planit të Veprimit të SNKK	MF DPT	DPAK	6M2 2025	6M2 2025	0	0	0	0
1.3.9	Parandalimi i korrupsionit në sektorë të tjerë publikë, të ndjeshëm për ekonominë dhe publikun	DPAK	ML	6M2 2026	6M2 2026	600,000	0	0	-600,000
1.3.9.1	Vlerësimi i ndërhyrjeve për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk korrupsioni (prevalencë të lartë korrupsioni) jashtë atyre të identifikuar në Planin e Veprimit 2024-2026	DPAK		6M2 2026	6M2 2026	600,000	0	0	-600,000
Qëllimi i Politikës: Qasja parandaluese									
Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: 01150 i AMVV, 01150 i DPAK dhe 01110 i NJQV									
	OBJEKTIVI SPECIFIK 1.4:Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore	Kryesore: AMVV, Qarqet, Bashkitë, DPAK	Kontributore: DPAK ASPA, AMVV, KDIMDP	2025	2026	8,939,830	7,547,830	1,200,000	-192,000
1.4.1	Identifikimi i mënyrave për të përmirësuar parandalimin e korrupsionit në njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	AMVV, DPAK	DPAK	2025	2026	1,396,714	196,715	1,200,000	0
1.4.1.1	Vlerësim për zbatimin e instrumenteve në parandalimin e korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore dhe në administratat e qarqeve (raport vlerësimi)	AMVV	DPAK	6M1 2025	6M2 2025	612,429	12,429	600,000	0
1.4.1.2	Raport vlerësimi për identifikimin e njësjve të vetëqeverisjes vendore që nuk kanë ende plane integriteti	AMVV	DPAK	6M1 2025	6M2 2025	124,286	124,286	0	0
1.4.1.3	Përgatitja e Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Korrupsionit dhe Planit model të Integritetit për qarqet dhe bashkitë	DPAK AMVV		6M2 2025	6M2 2025	600,000	0	600,000	0
1.4.1.4	Konsultime dhe sesione informimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për hartimin dhe miratimin e planeve të integritetit	AMVV	DPAK	6M1 2026	6M1 2026	60,000	60,000	0	0
1.4.2	Fuqizimi i mekanizmave për parandalimin efektiv të korrupsionit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	AMVV, Qarqet, Bashkitë, DPAK	DPAK, KDIMDP	2025	2026	120,000	0	0	-120,000
1.4.2.1	Tryezë vjetore ndërgjegjësimi për angazhimin e njësjve të vetëqeverisjes vendore në parandalimin e korrupsionit në ushtrimin e detyrave publike	DPAK	AMVV	6M1 2025	6M1 2026	120,000	0	0	-120,000
1.4.2.2	Identifikimi i qarqeve dhe bashkive ku nuk janë caktuar pika kontakti për integritetin dhe kundër korrupsionit	AMVV	DPAK	6M1 2025	6M2 2025	0	0	0	0
1.4.2.3	Caktimi i pikave të kontaktit për integritetin dhe kundër korrupsionit, dhe koordinatore të së drejtës për informim në qarqet dhe bashkitë ku ato nuk ekzistojnë	Qarqet Bashkitë	KDIMDP DPAK	6M2 2025	6M2 2025	0	0	0	0
1.4.2.4	Marëveshje bashkëpunimi mes DPAK dhe AMVV për bashkërendimin dhe koordinimin e punës në drejtim të zbatimit të masave kundër korrupsionit	DPAK AMVV		6M2 2025	6M1 2026	0	0	0	0
1.4.3	Zbatimi i mekanizmave parandalues të përshtatur me specifikat e Vetëqeverisjes Vendore	Qarqet, Bashkitë, AMVV	DPAK ASPA, AMVV, KDIMDP	2024	2026	7,423,116	7,351,116	0	-72,000
1.4.3.1	Vlerësimi i nevojave për trajnime për zbatimin e masave antikorruption dhe përgatitja e kurrikulave për trajnime	AMVV		6M2 2025	6M2 2026	5,426,830	5,426,830	0	0
1.4.3.2	Aktivitetet informuese me fokus parandalimin e mekanizmave antikorruption, në qarqe dhe bashki	Qarqet Bashkitë	DPAK	6M2 2025	6M2 2026	124,286	124,286	0	0



1.4.3.3	Organizimi i trajnimeve për zbatimin e masave dhe aktiviteteve parandaluese antikorruption në qarqe dhe bashki (trajnime periodike e të vazhdueshme)	AMVV	ASPA DPAK	6M2 2025	6M2 2026	72,000	0	0	-72,000
22. Vlera bazë aktuale:	Për tu caktuar gjatë Vlerësimit	
23. SDG - Titulli i Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas OKB-së	Objektivi 16	



24. Vlera e synuar e treguesit SDG	16.5 Reduktim i ndjeshëm i korrupsionit dhe të gjitha formave të rryshfetit	
------------------------------------	---	--

Objektivi Specifik 3.4: Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm

Tregues 3.4.1		
1. Titulli i Treguesit	3.4.1 Raporti i numrit i projekteve kundër korrupsionit me orientim gjinor në krahasim me numrin tyre në tre vitet e fundit	
2. Lloji i treguesit	Rezultati	
3. Titulli i Dokumentit Nr...Datë....	VKM e miratimit të SNKK 2024-2030 dhe PV 2024-2026	
4. Lidhja me SKZHI-në (Shtylla Nr...)	Shtylla 1: Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë	
5. Objektivi/Objektivi Strategjik në SKZHI	Transparenca dhe lufta kundër korrupsionit	
6. Qëllimi i politikës përkatëse	Parandalimi i korrupsionit	
7. Objektivi specifik me të cilin lidhet treguesi	Rritja e besimit të publikut të gjerë në luftën kundër korrupsionit	
8. Burimi i Treguesit (Përkatësia e Treguesit)	Kuadri i Politikave	
9. Lidhja me Acquis Communautaire	-	
10. Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Programi antikorrupsion i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe specifikisht pjesë të programeve për përfshirjen e grave dhe vajzave (të drejtat e vajzave dhe grave)	
11. Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave	Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit përgjegjëse për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave	
12. Përshkrimi i Metodologjisë	Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile për mbledhjen, sigurimin e informacionit dhe dërgimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit	
	Qëllimi i këtij treguesi është të masë nivelin e përmirësimit të përfshirjes së numrit të grave dhe vajzave në parandalimin e korrupsionit duke krahasuar numrin e projekteve me orientim gjinor në raportimin e korrupsionit kundrejt numrit të projekteve në tre vitet e fundit.	
	Për këtë qëllim, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, do të përgatisin analizë të detajuar mbi numrin e projekteve me orientim gjinor për projekte me fokus parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit të kryera gjatë tre viteve të fundit, e cila do të jetë niveli bazë (<i>baseline</i>) në matjen e zbatimit të këtij treguesi.	
	Analiza gjithashtu do të mundësojë informacione dhe të dhëna mbi aktivitetet e kryera më parë sikurse përmenden projektet që identifikojnë incentivat për gratë dhe vajzat e angazhuara në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si një informacion i vlefshëm për aktivitetet në vijim.	
	Mënyra e matjes së këtij treguesi do të jetë, <i>Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit</i> dhe <i>Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile</i> : -Do të mbledhin informacion konkret dhe relevant për numrin e projekteve kundër korrupsionit me orientim gjinor, subjektet e tyre të zbatimit dhe rezultatet e arritura gjatë periudhës së raportimit; -Do të logarisin përgjindjen e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore përgjatë zbatimit të SNKK 2024-2030 (kumulative), sipas formulës së dhënë.	
13. Frekuenca e matjes		
14. Natyra e treguesit: Kumulative/ Rritëse	Rritëse	
15. Input: Direkt ose i përbërë		
16. Formula e Llogaritjes	Formula për llogaritjen e periudhës së raportimit: (periudha 6-mujore)	
	Numri i projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore në periudhën e raportimit / numrit të projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore kryer në periudhën e mëparshme X 100	
	Formula për llogaritjen përgjatë zbatimit të SNKK 2024-2030: (periudha vjetore)	
17. Zbërthimi i të dhënave (për treguesit e përbërë)	Mesatarja e numrit të projekteve kundër korrupsionit me orientim gjinor gjatë zbatimit të SNKK 2024-2030 / mesatarja e numrit të projekteve kundër korrupsionit me orientim gjinor gjatë tre viteve të fundit para zbatimit të SNKK 2024-2030 X 100	
18. Përshkrimi i trendit të progresit	Në rritje	
19. Vlera bazë (Baseline)		
20. Vlera e synuar	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes	2024
	5% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore	2025
	10% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)	2026
	15% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)	2027
	20% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)	2028
	25% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)	2029
	30% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)	2030
21. Vlera e synuar/ Synimi i rishikuar	5% rritje vjetore rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)	
22. Vlera bazë aktuale:	Për tu caktuar gjatë Vlerësimit	
23. SDG - Titulli i Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas OKB-së	Objektivi 16	



24. Vlera e synuar e treguesit

16.5 Reduktim i ndjeshëm i korrupsionit dhe të gjitha formave të rryshfetit

**VENDIM****Nr. 279, datë 30.12.2024****MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN
2025–2027**

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa “c”, pika “i”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15 dhe nenit 22, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017, si dhe vendimit të Bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018, “Për miratimin e sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal të energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.12.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1859/25 prot., datë 16.12.2024, të për gatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025–2027”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 192, datë 18.9.2024, vendosi për: “Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OST” sh.a., për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025–2027”.

- ERE gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit, në kuadër të nevojës për sqarime të mëtejshme, në lidhje me çështjet e evidentuara në aplikim, i ka dërguar shoqërisë “OST” sh.a. kërkesat për informacion me nr. 1859/2 prot., datë 20.9.2024, si dhe nr. 1859/12 prot., datë 20.11.2024, në përgjigje të së cilave “OST” sh.a. ka përcjellë korrespondencat me nr. 6004/2 prot., datë

7.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 9.10.2024, dhe nr. 6004/7 prot., datë 2.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/19 prot., datë 3.12.2024.

- Më datë 28.10.2024, u zhvillua seanca teknike ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s dhe të shoqërisë “OST” sh.a., lidhur me informacionin, argumentet dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria në aplikim.

- Në përputhje me pikën 7, të nenit 22, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, ERE zhvilloi më datë 6.12.2024, seancën zyrtare publike me përfaqësues nga shoqëria “OST” sh.a., si dhe me palët e interesit, lidhur me aplikimin për përcaktimin e tarifës së transmetimit për periudhën rregullatore 2025–2027.

- Në zbatim të afateve të përcaktuara në “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, është kryer publikimi në faqen elektronike të ERE-s, www.ere.gov.al, i aplikimit, çdo korrespondence të depozituar nga shoqëria “OST” sh.a., si dhe i komenteve të kryera nga palët e interesit.

- Shoqëria “OST” sh.a. ka depozituar parashikimin e saj, lidhur me kërkesën për energji për periudhën rregullatore 2025–2027, mbështetur në mesataren historike të energjisë të transmetuar nga “OST” sh.a., për konsum, si dhe gradientin në rritje të kërkesës për energji prej 0.29 %.

- “OST” sh.a., me shkresën nr. 1859/19 prot., datë 3.12.2024, “OST” sh.a. deklaroi se në vlerësimin e kryer, në lidhje me konsumin në rënie për vitin 2026 dhe 2027, është marrë në konsideratë integrimi i parqeve fotovoltaike që pritet të futen në operim, si dhe “Vetëprodhues-it” që prodhojnë energji elektrike, e cila konsumohet kryesisht në rrjetin shpërndarës.

- Kostoja e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit për periudhën 2025–2027, i janë referuar çmimeve të publikuara për secilën periudhë respektive në HUDEX, i cili bë kushtet ku Bursa Shqiptare e Energjisë nuk ofron ende produkte derivative, konsiderohet si një ndër tregjet më përfaqësuese të rajonit.

- Vlera e shpenzimeve ndihmëse për periudhën e ardhshme rregullatore është përlogaritur duke u bazuar në koston mesatare të realizimit për vitet 202



2023, si dhe në koston e pritshme për mbylljen e vitit 2024.

- Baza e Rregulluar e Aseteve dhe Amortizimi i akumuluar është vlerësuar në të ardhurat e kërkuara sipas koston historike të deklaruar nga “OST” sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 247, datë 18.11.2024, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e planit të investimeve të shoqërisë “OST” sh.a. për periudhën rregullatore 2025–2027. Në rrethanat, ku procedura për miratimin e “Planit të investimeve për periudhën rregullatore 2025–2027” gjendet ende në proces, u konsiderua se investimet të cilat mund të pranohen në bazën e rregulluar të asetëve për periudhën 2025–2027 të ishin vlerat e paraqitura në dokumentin e sipërcituar, për të cilin ERE pritet të dalë me një vendim.

- Në zbatim të nenit 7, pika 4.2.6. të “Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të transmetimit”, në rast se “Plani i investimeve për periudhën rregullatore 2025–2027”, i miratuar nga ERE, do të ketë ndryshime nga sa propozuar nga shoqëria “OST” sh.a., ERE do të konsiderojë rishikimin e CAPEX-it lidhur me investimet që priten të realizohen nga “OST” sh.a., në periudhën pasardhëse.

- Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit të shoqërisë “OST” sh.a. për periudhën 2025–2027 është përllogaritur në nivelin 2.46%.

- Nga shqyrtimi i të dhënave të aplikimit, si dhe pasqyrave financiare të shoqërisë, u konstatua se gjatë periudhës 2022–2023, si dhe tetëmujorit të mbyllur të vitit 2024 “OST” sh.a. ka realizuar të ardhura nga tregu i balancimit.

- Shoqëria ka deklaruar në korrespondencat e saj gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit se: “Bazuar në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit, neni 12.3, përkatësisht pika 3.5, “Komponenti Nxitës”, parashikohet korrektimit i çmimeve të disbalancave nëpërmjet një komponenti nxitës, për të cilën “OST” ka hartuar një procedurë dhe ju është bërë me dije palëve që operojnë tregun...”, procedurë për të cilën duhet të bëjë me dije dhe ERE.

- “OST” sh.a. duhet të hartojë dhe zbatojë një mekanizëm për shpërndarjen e këtyre të ardhurave, në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese për të gjithë përdoruesit e rrjetit, si dhe duhet të korrektojë komponentin nxitës, me qëllim garantimin e neutralitetit të saj financiar të rregulluar, lidhur me shërbimet e balancimit në përpunje me Rregullat e

Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, të Bordit të ERE-s, dhe të bëjë me dije ERE-n mbi masat e marra për zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi.

- Të ardhurat e realizuara në periudhën 2022–2024 nga alokimi i kapaciteteve, si dhe ato të parashikuara për periudhën 2025–2027, sipas vlerësimeve të ERE-s, janë konsideruar si të zbritshme nga të ardhurat e kërkuara.

- Tarifat e transmetimit të energjisë elektrike për çdo vit të periudhës rregullatore 2025–2027 rezultojnë: a) 0.82 lekë/kwh për vitin 2025; b) 0.86 lekë/kwh për vitin 2026; c) 0.88 lekë/kwh për vitin 2027.

- Nga sa më sipër, tarifa e transmetimit për periudhën rregullatore 2025–2027, rezulton 0.85 lekë/kwh.

- ERE do të rishikojë të ardhurat e kërkuara përgjatë periudhës rregullatore, në përpunje me përcaktimet e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën rregullatore 1 janar 2025–31 dhjetor 2027, prej 0.85 lekë/kwh.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 288, datë 23.12.2024****MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT
TË BORDIT TË ERE-s NR. 73,
DATË 13.4.2022**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, gerrat “c”, pika “i”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar me VKM-në nr. 46, datë 31.1.2024; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2575/2 prot., datë 23.12.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi lënie në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 365, datë 15.12.2023, vendosi të shtyjë fuqinë juridike të vendimit nr. 73, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi të ri, bazuar në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2024, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në konstatimet e vendimit nr. 365/2024, shoqëria OSSH sh.a. u ngarkua të përcjellë në ERE kostot dhe të ardhurat faktike të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të sigurojë përmbushjen e kërkesave dhe dispozitave të akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi.

- Gjatë vitit 2024, ERE shqyrtoi raportet periodike teknike të përcjella nga OSSH sh.a. dhe, pas mbylljes së gjashtëmujorit të parë, i kërkoi kësaj të fundit, me shkresën nr. 1660 prot., datë 19.7.2024, dërgimin e pasqyrave financiare operative për periudhën janar – qershor 2024, pritshmëritë për treguesit ekonomiko-financiarë të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2024 të detajuara në mënyrë analitike për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe pasqyrat

financiare të audituara për vitet 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me shënimet shpjeguese.

- Në përgjigje të kërkesave të ERE-s, OSSH sh.a., me shkresën nr. 8195/1 prot., datë 30.7.2024 (protokolluar në ERE me nr. 1660/1, datë 31.7.2024), depozitoi pasqyrën e performancës për periudhën janar–qershor 2024 dhe pritshmëritë për treguesit e realizimit për vitin 2024. Sa u përket pasqyrave financiare të audituara për vitet 2021–2023, shoqëria njoftoi se, për shkak të vonesave në rivlerësimin e aseteve në vitin 2020 dhe raportimit të tyre në 2021, auditimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare për këtë periudhë është ende në proces dhe do të dërgohen sapo të përfundojnë.

- ERE, me shkresën nr. 1945 prot., datë 19.9.2024, i kërkoi shoqërisë OSSH sh.a. dorëzimin e të dhënave dhe dokumentacionit të nevojshëm për aktivitetin si operator i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Kërkesat përfshinin parashikimet për treguesit ekonomikë dhe financiarë për vitin 2025 me detajimin analitik të të ardhurave dhe shpenzimeve, sasinë e energjisë së parashikuar për pjesën e mbetur të vitit 2024 dhe për vitin pasardhës, përllogaritjet e pritshmërive për sasinë dhe nivelin e humbjeve të energjisë sipas burimit për periudhën e mbetur të vitit 2024 dhe për vitin 2025, si dhe kostot e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve për periudhën janar–gusht 2024, duke përfshirë pritshmëritë për vazhdimësinë, si dhe evidence mbi investimet e realizuara dhe të kapitalizuara për periudhën 2021–2023, si dhe parashikimi i investimeve që priten të realizohen dhe kapitalizohen në vitin 2025.

- Me shkresën nr. 1859/3 prot., datë 20.9.2024, ERE njoftoi palët e interesit, përfshirë OSSH sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE nr. 192, datë 18.9.2024, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të aplikimit të OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për periudhën rregullatore 2025–2027.

- OSSH sh.a. me shkresën nr. 10381/1, datë 3.10.2024, protokolluar nga ERE me nr. 1945/1, datë 8.10.2024, njoftoi se planifikimi i treguesve tekniko-ekonomik dhe financiar për vitin 2025 është ende në proces. Shoqëria deklaroi se nivelet e humbjeve për vitet 2024 dhe 2025 janë në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 253, datë 24.4.2019, të ndryshuar, dhe dorëzoi një evidencë të kostove për prokurimin e humbjeve të pritshme për tremujorin e fundit të vitit 2024. Bashkëlidhur



shkresës së sipërcituar, janë përfshirë edhe evidenca mbi investimet e realizuara gjatë periudhës 2021–2023 dhe 9-mujorit të vitit 2024, si dhe pritshmëritë deri në fund të vitit 2024.

- Me shkresën nr. 2575 prot., datë 17.12.2024, ERE, për vlerësimin e tarifave të shpërndarjes dhe në mungesë të një aplikimi sipas legjislacionit në fuqi, i kërkoi OSSH sh.a. të paraqesë parashikimet për treguesit ekonomikë dhe financiarë për vitin 2025, të ardhurat dhe shpenzimet në formë analitike, nivelin e humbjeve të energjisë elektrike dhe kostot për mbulimin e tyre, si dhe sasinë e energjisë së parashikuar për shpërndarje për vitin 2025, të detajuara sipas niveleve të tensionit.

- Në përgjigje, OSSH sh.a., me shkresën nr. 1038/4 prot., datë 20.12.2024, ka përcjellë informacion mbi treguesit ekonomikë dhe financiarë të parashikuar për vitin 2025, sasinë e energjisë së livruar dhe humbjet e pritshme për vitin 2025. Shoqëria njoftoi gjithashtu se plani financiar për vitin 2025 është ende në proces aprovimi.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga OSSH sh.a. me shkresat nr. 13174/1 prot., datë 19.1.2024, nr. 8195/1 prot., datë 30.7.2024, dhe nr. 1038/4 prot., datë 20.12.2024, rezulton se pasqyrat financiare paraprake për vitet 2022, 2023, realizimi i gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 dhe pritshmëritë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024, përmbajnë vetëm llogaritë sintetike, pa detaje analitike për secilin zë. Raportimet financiare nuk janë shoqëruar me shpjegime për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Për vitin 2025, të dhënat e paraqitura janë paraprake, pasi plani financiar i këtij viti është ende në proces aprovimi. Në përgjithësi, zërat janë paraqitur më të detajuar, por pa përfshirë llogaritë analitike.

- OSSH sh.a., në përgjigje të kërkesave të ERE me shkresat nr. 2131 prot., datë 23.12.2022, dhe nr. 2524 prot., datë 15.12.2023, njoftoi se pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2022 janë ende në proces. Megjithatë, me shkresat nr. 19/1 prot., datë 30.1.2023, dhe nr. 13174/1 prot., datë 19.1.2024, dorëzoi evidenca sintetike paraprake mbi të ardhurat dhe shpenzimet, të cilat përmbanin mospërputhje, duke pamundësuar vlerësimin e saktë të të ardhurave faktike, sipas “Metodologjisë së përlllogaritjes së tarifave”, të miratuar me vendimin nr. 182, datë 10.11.2017, të Bordit të ERE-s.

- OSSH sh.a. duhet të miratojë dhe dorëzojë pasqyrat financiare të audituara për periudhat e

mbyllura ushtrimore, së bashku me aplikimin për tarifat e shpërndarjes, në përputhje me “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimi e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, dhe “Metodologjinë për përlllogaritjen e tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017. Pavarësisht se pasqyrat për periudhat 2021–2023 janë paraprake, bazuar në to dhe parashikimet për vitin 2025, të përcjella me shkresën nr. 1038/4 prot., datë 20.12.2024, ERE vlerësoi mjaftueshmërinë e të ardhurave për vitin 2025. Vlerësimi analizoi nëse të ardhurat nga tarifa aktuale mbulojnë kostot e parashikuara, duke garantuar ofrimin e shërbimit të shpërndarjes sipas detyrimeve ligjore.

- Nga analiza e treguesve tekniko-ekonomikë të pasqyrave paraprake për periudhat e kaluara dhe parashikimit për vitin 2025, rezulton se OSSH sh.a. ka një nivel të qëndrueshëm të realizimit të të ardhurave për vitet 2023, 2024 dhe 2025, krahasuar me sasinë faktike të energjisë së shpërndarë. Pasqyrat paraprake tregojnë se të ardhurat kanë mbuluar shpenzimet operationale, duke përmirësuar gjendjen e kapitalit negativ. Në këto rrethana, tarifat aktuale pritët të mbulojnë kostot e aktivitetit edhe për vitin 2025.

- Shpenzimet operative dhe kapitale të OSSH sh.a. do të rëvlerësohen bazuar në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të dhënat faktike ekonomike për periudhat përkatëse, në përputhje me legjislacionin. Për vitin 2025, për të siguruar vijimin e aktivitetit të licencuar, është e domosdoshme që faturimi të vazhdojë mbi bazën e tarifave të miratuara nga ERE. Megjithatë, OSSH sh.a. duhet të marrë masa për dorëzimin në ERE të shpenzimeve dhe të ardhurave faktike për periudhën 2022–2024 dhe të plotësojë kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

- Bazuar në nenin 12 të VKM-së nr. 456, të ndryshuar, OSSH sh.a. ka siguruar mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike përmes blerjeve nga FTL sh.a., e cila tregon energjinë me çmimet e blerjes nga prodhuesit me përparësi. Përfundimi i kontratave të blerjes mes FTL sh.a. dhe prodhuesve me përparësi, por dhe dalja e prodhuesve në tregun e lirë me kërkesën e tyre sipas parashikimeve të kontratës tip të miratuar nga ERE përpara përfundimit të kontratave në fjalë, mund të ekspozojë OSSH sh.a. ndaj çmimeve të tregut të lirë



për prokurimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes. Gjithashtu, rritja e numrit të konsumatorëve të lidhur në TM që dalin në treg të lirë mund të krijojë kosto të tjera të paparashikuara për shoqërinë, sa u takon investimeve në matëse inteligjente dhe shërbime digjitale në shërbim të konsumatorëve.

- Sipas nenit 20 të ligjit nr. 43/2015, në rastet e vonesave në ndryshimin e tarifave, ERE miraton tarifa të përkohshme dhe, nëse këto dallojnë nga tarifat përfundimtare, vendos masa kompensuese.

- Meqenëse aktiviteti financiar i shoqërisë ka rezultat pozitiv, OSSH sh.a. mund të përdorë këtë diferencë për të mbuluar kostot e paparashikuara për humbjet e rrjetit të shpërndarjes në vitin 2025, për investime të domosdoshme dhe për të rikuperuar kapitalin negativ të akumuluar. Në përputhje me metodologjinë e miratuar me vendimin nr. 182, datë 10.11.2017, ERE do të vendosë masa kompensuese në rastet kur tarifat e miratuara ndryshojnë nga ato të përkohshme, siç është vepruar edhe në procedurat e mëparshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi të ri bazuar në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2025, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Nëse do të rezultojnë efekte mbi të ardhurat e shoqërisë OSSH sh.a., ato do të përditësohen dhe do të kompensohen në përputhje me përcaktimet e nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe metodologjinë përkatëse të miratuar nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 298, datë 30.12.2024

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMEVE TË BORDIT TË ERE-s NR. 74, DATË 13.4.2022 DHE NR. 72, DATË 15.4.2024

Në mbështetje të neneve 16, 83 dhe 85 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; neneve 15, dhe 22 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2549/3 prot., datë 30.12.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi lënien në fuqi të vendimeve të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022 dhe nr. 72 datë 15.4.2024”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 74, datë 13.4.2022, ka vendosur se çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022 mbeten ato të miratuara më herët me vendimin nr. 252, datë 21.12.2021. Gjithashtu, klientët që kanë plotësuar kushtet ligjore dhe/ose teknike për daljen në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike nuk u nënshtrohen dispozitave të pikës 1 të vendimit nr. 74/2022.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 366, datë 15.12.2023, vendosi të zgjasë fuqinë juridike të



vendimit nr. 74, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi të ri, bazuar në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2024, për çmimet me pakicë për klientët fundorë të shërbyer nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ndërsa, me vendimin nr. 72, datë 15.4.2024, Bordi i ERE-s miratoi çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët e kategorisë “Furra buke/prodhim mielli” të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV.

- ERE i është drejtuar shoqërisë FSHU sh.a. me shkresën nr. 1660 prot., datë 19.7.2024, duke kërkuar dorëzimin e të dhënave mbi pasqyrat financiare operative për periudhën janar–qershor 2024, si dhe pritshmëritë për realizimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024. Në të njëjtën shkresë, ERE ka rikujtuar, gjithashtu, detyrimin për dorëzimin e pasqyrave financiare të audituara për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

- FSHU sh.a., në përgjigje të shkresës së ERE-së nr. 1660 prot., datë 19.7.2024, ka dërguar shkresën nr. 4912/1 prot., datë 29.7.2024, e cila është protokolluar në ERE me nr. 1660/1 prot., datë 31.7.2024. Në këtë shkresë, FSHU sh.a. ka përcjellë pasqyrat e performancës për periudhën janar–qershor 2024 dhe parashikimet për vitin 2024, duke informuar se pasqyrat financiare të audituara për vitet 2021–2023 janë ende në proces dhe do të dorëzohen sapo të jenë përfunduar.

- Më pas, ERE, me shkresën nr. 1946 prot., datë 19.9.2024, i është drejtuar sërish FSHU sh.a., duke kërkuar informacion mbi parashikimet për treguesit ekonomikë dhe financiarë që pritet të realizohen për vitin 2025, si dhe parashikimin analitik të të ardhurave dhe shpenzimeve, të mbështetur mbi të dhënat historike. Gjithashtu, është kërkuar analiza e tregut të energjisë elektrike dhe trendet e zhvillimit të kësaj industrie, informacion mbi numrin e klientëve të furnizuar në kushtet e mundësisë së fundit për periudhën janar–gusht 2024 dhe për pjesën e mbetur të vitit, si dhe bilancin energjetik me evidencë të sasisë së energjisë së shitur ndaj klientëve, të ndarë nga FSHU sh.a.

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, FSHU sh.a., me korrespondencën nr. 6054/1 prot., datë 30.9.2024 (protokolluar në ERE me nr. 1946/1, datë 4.10.2024), ka përcjellë llogaritjen e performancës financiare për periudhën janar–gusht 2024 dhe parashikimin për vitin 2024. Gjithashtu, ka raportuar mbi numrin e klientëve të furnizuar në kushtet e

mundësisë së fundit gjatë kësaj periudhe, koston e blerjes së energjisë për tetëmuajorin e vitit 2024 dhe parashikimin për të gjithë vitin për klientët tariforë në nivelin e tensionit 0.4 kV dhe klientët në kushtet e mundësisë së fundit. FSHU sh.a. ka deklaruar se planifikimi i treguesve për vitin 2025 do të dërgohet sapo të jetë gati, por deri më tani nuk ka informacion shtesë. Po ashtu, është dorëzuar lista e çmimeve të përdorura për çdo kategori të klientëve të furnizuar, si në kushtet e shërbimit universal ashtu edhe në kushtet e mundësisë së fundit (në 35 kV dhe 20/10/6 kV), si dhe parashikimi i sasisë së energjisë elektrike të furnizuar për periudhën janar–gusht 2024 dhe për periudhën shtator–dhjetor 2024.

- Planifikimi i treguesve tekniko-financiarë për vitin 2025 është ende në proces. Parashikimet financiare për aktivitetin e shërbimit universal dhe Furnizuesin e Mundësisë së Fundit do të dërgohen sapo të përfundojnë.

- ERE, me shkresën nr. 2394 prot., datë 13.11.2024, bazuar në VKM nr. 456/2022, të ndryshuar, dhe në kuadër të vlerësimit të mjaftueshmërisë së të ardhurave të Furnizuesit të Shërbimit Universal, i ka kërkuar shoqërisë KESH sh.a. të informojë mbi çmimin e parashikuar të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a. për vitin 2025, si dhe mbi vendimmarrjen përkatëse të Asamblesë së Aksionarëve. Deri më tani nuk është marrë asnjë përgjigje nga KESH sh.a.

- FSHU sh.a., me shkresën nr. 7387 prot., datë 3.12.2024 (protokolluar në ERE me nr. 2549 prot., datë 16.12.2024), ka kërkuar hapjen e procedurës për rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2025. Në përgjigje, ERE, me shkresën nr. 2549/1 prot., datë 17.12.2024, i sqaroi shoqërisë FSHU sh.a., se për të vlerësuar çmimin e energjisë për vitin 2025, është e nevojshme depozitimi i dokumentacionit të kërkuar më herët nga ERE me shkresën nr. 1946, datë 19.9.2024, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

- Në vijim, FSHU sh.a., me shkresën nr. 7387/2 prot., datë 24.12.2024 (protokolluar në ERE me nr. 2549/2 prot., datë 26.12.2024), dërgoi një vlerësim të performancës për periudhën janar–nëntor 2024, së bashku me parashikimet për vitin 2025.

- Me korrespondencën e sipërcituar, FSHU sh.a. shton, gjithashtu: “... Duke pasur parasysh që ende nuk kemi një vlerësim përfundimtar të çmimit të shitjes që do të aplikohet nga KESH sh.a. për vitin e ardhshëm 2025, kërkojmë që edhe për muajin janar



2025 të mos bëhet rivlerësimi i kostove në përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët e shërbimit universal.”

- Referuar të dhënave financiare për periudhën janar–nëntor 2024, të raportuara në korrespondencën përkatëse, rezulton se të ardhurat nga shitja e energjisë për klientët e shërbimit universal kanë mbuluar kostot e aktivitetit të FSHU sh.a., duke garantuar një funksionim normal operacional. Shoqëria ka bërë të ditur se deri më tani nuk ka marrë nga KESH sh.a. të dhëna mbi çmimin me të cilin kjo e fundit do të tregtojë energjinë për vitin 2025, siç kërkohet nga VKM nr. 456/2022, i ndryshuar. Sipas kësaj VKM-je, KESH sh.a., si shoqëri publike me detyrim shërbimi publik, është e ngarkuar të furnizojë FSHU sh.a. me të gjithë sasinë e nevojshme për klientët e shërbimit universal. ERE, me shkresën nr. 2394 prot., datë 13.11.2024, kërkoi nga KESH sh.a. informacion mbi çmimin e parashikuar për vitin 2025 për mbulimin e kërkesës së FSHU sh.a. Deri më sot, KESH sh.a. nuk ka dorëzuar informacion mbi këtë çështje.

- Duke pasur parasysh sa më sipër dhe rrethanat në të cilat FSHU sh.a. ende nuk është në gjendje të parashikojë kostot e blerjes së energjisë për vitin 2025 për të mbuluar kërkesën e klientëve që furnizohen në kushtet e shërbimit universal, konsiderojmë të domosdoshme:

- Zgjatjen e fuqisë juridike të vendimit të Bordit të ERE nr. 74/2022 deri më 31.1.2025, ose deri në paraqitjen nga FSHU sh.a. të kërkesës për rivlerësimin e kostove që përcaktojnë çmimin e shitjes me pakicë për klientët e shërbimit universal.

- Zgjatjen e fuqisë juridike të vendimit të Bordit të ERE nr. 72/2024 deri më 31.1.2025, ose deri në paraqitjen nga FSHU sh.a. të kërkesës për rivlerësimin e kostove që përcaktojnë çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët e kategorisë “Furra buke/prodhim mielli”, të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjatet fuqia juridike e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, deri më 31.1.2025, për çmimet me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.

2. Të zgjatet fuqia juridike e vendimit nr. 72, datë 15.4.2024, deri më 31.1.2025, për çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët e kategorisë “Furra buke/prodhim mielli”, të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV.

3. Në rast se do të rezultojnë efekte mbi ose nën të ardhurat e lejuara, korrigjimi dhe kompensimi përkatës do të kryhet në përputhje me përcaktimet e nenit 20, germa “c” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe metodologjive përkatëse të miratuara nga ERE.

4. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë FSHU sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 299, datë 30.12.2024

MBI MIRATIMIN E LISTËS SË TARIFAVE TË ALPEX-it PËR TREGUN BRENDA TË NJËJTËS DITË DHE TREGUT TË DITËS NË AVANCË

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të pikës 3.5, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar; të Kushteve të Përgjithshme, seksionit B.4.5.6. të “Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX-it, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, të ndryshuar; të nenit 3, pika 8, të “Rregullores së kërkesave dhe



procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 6.3.2020; të neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”, të datës 21.10.2021, nënshkruar nga Enti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë (ERE), Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST sh.a.) dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT sh.a.); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2583/4 prot., datë 30.12.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi miratimin e listës së tarifave për tregun brenda të njëjtës ditë dhe tregut të ditës në avancë”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 286, datë 20.12.2024, miratoi “Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, e cila rregullon parimet dhe rregullat për tarifat e Tregut të Ditës në Avancë dhe Tregut Brenda Ditës.

- ALPEX sh.a., me shkresën nr. 380/2 prot., datë 23.12.2024 (protokolluar në ERE më 24.12.2024), kërkoi miratimin e ndryshimeve në Listën e Tarifave për Tregun e Ditës në Avancë (DAM). Propozimi përfshinte ndryshimin e 5 tarifave ekzistuese dhe shtimin e një tarife të re, duke u bazuar në faktorë të rinj që ndikuan në parashikimet fillestare krahas realizimeve faktike. Në përgatitjen e buxhetit për vitin 2023, ALPEX-i mbështeti llogaritjen e të ardhurave në dy burime kryesore: tarifat fikse, që lidhen me anëtarësimin si anëtar burse ose klerimi, dhe tarifat variabël, të bazuara në volumet e tregtuara. Shoqëria kishte parashikuar që operimi i Tregut të Ditës në Avancë për Shqipërinë të niste në tremujorin e parë të 2023-shit, ndërsa për Kosovën dhe bashkimin e tregjeve në tremujorin e dytë të 2023-shit. Operimi i Tregut Brenda Ditës për Shqipërinë dhe bashkimi me Kosovën ishin planifikuar për tremujorin e tretë të 2024-s.

- ALPEX sh.a., bazuar në udhërrëfyesin e MIE-

s, të miratuar me urdhrin nr. 28, datë 18.1.2021, për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë, kreu në fund të vitit 2022 parashikimet për volumet e tregtimit në tregjet e saj. Këto parashikime u përfshinë në buxhetin e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Mbikëqyrës për vitin 2023.

- Shoqëria ka propozuar një tarifë të re, të quajtur Tarifa Teknike, e cila do të aplikohet çdo vit për anëtarët e bursës, duke mbuluar kostot e mbështetjes teknike të ofruara nga ALPEX-i. Për vitin e parë, kjo tarifë do të paguhet proporcionalisht nga data e anëtarësimit deri në fund të vitit, ndërsa në vitet pasuese do të paguhet në janar të çdo viti kalendarik. Tarifa nuk do të rimbursohet në rast të dorëheqjes ose përfundimit të marrëveshjes me anëtarët.

- Shoqëria ka bazuar kërkesën për ndryshimet në Listën e Tarifave të ALPEX-it në argumente, sqarime dhe krahasime me praktikën e ngjashme, në përputhje me dispozitat përkatëse. Viti 2025 do të shërbejë si vit testimi, ku të ardhurat dhe kostot e realizuara nga aktiviteti i Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) do të përdoren si bazë për përcaktimin e të ardhurave të lejuara për vitin 2026, sipas metodologjisë së miratuar.

- Shoqëria ka vlerësuar të ardhurat e realizuara krahasuar me parashikimet për periudhat 2023–2024, duke konstatuar se ato kanë qenë më të ulëta për shkak të volumeve të pakta të tregtuara në bursë. Një tjetër faktor që ka ndikuar negativisht është ulja e vazhdueshme e kursit të këmbimit, e cila ka sjellë një reduktim prej mbi 10% në buxhetin e shoqërisë.

- Shoqëria parashikon një rritje të shpenzimeve operative, duke përfshirë kostot për personelin, shërbimet e platformave dhe integritet të tregjeve. Rritja e tarifave të propozuara dhe shtimi i një tarife të re janë të lidhura me faktorë si rritja e shpenzimeve operative, volumet e ulëta të energjisë së tregtuar dhe ulja e vazhdueshme e kursit të këmbimit. Kjo kërkesë është mbështetur edhe në praktikën e bursave rajonale, të cilat kanë rritur tarifat e tyre për të përballuar sfida të ngjashme. Për të vlerësuar drejtësinë dhe transparencën e propozimit të ALPEX-it për tarifat e vitit 2025, janë shqyrtuar tarifat aktuale dhe ato të propozuara, krahasuar me tarifat e bursave rajonale. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat përkatëse.

- Vlerësimet tregojnë se argumentet e ALPEX sh.a. për tarifat e propozuara janë në përputhje me pikën 2, nenin 14, të “Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të



Energjisë Elektrike” miratuar me vendimin nr. 286, datë 20.12.2024, nga Bordi i ERE-s. Propozimet bazohen në analogji me strukturat e tarifave të bursave rajonale dhe marrin parasysh situatën financiare të shoqërisë, duke siguruar që tarifat për vitin 2025 të mbulojnë kostot e aktivitetit operacional.

- Tarifat e ALPEX-it për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë, të miratuara dhe ndryshuara me vendimet përkatëse të Bordit të ERE-s, si dhe Lista e Tarifave të NEMO-s, të vlefshme deri më 31.12.2024, vlerësojmë të mbeten të pandryshuara dhe të zbatueshme edhe gjatë vitit 2025, pasi nuk janë objekt ndryshimi sipas kërkesës së ALPEX-it.

- Në përfundim, pavarësisht ndryshimeve që mund të ndodhin si rezultat i realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të aktivitetit të NEMO-s nga ALPEX-i, dhe në përputhje me pikën 6.9, të shtojcës III të metodologjisë përkatëse, të ardhurat e realizuara nga tarifat NEMO, që janë mbi ose nën ato të lejuara, do të korrigjohen gjatë periudhës rregullatore pasardhëse, në kuadër të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifave të NEMO-s për periudhën e ardhshme rregullatore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e Listës së Tarifave të ALPEX sh.a., të cilat do të jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitin 2025.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojnë shoqërinë ALPEX sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Tabela 1. Lista e tarifave të ALPEX-it, të cilat do të jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), për Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun e Ditës së Njëjtë, për vitin 2025.

Lista e Tarifave të ALPEX	Pagesa e Tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Administrative	Një herë	200 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	Vjetore	10,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun e Ditës në Avancë	Vjetore	14,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	7,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	Vjetore	3,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun e Ditës në Avancë	Ditore	0.09 €/MWh	Anëtari i Klerimit
Tarifa Teknike	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	6,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh	Transaksion	0.02 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Tregtimit në emër të dikujt tjetër	Urdhërporosi	20 €	Anëtari i Bursës
Tarifa për API përdorues	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Bursës
Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin personal të Klerimit	Mujore	100 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa e Administrimit të Letër Garancisë Bankare	Kur depozitohet	50 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore e Trajnimit	Vjetore	200 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Tarifa e Provimit	Vjetore	100 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Certifikata digjitale për Përdorues	Vjetore	50 €	Anëtari i Bursës/Anëtari i
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Vjetore	8,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.14 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.04 €	Anëtari i Bursës

• Për tregun e Shqipërisë, të gjitha tarifat do të shlyhen në monedhën euro për jorezidentët.

• Për tregun e Shqipërisë, të gjitha tarifat fikse do të shlyhen në monedhën lekë, ekuivalent të referencës së përcaktuar në monedhën euro, për rezidentët.

• Mbi tarifat do të aplikohet TVSH-ja.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 848 lekë

